



POLITIKA E DËNIMEVE NË KOSOVË

(Analizë e zbatimit të Udhëzuesit për Politikë
Ndëshkimore nga Gjykatat e Republikës së Kosovës)

Autor: Gzim Shala

Me kontribut të veçantë të hulumtuesve: Gzime Hashani, Lavdim Bajraktari dhe Mirvet
Thaqi dhe të gjithë monitoruesve dhe hulumtuesve të IKD-së

Ekipi i Redaktorëve: Ehat Miftaraj, Betim Musliu dhe Yll Zekaj

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë
elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të
Kosovës për Drejtësi.

*Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi -
IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve
të Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan dhe NED-it.*

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është
organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse
e politikave publike, fabrikë e mendimeve
e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Rrustem Statovci

Prishtinë

E: info@kli-ks.org

www.kli-ks.org

Përkrahur nga:



**National Endowment
for Democracy**
Supporting freedom around the world

Nëntor 2019

Prishtinë, Republika e Kosovës

Përmbajtja

I.	Përmbledhje ekzekutive	6
II.	Hyrje.....	9
III.	Udhëzuesi për politikë ndëshkimore	11
IV.	Metodologjia	13
V.	Politika ndëshkimore në Kosovë.....	16
a.	Hyrje.....	16
b.	Të gjeturat e përgjithshme.....	17
VI.	Politika ndëshkimore në rastet e korrupsionit	33
a.	Hyrje.....	33
b.	Gjetjet e përgjithshme	33
c.	Analiza e veçantë e rasteve të korrupsionit	46
VII.	Politika ndëshkimore në rastet e vrasjeve	105
a.	Hyrje.....	105
b.	Gjetjet e përgjithshme	105
c.	Analiza e veçantë e rasteve të vrasjeve	117
VIII.	Politika ndëshkimore në rastet e terrorizmit.....	145
a.	Hyrje.....	145
b.	Gjetjet e përgjithshme	145
c.	Analiza e veçantë e rasteve të terrorizmit.....	154
IX.	Politika ndëshkimore në rastet e veprave penale të armëve.....	168
a.	Hyrje.....	168
b.	Gjetjet e përgjithshme	168
c.	Analiza e veçantë e rasteve të veprave penale të armëve.....	177
X.	Politika ndëshkimore në rastet e veprave penale të gjykuara në Departamentin e Përgjithshëm.....	192
a.	Hyrje	192
b.	Gjetjet e përgjithshme	192
c.	Analizë e veçantë e rasteve të veprave penale të gjykuara në Departamentin e Përgjithshëm.....	205
XI.	Politika ndëshkimore në Gjykatën e Apelit	247
XII.	Rekomandime	249

Shkurtesat

AKF	Agjencia e Kosovës për Forenzikë
DBZHR	Drejtorinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
FAK	Federatën e Atletikës së Kosovës
IKD	Instituti i Kosovës për Drejtësi
KEDS	Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KPRK	Kodi Penal i Republikës së Kosovës
KRU	Kompaninë Rajonale e Ujësjetësimit
LBTS	Ligjit mbi bazat e sigurisë së trafikut.
MASHT	Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
MKRS	Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
Udhëzuesi	Udhëzuesi për Politikën Ndëshkimore

I. Përmbledhje ekzekutive

Politika ndëshkimore në Kosovë për një kohë të gjatë është objekt i kritikave të ndryshme si nga ana e organizatave jo-qeveritare që e monitorojnë sistemin e drejtësisë, ashtu dhe nga partnerët ndërkombëtarë që monitorojnë dhe mbështesin sistemin e drejtësisë në Kosovë. Sikurse, nuk janë raste të rralla kur edhe vet krerët e sistemit gjyqësor dhe prokurorial në publik kritikojnë praktikën e ndërtuar nga sistemi gjyqësor lidhur me politikën ndëshkimore.

Për të adresuar mungesën e një qasje të uniformuar të politikës ndëshkimore dhe zbatimit të drejtë të dispozitave të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale, pikë kthese ka qenë iniciativa e Ambasadës Amerikane lidhur me miratimin e Udhëzuesit për Politikën Ndëshkimore në Kosovë (tutje: udhëzuesi), nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës. Ky udhëzues është nxjerrë nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës më 15 shkurt 2018 në mbledhjen e përgjithshme të kësaj Gjykate.

Ky udhëzues nga akterët e ndryshëm brenda sistemit të drejtësisë u cilësua si pikë kthese sa i përket unifikimit të politikës ndëshkimore në sistemin gjyqësor të Republikës së Kosovës, e veçanërisht sa i përket dallimit të madh të llojit dhe lartësisë së dënimeve në rastet e ngjashme.

Por, për të vlerësuar zbatimin e këtij udhëzuesi në praktikë nga ana e gjykatave në Kosovë, përkritazi me politikën ndëshkimore, afërsisht 21 muaj nga miratimi i tij, IKD sjellë një raport të detajuar, lidhur me qasjen e gjykatave në zbatimin praktik të tij. IKD për të pasur një pasqyrë të drejtë lidhur me zbatimin e udhëzuesit në praktikë ka përdorur metodologjinë e ndërtuar nga Gjykata Supreme në vet udhëzuesin.

Në 73 aktgjykimet e analizuara të cilat hyjnë në kategori të ndryshme të veprave penale në të cilat gjykatat kanë vendosur me aktgjykime denuese, IKD ka gjetur se edhe udhëzuesi ka pasur fatin e njëjtë sikurse edhe shumë politika dhe dokumente të tjera të miratuara, në kuptimin që i njëjti nuk ka gjetur zbatim në praktikë, por ka mbetur një politikë dhe dokument në letër.

Fillimisht, të dhënat e hulumtuara dhe analizuara në këtë raport tregojnë dy dukuri. E para është se në sistemin gjyqësor të Republikës së Kosovës nuk kemi të bëjmë me një praktikë të uniformuar në parim, e cila më pastaj do të konkretizohej varësisht prej specifikave të një rasti. Dhe e dyta se asnjë pjesë e udhëzuesit nuk është zbatuar në nivel të kënaqshëm, që ndryshe mund të përkthehet se udhëzuesi është pothuajse i pazbatuar në praktikë.

Tutje, në aktgjykimet e analizuara shihet se nuk ka një konsistencë të arsyetimit, në atë mënyrë që sipas përcaktimeve tejet praktike të udhëzuesit, gjykata të vije deri tek një përfundim, në mënyrë që dënimi të jetë i arsyetuar.

Në mënyrën se si janë arsyetuar aktgjykimet në pjesën e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, përpos mos zbatueshmërisë së kërkesave të udhëzuesit, IKD gjenë se tanimë gjykatat kanë ndërtuar disa shabllone të arsyetimit, të cilat i aplikojnë në shumicën e aktgjykimeve, pa iu përshtatur specifikave të secilit rast. Kjo e gjetur e rrëzon arsyetimin e akterëve brenda

sistemit të drejtësisë së laramanitë në politikën ndëshkimore ekzistojnë për shkak se secili rast është specifik, pasi në shabllonet e krijuara nuk kanë ndikuar specifikat e rasteve, por vetë qasja e gjyqtarëve.

Për shkak të mënyrës së tillë të qasjes së gjyqtarëve, në aktgjykimet e analizuara është vërejtur se rrethanat lehtësuese dhe rënduese në shumicën dërrmuese të rasteve nuk zbatohen në përputhje me kërkesat e udhëzuesit dhe se ka një numër të madh të rrethanave të injoruara, të cilat gjykatat nuk i kanë aplikuar si dhe për të njëjtat nuk kanë dhënë arsyetim se pse nuk paraqesin rrethana lehtësuese apo rënduese në rastin konkret. Po ashtu, në secilën kategori është shumë e shprehur dukuria e asaj që sipas udhëzuesit cilësohet si “*dyfishim i rrethanave*”. Tutje, në aktgjykimet e analizuara, shihet se çështja e vlerësimit të brendshëm të rrethanave rënduese dhe lehtësuese si dhe peshimi i tyre, janë çështje plotësisht të vdekura në praktikë. Sipas udhëzuesit, këto dy çështje janë prej çështjeve kryesore në politikën e dënimeve. Në anën tjetër, disa prej përcaktimeve të udhëzuesit janë pothuajse fare të pazbatuara, të pa trajtuara dhe të pa përmendura në aktgjykimet e analizuara. Nëse kjo dukuri është pothuajse në të gjitha aktgjykimet e analizuara, atëherë përkthimi i saj është se për një pjesë të madhe të udhëzuesit, gjyqtarët nuk janë fare të informuar, nuk janë të interesuar apo nuk kanë njohuri të mjaftueshme për t’i kuptuar ato si duhet.

Fatkeqësisht, përpos arsytimit, shabllone kemi edhe tek dënimi i shqiptuar, dhe veçanërisht tek pjesa e korrupsionit. Kjo për arsye se nga 34 dënime me burgim efektiv dhe me kusht në rastet e korrupsionit, plotë 23 prej tyre janë dënime me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë muajve.

Sa i përket vëllimit të arsytimit të aktgjyqimeve në pjesën e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykatat në shumicën dërrmuese të rasteve nuk japin arsytimin e duhur. Në këtë rast, me arsytim të duhur nënkuptojmë nivelin e arsytimit sipas të cilit palët dhe publiku mund të binden se pse në rastin konkret është shqiptuar një dënim i caktuar. Sa i përket rrethanave të aplikuara, rrethanat lehtësuese të aplikuara janë në disproporcion total me ato rënduese. Në të gjitha aktgjykimet e analizuara, IKD ka gjetur se gjykatat kanë aplikuar 235 rrethana lehtësuese dhe vetëm 75 rrethana rënduese. Për më tepër, IKD ka gjetur se në gjithsej 32 raste, Gjykatat nuk kanë aplikuar asnjë rrethanë rënduese. Dukuria e thjesht citimit të rrethanave është e shprehur jashtëzakonisht shumë në të gjitha kategoritë.

Sa i përket qëllimeve të dënimit, IKD fillimisht gjenë se për një numër të caktuar të qëllimeve të përcaktuara në udhëzues, gjykatat nuk janë fare në dijeni, pasi të njëjtat as nuk i citojnë në aktgjykimet e tyre. Në anën tjetër, mënyra se si këto qëllime aplikohen është në kundërshtim të plotë me udhëzuesin, pasi arrijen e qëllimeve të dënimit me shqiptimin e një dënimi të caktuar, gjykatat e marrin si fakt të mirëqenë, dhe fare nuk e arsyetojnë mënyrën se si do të arrihen këto qëllime të dënimit.

Parimet e dënimit të përcaktuara në udhëzues, në praktikë janë pothuajse të vdekura.

Sa i përket ashpërsisë së dënimeve, gjetjet tregojnë se nga të gjitha kategoritë që janë analizuar në këtë kapitull, politika më e butë ndëshkimore është tek rastet e korrupsionit.

Madje, dënimet në rastet e korrupsionit kanë qenë më të buta se sa në rastet të cilat gjykohen në Departament të Përgjithshëm. Nga totali i dënimeve të shqiptuara në aktgjykimet e analizuara në këtë raport nga kapitulli i korrupsionit, gjykatat kanë shqiptuar gjithsej 14 aktgjykime me burgim efektiv. Por, prej këtyre 14 dënimeve me burgim efektiv, gjykatat 9 prej tyre i kanë shndërruar në dënim me gjobë, që nënkupton se kemi vetëm 5 aktgjykime me burgim efektiv, derisa 9 të tilla janë identifikuar në kapitullin e veprave penale të cilat gjykohen në Departamentin e Përgjithshëm.

Përpos kësaj, e dhëna tjetër që flet për mos ashpërsinë e sistemit të drejtësisë në rastet e korrupsionit është se nga 25 aktgjykimet e analizuara, gjykatat në vetëm një rast kanë shqiptuar edhe dënim plotësues, ndërsa këtë nuk e kanë bërë në plotë 24 aktgjykime të tjera.

II. Hyrje

Politika ndëshkimore në Kosovë për një kohë të gjatë ka qenë objekt i kritikave të ndryshme mediale. E gjithë kjo kritikë pothuajse është bërë për raste të caktuara për të cilat mediat kanë pasur një interesim më specifik. Dallimet prej rastit në rast lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit kanë qenë objekti kryesor i kritikave.

Por, për të gjitha rastet e paraqitura në media, askush nga akterët brenda sistemit të drejtësisë nuk ka dhënë asnjë arsytim, nën pretekstin se secili gjyqtar ka pavarësinë e vet për vendosje në një rast, e cila përfshinë edhe pavarësinë e tij për vendosje lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit.

Në anën tjetër, ndonëse Komisioni për Vlerësim të Performancës në KGJK analizon aktgjykimet e gjyqtarëve, të cilat aktgjykime zgjedhën sipas metodës rastësore, deri më tani KGJK nuk ka njoftuar nëse ndonjërit prej gjyqtarëve brenda sistemit gjyqësor të Republikës së Kosovës i është shqiptuar ndonjë masë për ndonjë prej arsyeve që ndërlidhen me politikën ndëshkimore brenda sistemit gjyqësor të Republikës së Kosovës.

Në këtë drejtim politika ndëshkimore në Republikën e Kosovës nuk ka pasur një konsistencë. Por, në anën tjetër, në mungesë të një pike relevante, edhe vetë kritika ndaj politikës ndëshkimore ka qenë jo konsistente.

Për të adresuar të gjitha këto probleme, pikë kthese ka qenë miratimi i Udhëzuesit për Politikën Ndëshkimore në Kosovë (tutje: udhëzuesi), nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës. Ky udhëzues është nxjerrë nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës më 15 shkurt 2018 në mbledhjen e përgjithshme të kësaj Gjykate. Këtë udhëzues Gjykata Supreme e ka nxjerrë duke u bazuar në nenin 22 dhe 23 të Ligjit nr. 03/L-199 për Gjykatat. Udhëzuesi në këtë mbledhje ishte miratuar me shumicë votash.

Tutje, miratimi i udhëzuesit nga akterët e ndryshëm brenda sistemit të drejtësisë u cilësua si pikë kthese sa i përket politikës ndëshkimore në sistemin gjyqësor të Republikës së Kosovës, e veçanërisht sa i përket dallimit të madh të llojit dhe lartësisë së dënimeve në rastet e ngjashme.

Sa i përket këtij udhëzuesi, miratimi i tij është përkrahur dhe vazhdon të përkrahet edhe nga IKD.

Por, për të vlerësuar nëse ky udhëzues paraqet realisht kthesën e sistemit gjyqësor përkitazi me politikën ndëshkimore, sot pas mbi 16 muajve nga miratimi i udhëzuesit, IKD sjellë një raport të detajuar, nëse ky udhëzues paraqet edhe një politikë të re në letër, apo një zbatim praktik të tij në aktgjykimet e gjykatave.

Në këtë raport, IKD ka analizuar deri në detaje zbatimin e këtij udhëzuesi në gjithsej 73 aktgjykime. Këto aktgjykime janë të ndara në kategori, ku një pjesë e tyre është nga kategoria e veprave penale që hyjnë në kapitullin e korrupsionit, veprave penale të vrasjes, veprave

penale të terrorizmit, trafikimit me armë, veprave penale të gjykuara në departamentin e përgjithshëm dhe aktgjykimet e Gjykatës së Apelit.

Për të vlerësuar sa më drejtë zbatimin e udhëzuesit në këto raste, IKD ka ndërtuar metodologji të veçantë, e cila metodologji është në përputhje të plotë me vetë metodologjinë e ndërtuar nga udhëzuesi.

III. Udhëzuesi për politikë ndëshkimore

Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës gjatë vitit 2018, ka miratuar Udhëzuesin e Politikës Ndëshkimore.¹ Sipas Gjykatës Supreme qëllimi i këtij udhëzuesi është të ofrojë pikëpamje të zgjeruar të ligjeve aktuale të dënimeve, të trajtojë problemet të cilat përmenden shpeshherë dhe të ofrojë një qasje uniforme. Edhe përkundër faktit se ky Udhëzues nuk është ligjerisht i detyrueshëm, i njëjti sipas Gjykatës Supreme, parimet dhe standardet e propozuara paraqesin mjete të dobishme për gjykatën në vlerësimin e një sërë rrethanash individuale të të pandehurve si dhe një kornizë për vlerësimin e vendimit mbi dënimin.

Udhëzuesi, është si një udhërrëfyes për qasjen, një metodë për të trajtuar në mënyrë gjithëpërfshirëse dispozitat përkatëse të Kodit, dhe një format të sugjeruar për mbledhjen e provave për caktimin e dënimit dhe përpilimin e opinioneve. Ato gjithashtu ofrojnë një listë indikative të rrethanave që duhet të shfrytëzohen nga gjyqtarët për zbutjen dhe ashpërsimin e dënimit; së bashku me një shtjellim të peshës që rrethanat e tilla do duhej të kishin në dënimin përfundimtar. Nëse ndiqen, këto udhëzime jo vetëm që mund të përmirësojnë profesionalizmin e gjykatave, por ato do të përmirësojnë edhe respektimin e të drejtave të njeriut në gjykatat e Kosovës në përgjithësi.²

Ky udhëzues citon autorin Gabriel Hallevy, sipas të cilat “vendimet e ndryshme nga gjykatat në raste të ngjashme shpien në një kulturë shoqërore ku zbatimi i ligjit de jure dallon nga zbatimi de facto. Kur një panel gjykues është jashtëzakonisht i butë me kryerësit, ndërsa paneli tjetër shqipton dënime të ashpra në këtë mekanizëm, i cili parandalon kryerësit nga përsëritja e veprës, identiteti i panelit bëhet faktor dhe kryerësit do të bëjnë përpjekje për t'u gjykuar nga njëri panel e jo nga tjetri”.

Po ashtu, në udhëzues citohet edhe një aktgjykim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës i cili kishte përcaktuar se mos konsistenca e vendimmarrjes paraqet shkelje të KEDNJ, ku shprehimisht thuhet se: *“Vendimmarrja nga gjykatat e rregullta në çështje ligjore që janë tërësisht të njëjta dhe mos mundësia dhe mos dëshira për ta krijuar një praktikë gjyqësore konsistente cenon rëndë parimin e sigurisë juridike si një nga parimet bazë të sundimit të së drejtës, prandaj, nuk ka dyshim që vendimmarrja në këto rrethana përbën shkelje të nenit 6 të KEDNJ dhe nenit 31 të Kushtetutës (shih: Rasti Beian kundër Rumanisë, 30658/05, 2007, GJEDNJ)”.*

Sipas udhëzuesit, një problem tjetër ka të bëjë me dështimin e gjykatave që të përshkruajnë në mënyrë adekuate arsyet për shqiptimin e dënimit të caktuar. Kjo përfshin si procesin e ndjekur nga gjykata ashtu edhe arsyetimin lidhur me gjetjen apo ekzistimin e rrethanës së caktuar lehtësuese apo rënduese. Siç theksohet nga Këshilli i Evropës, "gjykatat duhet në përgjithësi, të cekin arsye konkrete për shqiptimin e dënimeve".

¹ Udhëzues për Politikën Ndëshkimore, Gjykata Supreme e Kosovës, 2018, i qasshëm në: http://www.oak-ks.org/repository/docs/Udhezues_per_Politiken_Ndeshkimore_Shkurt_2018_346913.pdf

² Udhëzues për Politikën Ndëshkimore, Gjykata Supreme e Kosovës, 2018, i qasshëm në: http://www.oak-ks.org/repository/docs/Udhezues_per_Politiken_Ndeshkimore_Shkurt_2018_346913.pdf

Vetë udhëzuesi e pranon se praktikat aktuale të dënimeve gjithashtu sjellin deri tek ulja e transparencës, cenojnë parimin e legalitetit dhe kontribuojnë në masë të madhe në opinionin negativ për gjyqësorin. Që të tre këta faktorë e zbehin edhe më tej sundimin e ligjit.

Për të adresuar këto probleme, udhëzuesi ka dhënë sqarime të hollësishme për gjithë procedurën që duhet ndjekur gjykata me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, ndjekja e së cilës procedura edhe do të rregullonte problemet e identifikuara në politikën ndëshkimore.

Në këtë frymë, fillimisht udhëzuesi ka sqaruar aspektet procedurale të Politikës Ndëshkimore. Më pastaj, ky udhëzues ka trajtuar parimet relevante të caktimit të dënimit, ku janë sqaruar llojet e dënimeve, qëllimet e dënimit si dhe parimet e dënimit.

Tutje, udhëzuesi në dy kapituj të ndara dhe voluminoz, që përbëjnë edhe boshtin e këtij dokumenti, ka sqaruar në detaje rrethanat lehtësuese dhe rënduese, ku të njëjtat edhe i ka kategorizuar në kategori të ndryshme. Në këtë drejtim, udhëzuesi është jashtëzakonisht konkret dhe detal, në atë mënyrë që për secilën rrethanë sqaron kuptimin e asaj rrethane, faktorët që duhet të merren parasysh me rastin e aplikimi të së njëjtës si dhe pyetjet relevante të cilave gjykata duhet tu japë përgjigje me rastin e aplikimit të kësaj rrethane. Përkitazi me rrethanat, udhëzuesi jep edhe sqarime të detajuara se si përcakton rëndësia e brendshme e rrethanave rënduese dhe lehtësuese, si dhe si bëhet peshimi i këtyre dy lloj rrethanave. Po ashtu, udhëzuesi ofron edhe udhëzime konkrete se si gjykatat duhet t'i shmangen dyfishimit të rrethanave, në kuptim që ajo që nuk paraqet rrethanë në një rast mos të përdoret si dhe mos të përdoren rrethanat e njëjta brenda një aktgjykimi.

Pas kësaj, udhëzuesi përmban edhe kapitullin “*zbatimi i udhëzuesit në praktikë*”, ku udhëzon gjykatën se si duhet të veprojë në secilin rast, duke dhënë edhe sqarime të detajuara mbi akordimin e dënimeve.

Udhëzuesi trajton edhe zbatimin e dënimeve alternative, dënimet plotësuese, praktikat alternative dhe shqyrtimi i rasteve nga apeli.

Sipas udhëzuesit, dhënia e arsytimit adekuat për dënimin përfundimtar është e rëndësishë parësore.

Krejt në fund, udhëzuesi përmban edhe shtojcën 1, përkatësisht tabelën për matjen e dënimit. Në këtë tabelë, përcaktohen standarde për secilin rast se cilat janë limitet e dënimit në të cilat duhet të lëvizë gjykata me rastin e shqiptimit të një dënimi. Se në cilën kolonë duhet të kategorizohet një rast, udhëzuesi jep sqarime të detajuara në kapitullin “*zbatimi i udhëzuesit në praktikë*”.

IV. Metodologjia

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka hyrë në vitin e gjashtë të monitorimit sistematik të sistemit të drejtësisë në trajtimin e rasteve të korrupsionit. IKD ka monitorues në të gjitha gjykatat, degët e gjykatave dhe prokuroritë e Republikës së Kosovës, të cilët monitorojnë me fokus të veçantë trajtimin e rasteve të korrupsionit, rastet e tjera penale, rastet civile, administrative dhe ekonomike. Krahas këtij obligimi, monitoruesit e IKD-së janë të fokusuar në zbatimin e obligimeve ligjore nga ana e bartësve të funksioneve gjyqësore dhe prokuroriale si dhe stafit mbështetës. Monitorimi fokusohet në baza ditore tek performanca e gjykatave dhe prokurorive në zbatimin e ligjit, politikave dhe planeve të veprimit të cilat miratohen nga KGJK dhe KPK. Të gjitha gjetjet e monitorimit, grumbullohen në Qendrën e IKD-së në Prishtinë, në të cilën, analistët juridikë të Institutit, zhvillojnë hulumtim ligjor dhe praktik me të dhënat e terrenit. Kjo metodologji e hulumtimit ofron mundësi praktike që të bëhet identifikimi i problemeve dhe të analizohen të gjitha çështjet që janë me interes në shërbim të zbatimit të ligjit.

Ky raport është paraqet zbatimin e udhëzuesit në sistemin gjyqësor të Republikës së Kosovës. Të gjitha aktgjykimet e analizuar janë pas datës 15 shkurt 2018, që korrespondon me datën e miratimit të këtij udhëzuesi.

Sa i përket këtij raporti, IKD ka qenë jashtëzakonisht e kujdesshme që analizimi i aktgjyqimeve mos të paraqesë komentim të aktgjyqimeve të gjykatave. Në këtë mënyrë, e gjithë metodologjia e analizimit të një rasti është bërë sipas përcaktimeve të vetë udhëzuesit.

Ky raport është përpiluar plotësisht sipas metodës së induksionit, përkatësisht është analizuar secili rast veç e veç, pastaj me të dhënat e nxjerra nga këto raste është ndërtuar kapitulli i caktuar, në bazë të cilëve në fund është ndërtuar edhe raporti përfundimtar. Krejt në fund, IKD ka aplikuar edhe metodën deduktive, në atë kuptim që nga të gjeturat e përgjithshme, IKD ka ndërtuar vlerësimet mbi politikën ndëshkimore në Kosovë.

Sa i përket analizimit të rastit, secili rast i analizuar përmban dy pjesë: aktgjykimin i marrë dhe zbatimin e udhëzuesit. Në pjesën e aktgjyqimit të marrë, përshkruhet dispozitivi i aktgjyqimit, dënimi sipas legjislacionit për veprën penale për të cilën personi është dënuar, dënimi i shqiptuar, rrethanat lehtësuese dhe rënduese të aplikuara në rastin konkret si dhe arsyetimin mbi përshtatshmërinë e dënimit. Të gjitha këto janë përshkrim nga aktgjykimet e analizuar. Ndërsa, në pjesën e zbatimit të udhëzuesit analizohet aktgjykimin i marrë nëse është në përputhje me udhëzuesin në pjesën e përshtatshmërisë së dënimit, zbatimit të parimeve, rrethanave lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim, injorimin e rrethanave dhe metoda e udhëzuesit për matjen e dënimeve.

Tek përshtatshmëria e dënimit, IKD ka analizuar nëse gjykata në aktgjykimin i është referuar katër prej qëllimeve të dënimit të cekura në udhëzues. Në këtë pjesë, IKD po ashtu ka analizuar edhe nëse ka arsyetim të gjykatës përkitazi me qëllimet e cituara, përkatësisht nëse ka arsyetim lidhur me ndërlidhjen e dënimit të shqiptuar me arritjen e qëllimit të dënimit. Tek zbatimin e parimeve, sipas udhëzuesit, parimet e dënimit duhet të shërbejnë si orientim me

rastin e caktimit të dënimit, dhe pastaj të njëjtat parime duhet të arsyetohen me rrethana të veçanta lehtësuese apo rënduese. Në këtë frymë, IKD ka analizuar këto aktgjykime, nëse është zbatuar kjo mënyrë e arsyetimit në aktgjykimet e gjykatës.

Sa i përket rrethanave lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim. IKD ka analizuar secilën rrethanë të përdorur në raport me udhëzuesin. Udhëzuesi për secilën rrethanë përcakton kuptimin e asaj rrethane, faktorët që duhet të merren parasysh me rastin e aplikimit të një rrethane si dhe pyetjet relevante të cilave gjykata duhet tu japë përgjigje. Të gjitha këto aspekte janë analizuar në secilin aktgjykim, duke krahasuar rrethanat e cekura në aktgjykime me përcaktimet e udhëzuesit.

Sa i përket rrethanave të injoruara në një aktgjykim konkret, IKD i është shmangur asaj se çfarë në rastin konkret gjykata është dashur të marrë si rrethanë lehtësuese dhe rënduese. Si matës i vlerësimit nëse një rrethanë është injoruar ose jo nga gjykata në një aktgjykim është ajo që a e ka aplikuar gjykata një rrethanë të caktuar apo jo, dhe nëse jo, a ka dhënë gjykata arsyetim se pse një rrethanë e caktuar në rastin konkret nuk mund të shërbejë si rrethanë lehtësuese apo rënduese.

Ndërsa, sa i përket metodës së udhëzuesit për matjen e dënimeve, këtu vlen të përmendet metoda për kualifikimin e një rasti si dhe metoda për përcaktimin e limiteve të dënimeve. Të dyja këto aspekte janë ndërtuar nga vet udhëzuesi. Fillimisht, sa i përket kualifikimit të një rasti në raport me shtojcën 1 të udhëzuesit, IKD fillimisht ka shikuar nëse vetë gjykata ka përcaktuar rëndësinë e brendshme të rrethanave rënduese dhe lehtësuese të rrethanave, si dhe nëse ka baraspeshuar këto rrethana. Nëse jo, IKD ka analizuar vetë rrethanat e cekura në një aktgjykim konkret, dhe pastaj ka analizuar udhëzuesin, përkatësisht kapitullin “*Zbatimi i udhëzuesit në praktikë*”, për të përcaktuar se rasti konkret në cilën kolonë të shtojcës kualifikohet. Pra, IKD i është referuar vetëm rrethanave të cekura në aktgjykim dhe ajo çfarë gjykata është dashur apo nuk është dashur të marrë parasysh, nuk është cilësuar si relevante në këtë raport, dhe e gjithë kjo me qëllimin e shmangies nga komentimi i aktgjykimeve, në mënyrë që raporti të jetë ekskluzivisht vlerësim i zbatimit të udhëzuesit në praktikë. Pas kualifikimit, IKD i është referuar shtojcës 1 të udhëzuesit, e cila përcakton limitet e dënimeve, dhe në bazë të atyre limiteve, ka përcaktuar se dënimi i shqiptuar në një aktgjykim konkret a është apo nuk është brenda këtyre limiteve. Po ashtu, një çështje tjetër që vlen të theksohet në këtë rast është ajo se shtojca 1 e udhëzuesit nuk përcakton kurrfarë limitesh sa i përket dënimit me gjobë. Në këtë drejtim, bazuar në logjikën e njëjtë si është ndërtuar shtojca 1 e udhëzuesit, IKD ka përcaktuar edhe limitet e dënimit me gjobë, dhe me të njëjtat, ka vlerësuar nëse një dënim me gjobë është shqiptuar ose jo brenda këtyre limiteve.

Sa i përket aktgjykimeve të cilat janë marrë në rastet kur ka pasur marrëveshje mbi pranimin e fajësisë, udhëzuesi shprehimisht përcakton se “në mënyrë që të lehtësohet marrëveshja mbi pranimin e fajësisë dhe të shpejtohet procesimi i rastit, gjykatat inkurajohen fuqishëm që t'i refuzojnë marrëveshjet për pranim të fajësisë të cilat janë të papranueshme dhe të lejojnë ri negociimin e tyre në vend se të shqiptojnë dënim jashtë dënimit të propozuar në marrëveshje dhe kështu të shmangin ankesat dhe zgjidhjen e rastit në nivel të shkallës së apeli”. Për këtë arsye, edhe në këto raste, IKD nuk ka analizuar fare marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë por

vetëm aktgjykimin e nxjerrë, përkatësisht pjesën e aktgjykimit që trajton caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit.

Ndërsa, sa i përket Gjykatës së Apelit, udhëzuesi nuk ndërton një metodë të veçantë për rastet në procedurë ankimore në Gjykatën e Apelit, por vetëm flet për parimet nga e cila duhet të udhëhiqet kjo gjykatë me rastin e trajtimit të aktgjykimeve të nxjerra nga gjykatat e shkallës së parë. Për këtë arsye, pjesa për politikën ndëshkimore në Gjykatën e Apelit nuk është e ndërtuar mbi të njëjtën metodologji sikurse tek rastet e aktgjykimeve të nxjerra nga gjykatat e shkallës së parë, por vetëm i trajton në përgjithësi të gjeturat nga 10 rastet e analizuara.

Në fund të këtij raportit, IKD ka paraqitur edhe rekomandimet konkrete përkitazi me të gjeturat e këtij raporti.

V. Politika ndëshkimore në Kosovë

a. Hyrje

Në këtë raport, IKD ka analizuar gjithsej 73 aktgjykime. Prej tyre 25 janë aktgjykime lidhur me veprat penale nga kapitulli i korrupsionit, 10 aktgjykime për veprën penale të vrasjes, nga katër për veprat penale të terrorizmit dhe atyre me armë, 20 aktgjykime për veprat penale të cilat janë gjykuar në departamentin e përgjithshëm dhe 10 aktgjykime të Gjykatës së Apelit.

Në këtë pjesë të raportit, IKD do të paraqesë të gjeturat e përgjithshme për të gjitha kategoritë, ndërsa në pjesën vijuese, secila kategori e aktgjykimeve të analizuar është e ndarë në kapitull të veçantë.

Të gjeturat e përgjithshme të IKD-së tregojnë se udhëzuesi ka mbetur vetëm një dokument në letër, i cili nuk gjen zbatim në praktikë.

Fillimisht, të dhënat e mëposhtme tregojnë dy dukuri. E para është se në sistemin gjyqësor të Republikës së Kosovës nuk kemi të bëjmë me një praktikë të uniformuar në parim, e cila më pastaj do të konkretizohet varësisht prej specifikave të një rasti. E dyta është se asnjë pjesë e udhëzuesit nuk është zbatuar në nivel të kënaqshëm, që ndryshe mund të përkthehet se udhëzuesi është plotësisht i pazbatuar në praktikë.

Tutje, në aktgjykimet e analizuar shihet se nuk ka një konsistencë të arsyetimit, në atë mënyrë që sipas përcaktimeve tejet praktike të udhëzuesit, gjykata të vije deri tek një përfundim, në mënyrë që dënimi të jetë i arsyetuar.

Gjatë analizimit të rasteve në këtë raport, do të vërehet se gjykatat kanë krijuar disa shabllone të cilat i aplikojnë në shumicën e aktgjykimeve, pa iu përshtatur specifikave të secilit rast. Kjo e gjetur e rrëzon arsyetimin e akterëve brenda sistemit të drejtësisë se laramanitë në politikën ndëshkimore ekzistojnë për shkak se secili rast është specifik, pasi në shabllonet e krijuara nuk kanë ndikuar specifikat e rasteve, por vetë qasja e gjyqtarëve.

Për shkak të mënyrës së tillë të qasjes së gjyqtarëve, në aktgjykimet e analizuar është vërejtur një numër i madh i rrethanave të injoruara, të cilat gjykatat nuk i kanë aplikuar si dhe për të njëjtat nuk kanë dhënë arsyetim se pse nuk paraqesin rrethana lehtësuese apo rënduese në rastin konkret, dhe numri i madh i dyfishimit të rrethanave.

Po ashtu, në aktgjykimet e analizuar, shihet se çështja e vlerësimit të brendshëm të rrethanave rënduese dhe lehtësuese si dhe peshimi i tyre, janë çështje plotësisht të vdekura në praktikë. Sipas udhëzuesit, këto dy çështje janë prej çështjeve kryesore në politikën e dënimeve.

Fatkeqësisht, përpos arsyetimit, shabllone kemi edhe tek dënimi i shqiptuar, dhe veçanërisht tek pjesa e korrupsionit. Kjo për arsye se nga 34 dënime me burgim efektiv dhe me kusht në rastet e korrupsionit, plot 23 prej tyre janë dënime me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë muajve.

Po ashtu, disa prej përcaktimeve të udhëzuesit janë pothuajse fare të pazbatuara, të pa trajtuara dhe të pa përmendura në aktgjykimet e analizuara. Nëse kjo dukuri është pothuajse në të gjitha aktgjykimet e analizuara, atëherë përkthimi i saj është se për një pjesë të madhe të udhëzuesit, gjyqtarët nuk janë fare të informuar.

Një çështje tjetër që duhet të sqarohet në këtë pjesë dhe e cila vlen si për gjetjet e përgjithshme ashtu edhe për secilin kapitull veç e veç, është çështja e limiteve të dënimit të përcaktuara në shtojcën 1 të udhëzuesit. Sa i përket limiteve, fillimisht duhet ta kemi parasysh metodologjinë e sqaruar më lartë, se si IKD e ka vlerësuar nëse një dënim i shqiptuar është apo jo brenda këtyre limiteve. Metodologjia është ndërtuar vetëm sipas përcaktimeve të udhëzuesit, në mënyrë që të kemi të gjetura në këtë raport, por jo edhe komentime të aktgjykimëve, e as për ta marrë rolin e vlerësuesit të aktgjykimëve. Vlerësimi është bërë vetëm në kuptim të udhëzuesit. Në këtë drejtim, kur është bërë kualifikimi i një dënimi të shqiptuar në shtojcën e udhëzuesit, kualifikimi është bërë vetëm sipas asaj se çfarë gjykatat kanë aplikuar në aktgjykim dhe më pas janë përcaktuar limitet. IKD nuk ka thënë në asnjë rast se në rastin konkret është dashur të aplikohet edhe kjo rrethanë lehtësuese apo edhe kjo rrethanë rënduese. Sa i përket injorimit të rrethanave, kuptimi i kësaj çështje trajtohet tek metodologjia e këtij raporti. Por, përtej metodologjisë së këtij raporti, në asnjë rast nuk mund të themi se përkundër mos konsistencës së aktgjykimëve, dënimi është brenda limiteve, që nënkupton se edhe dënimi është i drejtë dhe i arsyeshëm. Nëse do të zbatoheshin parimet dhe rregullat e përcaktuara nga udhëzuesi, në raport me shtojcën 1 të udhëzuesit, kualifikimi brenda kolonave do të ndryshonte, dhe kjo do të nënkuptonte edhe limite të tjera, rrjedhimisht edhe të dhëna të tjera. Por, këtë pjesë, IKD nuk e vlerëson, këtë mbetet ta bëjë Komisioni për Vlerësimin e Performancës në KGJK.

b. Të gjeturat e përgjithshme

Në këto 73 aktgjykime, gjykatat kanë shqiptuar gjithsej 136 dënime. Prej të gjitha këtyre dënimeve, për nga lloji i dënimit, prin dënimi me burgim, i pasuar nga dënimi me kusht. Sa i përket dënimeve me burgim në kapitullin e korrupsionit, si të tilla figurojnë gjithsej 14 dënime. Por, prej këtyre 14 dënimeve, nëntë prej tyre janë shndërruar më pas me gjobë. Kjo i bie se në të gjitha këto raste të korrupsionit, kemi vetëm pesë dënime me burgim efektiv. Ndërsa, në Departamentin e Përgjithshëm janë nëntë dënime me burgim, që nënkupton se në përgjithësi, gjykatat kanë qenë më të ashpra në dënimet e shqiptuara për veprat penale që gjykohen në Departamentin e Përgjithshëm, se sa për veprat penale nga kapitulli i korrupsionit. Shtu këtu faktin se në korrupsion janë të analizuara 25 aktgjykime, ndërsa për veprat penale të gjykuara në Departamentin e Përgjithshëm janë analizuar pesë aktgjykime më pak, respektivisht 20 aktgjykime.

Llojet e dënimeve	Korrupsion	Vrasje	Departamenti i Përgjithshëm	Trafikim me armë	Terrorizëm	Total
Dënim me Kusht	21	0	11	0	1	33
Dënim me burgim	14	20	8	16	21	79
Dënim me gjobë	10	1	14	8	3	36
Totali	45	21	33³	24	25	148

Tabela 1 – Llojet e dënimeve të shqiptuara në të gjitha kategoritë.

³ 34 dënime gjithsej, përfshirë edhe vërejtjen gjyqësore.

Lartësia e dënimeve me gjobë	Korrupsion	Vrasje	Departamenti i Përgjithshëm	Trafikim me armë	Terrorizëm	Total
200 euro	1	0	3	0	0	4
300 euro	1	0	2	0	0	3
400 euro	0	0	1	0	0	1
500 euro	2	1	0	0	0	3
600 euro	0	0	1	0	0	1
700 euro	1	0	1	0	0	2
1000 euro	2	0	2	1	0	5
1500 euro	0	0	2	0	0	2
1800 euro	0	0	0	3	2	5
2000 euro	1	0	2	0	0	3
2500 euro	0	0	0	0	1	1
3000 euro	0	0	0	1	0	1
3600 euro	1	0	0	0	0	1
4000 euro	0	0	0	1	0	1
5000 euro	0	0	0	1	0	1
7000 euro	1	0	0	1	0	2

Tabela 2 – Lartësia e dënimeve të shqiptuara me gjobë.

Sa i përket aplikimit të rrethanave, në të gjitha aktgjykimet e analizuara në këtë raport, gjykata kanë aplikuar 310 rrethana. Por, ajo që vërehet është disproporcioni i madh i rrethanave lehtësuese në raport me rrethanat rënduese. Nga 310 rrethanat e aplikuar, 235 janë rrethana lehtësuese, derisa vetëm 75 janë rrethana rënduese.

Numri i rrethana lehtësuese të aplikuara	Korrupsion	Vrasje	Departamenti i Përgjithshëm	Trafikim me armë	Terrorizëm	Total
Asnjë rrethanë lehtësuese	1 rast	2 raste	0 raste	0 raste	0 raste	3 raste
1 rrethanë e aplikuara	0 raste	0 raste	3 raste	0 raste	0 raste	3 raste
2 rrethana të aplikuara	2 raste	3 raste	1 rast	0 raste	0 raste	6 raste
3 rrethana të aplikuara	5 raste	1 rast	6 raste	2 raste	0 raste	14 raste
4 rrethana të aplikuara	8 raste	2 raste	4 raste	2 raste	2 raste	18 raste
5 rrethana të aplikuara	7 raste	2 raste	5 raste	0 raste	0 raste	14 raste
6 rrethana të aplikuara	2 raste	0 raste	0 raste	0 raste	0 raste	2 raste
7 rrethana të aplikuara	0 raste	0 raste	1 rast	0 raste	1 rast	2 raste
11 rrethana të aplikuara	0 raste	0 raste	0 raste	0 raste	1 rast	1 rast

Tabela 3 – Numri i rrethanave të aplikuara në rastet e dënimeve.

Sa i përket lartësisë së dënimeve me burgim, ku përfshihet edhe dënimet me burgim efektiv edhe ato me gjobë, dënimi më i ulët është dënimi me dy muaj burgim derisa ai më lartë është dënimi me burgim të përjetshëm, i cili është shqiptuar në një rast të vrasjes. Ndërsa, dënimi më i shpeshtë i shqiptuar është dënimi me gjashtë muaj burgim. Ky dënim është shqiptuar në gjithsej 30 raste, 23 prej të cilave janë në kuadër të kapitullit të korrupsionit.

Lartësia e dënimeve	Korrupsion	Vrasje	Departamenti i Përgjithshëm	Trafikim me armë	Terrorizëm	Total
2 muaj	0	0	1	0	0	1
3 muaj	4	0	4	0	0	8
4 muaj	1	0	2	0	0	3
6 muaj	23	0	4	2	2	31
8 muaj	1	0	1	0	1	3
9 muaj	2	0	0	0	0	3
12 muaj	1	4	1	6	1	13
150 ditë	1	0	0	0	0	1
180 ditë	1	0	0	0	0	1
1 vit e 6 muaj	0	0	2	0	3	5
2 vite	0	2	4	2	3	11
2 vite e 4 muaj	0	0	0	0	2	2
2 vite e 8 muaj	0	0	0	0	1	1
2 vite e 6 muaj	1	0	0	1	0	2
3 vite	0	0	0	0	4	4
3 vite e 6 muaj	0	0	0	1	0	1
4 vite	0	0	2	0	1	3
4 vite e 3 muaj	0	1	0	0	0	1

4 vite e 6 muaj	0	1	0	3	0	4
5 vite	0	1	0	0	1	2
5 vite e 6 muaj	0	0	0	1	0	1
9 vite	0	0	0	0	3	3
9 vite e 6 muaj	0	1	0	0	0	1
12 vite	0	2	0	0	0	2
13 vite	0	1	0	0	0	1
14 vite e 6 muaj	0	1	0	0	0	1
19 vite e 6 muaj	0	1	0	0	0	1
20 vite	0	1	0	0	0	1
21 vite	0	1	0	0	0	1
23 vite	0	1	0	0	0	1
25 vite	0	1	0	0	0	1
Burgim i përjetshëm	0	1	0	0	0	1

Tabela 4 – Lartësia e dënimeve të shqiptuara me burg.

Sa i përket dënimit me gjobë, të gjeturat tregojnë se ka një laramani të dënimeve në kuptim të lartësisë së dënimit. Dënimi më i shpeshtë me gjobë në të gjitha rastet është dënimi me 1.800 euro gjobë, i shqiptuar në pesë raste.

Rrethanat	Korrupsion	Vrasje	Departamenti i Përgjithshëm	Trafikim me armë	Terrorizëm	Total
Rrethana lehtësuese	98	27	70	14	26	235
Rrethana rënduese	25	26	12	8	4	75
Totali	123	53	82	22	30	310

Tabela 5 – Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të aplikuara në aktgjykime.

Sa i përket aplikimit të rrethanave rënduese, gjykatat më së shpeshti kanë aplikuar nga katër rrethana lehtësuese, ku numër i tillë i rrethanave lehtësuese është përdorur në gjithsej 18 raste. Në tre raste, gjykatat nuk kanë përdorur asnjë rrethanë lehtësuese, derisa numri më i madh i rrethanave lehtësuese është në një rast të terrorizmit, në të cilin janë aplikua gjithsej 11 rrethana lehtësuese.

Numri i rrethana lehtësuese të aplikuara	Korrupsion	Vrasje	Departamenti i Përgjithshëm	Trafikim me armë	Terrorizëm	Total
Asnjë rrethanë lehtësuese	1 rast	2 raste	0 raste	0 raste	0 raste	3 raste
1 rrethanë e aplikuara	0 raste	0 raste	2 raste	0 raste	0 raste	2 raste
2 rrethana të aplikuara	2 raste	3 raste	1 rast	0 raste	0 raste	6 raste
3 rrethana të aplikuara	5 raste	1 rast	6 raste	2 raste	0 raste	14 raste
4 rrethana të aplikuara	8 raste	2 raste	4 raste	2 raste	2 raste	18 raste
5 rrethana të aplikuara	7 raste	2 raste	5 raste	0 raste	0 raste	14 raste
6 rrethana të aplikuara	2 raste	0 raste	0 raste	0 raste	0 raste	2 raste
7 rrethana të aplikuara	0 raste	0 raste	1 rast	0 raste	1 rast	2 raste
11 rrethana të aplikuara	0 raste	0 raste	0 raste	0 raste	1 rast	1 rast

Tabela 6 - Rrethanat lehtësuese të aplikuara në raste për të gjitha kategoritë.

Ndërsa sa i përket aplikimit të rrethanave rënduese, karakteristike është se prej të gjitha aktgjykimeve të shkallës së parë, mbi gjysma e tyre janë aktgjykime dënuese, të cilat janë nxjerrë duke mos aplikuar asnjë rrethanë rënduese. Në këtë mënyrë, numri i aktgjykimeve në të cilat nuk është aplikuar asnjë rrethanë lehtësuese është gjithsej 32. Ndërsa, me vetëm nga një rrethanë rënduese janë gjithsej 10 aktgjykime, ndërsa me nga dy rrethana rënduese janë gjithsej 11 aktgjykime. Numri më i madh i rrethanave rënduese është aplikuar në një rast të vrasjes, ku janë aplikuar gjithsej nëntë rrethana rënduese.

Numri i rrethana rënduese të aplikuara	Korrupsion	Vrasje	Departamenti i Përgjithshëm	Trafikim me armë	Terrorizëm	Terrorizëm
Asnjë rrethanë rënduese	15 raste	1 rast	12 raste	2 raste	1 rast	31 raste
1 rrethanë e aplikuar	3 raste	2 raste	5 raste	1 rast	2 raste	13 raste
2 rrethana të aplikuar	2 raste	4 raste	2 raste	0 raste	1 rast	9 raste
3 rrethana të aplikuara	3 raste	1 rast	1 rast	0 raste	0 raste	5 raste
4 rrethana të aplikuara	1 rast	1 rast	0 raste	0 raste	0 raste	2 raste
5 rrethana të aplikuara	1 rast	0 raste	0 raste	0 raste	0 raste	1 rast
7 rrethana të aplikuara	0 raste	0 raste	0 raste	1 rast	0 raste	1 rast
9 rrethana të aplikuara	0 raste	1 rast	0 raste	0 raste	0 raste	1 rast

Tabela 7 - Rrethanat rënduese të aplikuara në raste për të gjitha kategoritë.

Por në raport me udhëzuesin, problematika më serioze është mënyra se si këto rrethana janë aplikuar. Në këtë drejtim, analiza e IKD-së gjen se në total, vetëm 37 rrethana janë zbatuar sipas kërkesave të udhëzuesit, derisa kjo nuk është bërë në 272 rrethana të tjera. Në këtë drejtim, përkundër çështjeve të tjera, udhëzuesi rëndësinë më të madhe ia ka kushton rrethanave, qofshin ato lehtësuese apo rënduese dhe përcaktimin e kriterëve për përdorimin e të njëjtëve. Në këtë drejtim, nga kjo e gjetur e këtij raporti, mund të konkludojmë se sa i përket aplikimit dhe arsytimit të rrethanave, udhëzuesi është një dokument në letër, i cili nuk gjen zbatim në praktikë në shumicën dërrmuese të rasteve.

Aplikimi i rrethanave sipas kërkesës së udhëzuesit	Korrupsion	Vrasje	Departamenti i Përgjithshëm	Trafikim me armë	Terrorizëm	Total
Sipas kërkesave të udhëzuesit	18	17	2	0	0	37
Nuk janë plotësuar kërkesat e udhëzuesit	105	36	80	22	30	273

Tabela 8 - Aplikimi i rrethanave sipas kërkesës së udhëzuesit.

Po ashtu, problematike është edhe numri i rrethanave të injoruara në këto aktgjykime, të cilat nuk janë marrë fare si rrethanë lehtësuese apo rënduese, si dhe gjykata nuk ka dhënë asnjë arsyetim se pse të njëjtat në rastin konkret nuk paraqesin rrethanë lehtësuese apo rënduese. Në total, në vetëm dy raste nuk është identifikuar asnjë rrethanë e injoruar, derisa ka raste ku janë identifikuar nga 17, 18 dhe 19 rrethana të injoruara. Në 11 aktgjykime, gjykata kanë injoruar nga 10 rrethana.

Rrethanat e injoruara	Korrupsion	Vrasje	Departamenti i Përgjithshëm	Trafikim me armë	Terrorizëm	Total
0 rrethana	1	1	0	0	0	2
1 rrethanë	0	0	0	1	0	1
2 rrethana	0	0	0	0	0	0
3 rrethana	0	0	0	0	0	0
4 rrethana	0	0	0	0	0	0
5 rrethana	0	0	0	1	4	5
6 rrethana	1	0	1	2	0	4
7 rrethana	3	0	1	0	0	4
8 rrethana	1	0	3	0	0	4
9 rrethana	2	0	2	0	0	4
10 rrethana	6	0	5	0	0	11
11 rrethana	4	1	0	0	0	5
12 rrethana	5	1	3	0	0	9
13 rrethana	2	2	0	0	0	4
14 rrethana	0	0	1	0	0	1
15 rrethana	0	1	0	0	0	1
16 rrethana	0	3	2	0	0	5
17 rrethana	0	0	1	0	0	1
18 rrethana	0	1	0	0	0	1
19 rrethana	0	0	1	0	0	1

Tabela 9 - Rrethanat e injoruara në aktgjyqime.

Po ashtu, shqetësuese është edhe dukuria, e cila sipas udhëzuesit cilësohet si dyfishim i rrethanave. Në bazë të analizës së IKD-së të bërë sipas kritereve të përcaktuara në udhëzues, gjykatat kanë bërë dyfishim të rrethanave në plot 40 raste. Në 32 prej tyre, gjykatat brenda një aktgjykimi kanë bërë një dyfishim të rrethanave, në shtatë prej tyre gjykatat në një aktgjykim kanë bërë nga dy dyfishime të rrethanave, derisa në një rast të korrupsionit janë identifikuar gjithsej tre dyfishime të rrethanave.

Rrethanat	Korrupsion	Vrasje	Departamenti i Përgjithshëm	Trafikim me armë	Terrorizëm	Total
1 Dyfishim	10	7	11	1	3	32
2 Dyfishime	2	0	3	0	2	7
3 Dyfishime	1	0	0	0	0	1
Total	13	7	14	1	5	40

Tabela 10 - Rrethanat e dyfishuara në aktgjykim.

Sa i përket përshtatshmërisë së dënimit, IKD ka identifikuar gjithsej shtatë raste që gjykatat nuk kanë trajtuar dhe arsyetuar fare çështjen e përshtatshmërisë së dënimit.

Përshtatshmëria e dënimit në aktgjykim	Korrupsion	Vrasje	Departamenti i Përgjithshëm	Trafikim me armë	Terrorizëm	Total
Përmbajnë pjesën e përshtatshmërisë së dënimit	21	10	17	4	4	56
Nuk përmbajnë pjesën për përshtatshmërinë e dënimit	4	0	3	0	0	7

Tabela 11 – Përshtatshmëria e dënimit në aktgjykim.

Sa i përket katër qëllimeve të dënimit, të cilat sipas udhëzuesit duhet të zbatohen në secilin rast, IKD ka gjetur se në gjithsej 13 aktgjykime, gjykatat nuk kanë aplikuar asnjë prej qëllimeve të dënimit derisa në vetëm tre raste janë aplikuar të gjitha qëllimet e dënimit.

Qëllimet	Korrupsion	Vrasje	Departamenti i Përgjithshëm	Trafikim me armë	Terrorizëm	Total
0 Qëllime	7	3	3	0	1	14
1 Qëllim	1	1	0	0	0	2
2 Qëllime	10	3	2	1	1	17
3 Qëllime	6	2	14	3	2	27
4 Qëllime	1	1	1	0	0	3

Tabela 12 – Qëllimet e dënimeve të aplikuara në aktgjykime.

Në mesin e llojeve të qëllimit të dënimit, parandalimit specifik/i veçantë është aplikuar më së shpeshti, në gjithsej 50 aktgjykime, derisa qëllimi tjetër, viktimat dhe komuniteti, është aplikuar në vetëm tre aktgjykime.

Qëllimet	Korrupsion	Vrasje	Departamenti i Përgjithshëm	Trafikim me armë	Terrorizëm	Total
Parandalimi specifik/i veçantë	18	8	17	4	3	50
Parandalimi i përgjithshëm	17	7	17	3	3	47
Viktimat dhe komuniteti	1	0	1	1	0	3
Gjykimi shoqëror, ngritja e moralit dhe forcimi i detyrimit për respektimin e ligjit	7	2	15	3	2	29

Tabela 13 – Llojet e qëllimeve të aplikuara në aktgjykime.

Por, zbatimi i udhëzuesit në praktikë nuk e sheh dritën as sa i përket arsyetimit të qëllimeve të aplikuara në këto aktgjykime. Nga të gjitha qëllimet e aplikuara në të gjitha aktgjykimet, gjykatat sipas kërkesave të udhëzuesit kanë aplikuar dhe arsyetuar vetëm në gjashtë raste qëllimet e dënimeve, derisa në rastet e tjera, gjykatat vetëm i kanë cituar qëllimet e dënimeve, dhe e kanë marrë si të mirëqenë faktin se me shqiptimin e një dënimi të caktuar do të arrihet edhe qëllimi i cituar. Për më tepër, shumica e aktgjykimeve sa i përket kësaj pjese janë të njëjta për nga natyra, e dhënë kjo që flet për krijimin e një praktikë shabllone në kuptim të arsyetimit të aktgjykimeve sa i përket caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit.

Arsyetimi i qëllimeve	Korrupsion	Vrasje	Departamenti i Përgjithshëm	Trafikim me armë	Terrorizëm	Total
Parandalimi specifik/i veçantë	1	1	1	0	0	3
Parandalimi i përgjithshëm	0	1	0	0	0	1
Viktimat dhe komuniteti	0	1	0	0	0	1
Gjykimi shoqëror, ngritja e moralit dhe forcimi i detyrimit për respektimin e ligjit	0	1	0	0	0	1
Total	1	4	1	0	0	6

Tabela 14 – Arsyetimi i qëllimeve të aplikuara në aktgjykime.

Ndërsa, sa i përket parimeve të dënimit në mënyrën se si e përcakton udhëzuesi, këto parime nuk janë zbatuar në plot 55 raste, derisa janë zbatuar në vetëm një aktgjykim. Në shtatë aktgjykime, këto parime janë zbatuar vetëm pjesërisht. Në këtë mënyrë, edhe kjo e gjetur flet për pjesën tjetër të vdekur të udhëzuesit, i cili nga të gjeturat e IKD-së, nuk ka gjetur zbatim në praktikë që nga kjo e miratimit të tij.

Zbatimi i parimeve	Korrupsion	Vrasje	Departamenti i Përgjithshëm	Trafikim me armë	Terrorizëm	Total
Pa zbatuara	22	8	18	3	4	55
Pjesërisht	2	2	2	1	0	7
Plotësisht	1	0	0	0	0	1

Tabela 15 – Zbatimi i parimeve të dënimit sipas udhëzuesit.

Në kuptim të sqarimit të dhënë më lartë (faqe 12), IKD ka identifikuar gjithsej 26 raste kur dënimet kanë qenë jashtë limiteve të përcaktuara në shtojcën 1 të udhëzuesit, derisa 37 dënime kanë qenë brenda limiteve.

Matja e lartësisë së dënimeve	Korrupsion	Vrasje	Departamenti i Përgjithshëm	Trafikim me armë	Terrorizëm	Total
Jashtë kufijve	6	7	7	4	2	26
Brenda kufijve	19	3	13	0	2	37

Tabela 16 – Matja e lartësisë së dënimeve sipas udhëzuesit.

VI. Politika ndëshkimore në rastet e korrupsionit

a. Hyrje

IKD në këtë kapitull ka analizuar gjithsej 25 aktgjykime të veprave penale nga kapitulli i korrupsionit. Të gjitha këto aktgjykime i përkasin periudhës pas miratimit të udhëzuesit.

Në bazë të metodologjisë së përmendur në fillim të këtij raporti, IKD ka analizuar edhe këto 25 aktgjykime nga kapitulli i korrupsionit, nëse në të njëjtat, gjyqtarët kanë zbatuar kërkesat dhe standardet e vendosura nga udhëzuesi, me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit. Këto 25 aktgjykime përfshijnë gjithsej 40 persona, derisa ndaj tyre janë shqiptuar 43 dënime.

Të gjeturat e IKD-së të prezantuara më poshtë, tregojnë se në rastet e korrupsionit, udhëzuesi as për së afërmi nuk është zbatuar. Për më tepër, siç do të shohim në këtë kapitull, politika ndëshkimore në aktgjykimet e korrupsionit është shabllone, pasi në shumicën e aktgjykimeve ka përsëritje të rrethanave të njëjta, derisa përshtatshmëria e aktgjykimet arsyetohet në mënyrë të përgjithshme, dhe trajtohet si e mirëqenë. Nga të dhënat e mëposhtme, rezulton se parimet e dënimit të cekura në udhëzues, janë të vdekura për nga zbatimi në rastet e korrupsionit. Nëse si pikë reference për një politikë të ligjshme ndëshkimore merret udhëzuesi, atëherë mund të konkludojmë se politika ndëshkimore në sistemin gjyqësor të Republikës së Kosovës, në rastet e korrupsionit, është hiq më pak se arbitrare.

Sa i përket arsytimit të aktgjykimeve mbi caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, gjithnjë duke marrë parasysh standardet e vendosura nga udhëzuesi, palët dhe publiku në asnjë rrethanë nuk mund të krijojnë bindjen se pse në rastin konkret është caktuar një dënim i tillë.

Nëse themi se luftimi i korrupsionit bëhet duke dhënë aktgjykime me dënime më të larta, nga të dhënat e poshtëshënuara shihet se sistemi gjyqësor nuk e ka ndjekur këtë parim, pasi nga 25 raste me 40 persona, prej 43 dënimeve të shqiptuara, vetëm pesë kanë qenë më burgim efektiv, respektivisht 11.62 % e totalit të dënimeve.

Por, nga të dhënat e gjeneruara pas analizës që IKD u ka bërë këtyre rasteve, vërehet se edhe vetë lartësia e dënimit është shabllone, pasi në shumicën dërrmuese të rasteve, dënimi me burgim (efektiv apo me kusht) është gjashtë muaj.

Në këtë mënyrë, ajo që ishte prezantuar si progres dhe hap konkret në drejtim të përmirësimit të politikës ndëshkimore brenda sistemit të drejtësisë në Republikën e Kosovës, e që është miratimi i udhëzuesit, nga të gjeturat e këtij raporti shihet se ka mbetur politikë e mirë në letër, e pazbatuar në praktikë.

b. Gjetjet e përgjithshme

25 aktgjykimet e analizuara në këtë kapitull, janë për veprat penale nga kapitulli 34 i KPRK-së, përkatësisht kapitulli “Korrupsioni Zyrtar dhe Veprat Penale Kundër Detyrës Zyrtare”. Në

këto raste, brenda aktgjykimeve ka edhe dënime për vepra të tjera penale që nuk i përkasin kësaj kategorie, por që kanë qenë pjesë e aktgjykimeve në të cilat të pandehurit janë dënuar edhe për vepra penale të korrupsionit, dhe të cilat janë analizuar po ashtu në këtë pjesë. 42/43


Vepra penale	Numri i dënimeve
Keqpërdorim i detyrës apo autoritetit zyrtar	14
Ndihmë në kryerjen e veprës penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar	2
Falsifikim i dokumentit zyrtar	7
Dhënie ryshfeti	7
Marrje ryshfeti	6
Përvetësim ne detyrë	4
Ushtrimi i ndikimit	2
Konflikti i interesit	1
Legalizim i përmbajtjes se pavërtete	1
Deklarim i rremë nën betim	1

Tabela 17 – Numri i dënimeve sipas veprave penale.

Në 25 aktgjykimet e analizuara janë të përfshirë gjithsej 40 persona, si dhe ndaj të njëjtëve janë shqiptuar gjithsej 45 dënime.

Nga 45 dënimet e shqiptuara, prinë dënimi me kusht me gjithsej 21 dënime, i pasuar nga dënimi me burgim prej 14 dënimeve si dhe 10 dënime me gjobë.


Llojet e dënimeve të shqiptuara



Grafika 1 – Llojet e dënimeve të shqiptuara.

Ndonëse dënime me burgim janë shqiptuar gjithsej 14, vetëm pesë prej tyre kanë qenë dënim me burgim efektiv, pasi nëntë tjera janë shndërruar në dënim me gjobë. Prej këtyre pesë dënimeve me burgim efektiv, tre kanë qenë dënime me gjashtë muaj burgim efektiv, një ka qenë dënim me nëntë muaj burgim efektiv, ndërsa një ka qenë me dy vite e gjashtë muaj burgim efektiv. Kjo i bie se nga 25 rastet e analizuara, gjykatat kanë shqiptuar vetëm 57 muaj burgim efektiv në total.

Dënimet me burg




Grafika 2 – Dënimet me burg efektiv dhe të shndërruar me gjobë.

Sa i përket lartësisë së dënimit me burgim (efektiv dhe me kusht), të njëjtat kanë qenë nga tre muaj deri në dy vite e gjashtë muaj burgim. Karakteristike është se nga 35 dënimet, 23 dënime apo 67.64 % e këtyre dënimeve janë dënime me burgim prej gjashtë muajve.



Grafika 3 – Lartësia e dënimeve me burgim.

Sa i përket nëntë dënimeve me gjobë, ka një laramani në mesin e dënimeve, ku minimumi është 200 euro ndërsa maksimumi është 7000 euro.



Grafika 4 – Lartësia e dënimeve me gjobë.

Në 25 rastet e korrupsionit, gjykatat kanë shqiptuar vetëm një dënim plotësues (ndalimi i ushtrimit të profesionit në kohëzgjatje prej një viti) derisa në 24 aktgjykime tjera, gjykatat nuk kanë shqiptuar këtë lloj dënimi.

Sa i përket numrit total të rrethanave rënduese dhe lehtësuese të përdorura në këto raste, numri i rrethanave lehtësuese është pothuajse katër fish më i lartë se sa numri i rrethanave rënduese.



Grafika 5 – Numri total i rrethanave të përdorura në 25 aktgjykime të analizuar.

Ndërsa, në raste të ndara, gjykatat kanë përdorur nga dy deri në gjashtë rrethana lehtësuese, derisa në një rast nuk është përdorur asnjë rrethanë lehtësuese.

Numri i rrethanave lehtësuese të aplikuar	Numri i rasteve
Asnjë rrethanë lehtësuese	1 rast
2 rrethana të aplikuar	2 raste
3 rrethana të aplikuar	5 raste
4 rrethana të aplikuar	8 raste
5 rrethana të aplikuar	7 raste
6 rrethana të aplikuar	2 raste

Tabela 18 – Numri i rrethanave lehtësuese të aplikuar.

Por, gjendja është shqetësuese sa i përket përdorimit të rrethanave rënduese, pasi në 15 aktgjykime, gjykatat nuk kanë përdorur asnjë rrethanë rënduese, derisa maksimumi i rrethanave rënduese të përdorura është pesë (në një aktgjykim).

Numri i rrethana rënduese të aplikuara	Numri i rasteve
Asnjë rrethanë lehtësuese	15 raste
1 rrethanë të aplikuar	3 raste
2 rrethana të aplikuara	2 raste
3 rrethana të aplikuara	3 raste
4 rrethana të aplikuara	1 rast
5 rrethana të aplikuara	1 rast

Tabela 19 – Numri i rrethanave rënduese të aplikuara.

Sa i përket llojeve të rrethanave të përdorura, janë 36 lloje të rrethanave të cilat janë aplikuar në numrin total të këtyre aktgjykimeve të analizuara. Në këtë drejtim, IKD ka gjetur se disa prej rrethanave janë të përmendura në shumicën dërrmuese të raste. Nga gjithsej 25 raste, IKD ka gjetur se mungesa e dënimeve të mëparshme është përdorur si rrethanë lehtësuese në gjithsej 15 aktgjykime, ndërsa fakti se i dënuari është familjar dhe sjellja korrekte gjatë procedurës është përdorur në 13 aktgjykime si rrethanë lehtësuese. Por, janë 14 rrethana të tjera, të cilat në 25 aktgjykimet e analizuara, në total, ka rezultuar se janë përdorur në vetëm nga një rast.

Lloji i rrethanës	Numri i rasteve në të cilat është aplikuar
I dënuari nuk kishte qenë i dënuar më parë	15
Fakti se i dënuari është familjar	13
Sjellja korrekte gjatë procedurës	13
Pranimi i fajësisë	11
Pendimi	7
Gjendja e dobët ekonomike	6
Shkallën e lartë të dashjes	5
Mbajtës i familjes	4
Premtimi se ne të ardhmen nuk do të ndërmerr veprime të tilla	3
Është relativisht i ri	3
Mosha	3
Sjellja e personit të dënuar pas kryerjes së veprës penale	3
Koha e gjatë që nga kryerja e veprës penale	3
Rrezikshmëria shoqërore e kësaj vepre	3
Intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur	3
Baba i fëmijëve	2
Sjellja e personit të dënuar pas kryerjes së veprës penale	2
Rrethanat personale dhe karakteri i personit	2
Shkallën e lartë të pjesëmarrjes së të akuzuarit	2
Shkalla e dënimit të shkaktuar	2

Shkalla e përgjegjësisë penale	2
Mënyra e kryerjes së veprës penale	2
Është në gjendje të dobët shëndetësore	1
Fakti se i dënuari i ishte përgjigjur rregullisht ftesave të gjykatës	1
Marrëveshja e arritur ne prokurori për pranimin e fajësisë	1
Pranimi dhe gatishmërinë për kompensimin e dëmit	1
Bashkëpunimi me gjykatën	1
Sinqeriteti	1
Kompensimin	1
Shkollimi	1
Fakti se vepra penale është kryer duke e keqpërdorur detyrën zyrtare	1
Qëllimi i kryerjes për kryerjen e veprës penale, përkatësisht qëllimi për përfitim pasuror	1
Kryerja e veprës penale me paramendim	1
Shfrytëzimi i pozitës së vështirë ekonomike-sociale të së dëmtuarës	1
Rrethanat ne të cilat është kryer kjo vepër penale	1
Pesha e veprës penale	1

Tabela 20 – Lloji i rrethanave të aplikuara në aktgjykime.

Ndërsa në raport me udhëzuesin, problematike është mënyra se si këto rrethana janë përdorur. Nga 123 rrethanat e përdorura në total së të gjitha aktgjykimeve, analiza e IKD-së ka gjetur se vetëm 18 prej janë aplikuar dhe arsyetuar komfor kërkesave të udhëzuesit.



Grafika 6 – Aplikimi i rrethanave sipas udhëzuesit.

Sa i përket rrethanave lehtësuese, në total, prej 98 rrethanave lehtësuese të aplikuara në këto raste, vetëm nëntë prej tyre janë aplikuar dhe arsyetuar sipas kërkesave të udhëzuesit.



Grafika 7 – Aplikimi dhe arsyetimi i rrethanave lehtësuese sipas udhëzuesit.


Ndërsa, nga 25 rrethanat rënduese të aplikuara në 25 aktgjykime, IKD ka gjetur se gjykatat vetëm nëntë prej tyre i kanë aplikuar dhe zbatuar komfor kërkesave të udhëzuesit.



Grafika 8 – Aplikimi dhe arsyetimi i rrethanave rënduese sipas udhëzuesit.


Po ashtu, IKD ka gjetur se në asnjë prej rrethanave të përdorura, si lehtësuese ashtu edhe rënduese, gjykatat nuk kanë dhënë arsyetim lidhur me rëndësinë e brendshme të rrethanave.

Lidhur me rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat përmenden në aktgjykim, është një numër i madh i rrethanave lehtësuese dhe rënduese që IKD ka gjetur se gjykatat i kanë injoruar, përkatësisht nuk i ka aplikuar dhe nuk ka dhënë arsyetim se pse të njëjtat nuk janë aplikuar, derisa në vetëm një rast IKD nuk ka identifikuar asnjë rrethanë të injoruar.




Grafika 9 – Numri i rrethanave lehtësuese dhe rënduese të injoruara në aktgjykime.

Po ashtu, dukuria e asaj që udhëzuesi e cilëson si “dyfishim të rrethanave” e cila është e ndaluar sipas udhëzuesit shfaqet si dukuri mjaft e shprehur. Nga analiza që IKD u ka bërë këtyre 25 aktgjykimeve, dukuria e dyfishimit të rrethanave është e shprehur në gjithsej 13 raste, ku në 10 prej tyre ka një dyfishim të rrethanave, në dy raste janë nga dy dyfishime të rrethanave dhe në tre raste janë plot tre dyfishime të rrethanave.



Grafika 10 – Dukuria e dyfishimit të rrethanave në aktgjykime.


Sa i përket përshtatshmërisë së dënimit, prej 25 aktgjykimeve, katër apo 16% e aktgjykimeve nuk përmbajnë fare arsyetim mbi përshtatshmërinë e dënimit.



Grafika 11 – Përshtatshmëria e dënimeve.


Ndërsa sa i përket aplikimit dhe arsyetimit të katër qëllimeve të dënimit, të cilat sipas udhëzuesit duhet të aplikohen dhe arsyetohen në secilin aktgjykim, të gjitha qëllimet janë

aplikuar në vetëm një rast, tre qëllime janë aplikuar në gjashtë aktgjykime, dy në 10 aktgjykime, vetëm një në një aktgjykim, derisa në shtatë raste nuk është aplikuar asnjë prej këtyre qëllimeve të dënimit.




Grafika 12 – Numri i qëllimeve të dënimit të aplikuara në aktgjykime.

Tutje, sa i përket qëllimeve të dënimit, parandalimin specifik/i veçantë dhe parandalimi i përgjithshëm janë qëllimet që më së shpeshti janë aplikuar, derisa qëllimi “viktimat dhe komuniteti” është aplikuar në vetëm një rast.



Grafika 13 – Llojet e qëllimeve të dënimit të aplikuara në aktgjykime.

Por, prej të gjitha këtyre rasteve, shqetësuese është fakti se në vetëm një rast dhe vetëm njëri prej qëllimeve të dënimit është aplikuar dhe arsyetuar komfor kërkesave të udhëzuesit, derisa të gjitha të tjerat vetëm janë cituar në mënyrë të përgjithësuar dhe pa dhënë asnjë arsyetim.



Grafika 14 – Aplikimi dhe arsyetimi i qëllimit të dënimit sipas udhëzuesit.


Kështu qëndron situata edhe sa i përket zbatimit të parimeve të dënimit komfor kërkesave të udhëzuesit, ku kjo është bërë plotësisht vetëm në një rast, pjesërisht në dy raste, ndërsa nuk janë zbatuar fare në gjithsej 22 raste.



Grafika 15 – Zbatimi i parimeve sipas kërkesave të udhëzuesit.

Po ashtu, gjykatat në asnjë rast nuk kanë peshuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese me rastin e caktimit të dënimit, përkatësisht ashtu siç e përcakton udhëzuesi, gjykatat nuk kanë dhënë asnjë arsyetim lidhur me këtë çështje.

Një të dhënë befasuese kemi kur flasim për atë nëse dënimi i shqiptuar është brenda limiteve të cilat i përcakton shtojca 1 e udhëzuesit. Siç e kemi sqaruar edhe tek metodologjia e këtij raporti, IKD në këtë raport ka analizuar edhe faktin nëse dënimi i shqiptuar është brenda limiteve që përcakton udhëzuesi, duke e krahasuar udhëzuesit (zbatimi i udhëzuesit në praktikë – faqe 142 - 167) me rrethanat e përdorura në arsyetimin e aktgjykimit dhe dënimin e shqiptuar. Prej 25 aktgjykimeve të analizuara, në 19 raste ka rezultuar se dënimi i shqiptuar ka qenë brenda limiteve që përcakton udhëzuesi, derisa gjashtë aktgjykime kanë qenë jashtë këtij limiti.



Grafika 16 – Dënimet e shqiptuara sipas kërkesave të udhëzuesit.

c. Analiza e veçantë e rasteve të korrupsionit

1. **Rasti P.nr.79/2018** - Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK

Aktgjykimi i marrë

Sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti për Krime të Rënda, i dënuari B.S ishte shpallur fajtor për veprën penale “keqpërdorim i pozitës apo autoritetit

zyrtar”. Kjo pasi, sipas aktgjykimit, i dënuari nga 5 janari 2018 deri në kohë të pacaktuar në cilësinë e personit zyrtar si menaxher në Institucionin “D” me seli në Prizren, duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar i tejkalon kompetencat e tij me qëllim që të përfitojë dobi pasurore për vete, duke i shkaktuar dëme personit tjetër, ashtu që lëshon një certifikatë për aftësim profesional fasader-gipser M.J, dhe nga babai i tij pranon 250 euro, këtë pa qenë i akredituar nga autoriteti kombëtar i kualifikimeve me ç ‘rast Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë e shpall atë jo valide.

Dënimi sipas KPRK: *gjashtë (6) muaj deri në (pesë) 5 vite*

Dënimi i shqiptuar: *gjashtë (6) muaj burg, i cili i zëvendësohet me gjobë në shumë prej 2.800 euro.*

Rrethanat lehtësuese:

1. Fakti se është njëri familjar;
2. Është në gjendje të dobët shëndetësore;
3. Premtimi se në të ardhmen nuk do të ndërmer veprime të tilla;

Rrethanat rënduese

1. Rrezikshmëria shoqërore e kësaj veprë;

Përshtatshmëria e dënimit:

Gjykata ka vlerësuar se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit.

Zbatimi i udhëzuesit

Përshtatshmëria e dënimit

Asnjë nga katër qëllimet e dënimit të cekura në udhëzues, gjykata nuk i ka marrë parasysh në këtë aktgjykim, duke mos dhënë arsytim për asnjërin prej tyre, por vetëm duke e përcaktuar si të mirëqenë faktin se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit. Nga aktgjykimi, po ashtu nuk mund të kuptohet as ajo se cili është qëllimi i dënimit, i cili sipas gjykatës, do të arrihet në këtë rast.

Zbatimi i parimeve

Gjykata në këtë rast vetëm ka cituar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, duke mos bërë asnjë ndërlidhje me parimet që duhet të merren parasysh me rastin e caktimit të dënimit, siç përcaktohet në udhëzues. Por, sa i përket parimit të intensitetit të rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, gjykata nuk e përcakton

si parim të dënimit dhe të njëjtin ta arsyetojë me rrethana rënduese ose lehtësuese, por vetë të njëjtin e përdorë si rrethanë rënduese.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Sa i përket rrethanës rënduese se i akuzuari është familjar, udhëzuesi përcakton shtatë faktorë në të cilët gjykata duhet të bazohet në rastin kur këtë rrethanë e përcakton si rrethanë lehtësuese dhe të njëjtit faktorë duhet t'i arsyetojë, gjë të cilën nuk e ka bërë gjykata në këtë aktgjykim. Sa i përket gjendjes shëndetësore, në aktgjykim nuk ka asnjë arsyetim se i dënuari është i gjendjes së dobët shëndetësore dhe po ashtu gjykata nuk e ka arsyetuar se për çfarë arsye kjo rrethanë mund të merret si rrethanë lehtësuese. Për më tepër, gjendja familjare dhe shëndetësore nuk janë dy rrethana të ndara lehtësuese, por janë faktorë me të cilët vlerësohet rrethana lehtësuese "rrethanat personale dhe karakteri i personit të dënuar", që nënkupton se sipas udhëzuesit, këtu bëhet fjalë për dyfishim të rrethanave. Premtimi se në të ardhmen nuk do të kryejë vepër tjetër penale, në udhëzues nuk përmendet fare si rrethanë lehtësuese. Sa i përket rrezikshmërisë shoqërore që në aktgjykim është përmendur si rrethanë rënduese, sipas udhëzuesit, kjo nuk është rrethanë rënduese, por është parim të cilin gjykata duhet ta ketë parasysh me rastin e vendosjes mbi llojin dhe lartësinë e dënimit. Sipas udhëzuesit, në këtë rast bëhet fjalë për dyfishim të rrethanave.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruara nga aktgjykimi

Janë një sërë rrethanash, si lehtësuese ashtu edhe rënduese, të cilat gjykata nuk i ka marrë për bazë në këtë aktgjykim, e madje as nuk ka dhënë arsyetim se pse të njëjtat nuk janë marrë parasysh. Gjykata nuk ka marrë parasysh fare shkallën e dashjes, shkallën e dëmit të shkaktuar, keqpërdorimin e pushtetit ose pozitës zyrtare, shkeljen e besimit, pendimin/mungesën e pendimit nga i dënuari, keqardhjen e shfaqur, (mos) kompensimi i dëmit të shkaktuar, sjelljen e personit të dënuar pas konfliktit, e kaluara kriminale/ko kriminale e të dënuarve, moshë e të pandehurit dhe (mos) mbështetja pala e dëmtuar.

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Në rrethanat e përmendura, gjykata nuk e ka caktuar rëndësinë e brendshme të asnjë prej rrethanave, si dhe nuk ka dhënë asnjë arsyetim mbi peshimin e rrethanave. Për këtë arsye, llogaritja është kuantitative, që në rastin konkret janë tre rrethana lehtësuese dhe një rënduese. Sipas udhëzuesit, këtu bëhet fjalë për "ekzistimin e së paku dy rrethanave për zvogëlim të fajësisë apo dëmit dhe asnjë/ose një rrethanë të vogël rënduese", e cila kualifikohet tek kolona 5, përkatësisht tek rrethanat që arsyetojnë zbutjen maksimale të dënimit brenda kufirit. Sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 2, pika h, dënimi në këtë rast do të duhej të ishte nga gjashtë muaj deri në një vit e gjashtë muaj burgim. Pra, aktgjykimi në këtë rast është brenda këtyre kufijve.

2. Rasti PKR.nr.453/201 - Keqpërdorim i detyrës zyrtare nga neni 422/ndihmë në kryerjen e veprës penale Keqpërdorim i detyrës zyrtare 422 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK

Aktgjykimi i marrë

Sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, Xh.R dhe A.L, ishin shpallur fajtorë, ashtu që i dënuari i parë ishte dënuar për veprën penale “ndihmë në kryerjen e veprës penale keqpërdorim i detyrës zyrtare” ndërsa i akuzuari dytë për veprën penale “keqpërdorim i detyrës zyrtare”.

Kjo pasi sipas aktgjykimit, i dënuari Xh.R me dashje kishte ndihmuar A.F për të kryer veprën penale me vënien në dispozicion të mjeteve për kryerjen e veprës penale ashtu që më 1 prill 2016, rreth 13:30, duke e përcjellë me veturën e tij oficerin doganor të cilin e kishte dërguar nga Prizreni në Prishtinë për asgjësimin e 2880 parfume “Paco Rabane 1 Milion” produkte të ndaluara të importuara nga Kina nga N.TT.SH “Te Bashkimi” me pronarë B.L. Gjithë kjo me dëshirën që oficeri të mos përkujdeset për mbarëvajtjen e procesit të shkatërrimit të plotë të mallit.

Ndërsa i dënuari A.L., është shpallur fajtor pasi gjykata kishte gjetur se i njëjti ka kryer veprën penale keqpërdorim i detyrës zyrtare pasi që i njëjti nuk kishte përmbushur detyrat zyrtare me qëllim që tjetri të përfitoj dobi pasurore, ashtu që me rastin e asgjësimit të produkteve të lartcekura, niset në drejtim të Prizrenit më fugonin në të cilën gjendej malli i pa asgjësuar, e që më pas ndalohet nga njësitë Anti Kontrabandë i Doganës në rrugën Prishtinë-Fushë Kosovë, e gjithë këto veprime i ndërmer në cilësi të punëtorit të NP “Te Bashkimi”.

Dënimi sipas KPRK-së: *gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vite burgim*

Dënimi i shqiptuar:

Për “keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar”: *gjashtë (6) muaj burg i cili i është zëvendësuar me gjobë në lartësi 3.600 euro*

Për veprën penale “ndihmë në keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar”: *gjashtë (6) muaj burg i cili është zëvendësuar me gjobë në lartësi prej 2.500 euro*

Rrethanat lehtësuese:

1. Pranimi i fajësisë;
2. Fakti se kanë qenë persona familjar;
3. Sjellja korrekte gjatë gjithë procedurës;

Rrethanat rënduese

Asnjë.

Përshtatshmëria e dënimit:

Nuk përmendet në aktgjykim.

Zbatimi i udhëzuesit

Përshtatshmëria e dënimit

Përballë katër qëllimeve të dënimit që sipas udhëzuesit duhet të merren parasysh në secilin aktgjykim, gjykata nuk e ka përmendur asnjërin prej këtyre qëllimeve, madje nuk ka thënë asgjë mbi përshtatshmërinë e dënimit.

Zbatimi i parimeve

Gjykata në këtë rast vetëm ka cituar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, duke mos bërë asnjë ndërlidhje me parimet që duhet të merren parasysh me rastin e caktimit të dënimit, siç përcaktohet në udhëzues.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Gjykata nuk jep asnjë sqarim për tre prej rrethanave lehtësuese të përmendura në aktgjykim, por vetëm i citon ato. Tek pranimi i fajësisë, asnjë kërkesë e cila sipas udhëzuesit duhet të aplikohet me rastin e marrjes parasysh të kësaj rrethane, e cila përcakton edhe rëndësinë e kësaj rrethane në rastin konkret, nuk është marrë parasysh, si dhe gjykata nuk ka dhënë përgjigje në katër pyetjet që sipas udhëzuesit, janë relevante në këtë rast. Sa i përket rrethanës lehtësuese se i akuzuari është familjar, udhëzuesi përcakton shtatë faktorë në të cilët gjykata duhet të bazohet në rastin kur këtë rrethanë e përcakton si rrethanë lehtësuese dhe të njëjtit faktorë duhet ti arsyetojë, gjë të cilën nuk e ka bërë gjykata në këtë aktgjykim. Lidhur me sjelljen korrekte së të pandehurit gjatë procedurës, sipas udhëzuesit, gjykata duhet tu jap përgjigje gjithsej pesë pyetjeve, gjë të cilën gjykata nuk e ka bërë në këtë aktgjykim.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruara nga aktgjykimi

Janë një sërë rrethanash, si lehtësuese ashtu edhe rënduese, të cilat gjykata nuk i ka marrë për bazë në këtë aktgjykim, e madje as nuk ka dhënë arsyetim se pse të njëjtat nuk janë marrë parasysh. Gjykata nuk ka marrë parasysh fare shkallën e dashjes, shkallën e dëmit të shkaktuar, keqpërdorimin e pushtetit ose pozitës zyrtare, shkeljen e besimit, pendimin/mungesën e pendimit nga i dënuari, keqardhjen e shfaqur, (mos) kompensimi i dëmit të shkaktuar, e kaluara (jo) kriminale, mosha e të pandehurit, kalimin e kohës dhe (mos) mbështetja pala e dëmtuar.

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Gjykata në këtë aktgjykim ka përmendur vetëm tre rrethana lehtësuese dhe asnjë rënduese, si dhe nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me natyrën e brendshme dhe peshimin e rrethanave. Për këtë arsye, llogaritja është kuantitative. Sipas udhëzuesit, këtu bëhet fjalë për “ekzistimin

e së paku dy rrethanave për zvogëlim të fajësisë apo dëmit dhe asnjë/ose një rrethanë të vogël rënduese”, që sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, kualifikohet tek kolona 5, përkatësisht rastet kur rrethanat arsyetojnë zbutjen maksimale të dënimit brenda kufirit. Në këtë drejtim, sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 2, pika h, dënimi në këtë rast do të duhej të ishte nga gjashtë muaj deri në një vit e gjashtë muaj me burg. Pra, dënimi në këtë rast është marrë brenda këtyre kufijve.

3. Rasti PKR.nr.194/17 - Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së

Aktgjykimi i marrë

Sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjiilan – Departamenti për Krime të Rënda, i dënuari N.SH, ishte shpallur fajtor për veprën penale “keqpërdorim i pozitës zyrtare”, pasi që i njëjti në cilësinë e ekspertit në një çështje kontestimore, ku ishte caktuar me aktvendim të gjykatës të kryej ekspertizën, kishte kontaktuar me palën paditëse A.A, nga i cili kishte kërkuar kryerjen e pagesës për ekspertizën, por pa caktuar shumën, ndërsa më 24 prill 2017, i dërgon SMS gabimisht B.J Drejtorit të Bankës NLB - filialin në Gjiilan në procedurë e paditur, duke i thënë “mbetet të më paguhet shpërblimi nga ana juaj sipas marrëveshjes” dhe B.J e lajmëron në polici ashtu që vepra mbetet në tentativë.

Dënimi sipas KPRK-së: *dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.*

Dënimi i shqiptuar: *180 ditë burg me kusht në periudhë verifikuese prej një (1) viti.*

Rrethanat lehtësuese:

1. Fakti se i dënuari i ishte përgjigjur rregullisht ftesave të gjykatës;
2. Është njeri familjar;
3. Është baba i katër fëmijëve;

Rrethanat rënduese

1. Fakti se vepra penale është kryer duke e keqpërdorur detyrën zyrtare;

Përshtatshmëria e dënimit:

Nuk ka asnjë arsytim mbi përshtatshmërinë e dënimit.

Zbatimi i udhëzuesit

Përshtatshmëria e dënimit

Përballë katër qëllimeve të dënimit që sipas udhëzuesit duhet të merren parasysh në secilin aktgjykim, gjykata nuk e ka përmendur asnjërin prej këtyre qëllimeve, madje nuk ka thënë asgjë mbi përshtatshmërinë e dënimit.

Zbatimi i parimeve

Gjykata në këtë rast vetëm ka cituar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, duke mos bërë asnjë ndërlidhje me parimet që duhet të merren parasysh me rastin e caktimit të dënimit, siç përcaktohet në udhëzues.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Sipas udhëzuesit, fakti se i dënuari u është përgjigjur rregullisht ftesave të gjykatës mund ndoshta të merret si fakt për ekzistimin e rrethanës “bashkëpunimi i përgjithshëm i personit të dënuar me gjykatën, përfshirë dorëzimin vullnetar” apo “bashkëpunim vullnetar të personit të dënuar në hetimin ose ndjekjen penale”. Por, si rrethanë e veçantë, nuk ekziston në udhëzues. Sa i përket dy rrethanave të tjera, se i dënuari është njeri familjar dhe baba i katër fëmijëve, sipas udhëzuesit, këtu kemi të bëjmë me dyfishim të rrethanave, dhe jo me dy rrethana të veçanta. Kjo çështje hyn në kuadër të rrethanave personale dhe karakteri i personit të dënuar, për ekzistimin e së cilës, gjykata duhet të marrë parasysh shtatë faktorë, që në aktgjykim nuk arsyetohet asnjëri prej tyre. Edhe sa i përket rrethanës rënduese se kjo veprë penale është kryer duke keqpërdorur detyrës zyrtare, kemi të bëjmë me dyfishim të rrethanave, pasi keqpërdorimi i detyrës zyrtare në këtë rast është element qenësor i veprës penale për të cilën është i pandehuri është dënuar. Në këtë aktgjykim, gjykata nuk ka dhënë asnjë arsyetim se pse edhe kjo rrethanë mund të përdoret si rrethanë rënduese. Në anën tjetër, nëse merret parasysh kjo rrethanë, sipas udhëzuesit, janë tetë faktorë që duhet të merren parasysh për përdorimin e kësaj rrethane si rrethanë rënduese, e që në këtë aktgjykim nuk ka arsyetim për asnjërin prej tyre.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruara nga aktgjykimi

Janë një sërë rrethanash, si lehtësuese ashtu edhe rënduese, të cilat gjykata nuk i ka marrë për bazë në këtë aktgjykim, e madje as nuk ka dhënë arsyetim se pse të njëjtat nuk janë marrë parasysh. Gjykata nuk ka marrë parasysh fare shkallën e dashjes, shkallën e dëmit të shkaktuar, shkeljen e besimit, pendimin/mungesën e pendimit nga i dënuari, keqardhjen e shfaqur, (mos) kompensimi i dëmit të shkaktuar, sjelljen e personit të dënuar pas konfliktit, e kaluara kriminale/jo kriminale e të dënuarve, mosha e të pandehurit, kalimin e kohës dhe (mos) mbështetja pala e dëmtuar.

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Gjykata në këtë aktgjykim ka përmendur vetëm tre rrethana lehtësuese dhe një rënduese, si dhe nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me natyrën e brendshme të rrethanave dhe baraspeshimin e rrethanave, që i bie se llogaritja është kuantitative. Sipas kësaj, këtu kemi të bëjmë me “Ekzistimin e së paku dy rrethanave për zvogëlim të fajësisë apo dëmit dhe asnjë/ose një rrethanë të vogël rënduese”, që në shtojcën 1 të udhëzuesit kualifikohet tek

rastet kur rrethanat arsyetojnë zbutjen maksimale të dënimit brenda kufirit. Sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 2, pika h, në këtë rast dënimi do të duhej të ishte nga gjashtë muaj deri në një vit e gjashtë muaj burgim. e që në rastin konkret është gjashtë muaj me kusht. Sipas kësaj, i bie që në rastin konkret, dënimi është brenda këtyre kufijve.

4. Rasti PKR.nr.53/2019 - Falsifikim i dokumentit zyrtar nga neni 434 par.1 të KPRK

Aktgjykimi i marrë

Sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, N.SH, ishte dënuar dhe shpallur fajtorë për veprën penale “falsifikim i dokumentit zyrtar” Kjo pasi sipas aktgjykimit, ajo në cilësinë e personit zyrtar - Drejtoreshë Ekzekutive në Qendrën për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve (QMGF), më 1 shtator 2014, kishte shfrytëzuar detyrën dhe autoritetin zyrtar duke i tejkaluar kompetencat e saj dhe falsifikuar dokumentin zyrtar, ashtu që pa autorizim të punëtores sociale në QMGF, Xh.O ka vënë nënshkrimin në emër të saj në raportin final që lidhet me marrëveshje të datës 1 shtator 2014, shkresë zyrtare që ka të bëjë me përfitimin e donacioneve nga Ambasada Gjermane.

Dënimi sipas KPRK-së: *dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.*

Dënimi i shqiptuar: *dënim me 150 ditë burg, por që të njëjtin me pëlqimin e të akuzuarës i është zëvendësuar me gjobë në lartësi prej 3.000,00 euro.*

Rrethanat lehtësuese:

1. Pranimin e fajësisë;
2. Faktin se e dënuara është familjare;
3. E pandehura kishte treguar sjellje korrekte gjatë gjykimit;

Rrethanat rënduese

Asnjë.

Përshtatshmëria e dënimit:

Nuk përmendet në aktgjykim.

Zbatimi i udhëzuesit

Përshtatshmëria e dënimit

Përballë katër qëllimeve të dënimit që sipas udhëzuesit duhet të merren parasysh në secilin aktgjykim, gjykata nuk e ka përmendur asnjërin prej këtyre qëllimeve, madje nuk ka thënë asgjë mbi përshtatshmërinë e dënimit.

Zbatimi i parimeve

Gjykata në këtë rast vetëm ka cituar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, duke mos bërë asnjë ndërlidhje me parimet që duhet të merren parasysh me rastin e caktimit të dënimit, siç përcaktohet në udhëzues.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Gjykata nuk jep asnjë sqarim për tre prej rrethanave lehtësuese të përmendura në aktgjykim, por vetëm i citon ato. Tek pranimi i fajësisë, asnjë kërkesë e cila sipas udhëzuesit duhet të aplikohet me rastin e marrjes parasysh të kësaj rrethane, e cila përcakton edhe rëndësinë e kësaj rrethane në rastin konkret, nuk është marrë parasysh, si dhe gjykata nuk ka dhënë përgjigje në katër pyetjet që sipas udhëzuesit, janë relevante në këtë rast. Sa i përket rrethanës tjetër lehtësuese se e akuzuari është familjare, udhëzuesi përcakton shtatë faktorë në të cilët gjykata duhet të bazohet në rastin kur këtë rrethanë e përcakton si rrethanë lehtësuese dhe të njëjtit faktorë duhet ti arsyetojë, gjë të cilën nuk e ka bërë gjykata në këtë aktgjykim. Lidhur me sjelljen korrekte së të pandehurës gjatë procedurës, sipas udhëzuesit, gjykata duhet tu jap përgjigje gjithsej pesë pyetjeve, gjë të cilën gjykata nuk e ka bërë në këtë aktgjykim.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruara nga aktgjykimi

Janë një sërë rrethanash, si lehtësuese ashtu edhe rënduese, të cilat gjykata nuk i ka marrë për bazë në këtë aktgjykim, e madje as nuk ka dhënë arsyetim se pse të njëjtat nuk janë marrë parasysh. Gjykata nuk ka marrë parasysh fare shkallën e dashjes, shkallën e dëmit të shkaktuar, keqpërdorimin e pushtetit ose pozitës zyrtare, shkeljen e besimit, pendimin/mungesën e pendimit nga i dënuari, keqardhjen e shfaqur, (mos) kompensimi i dëmit të shkaktuar, sjelljen e personit të dënuar pas konfliktit, e kaluara kriminale/jo kriminale e të dënuarve, mosha e të pandehurit, kalimin e kohës dhe (mos) mbështetja pala e dëmtuar.

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Gjykata në këtë aktgjykim ka përmendur vetëm tre rrethana lehtësuese dhe asnjë rënduese, si dhe nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me natyrën e brendshme të rrethanave, baraspeshimin e rrethanave si dhe arsyetimin për zbutjen maksimale të dënimit brenda kufirit. Sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, këtu bëhet fjalë për “ekzistimi i së paku dy rrethanave për zvogëlim të fajësisë apo dëmit dhe asnjë/ose një rrethanë të vogël rënduese”, dhe kemi të bëjmë me rastin kur rrethanat arsyetojnë zbutjen maksimale të dënimit brenda kufirit. Në këtë drejtim, sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 2, pika h, dënimi në këtë rast do të duhej të ishte nga gjashtë

muaj deri në një vit e gjashtë muaj dënim me burgim. Në këtë rast, dënimi është marrë brenda kufijve.

5. Rasti PKR.nr.267/18 - Konflikt interesi nga neni 424 par.1 i KPRK-së

Aktgjykimi i marrë

Sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, e dënuara E.N, ishte shpallur fajtor pasi që gjykata kishte gjetur se e njëjta është kryese e veprës penale, “konflikt interesi”. Kjo, pasi sipas aktgjykimit, në cilësinë e personit zyrtar – Sekretare e përgjithshme në Ministrinë e Tregtisë dhe industrisë, me 2 qershor 2014 duke vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore, ka marr vendim me të cilin mjetet financiare në vlerë prej 20.000,00 euro, të ndahen për mbështetje financiare të OJQ-së “Jakova Inovation Center” në të cilën OJQ kishte qenë Drejtore e Bordit.

Dënimi sipas KPRK-së: *dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.*

Dënimi i shqiptuar: *dënim me gjobë në lartësi prej 7.000,00 euro të cilin do ta paguaj brenda 1 viti.*

Rrethanat lehtësuese:

1. Fakti se e dënuara për herë të parë kishte rënë ndesh me ligjin;
2. Sjellje korrekte gjatë gjykimit;

Rrethanat rënduese

Asnjë.

Përshtatshmëria e dënimit:

Gjykata me vendimin e saj është e bindur se do të arrihet qëllimi i dënimit.

Zbatimi i udhëzuesit

Përshtatshmëria e dënimit

Gjykata e merr si të mirëqenë faktin se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit, duke mos përmendur dhe arsyetuar asnjë prej katër qëllimeve të dënimit të cilat sipas udhëzuesit duhet të merren parasysh dhe të arsyetohen në secilin aktgjykim.

Zbatimi i parimeve

Gjykata në këtë rast vetëm ka cituar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, duke mos bërë asnjë ndërlidhje me parimet që duhet të merren parasysh me rastin e caktimit të dënimit, siç përcaktohet në udhëzues.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Gjykata ka marrë vetëm dy rrethana si rrethana lehtësuese, deri sa nuk ka marrë parasysh asnjë rrethanë si rënduese. Sa i përket faktit se e dënuara për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, sipas udhëzuesit, kjo rrethanë kualifikohet tek rrethanat e tjera lehtësuese. Në udhëzues thuhet se nëse gjykata e konstaton mungesën e dënimeve të mëparshme penale dhe mund të jepet zbutja, do të kërkoj gjetje të fakteve që e mbështesin përfundimin e sjelljes përkatëse dhe predispozitat për rehabilitim. Kjo çështje nuk trajtohet fare në këtë aktgjykim. Ndërsa sa i përket sjelljes korrekte, kjo fare nuk përmendet si rrethanë në udhëzues, por mund të jetë si fakt për vërtetimin e ekzistimit të rrethanave të tjera lehtësuese.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruara nga aktgjykimi

Janë një sërë rrethanash, si lehtësuese ashtu edhe rënduese, të cilat gjykata nuk i ka marrë për bazë në këtë aktgjykim, e madje as nuk ka dhënë arsytim se pse të njëjtat nuk janë marrë parasysh. Gjykata nuk ka marrë parasysh fare shkallën e dashjes, shkallën e dëmit të shkaktuar, keqpërdorimin e pushtetit ose pozitës zyrtare, shkeljen e besimit, rrethanat personale dhe karakteri i personit të dënuar, pendimin/mungesën e pendimit nga i dënuari, keqardhjen e shfaqur, (mos) kompensimi i dëmit të shkaktuar, sjelljen e personit të dënuar pas konfliktit, mosha e të pandehurit, kalimin e kohës dhe (mos) mbështetja pala e dëmtuar.

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Gjykata në këtë aktgjykim ka përmendur vetëm dy rrethana lehtësuese dhe asnjë rënduese, si dhe nuk ka dhënë asnjë arsytim lidhur me natyrën e brendshme të rrethanave dhe baraspeshimin e rrethanave. Për këtë arsye, llogaritja është kuantitative. Në rastin konkret, sipas udhëzuesit, bëhet fjalë për “ekzistimin e së paku dy rrethanave për zvogëlim të fajësisë apo dëmit dhe asnjë/ose një rrethanë të vogël rënduese”. Sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, këtu kemi të bëjmë me rastin kur rrethanat arsyetojnë zbutjen maksimale të dënimit brenda kufirit. Sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 1, pika f, dënimi me burgim duhet të jetë nga 1 muaj deri në 8 muaj dënim me burgim, ndërsa ai me gjobë duhet të jetë nga 6250 euro deri në 12500 euro, që i bie se dënimi në këtë rast është brenda këtyre limiteve.

6. Rasti P.nr.125/18 - Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 KPRK-së

Aktgjykimi i marrë

Sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda, N.A, ishte shpallur fajtor dhe dënuar për veprën penale “keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar” Kjo pasi sipas aktgjykimit, i dënuari më 13 maj 2015, në cilësinë e zyrtarit të gjendjes

civile në Bistricë të Shalës, ka tejkaluar kompetencat e tij duke i sjell dobi pasurore personit tjetër. I dënuari duke mos bërë verifikime paraprake e në kundërshtim me udhëzimin administrativ nr.25/2013 ka regjistruar personin N.N., kinse A.S, me shënime kinse ai është banor i fshatit Rvatska, e ku nga zyrtarët e qendrës së regjistrimit në Leposaviq është konstatuar se nuk ekziston një banor i këtij fshati me këtë emër, e që si rezultat i akuzuari N.A, nuk i ka kontrolluar librat e vjetra amzë për të vërtetuar se a janë të sakta dhe origjinale fletëkërkesat e dorëzuara nga N.N. personi kinse A.S, me ç' rast të njëjtin e regjistron në regjistrin e lindjeve dhe njëherësh i lëshon dhe ekstraktin e lindjes. Ai po ashtu ishte shpallur fajtor se në datën, kohën dhe vendin e njëjtë si në pikën e parë të aktakuzës, në cilësinë e zyrtarit të gjendjes civile, ka falsifikuar dokumentin zyrtar ashtu që ka nënshkruar dhe vulosur ekstraktin e lindjes të lëshuar në emër të A.S.

Dënimi sipas KPRK-së: *burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet;*

Dënimi i shqiptuar: *gjashtë (6) muaj burgim me kusht;*

Rrethanat lehtësuese:

1. Pranimi i fajësisë;
2. Pendimi;
3. I dënuari është person i varfër;
4. I dënuari është person familjar;

Rrethanat rënduese:

Asnjë.

Përshtatshmëria e dënimit:

Gjykata vlerëson se dënimi i shqiptuar është adekuat dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi që personat e tjerë të parandalohen nga kryerja e veprave të tilla penale si dhe do të ndikojë tek vet i dënuari që në të ardhmen mos të kryejë ndonjë vepër penale.

Zbatimi i udhëzuesit

Përshtatshmëria e dënimit

Gjykata në këtë aktgjykim i përmend vetëm dy prej katër qëllimeve që udhëzuesi përcakton se duhet të merren parasysh dhe të arsyetohen në çdo aktgjykim. Për më tepër, aktgjykimi këto dy qëllime vetëm i citon dhe nuk tregon se si do të arrihen të njëjtat.

Zbatimi i parimeve

Gjykata në këtë rast vetëm ka cituar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, duke mos bërë asnjë ndërlidhje me parimet që duhet të merren parasysh me rastin e caktimit të dënimit, siç përcaktohet në udhëzues.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Sa i përket pranimit të fajësisë, sipas udhëzuesit janë gjithsej katër pyetje relevante të cilave Gjykata duhet tu japë përgjigje në aktgjykim, gjë që në arsyetimin e këtij aktgjykimi nuk përmendet asnjë. Kështu ka vepruar gjykata edhe përballë tetë faktorëve që kërkohen sa i përket rrethanës së pendimit. Në këtë mënyrë, përderisa gjykata nuk i ka sqaruar këto dy rrethana me fakte dhe prova të caktuara, sipas udhëzuesit, bëhet fjalë për dyfishim të rrethanave. Sa i përket faktit se i dënuari është person i varfër, gjykata nuk e ka mbështetur me asnjë provë këtë. Për më tepër, është e çuditshme se si e ka marrë këtë fakt si rrethanë lehtësuese, përderisa në aktgjykim përmendet se i dënuari është i gjendjes së mesme ekonomike. Ndërsa, në lidhje me atë se si gjykata ka konstatuar se i dënuari është person familjar dhe kjo duhet të merret si rrethanë lehtësuese, në aktgjykim nuk mund të kuptohet se si ka ardhur deri tek një konstatim i tillë, pasi nga shtatë faktorët që sipas udhëzuesit duhet të merren parasysh, gjykata nuk e ka marrë parasysh asnjërin prej tyre. Për më tepër, statusi familjar dhe financiar nuk janë dy rrethana të ndara, por janë dy faktorë me të cilën merret parasysh rrethana e personalitetit dhe karakterit të personit të dënuar. Për këtë arsye, sipas udhëzuesit, këtu bëhet fjalë për dyfishim të rrethanave.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruar nga aktgjykimi

Janë një sërë rrethanash, si lehtësuese ashtu edhe rënduese, të cilat gjykata nuk i ka marrë për bazë në këtë aktgjykim, e madje as nuk ka dhënë arsyetim se pse të njëjtat nuk janë marrë parasysh. Gjykata nuk ka marrë parasysh fare shkallën e dashjes, shkallën e dëmit të shkaktuar, keqpërdorimin e pushtetit ose pozitës zyrtare, shkeljen e besimit, keqardhjen e shfaqur, (mos) kompensimi i dëmit të shkaktuar, sjelljen e personit të dënuar pas konfliktit, moshën e të pandehurit, kalimin e kohës dhe (mos) mbështetja pala e dëmtuar.

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Gjykata në këtë rast nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me rëndësinë e brendshme të rrethanave dhe peshimin e rrethanave. Për këtë arsye, llogaritja është kuantitative. Në rastin konkret, kemi katër rrethana rënduese dhe asnjë rrethanë lehtësuese. Sipas udhëzuesit, këtu bëhet fjalë për “ekzistimin e së paku dy rrethanave për zvogëlim të fajësisë apo dëmit dhe asnjë/ose një rrethanë të vogël rënduese”. Në këtë rast, bazuar në shtojcën 1 të udhëzuesit, pjesa II, pika h, sfera e dënimit është nga gjashtë muaj deri në një vit e gjashtë muaj, që i bie se dënimi është brenda limiteve që përcakton udhëzuesi.

7. Rasti PKR.nr.333/17 - Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 422, par.1 të KPRK-së

Aktgjykimi i marrë

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, më 1 tetor 2018, kishte shpallur fajtor të dënuarin Q.Rr. pasi që kishte ardhur në përfundim se i dënuari derisa ka ushtruar pozitën e zëvendësministrit në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) të Republikës së Kosovës në cilësinë e personit zyrtar, duke e shfrytëzuar pozitën apo autoritetin zyrtar ka tejkalluar kompetencat ligjore dhe me qëllim që vetes t'i sjellë përfitim pasuror të kundërligjshëm ka vepruar në kundërshtim me autorizimet zyrtare, ashtu që gjatë periudhës kohore nga muaji qershor 2015 e deri në muajin janar 2016 nga kredit kartela e tij bankare zyrtare, të lëshuar nga N. P.2, e destinuar për shpenzime të udhëtimeve zyrtare jashtë vendit, i akuzuari ka tërhequr, shpenzuar dhe shkaktuar dëm në shumë prej 12.363,40 euro, për të cilat nuk ka pasur udhëtime të aprovuar zyrtare, me ç rast të dëmtuarës MPMS ia ka kthyer shumën prej 7.504.51 euro, ndërsa dëmi i mbetur ndaj të dëmtuarës arrin shumën 4.858,89 euro.

Dënimi sipas KPRK-së: *burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.*

Dënimi i shqiptuar: *gjashtë (6) muaj burg, dënim i cili me pëlqimin e të dënuarit do të zëvendësohet me gjobë në lartësi prej 3.000 euro.*

Rrethanat lehtësuese:

1. I dënuari nuk kishte qenë i dënuar më parë;
2. Pranimi dhe gatishmërinë për kompensimin e dëmit të dëmtuarës MPMS;

Rrethanat rënduese:

1. Shkallën e lartë të pjesëmarrjes së të akuzuarit në veprën penale duke pasur parasysh se i njëjti ka tërhequr mjete disa herë dhe dëmi ka arritur një shumë të lartë;
2. Qëllimi i kryerjes për kryerjen e veprës penale, përkatësisht qëllimi për përfitim pasuror;
3. Intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur, përkatësisht tani të dëmtuarës MPMS i është shkaktuar dëm i konsiderueshëm material;
4. Shkallën e lartë të dashjes nga tani i akuzuari, duke vepruar në kundërshtim me udhëzimet administrative në fuqi të cilat kanë rregulluar procedurat e përdorimit të kredit kartelës zyrtare;
5. Keqpërdorimi i pozitës zyrtare nga tani i akuzuari në kryerjen e veprës penale, duke keqpërdorur pozitën e tij dhe autoritetin zyrtar;

Përshtatshmëria e dënimit:

Gjykata kishte vlerësuar se dënimi i shqiptuar, i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprave penale për të cilat i akuzuari edhe është shpallur fajtor, si dhe shkallës së përgjegjësisë penale së të akuzuarit dhe se me dënimin e shqiptuar ndaj tij, do të arrihet qëllimi i dënimit, përkatësisht të parandalojë kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandalojë persona të tjerë nga kryerja e veprave

penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga veprat penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, për ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Zbatimi i udhëzuesit

Përshtatshmëria e dënimit

Ndonëse sipas udhëzuesit ka vend për një arsyetim më të madh për secilin qëllim që duhet të merret parasysh, në këtë rast, gjykata ka marrë parasysh katër prej qëllimeve që sipas udhëzuesit duhet të merren parasysh me rastin e nxjerrën së çdo aktgjykimi.

Zbatimi i parimeve

Përfundimisht sjelljes së mëparshme së të dënuarit, të cilën gjykata nuk e ka marrë parasysh në këtë rast, në këtë aktgjykim janë zbatuar të gjitha parimet, në atë formë që secilin prej parimeve të përcaktuar në udhëzues, gjykata e ka arsyetuar me një nga rrethanat e përcaktuara në KPRK dhe udhëzues.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Sikurse tek përshtatshmëria e vendimit, edhe në këtë rast ka vend për një arsyetim më të detajuar të secilës rrethanë të përdorur. Por, ajo çfarë është me rëndësi të thuhet është se në këtë aktgjykim, dy rrethanat lehtësuese dhe katër prej rrethanave rënduese janë arsyetuar në atë formë që është sqaruar edhe rruga se si gjykata ka ardhur tek një konstatim i tillë, që në vete përmban edhe kërkesat e udhëzuesit. Por në bazë të udhëzuesit, fakti se i akuzuari ka keqpërdorur pozitës zyrtare nuk mund të aplikohet si rrethanë rënduese, pasi ky është element i veprës penale për të cilën i pandehuri është dënuar. Sipas udhëzuesit, në këtë rast kemi të bëjmë me dyfishim të rrethanave.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruara nga aktgjykimi

Në këtë aktgjykim, janë disa rrethana si lehtësuese ashtu edhe rënduese, të cilat gjykata nuk i ka marrë për bazë në këtë arsyetim, e madje as nuk ka dhënë arsyetim se pse të njëjtat nuk janë marrë parasysh. Gjukata nuk ka marrë parasysh fare rrethanat personale dhe karakteri i personit të dënuar, pendimin/mungesën e pendimit nga i dënuari, (mos) keqardhjen e shfaqur, (mos) kompensimi i dëmit të shkaktuar, sjelljen e personit të dënuar pas konfliktit, e kaluara kriminale/jo kriminale e të dënuarve, moshën e të pandehurit dhe (mos) mbështetja pala e dëmtuar.

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Ndonëse gjykata ka marrë parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese në këtë rast si dhe ka dhënë arsyetimin e duhur, dënimi i shqiptuar nuk është as për së afërmi siç përcaktohet në shtojcën e udhëzuesit. Në këtë rast, gjykata nuk jep arsyetim mbi peshimin e rrethanave rënduese dhe lehtësuese, por përdor pesë rrethana rënduese dhe dy lehtësuese. Në këtë rast, sipas udhëzuesit, kemi të bëjmë me rastin kur “totali i rrethanave rënduese e

tejkalon dukshëm më shumë atë të rrethanave lehtësuese “, që sipas shtojcës kemi të bëjmë me rastin kur faktorët arsyetojnë dënimin maksimal brenda kufirit. Sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 2, pika h, dënimi në këtë rast duhet të jetë nga katër vite deri në pesë vite burgim, ndërsa në rastin konkret është gjashtë muaj. Nëse do të veprimej sipas shtojcës së udhëzuesit, dënimi me burgim nuk do të mund të konvertohej në dënim me gjobë, por do të duhej që brenda këtyre limiteve të caktohej dënim me burgim efektiv.

8. Rasti P.nr.46/2016 - Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 i KPRK

Aktgjykimi i marrë

Sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda, A.J dhe B.H ishin shpallur fajtorë dhe dënuar për veprën penale “keqpërdorim i pozitës zyrtare” Kjo pasi që të njëjtit, sipas aktgjykimit, në cilësinë e analistëve të kredive në institucionin jo bankar “LESNA”, dega në Mitrovicë, në periudha të ndryshme gjatë vitit 2011, kanë nënshkruar kontrata në emër të kredi marrësve, me ç ‘rast kanë mundësuar lidhjen e kontratave për kredi bujqësore dhe blegtorale, ku vlera e tërësishme e përfitimit të personave të tjerë arrin shumën prej 46.800 euro.

Dënimi sipas KPRK-së: *burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.*

Dënimi i shqiptuar:

A.J ishte dënuar me dy (2) vite e gjashtë (6) muaj burgim efektiv;

B.H, ishte dënuar me gjashtë (6) muaj burgim me kusht;

Rrethanat lehtësuese:

Për të dënuarin A.J:

1. Është i martuar dhe baba i dy fëmijëve;
2. Mbajtës i familjes;
3. Nuk është kryerës i ndonjë vepre tjetër penale;
4. Është relativisht i ri;
5. Sjellje të mirë gjatë gjykimit;

Për të dënuarin B.H:

1. Është relativisht i ri;

2. Për herë të parë ka rënë në kundërshtim me ligjin;
3. Ka qenë punëtor i ri në këtë institucion;
4. Ka menduar se me referencat e marrë nga i dënuari i parë do ti ik përgjegjësisë penale;
5. Pasojat e kësaj vepre penale janë më të vogla se të dënuarit të parë;

Rrethanat rënduese

Për të dënuarin A.J:

1. Shkalla e dëmit të shkaktuar;
2. Shkalla e lartë e dashjes pasi që ka ndikuar tek kredi marrësit që ta marrin kredinë pa qenë prezent;

Për të akuzuarin B.H:

Asnjë

Përshtatshmëria e dënimit:

Nuk është dhënë arsyetim.

Zbatimi i udhëzuesit

Përshtatshmëria e dënimit

Edhe pse udhëzuesi përcakton se në çdo aktgjykim gjykata duhet të marrë parasysh dhe të arsyetojë katër qëllimet e dënimit përkitazi me përshtatshmërinë e dënimit, gjykata në këtë aktgjykim nuk e ka thënë asnjë fjalë të vetme lidhur me këtë çështje.

Zbatimi i parimeve

Vetëm një parim është zbatuar në këtë aktgjykim, në atë mënyrë që sa i përket shkallës së përgjegjësisë penale, gjykata ka marrë parasysh këtë parim duke e arsyetuar të njëjtin me rrethanë rënduese të veçanta, duke arsyetuar se i dënuari i pari ka ndikuar tek kredi marrësit për ta marrë kredinë. Pesë parimet e tjera të përcaktuara në udhëzues, janë injoruar nga gjykata në këtë aktgjykim.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Sa i përket të dënuarit të parë, gjykata ka dyfishuar rrethanat lehtësuese kur ka përcaktuar se i dënuari është i martuar, baba i dy fëmijëve dhe mbajtës i familjes, pasi të gjitha këto, sipas udhëzuesit, hyjnë tek rrethanat personale dhe karakteri i dënuar. Sa i përket moshës relativisht të re, fillimisht sipas udhëzuesit moshë “*relativisht e re*”, nuk ekziston si rrethanë lehtësuese, derisa është e pakuptimtë se si kjo rrethanë merret si rrethanë lehtësuese ndaj të dënuarit i cili në momentin e dënimit ka qenë 32 vjeçar. Lidhur me sjelljen korrekte së të pandehurit gjatë procedurës, sipas udhëzuesit, gjykata duhet tu jap përgjigje gjithsej pesë pyetjeve, gjë të cilën gjykata nuk e ka bërë në këtë aktgjykim. Sa i përket mungesës së dënimeve penale në të kaluarën, sipas udhëzuesit, nëse aplikohet kjo rrethanë gjykata do të

kërkoj gjetje të fakteve që e mbështesin përfundimin e sjelljes përkatëse dhe predispozitat për rehabilitim, fakt i cili në këtë aktgjykim nuk arsyetohet. Sa i përket dy rrethanave rënduese në raport me të dënuarin e parë, gjykata ka dhënë arsyetim të mjaftueshëm se si ka ardhur deri tek ky konstatim.

Sa i përket të dënuarit të dytë, fillimisht, është e paqartë se pse në këtë rast nuk është marrë si rrethanë lehtësuese sjellja korrekte e këtij të dënuari në gjykatë, përderisa kjo është bërë në raport me të dënuarin e parë. Sikurse tek i dënuari i parë, gjykata ngjashëm ka vepruar edhe në raport me të dënuarin e dytë, ku si rrethanë lehtësuese e ka cilësuar moshën relativisht të re së të dënuarit, edhe pse i njëjti në momentin e dënimit ka qenë 30 vjeçar. Si në rastin e parë është vepruar edhe sa i përket faktit se i dënuari për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin. Ndërsa, fakti se i dënuari ka qenë punëtor i ri në këtë institucion, nuk parashihet fare në udhëzues si rrethanë lehtësuese, derisa gjykata nuk ka dhënë asnjë arsyetim se pse kjo rrethanë duhet të merret si rrethanë lehtësuese. Tutje, është jashtëzakonisht e pakuptimtë se si gjykata e ka marrë si rrethanë lehtësuese faktin se i dënuari ka pasur për qëllim ti shmanget përgjegjësisë penale, kur si rrethanë lehtësuese e ka marrë atë se i dënuari “ka menduar se me referencat e marrë nga i dënuari i parë do ti ik përgjegjësisë penale”. Sa i përket asaj se pasojat e veprës penale janë më të vogla se sa tek i dënuari i parë, gjykata me këtë fakt e ka dalluar përgjegjësinë penale në mes të dy të dënuarve, derisa mbetet e pakuptimtë se pse e njëjta të përdoret si rrethanë lehtësuese. Ndërsa, për të dënuarin e dytë, gjykata nuk ka marrë parasysh asnjë rrethanë rënduese.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruara nga aktgjykimi

Janë një sërë rrethanash, si lehtësuese ashtu edhe rënduese, të cilat gjykata nuk i ka marrë për bazë në këtë aktgjykim, e madje as nuk ka dhënë arsyetim se pse të njëjtat nuk janë marrë parasysh. Gjukata nuk ka marrë parasysh fare keqpërdorimin e pushtetit ose pozitës zyrtare, shkeljen e besimit, pendimin/mungesën e pendimit nga i dënuari, (mos) keqardhjen e shfaqur, (mos) kompensimi i dëmit të shkaktuar, sjelljen e personit të dënuar pas konfliktit, kalimin e kohës dhe (mos) mbështetja pala e dëmtuar.

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Sa i përket të dy të dënuarve, gjykata nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me peshimin e rrethanave, që i bie se matja e rrethanave në këtë rast është kuantitative. Sa i përket të dënuarit të parë, gjykata ka marrë parasysh pesë rrethana lehtësuese dhe një rrethanë rënduese. Sipas udhëzuesit, këtu kemi të bëjmë me rastin kur ekzistojnë pak rrethana rënduese së bashku me shumë rrethana lehtësuese apo zbutëse. Sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, kemi të bëjmë me rastin kur rrethanat arsyetojnë zbutjen maksimale të dënimit brenda kufirit. Sipas pjesës 2, pika h e kësaj shtojce, dënimi në këtë rast duhet të jetë gjashtë muaj deri në një vit e gjashtë muaj, e që në rastin konkret është dy vite e gjashë muaj, pra nuk është brenda këtyre limiteve. Situatë e njëjte cilësohet edhe sa i përket të dënuarit të dytë, e që nënkupton se për këtë të dënuar, dënimi është brenda limiteve të shtojcës.

9. Rasti PKR.nr.111/2016 - Marrja e ryshfeti nga neni 343 par.1 i KPK-së

Aktgjykimi i marrë

Sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjiilan- Departamenti për Krime të Rënda, E.E ishte dënuar për veprën penale “marrje ryshfeti”. Kjo pasi sipas aktgjykimit, i dënuari në cilësinë e personit zyrtar, përkatësisht mjek në Spitalin Regjional në Gjiilan, më 22 maj të vitit 2012, në zyrën e tij, ka kërkuar përfitim material për vete, për të kryer një veprim, e të cilin nuk është dashur ta kryej. Ashtu që i njëjti ka kërkuar nga e dëmtuara L.H shumën prej 10 euro, për çdo raport specialistik të lëshuar nga ana e tij, duke marrë në tërësi nga e dëmtuara shumën prej 30 euro.

Dënimi sipas KPRK-së: *dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.*

Dënimi i shqiptuar: *180 ditë burg efektiv dhe dënim plotësues “Ndalim i ushtrimit të profesionit” për një (1) vit.*

Rrethanat lehtësuese:

Asnjë

Rrethanat rënduese:

1. Shfrytëzimi i pozitës së vështirë ekonomike-sociale të së dëmtuarës;
2. Shkallën e përgjegjësisë penale;
3. Rrezikshmërinë shoqërore;

Përshtatshmëria e dënimit:

Gjykata kishte ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit duke i marrë parasysh rrethanat e cekura, është i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, mënyrën e kryerjes së saj dhe përgjegjësinë penale të dënuarit. Gjykata ka vlerësuar se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit dhe rehabilitimi i tij, si dhe parandalimi i personave të tjerë nga kryerja e kësaj vepre penale, gjykimi shoqëror, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit të respektimit të ligjit.

Zbatimi i udhëzuesit

Përshtatshmëria e dënimit

Gjykata në këtë rast ka marrë parasysh tre qëllimet e dënimit, ndërsa nuk ka marrë parasysh fare “viktimat dhe komuniteti” si qëllim i dënimit, gjersa tre qëllimet e marra parasysh, gjykata nuk i ka arsyetuar fare, por vetëm i ka konstatuar si të mirëqena.

Zbatimi i parimeve

Asnjë prej parimeve nuk është zbatuar në mënyrën se si e kërkon udhëzuese. Në këtë aktgjykim, dy prej parimeve të dënimit, shkalla e përgjegjësisë penale dhe intensiteti i rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur (rrezikshmëria shoqërore), në vend se të merreshin si parime dhe të njëjtat të ndërlihdeshin me rrethana të caktuara, vetë të njëjtat janë përdorur si rrethana rënduese.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Sa i përket shfrytëzimit të pozitës së vështirë ekonomike-sociale të së dëmtuarës, gjykata nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me atë se si ka ardhur deri tek konstatimi i këtij fakti si rrethanë rënduese dhe vetëm e ka përmendur, duke mos dhënë asnjë arsyetim. Sa i përket shkallës së përgjegjësisë penale dhe rrezikshmërisë shoqërore, sipas udhëzues, këto janë parime që e udhëheqë gjykatën, dhe jo një rrethanë rënduese. Në këtë rast, sipas udhëzuesit, këtu bëhet fjalë për dyfishim të rrethanave.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruara nga aktgjykimi

Janë një sërë rrethanash, si lehtësuese ashtu edhe rënduese, të cilat gjykata nuk i ka marrë për bazë në këtë aktgjykim, e madje as nuk ka dhënë arsyetim se pse të njëjtat nuk janë marrë parasysh. Gjukata nuk ka marrë parasysh fare shkallën e dashjes, shkallën e dëmit të shkaktuar, keqpërdorimin e pushtetit ose pozitës zyrtare, shkeljen e besimit, rrethanat personale dhe karakteri i personit të dënuar, pendimin/mungesën e pendimit nga i dënuari, keqardhjen e shfaqur, (mos) kompensimi i dëmit të shkaktuar, sjelljen e personit të dënuar pas konfliktit, e kaluara kriminale/jo kriminale e të dënuarve, mosha e të pandehurit, kalimin e kohës dhe (mos) mbështetja pala e dëmtuar.

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Në rastin konkret, gjykata nuk ka caktuar fare rëndësinë e brendshme të rrethanave, si dhe nuk ka dhënë asnjë arsyetim mbi peshimin e rrethanave. Për këtë arsye, llogaritja e rrethanave është kuantitative. Në rastin konkret, janë përdorur tre rrethana rënduese dhe asnjë rrethanë lehtësuese. Ndonëse nuk ka asnjë arsyetim, kjo sipas udhëzuesit është situata kur kemi “dy apo më shumë rrethana të fajësisë apo dëmit të shtuar pa asnjë rrethanë lehtësuese”, e cila në shtojcën e udhëzuesit kualifikohet si rasti kur “faktorët arsyetojnë dënimin maksimal brenda kufirit”. Sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 2, pika h, dënimi në këtë rast duhet të jetë nga katër vite deri në pesë vite burgim efektiv, ndërsa në rastin konkret është gjashtë muaj, apo 180 ditë.

10. Rasti P.nr.20/19 - Dhënia e ryshfetit nga neni 429 par.1 i KPRK-së

Aktgjykimi i marrë

Sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda, Sh.I, ishte shpallur fajtor dhe dënuar për veprën penale “dhënie ryshfeti”.

Kjo pasi sipas aktgjykimit, i dënuari më 19 shkurt 2019, rreth orës 13:20, në Pejë, tek terminali doganor i kishte ofruar dobi pasurore personit zyrtar me qëllim që të njëjtit të mos e kryejnë detyrën zyrtare, ashtu që kur i akuzuari ishte njoftuar nga ana e policit të trafikut se kishte bërë kundërvajtje, i pandehuri fillimisht nxjerrë një kartëmonedhë prej 20 eurosh, mirëpo me pas u thotë policëve të trafikut se qenkan shumë dhe nga aty shkon në pompën e derivateve ku bën ndërrimin e 20 eurove, një 10 euro dhe dy nga ka 5 euro, ku më pas nga dy herë nga 5 euro ia hedhë zyrtarëve policorë në bllokun e tiketave duke u thënë që të mos e shkruajnë dënimin dhe se do t'i qeraste me nga një kafe. E edhe pse i akuzuari ishte njoftuar nga zyrtarët policorë se po bënte veprim korruptiv, ai insiston të mos i shkruhet dënimi, me ç'rast i pandehuri më pas dërgohet në stacion policor.

Dënimi sipas KPRK-së: *dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.*

Dënimi i shqiptuar: *gjashtë (6) muaj me kusht në periudhë verifikuese prej një (1) viti.*

Rrethanat lehtësuese:

- 1 Pranimin e fajësisë;
- 2 Sjelljen e mirë në gjykatë;
- 3 Pendimin e sinqertë për veprën penale;
- 4 Faktin se i dënuari nuk kishte qenë i dënuar më parë;

Rrethanat rënduese:

Asnjë.

Përshtatshmëria e dënimit:

Gjykata e bindur thellësisht se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i sanksionit penal dhe se do të parandalojë që i dënuari të kryente sërish ndonjë vepër tjetër penale.

Zbatimi i udhëzuesit

Përshtatshmëria e dënimit

Gjykata këtu ka marrë parasysh vetëm parandalimin specifik/të veçantë, si qëllim të dënimit, të cilin nuk e ka arsyetuar fare, derisa ka injoruar tre qëllimet e tjera të cilat sipas udhëzuesit duhet të merren parasysh në secilin rast.

Zbatimi i parimeve

Gjykata në këtë rast vetëm ka cituar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, duke mos bërë asnjë ndërlidhje me parimet që duhet të merren parasysh me rastin e caktimit të dënimit, siç përcaktohet në udhëzues.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Sa i përket pranimit të fajësisë, sipas udhëzuesit janë gjithsej katër pyetje relevante të cilave Gjykata duhet tu japë përgjigje në aktgjykim, gjë që në arsyetimin e këtij aktgjykimi nuk përmendet asnjë. Kështu ka vepruar gjykata edhe përballë tetë faktorëve që kërkohen sa i përket rrethanës së pendimit. Në këtë mënyrë, përderisa gjykata nuk i ka sqaruar dhe ndarë këto dy rrethana me fakte dhe prova të caktuara, bëhet fjalë për dyfishim të rrethanave. Sa i përket sjelljes së mirë në gjykatë, kjo fare nuk përmendet si rrethanë në udhëzues, por mund të jetë si fakt për vërtetimin e ekzistimit të rrethanave të tjera lehtësuese. Ndërsa, fakti se i dënuari për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, sipas udhëzuesit, kjo rrethanë kualifikohet tek rrethanat e tjera lehtësuese. Në udhëzues thuhet se nëse gjykata e konstaton mungesën e dënimeve të mëparshme penale dhe mund të jepet zbutja, do të kërkoj gjetje të fakteve që e mbështesin përfundimin e sjelljes përkatëse dhe predispozitat për rehabilitim. Kjo çështje nuk trajtohet fare në këtë aktgjykim.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruar nga aktgjykimi

Janë një sërë rrethanash, si lehtësuese ashtu edhe rënduese, të cilat gjykata nuk i ka marrë për bazë në këtë aktgjykim, e madje as nuk ka dhënë arsyetim se pse të njëjtat nuk janë marrë parasysh. Gjykata nuk ka marrë parasysh fare shkallën e dashjes, shkallën e dëmit të shkaktuar, keqpërdorimin e pushtetit ose pozitës zyrtare, shkeljen e besimit, rrethanat personale dhe karakteri i personit të dënuar, keqardhjen e shfaqur, (mos) kompensimi i dëmit të shkaktuar, sjelljen e personit të dënuar pas konfliktit, mosha e të pandehurit dhe (mos) mbështetja pala e dëmtuar.

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Në këtë rast, gjykata nuk ka përcaktuar rëndësinë e brendshme të rrethanave, derisa nuk ka dhënë asnjë arsyetim mbi peshimin e rrethanave. Për këtë arsye, numërimi i rrethanave cilësohet si kuantitativ. Në këtë aktgjykim, kemi katër rrethana lehtësuese dhe asnjë rrethanë rënduese. Sipas udhëzuesit, këtu kemi të bëjmë me “ekzistimin e së paku dy rrethanave për zvogëlim të fajësisë apo dëmit dhe asnjë/ose një rrethanë të vogël rënduese”, që sipas shtojcës kualifikohet tek rastet kur rrethanat arsyetojnë zbutjen maksimale të dënimit brenda kufirit”. Sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 1, pika f, dënimi në këtë rast duhet të jetë nga një deri në tetë muaj, që i bie se dënimi në këtë aktgjykim është brenda këtyre limiteve.

11. Rasti PKR.nr.335/18 - Dhënia e ryshfetit nga neni 429 par.1 i KPRK-së

Aktgjykimi i marrë

Sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, L.S, ishte shpallur fajtor dhe dënuar për veprën penale “dhënie ryshfeti”.

Kjo pasi sipas gjykatës, i dënuari më 7 nëntor 2018, rreth orës 8:30, në pikë kalimin kufitar në Merdare, i ka ofruar para ryshfet zyrtarit policor M.P në atë mënyrë që derisa polici në

fjalë kishte hyrë në autobusin e udhëtarëve të kompanisë “Barileva Turist”, për t’i regjistruar udhëtarët, vozitësi i kësaj kompanie, i akuzuari L.S. ia kishte ofruar pasaportën policit duke i thënë se “edhe librezë është në pasaportë”, ashtu që kur polici i lartcekur ka hapur pasaportën, në librezë i akuzuari i kishte vendosur 10 euro.

Dënimi sipas KPRK-së: *dënohet me gjobë ose me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tri (3) vjet.*

Dënimi i shqiptuar: *300 euro gjobë.*

Rrethanat lehtësuese:

1. Pranimin e fajësisë;
2. Rrethanat personale dhe karakterin e personit të dënuar;
3. Moshë e re;
4. Bashkëpunimi i përgjithshëm me gjykatën;
5. Sjellja e personit të dënuar pas kryerjes së veprës penale;
6. Fakti se asnjëherë nuk ka rënë ndesh me ligjin;

Rrethanat rënduese:

1. Shkallën e lartë të dashjes;
2. Rrethanat në të cilat është kryer kjo veprë penale;
3. Shkallën e dëmit të shkaktuar;

Përshtatshmëria e dënimit:

Gjykata vlerëson se dënimi i shqiptuar është në proporcion me veprën penale të kryer dhe është e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit në kuptim të preventives individuale, që t’i parandalojë të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe të arrihet qëllimi i dënimit në kuptimin e preventives gjeneralë. Gjykatësi ka arsyetuar edhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese, se si dhe pse ato kanë ndikuar në matjen e lartësisë së dënimit.

Zbatimi i udhëzuesit

Përshtatshmëria e dënimit

Gjykata ka marrë parasysh vetëm dy qëllimet e dënimit, të cilat nuk i ka arsyetuar në atë mënyrë që të kuptohet drejt se si do të arrihen këto dy qëllime me anë të këtij dënimi, derisa ka anashkaluar dy qëllimet e tjera (viktimat dhe komuniteti dhe gjykimi shoqëror, ngritja e moralit dhe forcimi i detyrimit për respektimin e ligjit).

Zbatimi i parimeve

Gjykata në këtë rast vetëm ka cituar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, duke mos bërë asnjë ndërlidhje me parimet që duhet të merren parasysh me rastin e caktimit të dënimit, siç përcaktohet në udhëzues.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Rrethanat lehtësuese, si pranimi i fajësisë, rrethanat personale dhe karakterin e personit të dënuar, bashkëpunimi i përgjithshëm me gjykatën dhe fakti se i dënuari asnjëherë nuk ka rënë ndesh me ligjin, në këtë aktgjykim janë arsyetuar komfort kërkesave të udhëzuesit, në atë mënyrë që gjykata ka treguar se cilët faktorë ka marrë për bazë kur këto rrethana i ka konsideruar si rrethana lehtësuese. Sa i përket sjelljes së të dënuarit pas kryerjes së veprës penale, kjo nuk është arsyetuar fare, në atë mënyrë që të tregohet se si ka qenë kjo sjellje, por vetëm është përmendur. E meta qëndron tek rrethana lehtësuese “*mosha e re*”, pasi i dënuari ishte 32 vjeç në momentin e dënimit, dhe këtë moshë, gjykata e ka konsideruar si “*moshë të re*”, e cila nuk konsiderohet e tillë sipas udhëzuesit. Sa i përket rrethanave rënduese shkalla e lartë e dashjes dhe shkalla e dëmit të shkaktuar, gjykata këto rrethana i ka përdorur dhe arsyetuar sipas kërkesave të udhëzuesit. Rrethana në të cilat është kryer vepra penale si rrethanë lehtësuese, gjykata nuk e ka arsyetuar fare, por vetëm e ka cituar.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruar nga aktgjykimi

Asnjë

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Gjykata në këtë aktgjykim nuk ka dhënë asnjë arsyetim mbi peshimin e rrethanave, që nënkupton se matja e rrethanave është kuantitative. Në këtë rast, kemi gjashtë rrethana lehtësuese dhe tre rënduese, që sipas udhëzuesit bëhet fjalë për rastin kur kemi “Rrethana lehtësuese të kombinuara në përgjithësi (të cilit do lloj) në sasi shumë më të madhe se sa rrethanat rënduese”, e cila në shtojcë kualifikohet tek kolona për rrethanat që arsyetojnë zbutjen maksimale të dënimit brenda kufirit. Në këtë rast, sipas shtojcës 1 të udhëzues, pjesa 1, pika f, dënimi me burgim do të duhej të ishte një muaj deri në tetë muaj, derisa ai me gjobë do të duhej të ishte nga 100 deri në 6250 euro, që i bie se aktgjykimi është marrë brenda këtij limiti.

12. Rasti PKR.nr.356/17 - Keqpërdorim i detyrës zyrtare nga neni 422 par.1 të KPRK

Aktgjykimi i marrë

Sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, i dënuari B.B ishte shpallur fajtor për veprën penale “keqpërdorim i detyrës zyrtar”. Kjo pasi sipas gjykatës, i njëjti më 3 korrik 2013 në Drenas, si person zyrtar të personelit të Stacionit

Policor në Drenas, me qëllim që të përfitoj çfarëdo dobie pasurore për veten apo për tjetrin, duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar, tejkalon kompetencat e tij ashtu që nga i dëmtuari F.I merr të holla në shumë prej 1200 euro, duke i premtuar të dëmtuarit që nuk do të vuaj dënimin për të cilin ishte dënuar nga gjykata.

Dënimi sipas KPRK: *gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vite burgim.*

Dënimi i shqiptuar: *gjashtë (6) muaj burgim efektiv.*

Rrethanat lehtësuese:

1. Fakti se është njëri familjar;
2. Nuk është përsëritës i veprave penale;
3. Sjellja e tij pas kryerjes së veprës penale;
4. Koha e gjatë që nga kryerja e veprës penale;
5. Sjellje të mirë gjatë shqyrtimit gjyqësor;

Rrethanat rënduese

Asnjë.

Përshtatshmëria e dënimit:

Gjykata ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar është në proporcion me peshën e veprës penale, sjelljen dhe rrethanat e kryerësit, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryerësit, me bindje se një dënim i tillë i përgjigjet peshës së veprës penale, sjelljeve dhe shkallës së përgjegjësisë penale, si dhe do të ndikojë në risocializimin e të dënuarit, ngritjen e moralit dhe formimin e detyrimit për respektimin e ligjit, si dhe do të ndikoj tek të tjetër të moj kryejnë vepra penale.

Zbatimi i udhëzuesit

Përshtatshmëria e dënimit

Tre qëllime të dënimit gjykata në këtë rast i merr si të mirëqena dhe vetëm i citon, duke mos dhënë asnjë arsytim për to. Sa i përket qëllimit “*viktimat dhe komuniteti*” gjykata këtë nuk e merr fare parasysh në këtë aktgjykim.

Zbatimi i parimeve

Gjykata në arsyetimin e këtij vendimi, kur ka arsyetuar përshtatshmërinë e dënimit, ka cituar edhe disa prej parimeve të dënimit, por që nuk i ka ndërtuar siç e përcakton udhëzuesi, në atë formë që të njëjtat të ndërliken me rrethana të veçanta, por vetëm i ka cituar të njëjtat.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Sa i përket faktit se i dënuari është person familjar, sipas udhëzuesit janë shtatë faktorë të cilët gjykata duhet ti marrë parasysh kur këtë ta konsiderojë si rrethanë lehtësuese, asnjë prej të cilëve gjykata nuk e ka marrë parasysh dhe arsyetuar në këtë aktgjykim. Sa i përket

mungesës së dënimeve të mëparshme, sipas udhëzuesit, nëse gjykata e konstaton mungesën e dënimeve të mëparshme penale dhe mund të jepet zbutja, do të kërkojë gjetje të fakteve që e mbështesin përfundimin e sjelljes përkatëse dhe predispozitat për rehabilitim, gjë të cilën gjykata nuk e ka bërë në këtë aktgjykim. Për sjelljen e të dënuarit pas kryerjes së veprës penale, sipas udhëzuesit duhet të merren parasysh dy faktorë dhe gjykata duhet tu jap përgjigje tre pyetjeve, e cila nuk është bërë fare në arsyetimin e këtij aktgjykimi. Përcaktimet e udhëzuesit nuk merren parasysh as sa i përket rrethanës lehtësuese “*koha e gjatë që nga kryerja e veprës penale*”. Ndërsa sa i përket sjelljes së mirë gjatë gjykimit, kjo fare nuk përmendet si rrethanë në udhëzues, por mund të jetë si fakt për vërtetimin e ekzistimit të rrethanave të tjera lehtësuese.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruara nga aktgjykimimi

Janë një sërë rrethanash, si rënduese ashtu edhe rënduese, të cilat gjykata nuk i ka marrë për bazë në këtë arsyetim, e madje as nuk ka dhënë arsyetim se pse të njëjtat nuk janë marrë parasysh. Gjukata nuk ka marrë parasysh fare shkallën e pjesëmarrjes së të pandehurve në kryerjen e veprës penale, shkallën e dashjes, shkallën e dëmit të shkaktuar, keqpërdorimin e pushtetit ose pozitës zyrtare, shkeljen e besimit, (mos) pendimin për kryerjen e veprës penale, (mos) keqardhjen e shfaqur, (mos) kompensimi i dëmit të shkaktuar, nëse viktimja ka qenë posaçërisht e pambrojtur apo e ndjeshme, moshën e viktimës dhe (mos)mbështetja pala e dëmtuar.

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Gjukata në këtë aktgjykim nuk ka përcaktuar rëndësinë e brendshme për asnjë prej rrethanave si dhe nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me peshimin e rrethanave. Për këtë arsye, llogaritja është kuantitative. Në këtë aktgjykim janë përdorur pesë rrethana lehtësuese dhe asnjë rrethanë rënduese. Sipas udhëzuesit, këtu kemi të bëjmë me rastet kur kemi rrethana lehtësuese të kombinuara në përgjithësi (të cilit do lloj) në sasi shumë më të madhe se sa rrethanat rënduese, që në shtojcë kualifikohet tek kolona 5, përkatësisht tek rrethanat që arsyetojnë zbutjen maksimale të dënimit brenda kufirit. Sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 2, pika h, dënimi në këtë rast duhet të jetë nga gjashtë muaj deri në një vit e gjashtë muaj dënim me burgim, që i bie se dënimi në këtë rast është brenda kufijve.

13. Rasti PKR.nr.47/19 - Dhënia e ryshfetit nga neni 429 par.1 të KPRK

Aktgjykimimi i marrë

Sipas aktgjykimit të Gjukatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, i dënuari D.F ishte shpallur fajtor për veprën penale “dhënie ryshfeti”. Kjo pasi që sipas aktgjykimit, i njëjti më 5 janar 2019 gjatë procedurave të kalimit në pikën kufitare në Mendarë, si ndihmës vozitës i autobusit në Kompaninë për transportin e udhëtareve “Pollush Trans” në mënyrë të drejtpërdrejtë i kishte ofruar personit zyrtar policit kufitarë të Republikës së Kosovës, dhe atë në shumën prej 10 euro të cilat ia kishte vendosur me librezën e

qarkullimit dhe derisa polici kufitar gjatë kontrollit ia kishte kërkuar sqarimin nëse këto të holla i kishte harruar, ndërsa ai i kishte thënë “nuk janë harruar por janë për një kafe” në mënyrë që personi të veproj në kundërshtim me detyrën e tij zyrtar, ku me ç ‘rast të hollat ishin konfiskuar ndërsa i njëjti ishte arrestuar nga policia e Kosovës.

Dënimi sipas KPRK-së: *gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.*

Dënimi i shqiptuar: *700 euro gjobë.*

Rrethanat lehtësuese:

1. Pranimi i fajësisë;
2. Pendimi i thellë për veprën penale;
3. Premtimi se në të ardhmen nuk do të kryej ndonjë veprë penale;
4. Gjykata nuk ka të dhëna se i dënuari kishte qenë më parë i dënuar;
5. Fakti se është njëri familjar dhe mbajtës i familjes;

Rrethanat rënduese

Asnjë.

Përshtatshmëria e dënimit:

Gjykata ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar është në përputhshmëri me përgjegjësinë penale, me bindje se një sanksion i tillë është në përputhshmëri rrezikshmërinë shoqërore të veprimeve inkriminuese së të akuzuarit dhe përgjegjësisë penale së të njëjtit dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikoj në riedukimin, risocializimin dhe parandalimin e të akuzuarit dhe personave të tjerë nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, me çka do të arrihet qëllimi përgjithshëm dhe i veçantë i dënimit.

Zbatimi i udhëzuesit

Përshtatshmëria e dënimit

Gjykata në këtë rast ka marrë parasysh vetëm dy prej qëllimeve të dënimit të cilat fare nuk i ka arsytuar, derisa dy qëllimet e tjera (gjykimi shoqëror, ngritja e moralit dhe forcimi i detyrimit për respektimin e ligjit dhe viktimat dhe komuniteti) gjykata nuk i ka marrë parasysh dhe nuk i ka arsytuar fare në këtë aktgjykim.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Sa i përket pranimit të fajësisë dhe pendimit për kryerjen e veprës penale, gjykata ka dhënë një arsytim modest, derisa arsytimi nuk është dhënë në përputhje të plotë me kërkesat e udhëzuesit. Pothuajse ngjashëm ka vepruar gjykata edhe kur ka marrë si rrethanë lehtësuese

faktin se i dënuari është familjar, kur ka thënë se është mbajtës i familjes, derisa ka anashkaluar dhe nuk ka arsyetuar shtatë faktorët që udhëzuesi kërkon të merren parasysh. Sa i përket mungesës së dënimeve të mëparshme, sipas udhëzuesit, nëse gjykata e konstaton mungesën e dënimeve të mëparshme penale dhe mund të jepet zbutja, do të kërkoj gjetje të fakteve që e mbështesin përfundimin e sjelljes përkatëse dhe predispozitat për rehabilitim, gjë të cilën gjykata nuk e ka bërë në këtë aktgjykim.

Zbatimi i parimeve

Gjykata në këtë rast vetëm ka cituar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, duke mos bërë asnjë ndërlidhje me parimet që duhet të merren parasysh me rastin e caktimit të dënimit, siç përcaktohet në udhëzues.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruara nga aktgjykimi

Janë një sërë rrethanash, si lehtësuese ashtu edhe rënduese, të cilat gjykata nuk i ka marrë për bazë në këtë aktgjykim, e madje as nuk ka dhënë arsytim se pse të njëjtat nuk janë marrë parasysh. Gjykata nuk ka marrë parasysh fare shkallën e dashjes, shkallën e dëmit të shkaktuar, keqpërdorimin e pushtetit ose pozitës zyrtare, shkeljen e besimit, (mos) kompensimi i dëmit të shkaktuar, sjelljen e personit të dënuar pas konfliktit, mosha e të pandehurit, dhe (mos) mbështetja pala e dëmtuar.

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Gjykata në këtë aktgjykim nuk ka dhënë asnjë arsytim mbi peshimin e rrethanave, që nënkupton se matja e rrethanave është kuantitative. Në këtë rast, kemi katër rrethana lehtësuese dhe asnjë rënduese, që sipas udhëzuesit bëhet fjalë për rastin kur kemi “marrëveshja mbi pranimin e fajësisë apo pranimi i fajësisë në fazë të hershme të procesit pa asnjë asnjë/ose një rrethanë të vogël rënduese”, e cila në shtojcë kualifikohet tek kolona për rrethanat që arsyetojnë zbutjen maksimale të dënimit brenda kufirit. Në këtë rast, sipas shtojcës 1 të udhëzues, pjesa 1, pika f, dënimi me burgim do të duhej të ishte një deri në tetë muaj, derisa ai me gjobë do të duhej të ishte nga 100 deri në 6250 euro, që i bie se aktgjykimi është marrë brenda këtij limiti.

14. Rasti PKR.nr.343/18 - Dhënia e ryshfetit, nga neni 429 par. 1 të KPR

Aktgjykimi i marrë

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, më 24 janar 2019, kishte shpallur fajtor të dënuarin B.R për veprën penale “dhënia e ryshfetit”. Kjo pasi që sipas aktgjykimit, i dënuari më 1 nëntor 2018, rreth orës 08:00, në pikë kalimin kufitar më Merdarë, në mënyrë të drejtpërdrejtë i ka dhënë ryshfet zyrtarit policor të Republikës së

Kosovës A.K., i cili kishe hyrë në autobusin e kompanisë "B." nga S. derisa vinte nga A. për në Kosovë për kontrollim të dokumenteve të udhëtarëve dhe gjatë kontrollës, i akuzuari i jep dokumentin e tij personal zyrtarit policor A.K. dhe nën dokument kishte futur një monedhë të letrës me vlerë 10 euro, e kur zyrtari policor e pyet se çka janë këto, i dënuari- vozitësi ju kishe drejtuar me fjalët "merri për një kafe", në atë moment polici e ndalon të akuzuarin dhe e raporton rastin duke e njoftuar përgjegjësën e ndërrimit M.M..

Dënimi sipas KPRK-së: *dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.*

Dënimi i shqiptuar: *dënimi me tre (3) muaj burg me kusht në periudhë verifikuese prej (një) 1 viti.*

Rrethanat lehtësuese:

1. Sjelljen e tij korrekte në gjykatë gjatë shqyrtimit;
2. Pranimin e fajësisë;
3. Pendimin e tij për veprën e kryer penale;
4. Premtimin se nuk do të përsërisë apo nuk do të kryejë ndonjë vepër penale;
5. Sinqeritetin e tij deklarues;
6. Faktin se për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin;

Rrethanat rënduese:

Asnjë.

Përshtatshmëria e dënimit:

Gjykata vlerësoi se dënimi i shqiptuar është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit, shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikojë në risocializimin dhe riedukimin e kryesit, si dhe do të ndikojnë te të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i përgjithshëm i dënimit. Sipas gjykatës ky dënim është risocializim i të akuzuarit me anë të pezullimit të dënimit. Me anë të këtij dënimi, kryesit i tërhiqet vërejtja seriozisht dhe i bëhet me dije, se nëse kryen vepër tjetër penale dënimi i suspenduar për një kohë të caktuar do të ekzekutohet. Gjykata pjesërisht i arsyeton këto rrethane dhe qëllimin e dënimit.

Zbatimi i udhëzuesit

Përshtatshmëria e dënimit

Sa i përket qëllimeve të dënimit, gjykata ka marrë parasysh vetëm tre prej katër qëllimeve që sipas udhëzuesit duhet të merren parasysh dhe të arsyetohen në secilin aktgjykim. Gjykata ka dhënë një arsyetim modest vetëm sa i përket parandalimit specifik apo të veçantë, derisa vetëm i ka përmendura dy të tjerat. Sa i përket qëllimit "viktimat dhe komuniteti", gjykata nuk e ka marrë fare parasysh dhe nuk e ka arsyetuar këtë qëllim të dënimit.

Zbatimi i parimeve

Gjykata në arsyetimin e këtij vendimi, kur ka arsyetuar përshtatshmërinë e dënimit, ka cituar edhe disa prej parimeve të dënimit, por që nuk i ka ndërtuar siç e përcakton udhëzuesi, në atë formë që të njëjtat të ndërlidhen me rrethana të veçanta, por vetëm i ka cituar të njëjtat.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Për asnjë prej rrethanave të përdorura në këtë rast, gjykata nuk ka dhënë asnjë arsyetim, por vetëm i ka cituar rrethanat. Sa i përket pranimi të fajësisë, sipas udhëzuesit janë gjithsej katër pyetje relevante të cilave Gjykata duhet tu japë përgjigje në aktgjykim, gjë që në arsyetimin e këtij aktgjykimi nuk përmendet asnjë. Kështu ka vepruar gjykata edhe përballë tetë faktorëve që kërkohen sa i përket rrethanës së pendimit. Në këtë mënyrë, përderisa gjykata nuk i ka sqaruar këto dy rrethana me fakte dhe prova të caktuara, sipas udhëzuesit, kemi të bëjmë me dyfishim të rrethanave. Lidhur me sjelljen korrekte së të pandehurit gjatë procedurës, sipas udhëzuesit, gjykata duhet tu jap përgjigje gjithsej pesë pyetjeve, gjë të cilën gjykata nuk e ka bërë në këtë aktgjykim. Premtimi se në të ardhmen nuk do të kryejë veprë tjetër penale, në udhëzues nuk përmendet fare si rrethanë lehtësuese. Situata është kështu edhe sa i përket rrethanës tjetër lehtësuese të përdorur në këtë aktgjykim, “*sinqeriteti deklaruar*”, ku në këtë rast, gjykata vërehet se ka bërë dyfishimin e rrethanave, pasi “*sinqeriteti deklarues*” është kusht i domosdoshëm që gjykata ta aprovojë pranimin e fajësisë nga i pandehuri. Sa i përket faktit se e dënuara për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, sipas udhëzuesit, kjo rrethanë kualifikohet tek rrethanat e tjera lehtësuese. Në udhëzues thuhet se nëse gjykata e konstaton mungesën e dënimeve të mëparshme penale dhe mund të jepet zbutja, do të kërkoj gjetje të fakteve që e mbështesin përfundimin e sjelljes përkatëse dhe predispozitat për rehabilitim. Kjo çështje nuk trajtohet fare në këtë aktgjykim.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruara nga aktgjykimi

Janë një sërë rrethanash, si lehtësuese ashtu edhe rënduese, të cilat gjykata nuk i ka marrë për bazë në këtë aktgjykim, e madje as nuk ka dhënë arsyetim se pse të njëjtat nuk janë marrë parasysh. Gjykata nuk ka marrë parasysh fare shkallën e dashjes, shkallën e dëmit të shkaktuar, keqpërdorimin e pushtetit ose pozitës zyrtare, shkeljen e besimit, rrethanat personale dhe karakteri i personit të dënuar, keqardhjen e shfaqur, (mos) kompensimi i dëmit të shkaktuar, sjelljen e personit të dënuar pas konfliktit, mosha e të pandehurit dhe (mos) mbështetja pala e dëmtuar.

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Gjykata në këtë aktgjykim nuk ka dhënë asnjë arsyetim mbi peshimin e rrethanave, që nënkupton se matja e rrethanave është kuantitative. Në këtë rast, kemi gjashtë rrethana lehtësuese dhe asnjë rënduese, që sipas udhëzuesit bëhet fjalë për rastin kur kemi “marrëveshja mbi pranimin e fajësisë apo pranimi i fajësisë në fazë të hershme të procesit pa asnjë asnjë/ose një rrethanë të vogël rënduese”, e cila në shtojcë kualifikohet tek kolona për rrethanat që arsyetojnë zbutjen maksimale të dënimit brenda kufirit. Në këtë rast, sipas

shtojcës 1 të udhëzues, pjesa 1, pika f, dënimi me burgim do të duhej të ishte një deri në tetë muaj, që i bie se aktgjykimi është marrë brenda këtij limiti.

15. Rasti PKR.nr. 266/16 - Dhënia e ryshfetit nga neni 429 par.1 KPRK-së

Aktgjykimi i marrë

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, më 26 shtator 2018, kishte shpallur fajtor të dënuarin N.A, pasi që kishte ardhur në përfundim se i njëjti, më 20 gusht 2015, rreth orës 09:00, në pikë kalimin kufitar në Merdarë, në mënyrë të drejtpërdrejtë i ka ofruar para personit zyrtar në mënyrë që të veproje në pajtim me detyrën e tij zyrtare, ashtu që si vozitës i Agjensionit turistik "B.T.", ishte ndaluar nga rreshteri B.M., i cili ishte në kryerjen e detyrës zyrtare, në kabinën e daljes ku bëhen kontrollimet dhe regjistrimet e dokumenteve nevojshme për kalimin e kufirit dhe në mes të librezës qarkullimit të automjetit ka futë kartëmonedhën në vlerë prej 10 euro, në emër të ryshfetit dhe me qëllim të lehtësimit të kalimit të kufirit..

Dënimi sipas KPRK-së: *dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet..*

Dënimi i shqiptuar: *dënim me gjobë në shumën prej 200 euro.*

Rrethanat lehtësuese:

- 1.Sjelljen e tij korrekte në gjykatë gjatë shqyrtimit gjyqësor;
- 2.Pranimin e fajësisë;
- 3.Nuk ka qenë i dënuar më parë;

Rrethanat rënduese:

Asnjë

Përshtatshmëria e dënimit:

Gjykata kishte vlerësuar se dënimi i shqiptuar si në dispozitiv të aktgjykimit, është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljet dhe rrethanat e kryesit, shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e saj, ku në këtë rast ka aplikuar dispozitën e zbutjes së dënimit me bindje se dënimi i tillë do të ndikojë në risocializimin dhe riedukimin e kryesve, si dhe do të ndikojë tek të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Zbatimi i udhëzuesit

Përshtatshmëria e dënimit

Sa i përket qëllimeve të dënimit, gjykata ka marrë parasysh vetëm tre prej katër qëllimeve që sipas udhëzuesit duhet të merren parasysh dhe të arsyetohen në secilin aktgjykim, e që gjykata nuk e ka arsyetuar asnjërin prej tyre, por vetëm i ka marrë si të mirëqena dhe i ka cituar. Sa i përket qëllimit “*viktimat dhe komuniteti*”, gjykata nuk e ka marrë fare parasysh dhe nuk e ka arsyetuar këtë qëllim të dënimit.

Zbatimi i parimeve

Gjykata në arsyetimin e këtij vendimi, kur ka arsyetuar përshtatshmërinë e dënimit, ka cituar edhe disa prej parimeve të dënimit, por që nuk i ka ndërtuar siç e përcakton udhëzuesi, në atë formë që të njëjtat të ndërlidhen me rrethana të veçanta, por vetëm i ka cituar të njëjtat.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Për asnjë prej rrethanave të përdorura në këtë rast, gjykata nuk ka dhënë asnjë arsyetim, por vetëm i ka cituar rrethanat. Sa i përket pranimit të fajësisë, sipas udhëzuesit janë gjithsej gjashtë faktorë që gjykata duhet ti marr parasysh, gjë që në arsyetimin e këtij aktgjykimi nuk përmendet asnjë. Lidhur me sjelljen korrekte së të pandehurit gjatë procedurës, sipas udhëzuesit, gjykata duhet tu jap përgjigje gjithsej pesë pyetjeve, gjë të cilën gjykata nuk e ka bërë në këtë aktgjykim. Ndërsa, sa i përket faktit se i dënuari për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, sipas udhëzuesit, kjo rrethanë kualifikohet tek rrethanat e tjera lehtësuese. Në udhëzues thuhet se nëse gjykata e konstaton mungesën e dënimeve të mëparshme penale dhe mund të jepet zbutja, do të kërkoj gjetje të fakteve që e mbështesin përfundimin e sjelljes përkatëse dhe predispozitat për rehabilitim. Kjo çështje nuk trajtohet fare në këtë aktgjykim.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruara nga aktgjykimi

Janë një sërë rrethanash, si lehtësuese ashtu edhe rënduese, të cilat gjykata nuk i ka marrë për bazë në këtë aktgjykim, e madje as nuk ka dhënë arsyetim se pse të njëjtat nuk janë marrë parasysh. Gjykata nuk ka marrë parasysh fare shkallën e dashjes, shkallën e dëmit të shkaktuar, keqpërdorimin e pushtetit ose pozitës zyrtare, shkeljen e besimit, rrethanat personale dhe karakteri i personit të dënuar, pendimin/mungesën e pendimit nga i dënuari, keqardhjen e shfaqur, (mos) kompensimi i dëmit të shkaktuar, sjelljen e personit të dënuar pas konfliktit, mosha e të pandehurit, kalimin e kohës dhe (mos) mbështetja pala e dëmtuar.

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Gjykata në këtë aktgjykim nuk ka dhënë asnjë arsyetim mbi peshimin e rrethanave, që nënkupton se matja e rrethanave është kuantitative. Në këtë rast, kemi katër rrethana lehtësuese dhe asnjë rënduese, që sipas udhëzuesit bëhet fjalë për rastin kur kemi “marrëveshja mbi pranimin e fajësisë apo pranimit të fajësisë në fazë të hershme të procesit pa asnjë asnjë/ose një rrethanë të vogël rënduese”, e cila në shtojcë kualifikohet tek kolona për rrethanat që arsyetojnë zbutjen maksimale të dënimit brenda kufirit. Në këtë rast, sipas shtojcës 1 të udhëzues, pjesa 1, pika f, dënimi me burgim do të duhej të ishte një deri në tetë muaj, derisa ai me gjobë do të duhej të ishte nga 100 deri në 6250 euro, që i bie se aktgjykimi është marrë brenda këtij limiti.

16. Rasti PKR.nr.83/18 - Marrja e ryshfeti nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së

Aktgjykimi i marrë

Sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti për Krime të Rënda, A.T dhe N.B ishin dënuar për veprën penale “marrje ryshfeti”. Sipas aktgjykimit, të njëjtit më 29 tetor 2014, në afërsi të restorantit “Giri” në Qafë të Duhles, në cilësinë e rojeve të pyllit në Drejtorinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në Komunën e Suharekës, në mënyrë të drejtpërdrejtë kërkojnë para për vete, me qëllim të mos veprojnë në pajtim me detyrat e tyre zyrtare, ashtu që deri sa i akuzuari A.T ishte në detyrë të rojtarit në Njësinë Ekonomike në Caralevë, F.Q e ka hasur duke prerë dru me motor sharrë dhe ka kërkuar nga ai që të shkojë në restorantin “Giri” në “Qafë të Duhles”, pasi që ka nevojë të konsultohet me kolegë të tjerë. Më pas, vazhdon aktgjykimi, kur arrijnë përballë restorantit, i afrohet i akuzuari N.B, duke i thënë “nëse ka para për ti dhënë, nuk do t’i shkruajnë procesverbal, por do ia falin”. Kështu, i dëmtuari F.Q ia jep 45 euro të akuzuarit N.B, i cili fillimisht i merr këto para dhe shkon në konsultim me të akuzuarin A.T i cili ishte në automjet, ku ky i fundit e hap dritaren e automjetit dhe nga aty i gjuan paratë dhe kërkon nga i dëmtuari 100 euro për mos paraqitje të rastit në gjykatë.

Dënimi sipas KPRK-së: *dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.*

Dënimi i shqiptuar: *gjashtë (6) muaj burg dhe 500 euro gjobë.*

Rrethanat lehtësuese:

1. Rrethanat personale;
2. Gjendjen ekonomike te tyre;
3. Janë mbajtës të familjes;
4. Në gjykim kanë qenë korrekt;

Rrethanat rënduese:

1. Shkalla e pjesëmarrjes në veprën e kryer me dashje direkte;

Përshtatshmëria e dënimit:

Gjykata vlerëson se dënimi i shqiptuar do të arrin efektin e dënimit dhe se një dënim i tillë është në proporcion me veprën penale të kryer dhe rrethanat personale të cilat i posedojnë të dënuarit.

Zbatimi i udhëzuesit

Përshtatshmëria e dënimit

Gjykata në këtë rast vetëm ka konstatuar se ky dënim do ta arrin efektin e vet, derisa nuk ka marrë parasysh dhe nuk ka arsyetuar asnjërin prej katër qëllimeve të dënimit të cilat sipas udhëzuesit duhet të merren parasysh në secilin aktgjykim.

Zbatimi i parimeve

Në këtë aktgjykim, sipas kërkesave të udhëzuesit, gjykata ka zbatuar vetëm një parim, atë të shkallës së pjesëmarrjes së të pandehurit në kryerjen e veprës penale, të cilën e ka lidhur me një rrethanë të veçantë dhe të njëjtën e ka arsyetuar. Sa i përket parimeve të tjera, në këtë rast, të njëjtat nuk janë zbatuar dhe arsyetuar sipas kërkesave të udhëzuesit.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Sa i përket tri rrethanave të para lehtësuese (rrethanat personale, gjendja ekonomike e të dënuarve dhe se janë mbajtës të familjes), gjykata ka trefishuar rrethanat, pasi gjendja ekonomike dhe gjendja familjare janë fakte që duhet të vërtetohen në mënyrë që “*rrethanat personale*” të merret si rrethanë lehtësuese. Po ashtu, vetëm për të marrë parasysh gjendjen familjare si rrethanë lehtësuese, gjykata, sipas udhëzuesit, duhet të marrë parasysh dhe të arsyetojë shtatë faktorë, gjë të cilën nuk e ka bërë në këtë aktgjykim. Lidhur me sjelljen korrekte së të pandehurve gjatë procedurës, sipas udhëzuesit, gjykata duhet tu jap përgjigje gjithsej pesë pyetjeve, gjë të cilën gjykata nuk e ka bërë në këtë aktgjykim. Ndërsa, sa i përket rrethanës rënduese “*shkalla e pjesëmarrjes në veprën e kryer me dashje direkte*”, as këtu gjykata nuk jep asnjë arsyetim. Sipas KPPRK-së dhe udhëzuesit, shkalla e pjesëmarrjes dhe shkalla e dashjes janë dy rrethana të ndara rënduese, të cilat gjykata në këtë aktgjykim i përmend si një të vetme. Në anën tjetër, nëse i referohet vetëm dashjes direkte, këtu kemi të bëjmë përsëri me dyfishim të rrethanave, pasi dashja direkte është element qenësor i veprës penale për të cilën të pandehurit janë dënuar. Sipas udhëzuesit, në këtë rrethanë, gjykata duhet të shqyrtojë kontributin individual të secilit pjesëmarrës në raport me njëri tjetrin, që gjykata nuk e ka bërë, por vetëm e ka cituar për të dy të pandehurit, çfarë nuk përkon me kërkesat e udhëzuesit. Për më tepër, në këtë rrethanë rënduese sipas udhëzuesit, gjykata duhet të marrë parasysh dhe të arsyetojë gjashtë faktorë, si dhe tu jap përgjigje shtatë pyetjeve relevante, gjë të cilën gjykata nuk e ka bërë fare në këtë aktgjykim.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruara nga aktgjykimi

Janë një sërë rrethanash, si lehtësuese ashtu edhe rënduese, të cilat gjykata nuk i ka marrë për bazë në këtë aktgjykim, e madje as nuk ka dhënë arsyetim se pse të njëjtat nuk janë marrë parasysh. Gjykata nuk ka marrë parasysh fare shkallën e dëmit të shkaktuar, keqpërdorimin e pushtetit ose pozitës zyrtare, shkëljen e besimit, pendimin/mungesën e pendimit nga i dënuari, keqardhjen e shfaqur, (mos) kompensimi i dëmit të shkaktuar, sjelljen e personit të dënuar pas konfliktit, e kaluara kriminale/jo kriminale e të dënuarve, moshën e të pandehurit, kalimin e kohës dhe (mos) mbështetja pala e dëmtuar.

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Gjykata në këtë aktgjykim nuk ka dhënë asnjë arsyetim mbi rëndësinë e brendshme dhe peshimin e rrethanave, që nënkupton se matja e rrethanave është kuantitative. Në këtë rast, kemi katër rrethana lehtësuese dhe një rënduese, që sipas udhëzuesit bëhet fjalë për rastin kur kemi “ekzistimi e së paku dy rrethanave për zvogëlim të fajësisë apo dëmit dhe asnjë/ose një rrethanë të vogël rënduese”, e cila në shtojcë kualifikohet tek kolona për rrethanat që arsyetojnë zbutjen maksimale të dënimit brenda kufirit. Në këtë rast, sipas shtojcës 1 të udhëzues, pjesa 2, pika h, dënimi me burgim duhet të jetë gjashtë muaj deri në një vit e gjashtë muaj, derisa ai me gjobë do të duhej të ishte nga 100 deri në 6250 euro, që i bie se aktgjykimi në këtë rast është marrë brenda këtij limiti.

17. Rasti PKR.nr.222/15 - Dhënie Ryshfeti nga neni 429 par.1 dhe 5 të KPRK

Aktgjykimi i marrë

Sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, i dënuari N.E ishte shpallur fajtor për veprën penale “dhënie ryshfeti”. Kjo pasi sipas gjykatës, i dënuari më 8 janar 2015, në pikën kufitare Mendare me qëllim të kontrabandimit, me veturën e markës “Golf” me qëllim që zyrtari policor të mos veprojnë në pajtim me detyrën e tij zyrtare, deri sa ishte duke e paraqitur dokumentacionin personit zyrtar B.Za, së bashku me dokumentacionin e veturës i kishte ofruar shumën prej 50 euro duke i thënë se këto janë për ty.

Dënimi sipas KPRK-së: *gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.*

Dënimi i shqiptuar: *3.600 euro gjobë.*

Rrethanat lehtësuese:

1. I dënuari nuk ka qenë më parë i gjykuar apo i dënuar;
2. Sjelljen korrekte para dhe pas kryerjes së veprës penale;
3. Koha e gjatë që nga kryerja e veprës penale;
4. Baba i pesë fëmijëve dhe mbajtës i familjes;

Rrethanat rënduese

1. Shkallën e lartë të dashjes;
2. Kryerjen e veprës penale me paramendim;
3. Shkalla e lartë e rrezikimit të vlerave të mbrojtura;

Përshtatshmëria e dënimit:

Gjykata ka vlerësuar se dënimi me gjobë i shqiptuar është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale së të dënuarit dhe se do ta parandalojë atë dhe personat e tjerë nga kryerja e veprave të tjera penale.

Zbatimi i udhëzuesit

Përshtatshmëria e dënimit

Gjykata në këtë aktgjykim ka cituar vetëm parandalimin specifik apo të veçantë dhe parandalimin e përgjithshëm, derisa nuk ka dhënë kurrfarë arsytimi për asnjërin prej tyre. Sa i përket dy qëllimeve të tjera (gjykimi shoqëror, ngritja e moralit dhe forcimi i detyrimit për respektimin e ligjit dhe viktimat dhe komuniteti) gjykata nuk i ka marrë parasysh dhe nuk i ka arsyetuar fare të njëjtat.

Zbatimi i parimeve

Gjykata në këtë rast vetëm ka cituar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, duke mos bërë asnjë ndërlidhje me parimet që duhet të merren parasysh me rastin e caktimit të dënimit, siç përcaktohet në udhëzues. Sa i përket shkallës së përgjegjësisë penale, ky parim citohet tek përshtatshmëria e dënimit të dhënë me anë të këtij aktgjykimi, por i njëjti nuk arsyetohet me rrethana të veçanta, siç edhe është kërkesë e udhëzuesit.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Sa i përket mungesës së dënimeve të mëparshme, sipas udhëzuesit, nëse gjykata e konstaton mungesën e dënimeve të mëparshme penale dhe mund të jepet zbutja, do të kërkoj gjetje të fakteve që e mbështesin përfundimin e sjelljes përkatëse dhe predispozitat për rehabilitim, gjë të cilën gjykata nuk e ka bërë në këtë aktgjykim. Lidhur me sjelljen korrekte së të pandehurit gjatë procedurës, sipas udhëzuesit, gjykata duhet tu jap përgjigje gjithsej pesë pyetjeve, gjë të cilën gjykata nuk e ka bërë në këtë aktgjykim. Kështu ka vepruar gjykata edhe përballë shtatë faktorëve që duhet të merren parasysh lidhur me sjelljen e të dënuarit para kryerjes së veprës penale. Sa i përket kalimit të kohës, gjykata nuk jep asnjë konsideratë në arsyetimin e këtij aktgjykimi. Sa i përket rrethanës lehtësuese se i dënuari është baba i pesë fëmijëve dhe mbajtës i familjes, gjykata në këtë rast ka marrë parasysh vetëm dy prej shtatë faktorëve që sipas udhëzuesit kërkohen të merren në këto raste. Sa i përket rrethanave rënduese, gjykata nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me rrethanën rënduese “*shkalla e lartë e dashjes*”. Lidhur me këtë rrethana, gjykata ka trajtuar vetëm një pyetje relevante të kësaj rrethane, derisa ka anashkaluar gjashtë pyetje të tjera relevante dhe gjashtë faktorë. Si pyetje të vetme relevante, gjykata e ka trajtuar paramendimin e të pandehurit. Por, këtë nuk e ka cilësuar në nivel të faktorit, por në nivel të rrethanës së veçantë rënduese, çka paraqet dyfishim të rrethanave. Sa i përket shkallës së lartë të rrezikimit të vlerave të mbrojtura, gjykata në këtë rast thotë vetëm atë se kemi të bëjmë me vepra penale kundër detyrës zyrtare, deri nuk merr parasysh fare katër faktorët të cilët i përcakton udhëzuesi përkitazi me këtë rrethanë.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruara nga aktgjykimi

Janë një sërë rrethanash, si lehtësuese ashtu edhe rënduese, të cilat gjykata nuk i ka marrë për bazë në këtë aktgjykim, e madje as nuk ka dhënë arsytim se pse të njëjtat nuk janë marrë parasysh. Gjykata nuk ka marrë parasysh fare, keqpërdorimin e pushtetit ose pozitës zyrtare, shkeljen e besimit, pendimin/mungesën e pendimit nga i dënuari, keqardhjen e shfaqur, (mos) kompensimi i dëmit të shkaktuar, mosha e të pandehurit, dhe (mos) mbështetja pala e dëmtuar.

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Gjykata në këtë aktgjykim nuk ka dhënë asnjë arsytim mbi peshimin e rrethanave, që nënkupton se matja e rrethanave është kuantitative. Në këtë rast, kemi katër rrethana lehtësuese dhe tre rrethana rënduese, që sipas udhëzuesit bëhet fjalë për rastin kur kemi “ekzistimin e pak rrethanave rënduese së bashku me shumë rrethana lehtësuese apo zbutëse (rrethanë individuale apo rrethana të kombinuara) në sasi më të madhe se sa rrethanat rënduese”, e cila në shtojcë kualifikohet tek kolona për faktorët që tregojnë më shumë rrethana lehtësuese sesa rënduese. Në këtë rast, sipas shtojcës 1 të udhëzues, pjesa 1, pika f, dënimi me burgim do të duhej të ishte nga tetë muaj deri në një vit, derisa ai me gjobë do të duhej të ishte nga 6250 deri në 8333 euro, që i bie se aktgjykimi nuk është marrë brenda këtij limiti.

18. Rasti PKR.nr.327/18 - Marrje ryshfeti nga neni 428 par.1 i KPRK

Aktgjykimi i marrë

Sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë– Departamenti për Krime të Rënda, i dënuari R.K, ishte shpallur fajtor pasi që më 6 korrik 2018, rreth orës 10:30, si Drejtor i Repartit të Urologjisë në QKUK, me dashje dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm ka kërkuar dhe ka pranuar 100 euro ryshfet nga i dëmtuari B.H, mënyrë që nipi i tij F. H, të futej në listën e operimit në mënyrë të përsheptuar. Më pas, nën masat e simulimit të veprës penale të korrupsionit, i dëmtuari ka hyrë në repartin e Urologjisë dhe në zyrën e tani të pandehurit ia dorëzon paratë e kërkuara, ku më pas të njëjtat gjenden në xhepin e të dënuarit dhe konfiskohen nga hetuesi policor dhe menjëherë arrestohet.

Dënimi sipas KPRK-së: *dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.*

Dënimi i shqiptuar: *nëntë (9) muaj burg dhe 2,000.00 gjobë.*

Rrethanat lehtësuese:

1. Është person i moshës së shtyrë pak para pensionimit;
2. I pa dënuar më parë me aktgjykim të formës së prerë;
3. Ka pranuar fajësinë dhe është penduar;
4. Shprehja e keqardhjes dhe pendimit të sinqertë dhe real;

Rrethanat rënduese

1. Niveli i dëmtimit të vlerës së mbrojtur;
2. Mënyra e kryerjes së veprës penale;
3. Shkalla e lartë e dashjes;
4. Veprimi me përgjegjësi;

Përshtatshmëria e dënimit:

Gjykata vlerëson se dënimi i shqiptuar është në proporcion me peshën dhe rëndësinë e veprës penale, dhe se është e bindur se dënimi i shqiptuar do të shërbej si preventivë individuale dhe gjeneral duke e parandaluar që në të ardhmen të kryej vepra penale. Po ashtu, gjykata vlerëson se me anë të këtij dënimi do të parandalohet i pandehuri por edhe kryerësit e tjerë eventual që në të ardhmen mos të kryejnë veprime të tilla.

Zbatimi i udhëzuesit

Përshtatshmëria e dënimit

Sa i përket përshtatshmërisë së dënimit, gjykata e merr si të mirëqenë arritjen e qëllimit individual dhe gjeneral, duke mos dhënë asnjë arsytim se si do të arrihet ky dënim përmes këtij qëllimi. Sa i përket dy qëllimeve të tjera (gjykimi shoqëror, ngritja e moralit dhe forcimi i detyrimit për respektimin e ligjit dhe viktimat dhe komuniteti) gjykata nuk i merr fare parasysh dhe nuk i arsyeton.

Zbatimi i parimeve

Gjykata në këtë rast vetëm ka cituar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, duke mos bërë asnjë ndërlidhje me parimet që duhet të merren parasysh me rastin e caktimit të dënimit, siç përcaktohet në udhëzues. Por, dy prej parimeve të dënimit, e që janë intensiteti i rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, gjykata nuk i përcakton si parime të dënimit dhe të njëjtat ti arsyetojë me rrethana rënduese ose lehtësuese, por vetë të njëjtat i përdorë si rrethana rënduese.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Sa i përket moshës së të pandehurit si rrethanë lehtësuese, gjykata në këtë rast ka konstatuar se i njëjti është para pensionimit, përcaktimi i cili nuk ceket në udhëzues. Për më tepër, gjykata në këtë rast nuk ka marrë parasysh dhe nuk ka arsyetuar nëntë faktorët të cilët sipas udhëzuesit duhet të merren parasysh në këtë rast. Sa i përket faktit se i dënuari për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, sipas udhëzuesit, kjo rrethanë kualifikohet tek rrethanat e tjera lehtësuese. Në udhëzues thuhet se nëse gjykata e konstaton mungesën e dënimeve të

mëparshme penale dhe mund të jepet zbutja, do të kërkoj gjetje të fakteve që e mbështesin përfundimin e sjelljes përkatëse dhe predispozitat për rehabilitim. Kjo çështje nuk trajtohet fare në këtë aktgjykim. Sa i përket pendimit, gjykata në këtë rast ka bërë dyfishimin e rrethanave, pasi pranimit i fajit dhe keqardhja e shprehur, sipas udhëzuesit, janë pjesë e pendimit, dhe jo rrethana të veçanta dhe të ndara. Për më tepër, sipas udhëzuesit, edhe keqardhja ka lidhshmëri të veçantë me pranimin e fajësisë, diferencimin e të cilit gjykata nuk e ka bërë në arsyetimin e këtij aktgjykimi. Po ashtu, sa i përket pranimit të fajësisë, në udhëzues janë përcaktuar katër faktorë që duhet të merren parasysh në çdo aktgjykim me rastin kur kjo rrethanë konstatohet si rrethanë lehtësuese, gjë të cilën gjykata nuk e ka bërë në këtë aktgjykim. Në këtë mënyrë gjykata ka vepruar edhe përballë shtatë faktorëve që duhet të merren parasysh tek rrethana e shprehjes së keqardhjes. Sa i përket nivelit të dëmtimit të vlerës së mbrojtur dhe mënyrës së kryerjes, këtu kemi dyfishim të rrethanave, pasi sipas udhëzuesit këto kualifikohen si parime të dënimit, dhe jo si rrethana të veçanta rënduese ose lehtësuese. Po ashtu, dyfishim të rrethanave kemi edhe në rastin kur gjykata merr si rrethanë rënduese shkallën e lartë të dashjes dhe veprimin me përgjegjësi, pasi veprimi me përgjegjësi, sipas udhëzuesit, është pyetje relevante për shkallën e lartë të dashjes, dhe jo rrethanë e veçantë rënduese.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruara nga aktgjykimimi

Janë një sërë rrethanash, si lehtësuese ashtu edhe rënduese, të cilat gjykata nuk i ka marrë për bazë në këtë aktgjykim, e madje as nuk ka dhënë arsyetim se pse të njëjtat nuk janë marrë parasysh. Gjykata nuk ka marrë parasysh fare keqpërdorimin e pushtetit ose pozitës zyrtare, shkeljen e besimit, rrethanat personale dhe karakteri i personit të dënuar, (mos) kompensimi i dëmit të shkaktuar, sjelljen e personit të dënuar pas konfliktit dhe (mos) mbështetja pala e dëmtuar.

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Gjykata në këtë aktgjykim nuk ka dhënë asnjë arsyetim mbi rëndësinë e brendshme dhe peshimin e rrethanave, që nënkupton se matja e rrethanave është kuantitative. Në këtë rast, kemi katër rrethana lehtësuese dhe katër rënduese, që sipas udhëzuesit bëhet fjalë për rastin kur kemi “Rrethanat rënduese dhe lehtësuese janë të barabarta dhe asnjëra nuk mbizotëron mbi tjetrën”, e cila në shtojcë kualifikohet tek kolona e pikënisjes për matjen e dënimit.. Në këtë rast, sipas shtojcës 1 të udhëzues, pjesa 2, pika h, dënimi me burgim duhet të jetë dy vjet e gjashtë muaj, derisa ai me gjobë do të duhej të ishte nga 12500 euro, që i bie se aktgjykimimi në këtë rast nuk është marrë brenda këtij përcaktimi.

19. Rasti PKR.nr.181/14 - Përvetësim në detyrë nga neni 425 par.1 lidhur me 31 të KPRK-së

Aktgjykimimi i marrë

Sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Krime të Rënda, B.F, I.H dhe P.K ishin dënuar për veprën penale “përvetësim në detyrë”. Kjo pasi sipas

aktgjykimit, në bashkëkryerje B.F depoist dhe I.H, shitës ambulant kishin ngarkuar mall, përkatësisht detergjent rrobash “Duel”, më tepër se sa kishte qenë në faturë. Ndërkaq, të njëjtit më 4 mars të të njëjtit vit, ishin zënë në flagrancë duke e kryer këtë veprim, ku pastaj malli edhe ishte kthyer në depo. Vlera totale për të cilën akuzohen se e kanë përvetësuar, përmes këtyre veprimeve, kap shumë prej 878,88 eurosh. Ndërsa, i akuzuari V.I për të cilin është veçuar procedura, në cilësinë e shitësit ambulant, ia kishte shitur produktin “Duel”, i cili kishte qenë e ofertës “gratis”, pronarit të maketit, në vlerë totale prej 33.20 euro, dhe për të njëjtin mall nuk kishte dhënë faturë të shitjes. Po ashtu, procedura është veçuar edhe ndaj F.S. Ndërsa i dënuari P.K, mallin, i cili kishte dalë nga depoja nuk e kishin faturuar, duke i shkaktuar kështu dëm material kompanisë në fjalë.

Dënimi sipas KPRK-së: *dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.*

Dënimi i shqiptuar:

B.F: *dënim me gjobë 1.000 dhe dënim me burg 6 muaj i cili i zëvendësohet me gjobë në shumë prej 3.000 euro - dënim unik 4.000 euro.*

I.H: *dënim me gjobë 500 euro dhe me burg katër muaj i cili i zëvendësohet me gjobë në lartësi prej 2.000 euro – dënim unik 2.500 euro.*

P.K: *dënim me gjobë në shumë prej 1.000 euro dhe dënim me burgim gjashtë muaj i cili i zëvendësohet me gjobë në lartësi prej 3.000 euro – dënim unik 4.000 euro.*

Rrethanat lehtësuese:

1. Të dënuarit nuk kanë qenë më parë të dënuar;
2. Sjelljen e treguar pas kryerjes së veprës penale;
3. Për të dënuarit P.K dhe I.H, veçanërisht fakti se janë familjar dhe mbajtës të familjes;
4. Për B.F moshën relativisht të re;
5. Koha relativisht e gjatë që nga kryerja e veprës penale;

Rrethanat rënduese:

Asnjë

Përshtatshmëria e dënimit:

Gjykata ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprave penale të kryera dhe shkallën e përgjegjësisë penale, si dhe do të ndikoj si preventivë gjeneralë, individuale si dhe në forcimin e moralit të shoqërisë dhe disiplinës qytetare.

Zbatimi i udhëzuesit

Përshtatshmëria e dënimit

Sa i përket përshtatshmërisë së dënimit, gjykata e merr si të mirëqenë arritjen e qëllimit individual, gjeneral dhe forcimit të moralit të shoqërisë dhe disiplinës qytetare, duke mos dhënë asnjë arsytim se si do të arrihen këto qëllime përmes këtij qëllimi. Sa i përket qëllimit tjetër (viktimat dhe komuniteti) gjykata nuk e merr fare parasysh dhe nuk i arsyeton.

Zbatimi i parimeve

Gjykata në këtë rast vetëm ka cituar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, duke mos bërë asnjë ndërlidhje me parimet që duhet të merren parasysh me rastin e caktimit të dënimit, siç përcaktohet në udhëzues. Sa i përket sjelljes së të pandehurit pas kryerjes së veprës penale, i cili në udhëzues përcaktohet si parim, të njëjtin gjykata e përdorë vetëm si rrethanë rënduese, duke mos e ndërlidhur dhe arsyetuar me asnjë rrethanë të veçantë.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Sa i përket faktit se të dënuarit për herë të parë kanë rënë ndesh me ligjin, sipas udhëzuesit, kjo rrethanë kualifikohet tek rrethanat e tjera lehtësuese. Në udhëzues thuhet se nëse gjykata e konstaton mungesën e dënimeve të mëparshme penale dhe mund të jepet zbutja, do të kërkoj gjetje të fakteve që e mbështesin përfundimin e sjelljes përkatëse dhe predispozitat për rehabilitim. Kjo çështje nuk trajtohet fare në këtë aktgjykim. Sa i përket sjelljes së të dënuarve pas kryerjes së veprës penale, sipas udhëzuesit, kjo është parim dhe jo rrethanë, që i bie se parimi është përdorur si rrethanë, që paraqet dyfishim të rrethanave. Sa i përket rrethanës lehtësuese se i akuzuari është familjar, udhëzuesi përcakton shtatë faktorë në të cilët gjykata duhet të bazohet në rastin kur këtë rrethanë e përcakton si rrethanë lehtësuese dhe të njëjtit faktorë duhet ti arsyetojë. Në këtë rast kjo nuk është përmbushur, pasi gjykata ka marrë parasysh vetëm një faktorë (se janë mbajtës të familjes), derisa ka injoruar gjashtë faktorë të tjerë. Sa i përket moshës relativisht të re, fillimisht sipas udhëzuesit mosha “*relativisht e re*”, nuk ekziston si rrethanë lehtësuese. Në rastin konkret, janë nëntë faktorë që duhet të merren parasysh dhe sipas udhëzuesit, të arsyetohen në këto raste, gjë të cilën gjykata nuk e ka bërë në këtë aktgjykim. Për më tepër, i dënuari në kohën e kryerjes së veprës penale, ka qenë mbi 18 vjeçar. Sa i përket kalimit të kohës, gjykata nuk jep asnjë konsideratë në arsyetimin e këtij aktgjykimi.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruara nga aktgjykimi

Janë një sërë rrethanash, si lehtësuese ashtu edhe rënduese, të cilat gjykata nuk i ka marrë për bazë në këtë aktgjykim, e madje as nuk ka dhënë arsytim se pse të njëjtat nuk janë marrë parasysh. Gjykata nuk ka marrë parasysh fare shkallën e dashjes, shkallën e dëmit të shkaktuar, keqpërdorimin e pushtetit ose pozitës zyrtare, shkeljen e besimit, pendimin/mungesën e pendimit nga i dënuari, keqardhjen e shfaqur, kompensimi/mos kompensimi i dëmit të shkaktuar dhe (mos) mbështetja nga viktimat.

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Gjykata në këtë aktgjykim nuk ka dhënë asnjë arsyetim mbi rëndësinë e brendshme dhe peshimin e rrethanave, që nënkupton se matja e rrethanave është kuantitative. Në këtë rast, kemi pesë rrethana lehtësuese dhe asnjë rënduese, që sipas udhëzuesit bëhet fjalë për rastin kur kemi “ekzistimin e së paku dy rrethanave për zvogëlim të fajësisë apo dëmit dhe asnjë/ose një rrethanë të vogël rënduese”, e cila në shtojcë kualifikohet tek kolona kur rrethanat arsyetojnë zbutjen maksimale të dënimit brenda kufirit. Në këtë rast, sipas shtojcës 1 të udhëzues, pjesa 2, pika h, dënimi me burgim duhet të jetë nga gjashtë muaj deri në një vjet e gjashtë muaj dënimin me burgim, si dhe gjobë në lartësi prej nga 100 euro deri në 6250 euro. Në rastin konkret, dënimi me gjobë është brenda këtyre limiteve për të tre të dënuarit, e po ashtu, brenda këtij limiti është edhe dënimi me burgim për të dënuarin e parë dhe të tretë. Sa i përket të dënuarit të dytë i cili në këtë rast është dënuar me katër muaj burgim, gjykata nuk ka dhënë asnjë arsyetim se pse në këtë rast të dënuarit duhet ti zbutet dënimi komfor nenit 75 të KPRK-së.

20. Rasti P.nr.121/18 - Përvetësim në detyrë nga neni 425 par.1 i KPRK

Aktgjykimi i marrë

Sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda, A.A, ishte shpallur fajtor për veprën penale “përvetësim në detyrë”, pasi që prej janarit deri në mars të vitit 2016, si person zyrtar, inkasant në Kompaninë Rajonale e Ujësjellësit “Mitrovica” në Mitrovicë, në vazhdimësi me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore ka përvetësuar pasurinë – paratë që i janë besuar për shkak të detyrës, ashtu që një pjesë të parave që ka arkëtuar prej konsumatorëve që kanë paguar për shfrytëzimin e ujit, i ka përvetësuar për vete, gjithsej shumën në vlerë prej 263.40 euro. Konsumatorët të dënuari si inkasant kanë paguar shuma të tjera, derisa i akuzuari në flete dorëzimin e pazarit ditor ka shkruar shuma më të ulëta.

Dënimi sipas KPRK-së: *dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.*

Dënimi i shqiptuar: *gjashtë (6) muaj me kusht në periudhë verifikuese prej 2 vitesh.*

Rrethanat lehtësuese:

1. Pranimin e fajësisë;
2. Sjelljen e mirë në gjykatë;
3. Pendimin e sinqertë për veprën penale;
4. Ka bërë kompensimin e dëmit ndaj Kompanisë Regjionale të Ujësjellësit;
5. Faktin se është njeri familjar, baba i dy fëmijëve;

Rrethanat rënduese:

Asnjë

Përshtatshmëria e dënimit:

Gjykata vlerëson se dënimi me kusht i shqiptuar ndaj të dënuarit është në përputhshmëri të plotë me shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrezikun shoqëror për veprën penale për të cilën akuzohet i pandehuri. Madje gjykata po ashtu vlerëson se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që të parandalohet kryerësi i veprës penale por edhe personat e tjerë, që në të ardhmen mos të kryejnë veprime të tilla.

Zbatimi i udhëzuesit

Përshtatshmëria e dënimit

Sa i përket përshtatshmërisë së dënimit, gjykata e merr si të mirëqenë arritjen e qëllimit individual dhe gjeneral, duke mos dhënë asnjë arsyetim se si do të arrihen këto qëllime përmes këtij qëllimi. Sa i përket dy qëllimeve të tjera (gjykimi shoqëror, ngritja e moralit dhe forcimi i detyrimit për respektimin e ligjit dhe viktimat dhe komuniteti) gjykata nuk i merr fare parasysh dhe nuk i arsyeton.

Zbatimi i parimeve

Gjykata në këtë rast vetëm ka cituar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, duke mos bërë asnjë ndërlidhje me parimet që duhet të merren parasysh me rastin e caktimit të dënimit, siç përcaktohet në udhëzues.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Sa i përket pendimit, gjykata në këtë rast ka bërë dyfishimin e rrethanave, pasi pranimi i fajit dhe keqardhja e shprehur, sipas udhëzuesit, janë pjesë e pendimit, dhe jo rrethana të veçanta dhe të ndara. Për më tepër, sipas udhëzuesit, edhe keqardhja ka lidhshmëri të veçantë me pranimin e fajësisë, diferencimin e të cilit gjykata nuk e ka bërë në arsyetimin e këtij aktgjykimi. Po ashtu, sa i përket pranimit të fajësisë, në udhëzues janë përcaktuar katër faktorë që duhet të merren parasysh në çdo aktgjykim me rastin kur kjo rrethanë konstatohet si rrethanë lehtësuese, gjë të cilën gjykata nuk e ka bërë në këtë aktgjykim. Lidhur me sjelljen korrekte së të pandehurit gjatë procedurës, sipas udhëzuesit, gjykata duhet tu japë përgjigje gjithsej pesë pyetjeve, gjë të cilën gjykata nuk e ka bërë në këtë aktgjykim. Sa i përket kompensimit të dëmit, në udhëzues janë të përcaktuara shtatë pyetje relevante të cilave gjykata duhet tu japë përgjigje, gjë të cilën gjykata nuk e ka bërë në këtë aktgjykim. Sa i përket faktit se i dënuari është familjar, gjykata në këtë rast vetëm ka cekur numrin e fëmijëve, duke i anashkaluar gjashtë faktorët e tjerë të cilët i përcakton udhëzuesi.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruara nga aktgjykimi

Janë një sërë rrethanash, si lehtësuese ashtu edhe rënduese, të cilat gjykata nuk i ka marrë për bazë në këtë aktgjykim, e madje as nuk ka dhënë arsyetim se pse të njëjtat nuk janë marrë parasysh. Gjykata nuk ka marrë parasysh fare shkallën e dashjes, shkallën e dëmit të shkaktuar, keqpërdorimin e pushtetit ose pozitës zyrtare, shkeljen e besimit, (mos) keqardhjen e shfaqur, sjelljen e personit të dënuar pas konfliktit, e kaluara (jo) kriminale e të dënuarit, moshën e të pandehurit dhe kalimin e kohës.

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Gjykata në këtë aktgjykim nuk ka dhënë asnjë arsyetim mbi rëndësinë e brendshme dhe peshimin e rrethanave, që nënkupton se matja e rrethanave është kuantitative. Në këtë rast, kemi pesë rrethana lehtësuese dhe asnjë rënduese, që sipas udhëzuesit bëhet fjalë për rastin kur kemi “ekzistimin e së paku dy rrethanave për zvogëlim të fajësisë apo dëmit dhe asnjë/ose një rrethanë të vogël rënduese”, e cila në shtojcë kualifikohet tek kolona kur rrethanat arsyetojnë zbutjen maksimale të dënimit brenda kufirit. Në këtë rast, sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 2, pika h, dënimi me burgim duhet të jetë nga gjashtë muaj deri në një vit e gjashtë muaj dënimit me burgim, si dhe gjobë në lartësi prej nga 100 euro deri në 6250 euro. Në rastin konkret, i bie që dënimi me burgim është brenda këtij limiti. Ndërsa, në këtë rast, kjo veprë penale përmban dy dënime kumulative, si atë me burgim ashtu edhe dënim me gjobë. Këtë të fundit, gjykata në këtë rast nuk e ka shqiptuar fare.

21. Rasti DKR. P.nr.111/2018 - Legalizim i përmbajtjes së rreme nga neni 403 par.2 lidhur me par.1 të KPRK, Falsifikim i dokumentit zyrtar nga neni 434 par 1 i KPRK, Falsifikim i dokumentit zyrtar nga neni 431 par.1 i KPRK dhe Deklarim i rremë nën betim nga neni 391 par.1 i KPRK-së

Aktgjykimi i marrë

Sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda, A.K, Rr.M, B.B ishin shpallur fajtorë për veprat penale “legalizim i përmbajtjes së rreme”, “falsifikim i dokumentit zyrtar” dhe “deklarim i rremë nën betim”.

Sipas aktgjykimit, e dënuara A.K, më 12 qershor 2014, është regjistruar në librat amzë të lindurve duke u prezantuar me dokumente të falsifikuara dhe atë vërtetimin e shkollës fillore “Emin Duraku”, në Sferkë, vërtetimin e vaksinimit të lëshuar nga ish-Shtëpia e Shëndetësisë në Klinë, të 26 shtatorit 2000, e në të cilat dokumente është fshirë emri A.K është vendosur emri L.K, ashtu që e dënuara ka prezantuar dokumentin e falsifikuar dhe i ka vënë në lajthim zyrtarët, kinse A.K ka vdekur në vitin 2006, kurse këtu e pandehura është fëmija tjetër binjak,

ndërsa më parë është regjistruar së bashku me A.K, e të cilat të dhëna për L.K i ka përdorur e pandehura A.K.

Ndërsa, i dënuari Rr.M, është shpallur fajtor pasi që më 12 qershor 2014, në fshatin Sferkë, pikërisht në zyrën e gjendjes civile, si person zyrtar, në regjistrin dhe dokumentin zyrtar ka shënuar të dhëna të rreme ashtu që në cilësinë e zyrtarit të gjendjes civile, duke i përdorur dokumentet e falsifikuara të prezantuara nga e dënuara A.K, i ka regjistruar në librin amzë të lindjeve, duke ia lëshuar edhe ekstraktin e lindjes dhe atë jo në emër të saj, por në emër të L.K.

Kurse, B.B, është shpallur fajtor pasi që më 6 shtator 2014, në shkollën fillore “Emin Duraku”, në fshatin Sferkë, Komuna e Klinës, si sekretar shkolle, në dokumentin zyrtar, ka shënuar të dhëna të rreme të A.K, duke i përdorur dokumentet e falsifikuara të cilat ia kishte prezantuar e dënuara A.K, Krasniqi, duke ia lëshuar vërtetimin se kinse L.K ka qenë nxënës i asaj shkolle, në vitin shkollor 1997/1998, edhe pse e ka ditur që ai nuk ka qenë nxënës i asaj shkolle.

Ndërsa, K.K dhe G.M, ishin shpallur fajtorë pasi që më, 14 tetor 2016, në Gjykatën Themelore në Pejë, dega në Klinë, në cilësinë e dëshmitarëve kanë dhënë dëshmi të rreme, kur kanë deklaruar se e ndjera A.K ka vdekur më 10 maj 2006, nga vdekja natyrore, në fshatin Pereghev, Komuna e Klinës, ku edhe është varrosur me qëllim që këtë vërtetim më pas e pandehura A.K ta përdor për nxjerrjen e letërnjoftimit në emër të L.K.

Dënimi sipas KPRK-së:

Legalizimi i përmbajtjes së rreme: *dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në pesë (5) vjet.*

Falsifikimi i dokumentit zyrtar: *dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.*

Deklarimi i rremë nën betim: *dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.*

Dënimi i shqiptuar:

A.K: *Dënim me burgim, tetë (8) muaj me kusht në periudhë verifikuese prej një (1) viti.*

Rr.M: *Dënim me burgim, gjashtë (6) muaj me kusht në periudhë verifikuese prej një (1) viti.*

B.B: *Dënim me burgim, gjashtë (6) muaj me kusht në periudhë verifikuese prej një (1) viti.*

K.K: *Dënim me burgim, tre (3) muaj me kusht në periudhë verifikuese prej një (1) viti.*

G.M: *Dënim me burgim, tre (3) muaj me kusht në periudhë verifikuese prej një (1) viti.*

Rrethanat lehtësuese:

1. Sjellja e të akuzuarve para dhe pas kryerjes së veprës penale;
2. Të dënuarit nuk kanë qenë të dënuar më parë dhe nuk kanë kryer ndonjë vepër tjetër penale;
3. Janë prindër dhe mbajtës të familjes;
4. Gjendje tejet të dobët ekonomike;
5. E kanë pranuar që në fillim fajësisë për veprat penale për të cilat janë akuzuar;

Rrethanat rënduese:

Asnjë

Përshtatshmëria e dënimit:

Gjykata kishte ardhur në përfundim se dënimet e shqiptuara janë në proporcion me shkallën e përgjegjësisë penale së të akuzuarve, rrezikshmërinë shoqërore të veprave penale të kryera dhe me intensitetin e pasojës së shkaktuar, duke qenë e sigurt se dënimet e shqiptuara janë të baras-peshuar dhe do të jenë në funksion të arritjes së qëllimit të dënimit, në atë mënyrë që si kryerësit e këtyre veprave penale por edhe të tjerët do të parandalohen nga kryerja e veprimeve të tilla në të ardhmen.

Zbatimi i udhëzuesit

Përshtatshmëria e dënimit

Sa i përket përshtatshmërisë së dënimit, gjykata e merr si të mirëqenë arritjen e qëllimit individual dhe gjeneral, duke mos dhënë asnjë arsytim se si do të arrihen këto qëllime përmes këtij qëllimi. Sa i përket dy qëllimeve të tjera (gjykimi shoqëror, ngritja e moralit dhe forcimi i detyrimit për respektimin e ligjit dhe viktimat dhe komuniteti) gjykata nuk i merr fare parasysh dhe nuk i arsyeton.

Zbatimi i parimeve

Gjykata në këtë rast vetëm ka cituar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, duke mos bërë asnjë ndërlidhje me parimet që duhet të merren parasysh me rastin e caktimit të dënimit, siç përcaktohet në udhëzues. Dy prej parimeve të dënimit (shkalla e përgjegjësisë penale dhe intensiteti i rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur) gjykata i ka cituar tek përshtatshmëria e dënimit, duke mos i ndërlidhur me asnjë rrethanë lehtësuese apo rënduese si dhe duke mos dhënë asnjë arsytim për këto dy parime.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Sa i përket sjelljes së të dënuarve pas konfliktit, gjykata nuk ka dhënë asnjë përgjigje lidhur me tre pyetjet relevante të cekura në udhëzues, derisa nuk dihet se çfarë ka pasur parasysh gjykata kur si rrethanë lehtësuese ka përmendur sjelljen e të akuzuarve para kryerjes së veprës penale. Në rastin konkret, nuk mund të merret parasysh fakti se të dënuarit nuk kanë qenë të dënuar më parë, pasi këtë rrethanë, gjykata e ka cituar si rrethanë të veçantë lehtësuese. Sa i përket rrethanës lehtësuese se të dënuarit nuk kanë qenë të dënuar më parë, sipas udhëzuesit, kjo rrethanë kualifikohet tek rrethanat e tjera lehtësuese. Në udhëzues thuhet se nëse gjykata e konstaton mungesën e dënimeve të mëparshme penale dhe mund të jepet zbutja, do të kërkoj gjetje të fakteve që e mbështesin përfundimin e sjelljes përkatëse dhe predispozitat për rehabilitim. Kjo çështje nuk trajtohet fare në këtë aktgjykim. Sa i përket rrethanës lehtësuese se të dënuarit janë prindër dhe mbajtës të familjes, gjykata në këtë rast vetëm ka cekur vetëm faktin se janë mbajtës të familjes, duke i anashkaluar shtatë faktorët e tjerë të cilët i përcakton udhëzuesi. Sa i përket asaj se të dënuarit janë mbajtës të familjes, gjykata nuk ka dhënë arsyetim nëse të dënuarit janë mbajtës të vetëm të familjes. Sa i përket gjendjes së dobët ekonomike, kjo sipas udhëzuesit nuk mund të citohet si rrethanë e veçantë lehtësuese, por është faktorë për të zbatuar rrethanën lehtësuese “rrethanat personale dhe karakteri i personit të dënuar”. Në këtë mënyrë, këtu sipas udhëzuesit kemi të bëjmë me dyfishim të rrethanave. Sa i përket pranimi të fajësisë, gjykata vetëm ka treguar se të dënuarit kanë pranuar që në fillim fajësinë, element i cili është kërkesë e udhëzuesit, duke anashkaluar tre pyetjet e tjera të cilave sipas udhëzuesit duhet tu ipet përgjigje në këtë rast.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruar nga aktgjykimi

Janë një sërë rrethanash, si lehtësuese ashtu edhe rënduese, të cilat gjykata nuk i ka marrë për bazë në këtë aktgjykim, e madje as nuk ka dhënë arsyetim se pse të njëjtat nuk janë marrë parasysh. Gjukata nuk ka marrë parasysh fare shkallën e dashjes, shkallën e dëmit të shkaktuar, keqpërdorimin e pushtetit ose pozitës zyrtare, shkëlqen e besimit, pendimin/mungesën e pendimit nga i dënuari, keqardhjen e shfaqur, (mos) kompensimi i dëmit të shkaktuar, mosha e të pandehurve, kalimin e kohës dhe (mos) mbështetja nga pala e dëmtuar.

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Gjukata në këtë aktgjykim nuk ka dhënë asnjë arsyetim mbi rëndësinë e brendshme dhe peshimin e rrethanave, që nënkupton se matja e rrethanave është kuantitative. Në këtë rast, kemi pesë rrethana lehtësuese dhe asnjë rënduese, që sipas udhëzuesit bëhet fjalë për rastin kur kemi “ ekzistimin e së paku dy rrethanave për zvogëlim të fajësisë apo dëmit dhe asnjë/ose një rrethanë të vogël rënduese”, e cila në shtojcë kualifikohet tek kolona kur rrethanat arsyetojnë zbutjen maksimale të dënimit brenda kufirit. Sa i përket veprës penale të legalizimit të përmbajtjes së rreme, sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 2, pika c, dënimi në këtë rast duhet të jetë nga tre muaj deri në një vit e tre muaj, që i bie se dënimi është brenda këtij limiti. Sa i përket veprës penale falsifikimi i dokumentit zyrtar, sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 2, pika h, dënimi në këtë rast duhet të jetë nga 6 muaj deri në 1 vjet e 6 muaj, që i bie se dënimi është brenda limitit. Ndërsa, sa i përket veprës penale deklarimi i

rremë nën betim, sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 1, pika f, dënimi duhet të jetë nga një muaj deri në tetë muaj burgim, që i bie se edhe ky dënim është brenda këtyre limiteve.

22. Rasti PKR.nr.111/17 Keqpërdorimi i pozitës apo i autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 lidhur me par. 2 nën par. 2.4 të KPRK-së

Aktgjykimi i marrë

Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti për Krime të Rënda më 25 prill 2018, kishte shpallur fajtor të dënuarin I.B, pasi që i njëjti, në periudhën kohore gusht të vitit 2015 deri në dhjetor të vitit 2016, në cilësinë e Drejtorit të Administratës Publike në Komunën e Prizrenit, duke e shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar i tejkalon kompetencat e tij zyrtare duke keqpërdorur pasurinë publike me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për të tjerët TV Opinon, TV Besa dhe TV Prizreni në atë mënyrë që pa ndonjë procedurë të tenderimit lidh dhe nënshkruan kontratat për emitimin e spoteve reklamuese në lidhje me aplikimet online për nevojat e komunës së Prizrenit gjegjësisht të administratës publike ashtu që me TV Opinon lidh kontratën për transmetim me 01 gusht 2015, deri me 31 korrik 2016, në vlerë prej 300 euro në muaj, me TV Besa lidhë kontratë me 1 shtator 2015, deri me 1 gusht 2016 në vlerë prej 250 euro në muaj dhe me TV Prizrenin lidh kontratë me 1 prill 2016 e cila do të zgjasë deri me datën 31 dhjetor 2016 në shumën prej 500 euro në muaj, ndërsa pas ekspertizës së kryer financiare ka rezultuar se në bazë të kartelave të furnitorëve të tre TV të lartpërmendura për shërbimet e spoteve reklamuese lidhur me aplikimet online janë tejkalluar shumat e parashikuara me kontrata të nënshkruar e cila arrin shumën prej 17.100 euro.

Dënimi sipas KPRK-së: *dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.*

Dënimi i shqiptuar: *gjashtë (6) muaj burg me kusht, në periudhë verifikuese prej një (1) vit.*

Rrethanat lehtësuese:

- 1.Sjellja korrekte para gjykatës;
2. Mosha e të dënuarit;
3. Gjendja e tij ekonomike;
4. Shkollimin e tij;
5. Faktin se për herë të parë që ballafaqohet me drejtësinë;

Rrethanat rënduese:

- 1.Mënyrën e kryerjes së veprës penale;

2. Pesha e veprës penale;

Përshtatshmëria e dënimit:

Gjykata kishte vlerësuar se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit, dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij penale dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe do të përmbahen nga veprimet e tilla. Ky dënim do të jetë edhe preventiv edhe për personat tjerë që në të ardhmen të jenë më të kujdesshëm me veprimet e tyre.

Zbatimi i udhëzuesit

Përshtatshmëria e dënimit

Sa i përket përshtatshmërisë së dënimit, gjykata e merr si të mirëqenë arritjen e qëllimit individual dhe gjeneral, duke mos dhënë asnjë arsytim se si do të arrihet ky dënim përmes këtij qëllimi. Sa i përket dy qëllimeve të tjera (gjykimi shoqëror, ngritja e moralit dhe forcimi i detyrimit për respektimin e ligjit dhe Viktimat dhe komuniteti) gjykata nuk i merr fare parasysh dhe nuk i arsyeton.

Zbatimi i parimeve

Gjykata në këtë rast vetëm ka cituar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, duke mos bërë asnjë ndërlidhje me parimet që duhet të merren parasysh me rastin e caktimit të dënimit, siç përcaktohet në udhëzues. Por, dy prej parimeve të dënimit, e që janë intensiteti i rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur (pesha e veprës penale) dhe mënyra e kryerjes së veprës penale, gjykata nuk i përcakton si parime të dënimit dhe të njëjtat ti arsyetojë me rrethana rënduese ose lehtësuese, por vetë të njëjtat i përdorë si rrethana rënduese.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Lidhur me sjelljen korrekte së të pandehurit gjatë procedurës, sipas udhëzuesit, gjykata duhet tu jap përgjigje gjithsej pesë pyetjeve, gjë të cilën gjykata nuk e ka bërë në këtë aktgjykim. Ndërsa, sa i përket moshës së të dënuarit, gjykata nuk ka dhënë asnjë arsytim lidhur me këtë rrethanë, përballë nëntë pyetjeve relevante të cilave sipas udhëzuesit duhet dhënë përgjigje në këtë rast. Për më tepër, nga arsyetimi i aktgjykimit nuk dihet se cila ka qenë mosha e të dënuarit. Në anën tjetër, sa i përket gjendjes ekonomike dhe shkollimit së të dënuarit, gjykata në këtë rast nuk jep asnjë arsytim por të njëjtat vetëm i citon. Në këtë drejtim, sipas udhëzuesit, gjendja ekonomike dhe shkollimi i të dënuarit nuk janë rrethana të veçanta lehtësuese, por janë faktorë me të cilët vlerësohen rrethanat personale dhe karakteri i të dënuarit si rrethanë lehtësuese, pra, në këtë rast, kemi të bëjmë me dyfishim të rrethanave. Sa i përket faktit se e dënuara për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, sipas udhëzuesit, kjo rrethanë kualifikohet tek rrethanat e tjera lehtësuese. Në udhëzues thuhet se nëse gjykata e konstaton mungesën e dënimeve të mëparshme penale dhe mund të jepet zbutja, do të kërkoj

gjetje të fakteve që e mbështesin përfundimin e sjelljes përkatëse dhe predispozitat për rehabilitim. Kjo çështje nuk trajtohet fare në këtë aktgjykim. Sa i përket dy rrethana rënduese të përdorura në këtë aktgjykim, e që janë pesha e veprës penale dhe mënyra e kryerjes së veprës penale, siç u sqarua tek zbatimi i parimeve në këtë aktgjykim, kemi të bëjmë me dyfishim të rrethanave. Kjo pasi pesha e kryerjes së veprës penale dhe mënyra e kryerjes së veprës penale janë parime të dënimit të cilat duhet të ndërlidhen me rrethana të veçanta lehtësuese apo rënduese, dhe jo të njëjtat të përdoren si rrethana lehtësuese apo rënduese.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruar nga aktgjykimi

Janë një sërë rrethanash, si lehtësuese ashtu edhe rënduese, të cilat gjykata nuk i ka marrë për bazë në këtë aktgjykimin e këtij aktgjykimi, e madje as nuk ka dhënë arsyetim se pse të njëjtat nuk janë marrë parasysh. Gjykata nuk ka marrë parasysh fare shkallën e dashjes, shkallën e dëmit të shkaktuar, keqpërdorimin e pushtetit ose pozitës zyrtare, shkeljen e besimit, pendimin/mungesën e pendimit nga i dënuari, (mos) keqardhjen e shfaqur, (mos) kompensimi i dëmit të shkaktuar, kalimin e kohës dhe (mos) mbështetja nga pala e dëmtuar.

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Gjykata në këtë aktgjykim nuk ka përcaktuar rëndësinë e brendshme për asnjë prej rrethanave si dhe nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me peshimin e rrethanave. Për këtë arsye, llogaritja është kuantitative. Në këtë aktgjykim janë përdorur 5 rrethana lehtësuese dhe 2 rrethana rënduese. Sipas udhëzuesit, këtu kemi të bëjmë me rastet kur kemi “Ekzistimin e pak rrethanave rënduese së bashku me shumë rrethana lehtësuese apo zbutëse (rrethanë individuale apo rrethana të kombinuara) në sasi më të madhe se sa rrethanat rënduese”, që në shtojcë kualifikohet tek kolona 6, përkatësisht tek faktorët që tregojnë më shumë rrethana lehtësuese sesa rënduese. . Sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 2, pika h, dënimi në këtë rast duhet të jetë nga një vit e gjashtë muaj deri në dy vite e gjashtë muaj dënim me burgim, që i bie se dënimi në këtë rast nuk është brenda kufijve.

23. Rasti PKR.nr.340/18 - Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK

Aktgjykimi i marrë

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, më 26 shtator 2018, kishte shpallur fajtorë të dënuarit F.G. dhe A.Sh, pasi që sipas aktgjykimit, i dënuari F.G. në cilësinë e zyrtarit në Ministrinë për Kulturë, Rini dhe Sport, së bashku me të pandehurin A.Sh. si Sekretar në Federatën e Atletikës së Kosovës, me qëllim që të përfitojnë çfarëdo dobie pasurore për vete apo tjetrin në bashkëveprim i tejkalojnë kompetencat e tyre, me datën 4 qershor 2015, Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport ka nënshkruar një memorandum për të ndihmuar financiarisht Federatën e Atletikës dhe Sporteve në vlerë prej 6,522 euro të cilat mjete kanë qenë të destinuar për Klubin “R.” nga K. për zhvillimin e garave sportive në Belgjikë, ndonëse të pandehurit kanë qenë në dijeni se shpenzimet për këtë projekt janë

mbuluar nga një bashkë atdhetarë, kanë përpiluar raporte të rrejshme duke përdorur si dëshmi mbi shpenzimet fatura fiktive, me qëllim që këto mjete të mos kthehen në Ministrinë e Kulturës dhe Sportit duke e mbyllur këtë projekt dhe mjetet financiare në vlerë prej 6.552 euro të mbesin në Federatën e Atletikës së Kosovës,

Dënimi sipas KPRK-së: *dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.*

Dënimi i shqiptuar:

F.G.: në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, dënim ky i cili i zëvendësohet me gjobë në shumë prej 3.000 euro

A.Sh.: në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, dënim ky i cili i zëvendësohet me gjobë në shumë prej 3.000 euro

Rrethanat lehtësuese:

1. Marrëveshjen e arritur në prokurori për pranimin e fajësisë;
2. Gjendjen e dobët ekonomike;
3. Shprehjen e pendesës për veprën e kryer;
4. Faktin se ndaj të njëjtëve nuk zhvillohet procedurë tjetër penale e natyrës së njëjtë apo të ngjashme

Rrethanat rënduese:

Asnjë

Përshtatshmëria e dënimit:

Gjykata kishte vlerësuar se dënimet e tilla i përgjigjen peshës së veprës penale, sjelljeve dhe shkallës së përgjegjësisë penale së të pandehurve, se ky dënim do të ndikojë në risocializimin e të njëjtëve, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, gjithashtu, do të ndikojë tek të tjerët në mos kryerjen e veprave penale të tilla dhe se, me dënime të tilla do të arrihet qëllimi i dënimit, gjithashtu me bindje se të pandehurit në të ardhmen nuk do të përsërisin vepra tjera penale të natyrës së tillë apo të ngjashme.

Zbatimi i udhëzuesit

Përshtatshmëria e dënimit

Sa i përket përshtatshmërisë së dënimit, gjykata e merr si të mirëqenë arritjen e qëllimit individual, gjeneral dhe forcimit të moralit të shoqërisë dhe disiplinës qytetare, duke mos

dhënë asnjë arsytim se si do të arrihen këto qëllime përmes këtij qëllimi. Sa i përket qëllimit tjetër (viktimat dhe komuniteti) gjykata nuk e merr fare parasysh dhe nuk e arsyeton.

Zbatimi i parimeve

Gjykata në këtë rast vetëm ka cituar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, duke mos bërë asnjë ndërlidhje me parimet që duhet të merren parasysh me rastin e caktimit të dënimit, siç përcaktohet në udhëzues. Por, sa i përket të intensiteti i rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur (pesha e veprës penale), gjykata nuk e përcakton si parim të dënimit dhe të njëjtin ta arsyetojë me rrethana rënduese ose lehtësuese, por me të njëjtin parim e arsyeton përshtatshmërinë e dënimit, në mënyrë krejtësisht të përgjithshme dhe pa asnjë arsytim.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Në këtë aktgjykim, gjykata e përdorë arritjen e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë si rrethanë lehtësuese. Sipas udhëzuesit “kjo rrethanë (pranimi i fajësisë) nuk duhet të ngatërrohet me marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë. Ato janë konsiderata krejtësisht të ndryshme”. Pra, në këtë rast është përdorur si rrethanë lehtësuese një rrethanë e cila në udhëzues nuk cilësohet e tillë, çka paraqet dyfishim të rrethanave. Sa i përket faktit se i dënuari është person i varfër, gjykata nuk e ka mbështetur me asnjë provë këtë. Për më tepër, është e çuditshme se si e ka marrë këtë fakt si rrethanë lehtësuese, përderisa në aktgjykim përmendet se i dënuari është i gjendjes së mesme ekonomike. Sa i përket shprehjes së pendesës, sipas udhëzuesit, kjo nuk është fare rrethanë lehtësuese, por është kategori në të cilën hyjnë shtatë rrethana lehtësuese. Përdorimi i kategorisë si rrethanë në këtë rast, sipas udhëzuesit, paraqet dyfishim të rrethanave. Sa i përket asaj se ndaj të pandehurve nuk është duke u zhvilluar procedurë tjetër penale, realiteti është se edhe sikur të ishte duke u zhvilluar procedurë tjetër penale, kjo nuk do të mund të merrej parasysh as si rrethanë lehtësuese as si rrethanë rënduese. Relevante në këtë rast janë dënimet e kaluara, dhe jo proceset për të cilat ende nuk ka një aktgjykim të formës së prerë. Pra, në këtë rast është përdorur si rrethanë lehtësuese një rrethanë inekzistente, çfarë sipas udhëzuesit paraqet dyfishim të rrethanave. Në anën tjetër, gjykata në këtë rast thotë se nuk ka gjetur asnjë rrethanë rënduese, derisa një prej tyre e citon tek përshtatshmëria e dënimit, e që është shkalla e përgjegjësisë penale të të pandehurve.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruar nga aktgjykimi

Janë një sërë rrethanash, si lehtësuese ashtu edhe rënduese, të cilat gjykata nuk i ka marrë për bazë në këtë aktgjykim, e madje as nuk ka dhënë arsytim se pse të njëjtat nuk janë marrë parasysh. Gjykata nuk ka marrë parasysh fare shkallën e dashjes, shkallën e dëmit të shkaktuar, keqpërdorimin e pushtetit ose pozitës zyrtare, shkeljen e besimit, keqardhjen e shfaqur, (mos) kompensimi i dëmit të shkaktuar, sjelljen e personit të dënuar pas konfliktit, e kaluara kriminale/jo kriminale e të dënuarve, mosha e të pandehurit, kalimin e kohës dhe (mos) mbështetja nga pala e dëmtuar.

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Gjykata në këtë aktgjykim nuk ka përcaktuar rëndësinë e brendshme për asnjë prej rrethanave si dhe nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me peshimin e rrethanave. Për këtë arsye, llogaritja është kuantitative. Në këtë aktgjykim janë përdorur katër rrethana lehtësuese dhe asnjë rrethanë rënduese. Sipas udhëzuesit, këtu kemi të bëjmë me rastet kur kemi “marrëveshje mbi pranimin e fajësisë apo pranimi i fajësisë në fazë të hershme të procesit pa asnjë asnjë/ose një rrethanë të vogël rënduese”, që në shtojcë kualifikohet tek kolona 5, përkatësisht tek rrethanat që arsyetojnë zbutjen maksimale të dënimit brenda kufirit. Sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 2, pika h, dënimi në këtë rast duhet të jetë nga gjashtë muaj deri në një vit e gjashtë muaj, që i bie se dënimi në këtë rast është brenda kufijve.

24. Rasti PKR.nr.36/2018 - Falsifikim i dokumentit zyrtar nga neni 434 par.1 lidhur me nenin 31 të KPR, Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, Ushtrim i ndikimit nga neni 431 par.1 i KPRK

Aktgjykimi i marrë

Sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë - Departamenti për Krime të Rënda, M.H, M.B, K.K, A.B, S.N dhe A.A, ish-in shpallur fajtorë për veprat penale, “falsifikim i dokumenteve zyrtare”, “keqpërdorim i pozitës zyrtare” dhe “ushtrim i ndikimit”.

Sipas aktgjykimit, të dënuarit M.M, M.B dhe K.K, në muajin dhjetor të vitit 2014 në Spitalin “Isa Grezda”, në Gjakovë, M.M., në cilësinë e Kryetares së Komisionit, ndërsa M.B. dhe K.K, anëtar te Komisionit, dokumentin zyrtar - procesverbalin me numër protokollit 3993/2 te datës 24 dhjetor 2014, kanë shënuar të dhëna të rreme duke vërtetuar se kane ardhur numri i plotë i uniformave, duke konfirmuar që sipas kontratës me numër të protokollit 3191 nga operatori N.Sh.EL- Ri Graphic Prishtinë kanë pranuar 438 uniforma komplete për personel ku vlera totale ka qene 9855€, i cili dokumente përbente te dhëna te rreme. Tutje, sipas aktgjykimit, i dënuari A.B, në muajin dhjetor te vitit 2014 në Spitalin “Isa Grezda” në Gjakovë, në cilësinë e personit zyrtare depoist ka shfrytëzuar detyrën zyrtare duke tejkaluar kompetenca e tija, duke mos i përmbushur detyrat zyrtare te tija, me qellim të përfitimit të çfarëdo dobie për vete dhe për peronat tjerë duke i shkaktuar dëm spitalit Rajonal “Isa Grezda” në Gjakovë, në atë mënyrë që në depo ka pranuar uniforma nga kontraktuesi i firmës N.Sh “E” në sasi me të vogël sa qe është kontraktuar dhe atë 253 copë pantolla me ngjyrë të bardhë, 240 mantila me ngjyre të bardhë dhe 78 bluza me ngjyrë te bardhë pa përpiluar ndonjë procesverbal për pranimin e uniformave por këtë e ka bere me urdhër verbal te shefit te infermierisë S.N., ku nuk ka pranuar 198 copa mantila me ngjyre te bardh, te kaltër, te gjelbër, dhe pembe dhe 49 copa pantallona me ngjyra te ndryshe dhe 360 bluza te ngjyrave te ndryshme. I dënuaro, S.N, ne muajin dhjetor te vitit 2014 ne Spitalin “Isa Grezda” në Gjakovë, në cilësinë e Drejtorit të Infermiereve të Spitalit Rajonal “Isa Grezda” ne Gjakovë, në mënyrë te drejtpërdrejtë pranon përfitim pasuror në atë mënyrë që ushtron ndikim të pa drejtë mbi vendim marrje me personin zyrtar - depoistit A.B. i ka urdhëruar që të pranojë uniforma nga kontraktuesi N.Sh. “E” në sasi me te vogël se që është kontraktuar dhe atë 253 copa pantallona me ngjyre te bardhë, 240 mantila me ngjyre te bardhë, dhe 78 bluza me

ngjyre të bardhë pa përpiluar ndonjë procesverbal për pranimin e uniformave por këtë e ka bërë me urdhër verbal së të akuzuarit S.N. Sipas aktgjykimit, i dënuari A.A, në muajin dhjetor të vitit 2014 në Spitalin “Isa Grezda “ në Gjakovë, në cilësinë e personit zyrtar Drejtori Ekzekutiv në Spitalin “Isa Grezda” në Gjakovë ka shfrytëzuar detyrën e tij zyrtare duke tejkalluar kompetencat e tij duke mos i përmbushur detyrat zyrtare të tija me qëllim të përfitimit dhe çfarëdo dobie pasurore për veti dhe për personat tjerë duke i shkaktuar edhe dëm Spitalit Rajonal “Isa Grezda” në Gjakovë, në atë mënyre që si Drejtor Ekzekutiv, ka nënshkruar lejimin e pagese se të hollave për kontratën e blerjes se uniformave të cilat nuk kanë ardhur me numër të plotë sipas kontratës të lidhur në mes të N.Sh “E” Prishtinë, si dhe duke mos verifikuar sipas dokumenteve të pranimit të uniformave në sasi prej 438 në vlerë totale prej 9855€.

Dënimi sipas KPRK-së:

Falsifikimi i dokumentit zyrtar dhe Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar: *dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.*

Ushtrimi i ndikimit: *dënohet me gjobë ose me burgim deri në tetë (8) vjet.*

Dënimi i shqiptuar:

M.M: Dënim me burgim, gjashtë (6) muaj me kusht në periudhë verifikuese prej një (1) viti;

M.B: Dënim me burgim, gjashtë (6) muaj me kusht në periudhë verifikuese prej një (1) viti;

K.K: Dënim me burgim, gjashtë (3) muaj me kusht në periudhë verifikuese prej një (1) viti;

A.B: Dënim me burgim, gjashtë (6) muaj me kusht në periudhë verifikuese prej një (1) viti;

S.N: Dënim me burgim, gjashtë (6) muaj me kusht në periudhë verifikuese prej një (1) viti;

A.A: Dënim me burgim, gjashtë (6) muaj me kusht në periudhë verifikuese prej një (1) viti;

Rrethanat lehtësuese:

1. Sjellja e të dënuarve gjatë procedurës penale;
2. Fakti se janë mbajtës të vetëm familjes dhe e dënuara e parë ka dy fëmijë të moshës së mitur;
3. Gjendjen ekonomike;
4. Kalimi i kohës nga kryerja e veprës penale;

Rrethanat rënduese:

Asnjë.

Përshtatshmëria e dënimit:

Gjykata kishte vlerësuar se dënimi me burg me kusht që në periudhën verifikuese nuk kryejnë ndonjë veprë tjetër penale, me shpresë dhe me bindje se dënimet e shqiptuara janë në harmoni me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale se të akuzuarve dhe me dënimet e shqiptuara do të arrihet qëllimi i dënimit, i cili konsiston në parandalimi e të pandehurve dhe të personave të tjerë nga kryerja e veprimeve të tilla në të ardhmen si dhe shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen morale dhe forcimin e detyrimit për respektim të ligjit.

Zbatimi i udhëzuesit

Përshtatshmëria e dënimit

Sa i përket përshtatshmërisë së dënimit, gjykata e merr si të mirëqenë arritjen e qëllimit individual, gjeneral dhe gjykimit shoqëror, ngritjes së moralit dhe forcimit i detyrimit për respektimin e ligjit, duke mos dhënë asnjë arsytim se si do të arrihen këto qëllime përmes këtij qëllimi. Sa i përket qëllimit tjetër (viktimat dhe komuniteti) gjykata nuk e merr fare parasysh dhe nuk e arsyeton.

Zbatimi i parimeve

Gjykata në këtë rast vetëm ka cituar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, duke mos bërë asnjë ndërlidhje me parimet që duhet të merren parasysh me rastin e caktimit të dënimit, siç përcaktohet në udhëzues. Por, sa i përket intensitetit të rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur (pesha e veprës penale) dhe shkallës së përgjegjësisë penale gjykata nuk i përcakton të njëjtat si parime të dënimit dhe të njëjtat ti arsyetojë me rrethana rënduese ose lehtësuese, por me të njëjtat parime e arsyeton përshtatshmërinë e dënimit, në mënyrë krejtësisht të përgjithshme dhe pa asnjë arsytim.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Lidhur me sjelljen korrekte së të pandehurve gjatë procedurës, sipas udhëzuesit, gjykata duhet tu jap përgjigje gjithsej pesë pyetjeve, gjë të cilën gjykata nuk e ka bërë në këtë aktgjykim. Sa i përket rrethanave familjare, gjykata në këtë rast u jep përgjigje dy prej shtatë pyetjeve relevante që përcaktohen nga udhëzuesi lidhur me këtë rrethanë, duke anashkaluar pesë pyetjet e tjera. Sa i përket gjendjes ekonomike, gjykata në këtë aktgjykim këtë nuk e ka mbështetur në asnjë provë, dhe nga aktgjykimi nuk mund të kuptohet se cila ka qenë gjendja ekonomike e të dënuarve. Për më tepër, gjendja ekonomike dhe rrethanat familjare, sipas udhëzuesit, janë dy faktorë me anë të së cilave vërtetohen rrethanat personale dhe karakteri i personit të dënuar, dhe jo dy rrethana të veçanta lehtësuese. Sipas udhëzuesit, në këtë rast kemi të bëjmë me dyfishim të rrethanave. Sa i përket kalimit të kohës, gjykata nuk jep asnjë konsideratë në arsyetimin e këtij aktgjykimi. Për më tepër, gjykata në këtë rast përdorë të

njëjtat rrethana për gjashtë të pandehurit, të cilët sipas këtij aktgjykimi dënohen me dënime të ndryshme dhe për vepra të ndryshme penale, duke mos bërë diferencimin, në kuptim të përdorimit të rrethanave, për asnjërin prej të dënuarve.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruar nga aktgjykimi

Janë një sërë rrethanash, si lehtësuese ashtu edhe rënduese, të cilat gjykata nuk i ka marrë për bazë në këtë aktgjykim, e madje as nuk ka dhënë arsytim se pse të njëjtat nuk janë marrë parasysh. Gjykata nuk ka marrë parasysh fare shkallën e dashjes, shkallën e dëmit të shkaktuar, keqpërdorimin e pushtetit ose pozitës zyrtare, shkeljen e besimit, (mos) pendimin e të dënuarve, keqardhjen e shfaqur, (mos) kompensimi i dëmit të shkaktuar, e kaluara kriminale/jo kriminale e të dënuarve, mosha e të pandehurve, kalimi e kohës dhe (mos) mbështetjen nga pala e dëmtuar.

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Gjykata në këtë aktgjykim nuk ka përcaktuar rëndësinë e brendshme për asnjë prej rrethanave si dhe nuk ka dhënë asnjë arsytim lidhur me peshimin e rrethanave. Për këtë arsye, llogaritja është kuantitative. Në këtë aktgjykim janë përdorur katër rrethana lehtësuese dhe asnjë rrethanë rënduese. Sipas udhëzuesit, këtu kemi të bëjmë me rastet kur kemi “ekzistimin e së paku dy rrethanave për zvogëlim të fajësisë apo dëmit dhe asnjë/ose një rrethanë të vogël rënduese”, që në shtojcë kualifikohet tek kolona 5, përkatësisht tek rrethanat që arsyetojnë zbutjen maksimale të dënimit brenda kufirit. Sa i përket veprave penale të falsifikimit të dokumenteve zyrtare dhe keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar, sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 2, pika h, dënimi në këtë rast duhet të jetë nga gjashtë muaj deri në një vit e gjashtë muaj dënim me burgim. Në rastin konkret, dënimi është brenda kufijve sa i përket të dënuarit të parë, të dytë, të katërt dhe të gjashtë, derisa nuk është brenda këtyre kufijve sa i përket të dënuarit të tretë. Lidhur me veprën penale ushtrimi i ndikimit, sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 1, pika i, dënimi duhet të jetë nga një vit deri në tre vite dënim me burgim. Në rastin konkret, sa i përket të akuzuarit të pestë, dënimi nuk është brenda këtij limiti, pasi dënimi ndaj të njëjtit ka qenë gjashtë muaj dënim me kusht. Rrjedhimisht, nëse dënimi do të shqiptohej brenda këtyre kufijve, dënimi me kusht nuk do të ishte i mundur të shqiptohej.

25. Rasti PKR.nr.49/19 “dhënie ryshfeti” “falsifikim i dokumenteve zyrtar” dhe “ushtrim ndikimi” – KPRK

Aktgjykimi i marrë

Sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj – Departamenti për Krime të Rënda, i dënuari R.E ishte shpallur fajtor pasi që gjykata kishte gjetur se i njëjti është fajtor për veprat penale “dhënie ryshfeti”, “falsifikim i dokumenteve zyrtar” dhe “ushtrim ndikimi”. Kjo pasi sipas aktgjykimit, i njëjti gjashtë muajve janar – shkurt 2015, si profesor i gjimnazit Gjergj Kastrioti Skënderbeu” në Gillogovc, ka pranuar ofertën për përfitim pasuror për tjetrin me qëllim që të ndikoj tek personat e tjerë për të kryer ndonjë veprim në kundërshtim me detyrat

e tij zyrtare, ka ndikuar tek zyrtaret e drejtorisë së shkollës së mesme profesionale “Fehmi Lladrovci”, ashtu që të pandehurit nga i cili kishte marr 800 euro, E.F ti lëshohet diplomë e falsifikuar si dëshmi se e ka të përfunduar shkollën e mesme, me qëllim që ta përdor për tu avancuar në FSK, duke kryer kështu veprën penale “ushtrim i ndikimit”.

Ndërsa, vazhdon aktgjykimi, i dënuari gjatë muajit nëntor 2014 në Glllogvc si person zyrtar kishte falsifikuar të dhënat në librat amë për nxënësit e gjimnazit “Gjergj Kastrioti Skënderbeu”, në mënyrë që në librat amë të viteve 1993/94, 1994/94 dhe 1995/96 ka shënuar të dhëna të pavërteta në emër të F.M, kinse kishte qenë e regjistruar në gjimnaz drejtimi matematikor-natyror, duke kryer veprën penale “falsifikim i dokumentit zyrtar”.

Po ashtu, sipas aktgjykimit, i dënuari gjatë muajit nëntor 2014, në Glllogvc, i ka dhënë shpërblim me para prej 200 euro, personit zyrtar M.Gj, sekretar i shkollës së mesme Gjimnazi “Gjergj Kastrioti Skënderbeu”, në mënyrë që të veproj në kundërshtim me detyrat e tij dhe të lëshojë dokumente të falsifikuara dublikate në emër të F.M, duke kryer kështu veprën penale “dhënie ryshfeti”.

Dënimi sipas KPRK-së:

1. “Ushtrim i ndikimit” - dënohet me gjobë ose me burgim deri në tetë (8) vjet.
2. “Falsifikim i dokumenteve zyrtare” - gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
3. “Dhënie ryshfeti” - dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

Dënimi i shqiptuar:

1. “Ushtrim i ndikimit” – një (1) vit burgim me kusht
2. “Falsifikim i dokumenteve zyrtare” – nëntë (9) muaj burgim me kusht
3. “Dhënie ryshfeti” – gjashtë (6) muaj burgim me kusht

Rrethanat lehtësuese:

1. Pranimi i fajësisë;
2. Nuk ka të dhëna se i pandehuri kishte qenë më parë i dënuar;
3. Fakti se është penduar;
4. Premtimi se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tjera penale;

Rrethanat rënduese

Asnjë

Përshtatshmëria e dënimit:

Gjykata me vendimin e saj është e bindur se do të arrihet qëllimi i dënimit, pasi që i dënuari me rastin e pranimit të fajësisë është penduar thellë për veprimet që i ka bërë dhe se dënimi i shqiptuar është i justifikueshëm dhe në përshtatje me rrethanat e kryerjes dhe rrezikshmërinë e saj dhe të autorit që të shërbej për parandalimin e kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe parandalimi i të tjerëve.

Zbatimi i udhëzuesit

Përshtatshmëria e dënimit

Sa i përket përshtatshmërisë së dënimit, gjykata e merr si të mirëqenë arritjen e qëllimit individual dhe gjeneral, duke mos dhënë asnjë arsytim se si do të arrihet ky dënim përmes këtij qëllimi. Sa i përket dy qëllimeve të tjera (grykimi shoqëror, ngritja e moralit dhe forcimi i detyrimit për respektimin e ligjit dhe viktimat dhe komuniteti) gjykata nuk i merr fare parasysh dhe nuk i arsyeton.

Zbatimi i parimeve

Gjykata në këtë rast vetëm ka cituar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, duke mos bërë asnjë ndërlidhje me parimet që duhet të merren parasysh me rastin e caktimit të dënimit, siç përcaktohet në udhëzues. Sa i përket rrethanave në të cilat është kryer kjo vepër penale, gjykata të njëjtat i përmend tek përshtatshmëria e dënimit dhe të njëjtat nuk i ndërlidhë me asnjë rrethanë lehtësuese dhe as rënduese dhe as të njëjtat nuk i përdorë as si rrethanë lehtësuese apo rënduese, por i vetëm i citon pa asnjë arsytim.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Sa i përket pendimit, gjykata në këtë rast ka bërë dyfishimin e rrethanave, pasi pranimi i fajit dhe keqardhja e shprehur, sipas udhëzuesit, janë pjesë e pendimit, dhe jo rrethana të veçanta dhe të ndara. Për më tepër sipas udhëzuesit, edhe keqardhja ka lidhshmëri të veçantë me pranimin e fajësisë, diferencimin e të cilit gjykata nuk e ka bërë në arsyetimin e këtij aktgjykimi. Po ashtu, sa i përket pranimit të fajësisë, në udhëzues janë përcaktuar katër faktorë që duhet të merren parasysh në çdo aktgjykim me rastin kur kjo rrethanë konstatohet si rrethanë lehtësuese, gjë të cilën gjykata nuk e ka bërë në këtë aktgjykim. Sa i përket faktit se i dënuari për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, sipas udhëzuesit, kjo rrethanë kualifikohet tek rrethanat e tjera lehtësuese. Në udhëzues thuhet se nëse gjykata e konstaton mungesën e dënimeve të mëparshme penale dhe mund të jepet zbutja, do të kërkoj gjetje të fakteve që e mbështesin përfundimin e sjelljes përkatëse dhe predispozitat për rehabilitim. Kjo çështje nuk trajtohet fare në këtë aktgjykim. Ndërsa, premtimi se në të ardhmen nuk do të kryejë vepër tjetër penale, në udhëzues nuk përmendet fare si rrethanë lehtësuese.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruar nga aktgjykim

Janë një sërë rrethanash, si lehtësuese ashtu edhe rënduese, të cilat gjykata nuk i ka marrë për bazë në këtë aktgjykim, e madje as nuk ka dhënë arsyetim se pse të njëjtat nuk janë marrë parasysh. Gjykata nuk ka marrë parasysh fare shkallën e dashjes, shkallën e dëmit të shkaktuar, keqpërdorimin e pushtetit ose pozitës zyrtare, shkeljen e besimit, rrethanat personale dhe karakteri i personit të dënuar, (mos) kompensimi i dëmit të shkaktuar, sjelljen e personit të dënuar pas konfliktit, moshën e të pandehurit, kalimin e kohës dhe (mos) mbështetja nga viktimat.

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Fillimisht, gjykata ka thënë se aktgjykimi në këtë rast është marrë duke u bazuar në nenin 75 të KPRK, ku përcaktohet zbutja e dënimit nën minimumin e paraparë me ligj. Sa i përket tre kushteve të cilat duhet të plotësohen për zbatimin e nenit 75, gjykata nuk ka dhënë asnjë sqarim për asnjërin prej tyre. Në këtë drejtim, nëse potencialisht do të ishte pranimi i fajësisë, prapë se prapë, sipas udhëzuesit, në këtë rast nuk ka pasur vend për zbatimin e nenit 75. Sipas udhëzuesit “përfitimi substancial që jepet për pranim të fajësisë është i bazuar në kursimin e kostos për shoqërinë për sa i përket kohës, parave dhe shpenzimeve emocionale që ndërlihen me dëshminë dhe viktimizimin. Këto përfitime zhduken dukshëm me fillimin e gjykimit. Andaj, zbutja sipas nenit 75 nuk duhet të jetë më në dispozicion kur të filloj gjykimi”. Për këtë arsye, meqenëse për këtë nuk është dhënë asnjë sqarim me vlerën e brendshme të rrethanave e as për peshimin e rrethanave, matja në këtë rast është kuantitative. Në këtë rast, kemi katër rrethana lehtësuese dhe një rrethanë rënduese, që sipas udhëzuesit bëhet fjalë për “ekzistimin e së paku dy rrethanave për zvogëlim të fajësisë apo dëmit dhe asnjë/ose një rrethanë të vogël rënduese”. Sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, në këtë rast kemi të bëjmë me rrethanat që arsyetojnë zbutjen maksimale të dënimit brenda kufirit. Sa i përket veprës penale të ushtrimit të ndikimit, sipas pjesës 1, pika i të kësaj shtojce, dënimi në këtë rast duhet të jetë nga një vit deri në tre vite burgim efektiv, ndërsa në rastin konkret është një vit me kusht. Zbatueshmëria e dënimit me kusht, sipas udhëzuesit, në këtë rast nuk ka qenë e mundur, që i bie se dënimi në këtë rast nuk është përcaktuar brenda këtyre standardeve. Sa i përket veprës penale të falsifikimit të dokumentit zyrtar, sipas kësaj shtojce, pjesa 2, pika h, dënimi në këtë rast duhet të jetë nga gjashtë muaj deri në një vit e gjashtë muaj dënim me burgim, që i bie se për këtë pikë, dënimi është brenda këtyre kufijve. Sa i përket veprës penale dhënia e ryshfetit, sipas të njëjtës shtojcë, pjesa 1, pika f, dënimi duhet të jetë nga një muaj deri në tetë muaj, që i bie se dënimi edhe për këtë veprë penale është brenda kufirit. Por, për të gjitha këto vepra penale është shqiptuar dënim me kusht. Sikurse gjykata të vepronte në përputhje me standardet e udhëzuesit sa i përket veprës penale të ushtrimit të ndikimit, dënimi nuk do të kishte mundësi që të shqiptohej me kusht, por do të ishte dënim me burgim efektiv.

VII. Politika ndëshkimore në rastet e vrasjeve

a. Hyrje

IKD në këtë kapitull ka analizuar gjithsej 10 aktgjykime të veprave penale të vrasjeve. Në bazë të metodologjisë së përmendur në fillim të këtij raporti, IKD ka analizuar edhe këto 10 aktgjykime që kanë të bëjnë me veprat penale të vrasjeve, nëse në të njëjtat, gjyqtarët kanë zbatuar kërkesat dhe standardet e vendosura nga udhëzuesi, me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit. Këto 10 aktgjykime përfshijnë gjithsej 14 persona, derisa ndaj tyre janë shqiptuar 21 dënime.

Të gjeturat e IKD-së të prezantuara më poshtë, tregojnë se as në rastet e vrasjeve, udhëzuesi nuk ka gjetur zbatimin e kënaqshëm në praktikë.. Ajo çfarë e dallon këtë kategori nga kategoritë e tjera, është se numri i rrethanave rënduese të aplikuara në këto raste është relativisht proporcional me numrin e rrethanave lehtësuese, derisa numri i rrethanave të identifikuar si të injoruar në këtë kapitull është më i lartë. Edhe në këtë kapitull, nëse si pikë reference për një politikë të ligjshme ndëshkimore merret udhëzuesi, atëherë nënkuptojmë se politika ndëshkimore në sistemin gjyqësorë të Republikës së Kosovës, në rastet e veprave penale të vrasjeve, është hiq më pak se arbitrare.

Sa i përket arsytimit të aktgjykimeve mbi caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, gjithnjë duke marrë parasysh standardet e vendosura nga udhëzuesi, palët dhe publiku në asnjë rrethanë nuk mund të krijojnë bindjen se pse në rastin konkret është caktuar një dënim i tillë.

Në këtë mënyrë, ajo që ishte prezantuar si progres dhe hap konkret në drejtim të përmirësimit të politikës ndëshkimore brenda sistemit të drejtësisë në Republikën e Kosovës, e që është miratimi i udhëzuesit, nga të gjeturat e këtij raporti shihet edhe në veprat penale të vrasjeve, ky udhëzues ka mbetur politikë në letër, i pazbatuar në praktikë.

b. Gjetjet e përgjithshme

10 aktgjykimet e analizuar nga IKD në këtë kapitull janë për veprën penale të vrasjes së rëndë dhe veprën penale të vrasjes. Në këto raste, brenda aktgjykimeve ka edhe dënime të tjera për vepra të tjera përpos vrasjes dhe vrasjes së rëndë, por që janë pjesë e aktgjykimeve në të cilat të pandehurit janë dënuar edhe për njëri nga këto dy vepra penale. Në këtë drejtim, analiza është bërë për të gjithë vepra penale që janë pjesë e këtyre 10 aktgjykimeve.

Vepra penale	Numri i dënimeve
Vrasje e rëndë	9
Vrasje	1
Vrasje e mbetur në tentativë	1
Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armës	6
Pjesëmarrje në rrahje	1
Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm	1
Ndihmë në kryerjen e veprës penale	1
Dhënia e ndihmës pas kryerjes së veprës penale	1

Tabela 20 – Numri i dënimeve sipas veprës penale.

Në 10 aktgjykimet e analizuara janë të përfshirë 14 persona, si dhe ndaj të njëjtëve, gjykatat kanë shqiptuar gjithsej 21 dënime.

Prej këtyre 21 dënimeve, 20 dënime janë dënime me burgim efektiv, ndërsa një dënim është me gjobë.



Grafika 17 – Llojet e dënimeve të shqiptuara.


Sa i përket lartësisë së dënimeve me burgim, dënimi më i shpeshtë dhe më i ulët i shqiptuar është dënimi me një vit burgim, i cili është shqiptuar në katër raste, ndërsa dënimi më i lartë është dënimi me burgim të përjetshëm, i cili është shqiptuar në një rast.



Grafika 18 – Lartësia e dënimeve me burgim.

Dënim me gjobë është shqiptuar vetëm në një rast, i cili ka qenë në lartësi prej 500 eurove.

Sa i përket numrit total të rrethanave të përdorura në këto 10 aktgjykime, gjykatat kanë aplikuar gjithsej 53 rrethana, ku përqindja e atyre lehtësuese dhe rëndësuese është pothuajse ekuivalente.



Grafika 19 – Numri i rrethanave të përdorura në aktgjykimet e analizuar.

Në raste të ndara, gjykata kanë aplikuar prej dy deri në pesë rrethana lehtësuese në një aktgjykim, derisa në dy aktgjykime, gjykatat nuk kanë përdorur asnjë rrethanë lehtësuese.

Numri i rrethana lehtësuese të aplikuara	Numri i rasteve
Asnjë rrethanë lehtësuese	2 raste
2 rrethana të aplikuara	3 raste
3 rrethana të aplikuara	1 rast
4 rrethana të aplikuara	2 raste
5 rrethana të aplikuara	2 raste

Tabela 21 – Numri i rrethanave lehtësuese të aplikuara.

Sa i përket rrethanave rënduese, numri i rrethanave rënduese të aplikuara në një aktgjykim është nga një deri në nëntë rrethana rënduese të aplikuara, derisa në një rast, gjykata nuk ka marrë parasysh asnjë rrethanë rënduese.

Numri i rrethana rënduese të aplikuara	Numri i rasteve
Asnjë rrethanë rënduese	1 rast
1 rrethanë të aplikuar	2 raste
2 rrethana të aplikuara	4 raste
3 rrethana të aplikuara	1 rast
4 rrethana të aplikuara	1 rast
9 rrethana të aplikuara	1 rast

Tabela 22 – Numri i rrethanave rënduese të përdorura.

Sa i përket llojit të rrethanave të përdorura, në total, gjykatat në këto 10 raste të analizuara kanë aplikuar 35 lloje të ndryshme të rrethanave lehtësuese dhe rënduese. Në fakt, rrethana që më së shpeshti i janë referuar gjykatat në këto 10 aktgjykime (katër raste) është një rrethanë e cila nuk ekziston në udhëzues, e që është mosha relativisht e re.

Lloji i rrethanës	Numri i rasteve në të cilat është aplikuar
Mosha relativisht e re	4
Nuk është i dënuar më herët për ndonjë veprë penale	4
Dëmin e shkaktuar me kryerjen e veprës penale familjeve të tani të ndjerëve të cilët janë privuar në mënyrë të përhershme nga prania e më të dashurve të tyre duke shkaktuar dhembje të pa kompensueshme prindërve së të njëjtëve;	3
Koha e kryerjes së veprës penale	2
Llogaritshmërinë e zvogëluar	2
Keqardhjen për familjen e viktimës	2
Shkalla e pjesëmarrjes në kryerjen e veprës penale	2
Rrezikimi nga prezenca e njerëzve të tjerë të pafajshëm	2
I dënuar kishte qenë i dënuar edhe më parë për dy vepra penale me aktgjykime të formës së prerë	2
Sjelljen e tij para dhe pas kryerjes së veprës penale	2
Shkalla e lartë e dashjes	2
I dënuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale	2
Mosha e re e viktimës	2
Viktima ka qenë posaçërisht e pambrojtur	1


Raporti familjar i të dënuarit me viktimën	1
Sjellja e të akuzuarit pas kryerjes së veprës penale	1
Fakti se i akuzuari e ka vënë viktimën në pozitë të detyruar	1
Shfrytëzimi i rastit kur në fshat kishte qenë varrimi i një bashkëfshatari	1
I dënuari është njeri familjar dhe vajza e tij kishte qenë në klasë me viktimën	1
Përfshirja e vajzës së tij, kinse ajo kishte qenë me të dhe e ulur në ulësen e pasme të veturës	1
Tentimi i të dënuarit për orientimin e vëmendjes	1
Vepra është kryer në rrethana posaçërisht rënduese dhe ka shkaktuar pasoja për familjen e viktimës dhe ndjenjën e sigurisë së përgjithshme tek gjinia femërore;	1
Ndaj të dënuarit prej gjashtë vitesh ishte lëshuar flete rreshtim ndërkombëtarë por ai iu ishte shmangur organeve të ndjekjes	1
Është baba i tre fëmijëve dhe se i ka vdekur bashkëshortja dhe është mbajtës i vetëm i familjes	1
Pasojat e kësaj vepre penale, meqë me veprimet e tij është shkaktuar vdekja e tani të ndjerit	1
Rrethanat në të cilat është kryer vepra penale pra që ngjarjes kritike i ka paraprirë një mosmarrëveshje lidhur me një borxh të cilin i akuzuari nuk e ka pranuar si të vetin e që për këtë edhe ka qenë i kërcënuar e po ashtu edhe i është marrë vetura e cila ka qenë në pronësi	1

të motrës së tij	
I dënuari që nga fillimi i procedurës penale thuajse në tërësi e ka pranuar kryerjen e veprës penale me përjashtim të rrethanave që i kanë paraprirë të njëjtës	1
Vepra penale është kryer në orët e vona të natës, kur e ndjera ka qenë në gjumë	1
Pendimin e shprehur;	1
Mosha e shtyrë;	1
Numri i viktimave	1
Sjelljen korrekte së të akuzuarve në të gjitha fazat e procedurës	1
Provokimin e vazhdueshëm	1
Kërkim falja palëve të dëmtuara	1
Ka mbajtur armën pa ndonjë arsye të fortë dhe në mënyrë të vazhdueshme, duke shkaktuar rrezik potencial	1

Tabela 23 – Llojet e rrethanave të aplikuara në aktgjykimet e analizuara.

Sikurse në kapitujt e tjerë, problematike mbetet aplikimi i rrethanave lehtësuese dhe rënduese sipas kërkesave të përcaktuara nga udhëzuesi. Në këtë drejtim, sa i përket kategorisë së vrasjeve, përqindja e rrethanave në të cilat janë aplikuar kërkesat e udhëzuesit është më e lartë se sa në disa prej kategorive të tjera, ndonëse prapë se prapë, ky numër është larg të qenit i mjaftueshëm.


Aplikimi i rrethanave sipas kërkesave të udhëzuesit



Grafika 20 – Aplikimi i rrethanave sipas kërkesave të udhëzuesit.

Sa i përket rrethanave lehtësuese, në total, vetëm 19 % e rrethana lehtësuese të përdorura janë aplikuar dhe arsyetuar sipas kërkesave të udhëzuesit.

Aplikimi dhe arsyetimi i rrethanave lehtësuese sipas kërkesave të udhëzuesit




Grafika 21 – Aplikimi dhe arsyetimi i rrethanave lehtësuese sipas udhëzuesit.

Ndërsa, sa i përket rrethanave rënduese, numri i rrethanave rënduese të aplikuar dhe arsyetuara sipas kërkesave të udhëzuesit arrijnë pothuajse gjysmën e totalit, përkatësisht 46%.



Grafika 22 – Aplikimi dhe arsyetimi i rrethanave rëndësuese sipas udhëzuesit.

Ndërsa, shqetësuese mbetet numri i rrethanave të injoruara në këto 10 aktgjykime. Është vetëm një rast në të cilin nuk është identifikuar asnjë rrethanë lehtësuese derisa në një rast janë identifikuar plot 18 rrethana të injoruara. Në tre aktgjykime, numri i rrethanave të injoruara është 16.




Grafika 23 – Numri i rrethanave të injoruara në aktgjykime.

Sa i përket asaj që udhëzuesi e përcakton si dyfishim të rrethanave, shqetësuese është se në 70 % të aktgjykimeve të analizuar (përkatësisht shtatë aktgjykime) është identifikuar nga një

dyfishim i rrethanave, derisa raste me më shumë dyfishime të rrethanave nuk janë identifikuar në këtë kategori të aktgjykimeve të analizuara.


Sa i përket përshtatshmërisë së gjykimit, gjykatat e kanë trajtuar këtë çështje në 10 aktgjykimet e analizuara në këtë kapitull.

Por, sa i përket aplikimit të qëllimeve të dënimit, gjykata vetëm në një rast ka aplikuar të gjitha qëllimet e dënimit, ndërsa vetëm në dy raste ka aplikuar tre prej qëllimeve të dënimit. Nga kjo e dhënë, krijohet përshtypja se për këtë aspekt është krijuar një “shabllon” i arsytimit.




Grafika 24 – Numri i qëllimeve të dënimit të aplikuara në aktgjykime.

Qëllimi më i shpeshtë i aplikuar në këto aktgjykime është parandalimi i përgjithshëm, ndërsa në shtatë aktgjykime është përdorur edhe qëllimi specifik apo i veçantë, në dy raste është përdorur qëllimi i gjykimit shoqëror, ngritja e moralit dhe forcimi i detyrimit për respektimin e ligjit, derisa qëllimi viktimat dhe komuniteti është aplikuar në një rast.



Grafika 25 – Llojet e qëllimeve të dënimit të aplikuara në aktgjykime.

Në kuptim të udhëzuesit, jashtëzakonisht shqetësuese është mos arsyetimi i këtyre qëllimeve, ashtu siç përcakton edhe udhëzuesi. Nga të gjitha aktgjykimet në këtë kapitull, IKD ka gjetur se në total, vetëm në tre raste është arsyetuar qëllimi i dënimit, derisa të tjerat vetëm janë cituar, duke mos dhënë asnjë arsyetim. Edhe në këtë rast, krijohet përshtypja e një praktike të arsyetimit “bllanko” të përshtatshmërisë së dënimit, përkatësisht qëllimeve të dënimit.



Grafika 26 – Aplikimi i qëllimeve të dënimit sipas kërkesave të udhëzuesit.

Po ashtu, situatë pothuajse e ngjashme qëndron edhe sa i përket zbatimit të parimeve sipas kuptimit të udhëzuesit. Nga analiza që IKD ka bërë për kategorinë e vrasjeve, është gjetur se

në 80% të rasteve nuk janë zbatuar fare parimet e dënimit, derisa në vetëm 20% të rasteve parimet e dënimit, sipas kërkesave të udhëzuesit, janë zbatuar vetëm pjesërisht.



Grafika 27 – Zbatimi i parimeve sipas kërkesave të udhëzuesit.

Sa i përket kufijve të dënimit të përcaktuar në shtojcën 1 të udhëzuesit, nga analiza e IKD-së për këtë pjesë, rezulton se 67% e aktgjyqimeve nga kjo kategori nuk i janë përmbajtur kërkesave të udhëzuesit.



Grafika 28 – Dënimet e shqiptuara sipas kufijve të dënimeve në udhëzues.

c. Analiza e veçantë e rasteve të vrasjeve

1. Rasti PKR.nr.83/18 - Vrasje e rëndë 179 par1. nën par. 1.4 dhe 1.12 i KPRK-së

Aktgjykimi i marrë

Sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, të shpallur më 25 prill 2019, i dënuari, N.P. ishte shpallur fajtor, pasi që kishte gjetur se i njëjti ishte kryerës i veprës penale “Vrasje e rëndë”. Kjo pasi që, më 9 nëntor 2015, prej orës 13:44 deri 15:19, në Bjeshkët e Strelcit, Komuna e Deçanit, në vendin e quajtur “Kroni i Lajthisë” me dashje në mënyrë dinamike kishte privuar nga jeta viktimën, D.P, ashtu që viktima në ditën kritike ishte duke shkuar në punë në këmbë, gjatë rrugës i afrohet i dënuari me veturë “Jeep” e merr dhe vazhdon më pas në drejtim të Bjeshkëve, kur arrin tek vendi “Kroni i Lajthisë”, e privon nga jeta viktimën duke e goditur dy herë në kokë, e ku më pas largohet nga vendi i ngjarës, kurse, kufoma e viktimës është gjetur më 17 dhjetor 2015, nga disa kalimtarë të rastit.

Dënimi sipas KPRK-së: *dënim me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim ose me burgim të përjetshëm*

Dënimi i shqiptuar: *burgim i përjetshëm*

Rrethanat lehtësuese:

Asnjë.

Rrethanat rënduese

- 1 .I dënuari ka vvarë një femër në bjeshkë, e cila ka qenë e pambrojtur dhe në pamundësi të kërkoj ndihmë;
2. Raporti familjar i të dënuarit me viktimën;
3. Sjellja e të akuzuarit pas kryerjes së veprës penale;
4. Fakti se i akuzuari e ka vënë viktimën në pozitë të detyruar;
5. Shfrytëzimi i rastit kur në fshat kishte qenë varrimi i një bashkëfshatari;
6. I dënuari është njeri familjar dhe vajza e tij kishte qenë në klasë me viktimën;
7. Përfshirja e vajzës së tij, kinse ajo kishte qenë me të dhe e ulur në ulësen e pasme të veturës;
8. Tentimi i të dënuarit për orientimin e vëmendjes;

9. Vepra është kryer në rrethana posaçërisht rënduese dhe ka shkaktuar pasoja për familjen e viktimës dhe ndjenjën e sigurisë së përgjithshme tek gjinia femërore;

Përshtatshmëria e dënimit:

Gjykata kishte marr dhe arsyetuar rrethanat posaçërisht rënduese dhe kishte vlerësuar se me dënimin e përjetshëm do të arrihet qëllimi i dënimit. Po ashtu, sipas gjykatës një vendim i tillë është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale dhe me intensitetin e vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata është e bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbejë për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin personave të tjerë në kryerjen e veprave penale.

Zbatimi i udhëzuesit

Përshtatshmëria e dënimit

Përshtatshmëria e dënimit të këtij aktgjykimi është sipas kërkesave të udhëzuesit. Ndonëse, ndoshta nuk janë të listuara teknikisht si të tilla, gjykata në këtë rast i është referuar të gjitha qëllimeve të dënimit të cilat parashihet dhe sqarohen në udhëzues.

Zbatimi i parimeve

Ndonëse gjykata i ka përmendur të gjitha rrethanat në këtë rast, si dhe ka dhënë arsyetim për rrethanat që nuk janë përdorur, se pse të njëjtat nuk paraqesin rrethana lehtësuese apo rënduese në këtë rast, këto rrethana gjykata në këtë aktgjykim nuk i ka ndërlidhur me asnjë prej parimeve të dënimit.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Nga ajo që u tha më lartë, shihet se ky aktgjykim ka marrë parasysh gjithsej nëntë rrethana rënduese dhe asnjë rrethanë lehtësuese. Gjykata në këtë aktgjykim ka dhënë arsyetimin e duhur lidhur me provat dhe gjendjen faktike që vërtetojnë ekzistimin e një rrethane dhe pse e njëjta cilësohet si rënduese. Edhe interpretimi i rrethanave është sipas kërkesave të udhëzuesit.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruara nga aktgjykimi

Asnjë

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Në mesin e rrethanave rënduese, nga aktgjykimi kuptohet edhe në mesin e vetë rrethanave rënduese se cilat kanë qenë rrethanat që kanë mbi peshuar më shumë se të tjerat. Kjo përballë faktit se gjykata nuk ka gjetur asnjë rrethanë lehtësuese, që është e kuptueshme edhe vetë peshimi i rrethanave që gjykata ka bërë në këtë rast. Po ashtu, gjykata ka arsyetuar mjaftueshëm se ka faktorë që arsyetojnë dënimin maksimal brenda kufirit. Sipas shtojcës 1 të

udhëzuesit, pjesa 7, pika h, limitet e dënimit me burgim janë prej 22 deri në 25 vjet burgim efektiv. Por, gjykata ka arsyetuar mjaftueshëm se në rastin konkret gjenden rrethanat veçanërisht rënduese dhe janë shkaktuar pasoja shumë të rënda, çka sipas udhëzuesit, e arsyeton shqiptimin e dënimit me burgim të përjetshëm. Nga kjo kuptohet se ky aktgjykim është në përputhje të plotë me këto kritere të vendosura nga udhëzuesi.

2. Rasti PKR.nr.2/2016 - Vrasje e rëndë 147 par.1 nën par.4 i KPPK-së

Aktgjykimi i marrë

Sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda të shpallur më 11 prill 2019, i dënuari A.K. ishte dënuar, pasi që i njëjti ishte gjetur fajtor për vrasjen e të ndjerit M.C. Kjo pasi që, më 25 prill 2011, rreth orës 12:30, para derës së Gjimnazit “Sami Frashëri” me dashje direkte ka privuar nga jeta tani të ndjerin M.C., si dhe ka rrezikuar jetën e të pandehurve M.L. e M.C. duke rrezikuar edhe nxënësit e tjerë e kalimtarët e rastit. Të njëjtën ditë, rreth orës 11:00, i dënuari ishte rrahur me të ndjerin M.L., e ku si pasojë e kësaj rrahjeje e me qëllim të qërimit të llogarive për këtë rrahje, i dënuari kishte marr me vete të miturin T.K., ndërsa i pandehuri M.L. kishte marr dy djemtë e dajës, M.C. dhe M.C. Pas përfundimit të mësimit në shkollë, i dënuari së bashku me vëllain e tij T.K. i cili ia jep armën, revole të markës “Ekol Tuna” filluan të rreheshin në mes vete me të ndjerin dhe të pandehurit M.L. dhe M.C., ashtu që duke u goditur me mjete të forta shufra të metalta dhe të drurit, i dënuari nxjerr nga xhepi revolen dhe në afërsi prej 1-2 metra, e godet të ndjerin M.C., në pjesën e kafazit të kraharorit e ku si pasojë e veprimit dinamik të kësaj predhe, të ndjerit i shkaktohen dëmtime në pjesë vitale të trupit për çka pas pak çastesh edhe ndërrohet jetë.

Dënimi sipas KPRK-së: *së paku dhjetë (10) vjet burgim apo me burgim afatgjatë*

Dënimi i shqiptuar: *13 vjet*

Rrethanat lehtësuese:

1. Koha e kryerjes së veprës penale (mosha e re);
2. Nuk ishte i dënuar më herët për ndonjë veprë penale;

Rrethanat rënduese:

Asnjë

Përshtatshmëria e dënimit:

Gjykata me dënimin e shqiptuar ka vlerësuar se do të arrihet qëllimi i përgjithshëm dhe i veçantë i dënimit.

Zbatimi i udhëzuesit

Përshtatshmëria e dënimit

Në këtë aktgjykim, gjykata fare nuk ka pasur parasysh kërkesat e udhëzuesit i cili përcakton se marrja parasysh dhe arsyetimi në aktgjykim i qëllimeve të dënimit duhet që të bëhet në çdo aktgjykim. Gjukata vetëm në mënyrë deklarative dhe pa asnjë fjalë arsyetim thotë se me anë të këtij aktgjykimi do të arrihet qëllimi i përgjithshëm dhe i veçantë i dënimit. Gjukata nuk ka marrë parasysh asnjërin nga qëllimet të cilat udhëzuesi kërkon që të merren parasysh, e që janë parandalimi specifik apo i veçantë, parandalimi i përgjithshëm, viktimat dhe komuniteti si dhe gjykimi shoqëror, ngritja e moralit dhe forcimi i detyrimit për respektimin e ligjit. Pra, mbi përshtatshmërinë e dënimit, gjykata përmend vetëm qëllimin e përgjithshëm dhe të veçantë, duke mos arsyetuar se çfarë realisht ka nënkuptuar gjykata me këto dy lloj qëllimesh, të cilat nuk parashihen në udhëzues.

Zbatimi i parimeve

Gjukata në këtë rast në mënyrën se si e përcakton udhëzuesi, nuk e ka marrë parasysh dhe nuk e ka arsyetuar asnjë prej parimeve të dënimit.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Në këtë aktgjykim, gjykata është kufizuar në dy rrethana lehtësuese, përdorimi i të cilave nuk është bërë në pajtim me udhëzuesin, ndërsa nuk e ka marrë parasysh asnjë rrethanë rënduese. Sa i përket moshës së të dënuarit me rastin e kryerjes së veprës penale, gjykata nuk ka dhënë asnjë arsyetim se pse i dënuari është i moshës së re dhe çfarë realisht kuptohet me moshë të re, pasi i dënuari me rastin e kryerjes së veprës penale, nuk ishte nën moshën 18 vjeçare. Se si është peshuar kjo rrethanë, aktgjykimi nuk jep asnjë të dhënë. Sa i përket faktit se i dënuari nuk ka qenë i dënuar më parë për ndonjë vepër penale, fillimisht duhet ta kemi parasysh se në KPRK, kjo nuk përmendet fare si rrethanë lehtësuese. Ndërsa, në udhëzues hyn në kuadër të rrethanave të tjera lehtësuese. Sipas udhëzuesit, kjo është një rrethanë e ndërlikuar dhe në rast se përdoret si rrethanë lehtësuese, gjykata duhet të kërkojë gjetje të fakteve që e mbështesin përfundimin e sjelljes përkatëse dhe predispozitat për rehabilitim. Në lidhje me këtë kërkesë të udhëzuesit, gjykata nuk ka vepruar në arsyetimin e këtij aktgjykimi.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruara nga aktgjykimi

Janë një sërë rrethanash, si lehtësuese ashtu edhe rënduese, të cilat gjykata nuk i ka marrë për bazë në këtë arsyetim, e madje as nuk ka dhënë arsyetim se pse të njëjtat nuk janë marrë parasysh. Gjukata nuk ka marrë parasysh fare shkallën e dashjes, praninë e dhunës apo kanosjes në kryerjen e veprës penale, nëse vepra penale është kryer në mënyrë posaçërisht mizore, nëse vepra penale përfshin disa viktime, nëse viktime e veprës penale ka qenë posaçërisht e pambrojtur apo e ndjeshme, mosha e viktimës, (mos) provokimin nga viktime, bashkëpunimi i përgjithshëm i personit me gjykatën, shkallën e dëmit të shkaktuar, rrethanat

personale dhe karakteri i personit të dënuar, pendimin/mungesën e pendimit nga i dënuari, keqardhjen e shfaqur, (mos)kompensimi i dëmit të shkaktuar, sjelljen e personit të dënuar pas konfliktit, (mos)shkelja e urdhrave të gjykatës, kalimin e kohës dhe (mos) mbështetja pala e dëmtuar.

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Sa i përket këtij aktgjykimi, gjykata nuk ka pasur fare çfarë të peshojë, për arsye se nuk ka përdorur asnjë rrethanë rënduese. Po ashtu, në këtë aktgjykim, gjykata nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me rëndësinë e brendshme të rrethanave, që i bie se matja është kuantitative. Në këtë aktgjykim, janë përdorur dy rrethana lehtësuese dhe asnjë rënduese. Sipas udhëzuesit, këtu bëhet fjalë për “ekzistimi i së paku dy rrethanave për zvogëlim të fajësisë apo dëmit dhe asnjë/ose një rrethanë të vogël rënduese”. Në bazë të shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa, 7, pika g, limitet e dënimit janë 10 deri në 12 vite burgim efektiv, që i bie se ky aktgjykim nuk është brenda limiteve, përkatësisht është për 1 vit më i ashpër.

3. Rasti PKR.nr.389/2015 - Vrasje e rëndë 179 par.1 nën par 1.5 i KPRK

Aktgjykimi i marrë

Sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, të shpallur më 22 janar 2019, i dënuari M.G., ishte shpallur fajtor për veprën penale “vrasje e rëndë”. Sipas këtij aktgjykimi, M.G. së bashku me të akuzuarin tjetër, Sh.K. i cili nga gjykata ishte shpallur fajtor vetëm për veprën penale “pjesëmarrje në rrahje”, kishin shkuar në lokalit “Bon Vivant” për të pirë kafe, mirëpo meqë paraprakisht nuk kishin pasur rezervim, punëtori i sigurimit, i ndjeri Rr.U. u kishte thënë se duhet të largohen. Në ato momente, i akuzuari Sh.K. fillon të fjaloset me të dhe ta godas me grushte, ndërsa i akuzuari M.G., në hapësirën brenda lokalit duke parë që ishin të pranishëm personeli i lokalit dhe mysafir të tjerë, e nxjerr nga çanta e tij armën “Crvena Zastava” të cilën ia drejton të ndjerit Rr.U, por arma i bllokohet, prapë ia tërheq këmbëzën e revoles, por revolja sërish nuk i shkrep. Më pas i akuzuari M.G. nisjet në drejtim të daljes së lokalit, i ndjeri Rr.U i shkon nga pas, e pas tij edhe i akuzuari Sh.K., dhe të tre fillojnë të kacafyten në hapësirën e tarracës, duke vënë në rrezik edhe jetën e personave të tjerë në lokal, M.G e privon nga jeta të ndjerin duke e qëlluar me revole me çka ia shkakton dy plagë tejshkuese një në regjionin e gjoksit dhe tjetrën në parakrahun e djathtë dhe si pasojë e gjakderdhjes masive nga plagët e marra, i ndjeri Rr.U., ndërron jetë në QKUK, ndërsa i akuzuari M.G., largohet nga vendi i ngjarjes por jo larg arrin të kapet nga policët.

Dënimi sipas KPRK-së:

Për veprën penale “vrasje e rëndë”: *dënim me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim ose me burgim të përjetshëm*

Për veprën penale “pjesëmarrje në rrahje”: *gjobë ose burgim deri në tre (3) vjet*

Dënimi i shqiptuar:

Për veprën penale “vrasje e rëndë”: *21 vjet*

Për veprën penale “pjesëmarrje në rrahje”: *4 vite e 3 muaj*

Rrethanat lehtësuese:

1. Llogaritshmërinë e zvogëluar;
2. Keqardhjen për familjen e viktimës;

Rrethanat rënduese:

1. Shkalla e pjesëmarrjes në kryerjen e veprës penale;
2. Rrezikimi i njerëzve të tjerë të pafajshëm;
3. I dënuar kishte qenë i dënuar edhe më parë për dy vepra penale me aktgjykime të formës së prerë;

Përshtatshmëria e dënimit:

Gjykata ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar është adekuat dhe i përgjigjet peshës së veprës penale, sjelljes dhe shkallës së përgjegjësisë penale së të akuzuarit, se një dënim i tillë do të ndikonte në risocializimin e të njëjtëve, ngritjen e moralit shoqëror, forcimin e detyrimit të respektimit të ligjit dhe gjithashtu do të ndikonte tek të tjerët në mos kryerjen e veprave penale si dhe me dënime të tilla, gjykata është e bindur se do të arrihet qëllimi i dënimit dhe se i akuzuari nuk do të përsëris vepër tjetër penale.

Kundër kushtetutshmëria dhe kundërligjshmëria e këtij aktgjykimi

I akuzuari i dytë në këtë rast është dënuar për kryerjen e veprës penale “pjesëmarrje në rrahje”, e cila në bazë të nenit 190, paragrafi 1 i KPRK-së, është e dënueshme me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

Neni që gjykata i është referuar në aktgjykim kur edhe e ka caktuar këtë dënim, ka qenë pikërisht neni 190, paragrafi 1 i KPRK-së. Gjykata nuk i është referuar asnjë neni tjetër, me të cilin do të arsyetonte se pse i është shqiptuar dënim më i lartë se sa ai që është përcaktuar në KPRK. Për këtë çështje, në arsyetim, gjykata ka dhënë një arsyetim arbitrar, i cili nuk bazohet askund në ligj, ku thuhet se “në veprimet e të akuzuarit Sh.K., gjykata vërtetoi fajësinë për pjesëmarrje në rrahje, e cila ka qenë shkas për të rrjedhë edhe pasoja e rëndë që e ka tejkaluar edhe qëllimin e kryerësit, andaj duke marrë parasysh rrethanat në të cilat është

kryer vepra, motivi, faktin se i akuzuari Sh.K. pa hezitim shpreh gatishmëri për shkaktimin e problemit, gjykata ka vlerësuar se i akuzuari Sh.K. mban përgjegjësi për pasojën e shkaktuar më të rëndë, andaj ka vlerësuar se ndaj të njëjtit është i nevojshëm ashpërsimi i dënimit për tu realizuar qëllimi i dënimit”.

Lidhur me këtë rast, IKD ka analizuar gjithë aktgjykimin, dispozitat ligjore dhe kushtetuese. Gjithë kjo në mënyrë që të kuptohet nëse ka ndonjë bazë ligjore që e mbulon këtë fakt, por që gjykata nuk e ka përmendur. Por, në sistemin kushtetues dhe juridik të Republikës së Kosovës, nuk është gjetur asnjë normë e vetme e cila do ta arsyetonte këtë veprim të gjykatës.

Për këtë arsye, ky dënim është një dënim i cili konsiston në shkelje kushtetuese dhe ligjore nga ana e gjykatës, çfarë e bënë këtë aktgjykim kundër kushtetues dhe të kundërligjshëm.

Neni 33, paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton se “dënimi i shqiptuar për një veprë penale nuk mund të jetë më i ashpër sesa ka qenë i përcaktuar me ligj në kohën e kryerjes së veprës”.

Përpos Kushtetutës së Republikës së Kosovës, parimi i ligjshmërisë është edhe parim bazë i KPPRK-së, i cili përcaktohet në nenin 2 të tij. Në këtë nen përcaktohet “1. Veprat penale, sanksionet penale dhe masat e trajtimit të detyrueshëm përcaktohen vetëm me ligj. 2. Askujt nuk mund t’i shqiptohet sanksioni penal ose masa e trajtimit të detyrueshëm për një veprë nëse para kryerjes së saj nuk është përcaktuar me ligj si veprë penale dhe nuk është paraparë sanksioni penal ose masa e trajtimit të detyrueshëm për atë veprë. 3. Përkufizimi i një veprë penale duhet të përcaktohet në mënyrë të saktë dhe nuk lejohet interpretimi sipas analogjisë. Në rast paqartësie, përkufizimi i veprës penale interpretohet në favor të personit ndaj të cilit zhvillohet procedura penale”.

Në legjislacionin penal të secilit vend në botë, dënimi me burgim nuk përcaktohet si dënim fiks, por përcaktohet minimumi dhe maksimumi i atij dënimi. Kjo është detyrë e gjykatës, që brenda dy limiteve, të marrë një vendim me të cilin arrihet qëllimi i dënimit. Arritja e qëllimit të dënimit, në asnjë rrethanë nuk mund të bëhet në dëm të parimit të ligjshmërisë. Sikurse veprat penale, edhe lloji dhe lartësia e dënimit përcaktohet me ligj, e cila detyrë nuk i përket gjykatës. Një veprim i tillë, sjellë deri në anarki brenda sistemit të drejtësisë, pra, shkon shumë përtej cenimit të sigurisë juridike.

Në anën tjetër, në raport me udhëzuesin, vlerësimi nëse ky aktgjykim është në përputhje me udhëzuesin është i pamundur, pasi vetë udhëzuesi është shpjegim i dispozitave ligjore dhe i njëjti nuk shpjegon rastet kur një aktgjykim merret duke shkelur Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës.

Zbatimi i udhëzuesit

Përshtatshmëria e dënimit

Në materie, aktgjykimi i referohet tre prej katër qëllimeve të cilat sipas udhëzuesit duhet të sqarohen në aktgjykim, derisa nuk thotë asgjë lidhur me qëllimin “viktimat dhe komuniteti”.

Por, se si do të arrihen këto qëllime të dënimit, gjykata nuk jep asnjë arsytim, por vetëm e merr si të mirëqenë se me këtë dënim do të arrihen qëllimet e përmendura.

Zbatimi i parimeve

Gjykata në këtë rast vetëm ka cituar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, duke mos bërë asnjë ndërlidhje me parimet që duhet të merren parasysh me rastin e caktimit të dënimit, siç përcaktohet në udhëzues.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Sa i përket veprës penale të vrasjes së rëndë, si rrethana lehtësuese, gjykata ka marrë parasysh llogaritshmërinë e zvogëluar së të pandehurit dhe shprehjen e keqardhjes nga i pandehuri për familjen e viktimës. Sa i përket rrethanës lehtësuese mbi llogaritshmërinë e zvogëluar, gjykata nuk jep asnjë arsytim se pse kjo rrethanë është marrë si rrethanë lehtësuese. Njëjtë vepron edhe për rrethanën e dytë lehtësuese, që është shprehja e keqardhjes nga i pandehuri për familjen e viktimës. Sa i përket rrethanës së dytë, udhëzuesi përcakton se duhet të merren parasysh shtatë faktorë si dhe gjykata duhet tu japë përgjigje tetë pyetjeve relevante, derisa gjykata i ka injoruar të gjitha këto. Sa i përket rrethanave rënduese, aktgjykimi përmend tri rrethana rënduese: shkalla e pjesëmarrjes së të pandehurit në kryerjen e veprës penale, vënia në rrezik e personave të tjerë të pafajshëm, të cilët ishin prezent në momentin e kryerjes së veprës penale dhe faktin se i dënuari më parë ka qenë dy herë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë. Sa i përket shkallës së pjesëmarrjes së të pandehurit në kryerjen e veprës penale, udhëzuesi paraqet shtatë pyetje të cilat duhet të sqarohen, ndërsa gjykata nuk e ka sqaruar asnjë prej tyre. Sipas udhëzuesit, për këtë rrethanë duhet të merren parasysh pesë faktorë, derisa janë gjashtë pyetje të cilave gjykata duhet tu japë përgjigje. Në këtë drejtim, gjykata ka marrë parasysh vetëm një faktor, numrin e dënimeve të mëparshme, derisa ka injoruar të gjithë faktorët dhe pyetjet e tjera të cilat duhet të merren parasysh dhe sipas udhëzuesit, edhe të arsyetohen. Sa i përket rrethanës tjetër rënduese, asaj se i dënuari kishte rrezikuar edhe personat e tjerë të pafajshëm të cilët kishin qenë prezent, sipas udhëzuesit, gjykata në këtë rast ka bërë dyfishimin e rrethanave. Kjo për arsye se i akuzuari është dënuar për një vepër të kualifikuar të vrasjes së rëndë, në të cilën thuhet “privon nga jeta personin tjetër dhe me atë rast me dashje e vë në rrezik jetën e një ose më shumë personave tjerë”. Për këtë arsye, me vetë faktin se kjo rrethanë është formë e kualifikuar, për të cilën arsye rritet edhe dënimi sipas KPRK-së, e njëjta nuk mund të përdoret përsëri si rrethanë rënduese, pasi kemi dyfishim të rrethanave.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruara nga aktgjykimi

Janë një sërë rrethanash, si lehtësuese ashtu edhe rënduese, të cilat gjykata nuk i ka marrë për bazë në këtë arsytim, e madje as nuk ka dhënë arsytim se pse të njëjtat nuk janë marrë parasysh. Gjykata nuk ka marrë parasysh fare praninë e dhunës apo kanosjes në kryerjen e veprës penale, nëse vepra penale është kryer në mënyrë posaçërisht mizore, nëse vepra penale përfshin disa viktima, nëse viktima e veprës penale ka qenë posaçërisht e pambrojtur apo e ndjeshme, mosha e viktimës, (mos) provokimin nga viktima, mosha e të pandehurit,

bashkëpunimi i përgjithshëm i personit me gjykatën, shkallën e dëmit të shkaktuar, rrethanat personale dhe karakteri i personit të dënuar, pendimin/mungesën e pendimit nga i dënuari, (mos) kompensimi i dëmit të shkaktuar, sjelljen e personit të dënuar pas konfliktit, (mos) shkelja e urdhrave të gjykatës, kalimin e kohës dhe (mos) mbështetja pala e dëmtuar.

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Gjykata në aktgjykim ka marrë parasysh tri rrethana rënduese dhe dy rrethana lehtësuese. Përrjashtimisht, një rrethane lehtësuese për të cilën gjykata ka thënë se është minore, gjykata nuk ka dhënë asnjë sqarim tjetër lidhur me rëndësinë e brendshme të një rrethane të caktuar, si dhe nuk ka dhënë arsyetim se si është bërë peshimi i rrethanave. Në këtë drejtim, meqenëse nuk kemi arsyetim tjetër, mund të themi se këtu bëhet fjalë për rastet kur faktorët tregojnë më shumë rrethana rënduese sesa lehtësuese. Bazuar në shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 7, pika h, dënimi duhet të jetë nga 17 deri në 22 vjet, që i bie se dënimi i shqiptuar nga gjykata është brenda limiteve të përcaktuar në shtojcën e udhëzuesit.

4. Rasti PKR.nr.590/15 - Vrasje e rëndë nga neni 179 par 1 nën par 1.5 KPRK-së

Aktgjykimi i marrë

Sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, të shpallur më 27 nëntor 2018, i dënuari B.B. ishte shpallur fajtor për veprën penale “Vrasje e rëndë”. Kjo pasi që më, 14 shkurt 2015, rreth orës 02:00, në restorantin “Agoni” në fshatin Banullë të Lipjanit pas një mosmarrëveshje mes tyre, bashkë me të dënuarin tjetër B.B, i cili është dënuar për ndihmë në kryerjen e veprës penale, kishte privuar nga jeta të njërin U.D. I dënuari B.B së bashku me të dënuarin tjetër, kishin shkuar tek viktima, ku fillimisht ishin fjalosur e pastaj e kishin sulmuar të ndjerin dhe të dëmtuarit E.Q. dhe S.A. me mjete të forta. I ndjeri e kishte përdorur armën e tij për ta evituar sulmin, mirëpo, i dënuari B.B, me revolen e tij në afërsi rreth një metër ka shtënë në drejtim të të ndjerit katër herë dhe nga plagët e marra U.D kishte vdekur në vendin e ngjarjes.

Dënimi sipas KPRK-së:

Vrasje e rëndë: *dënim me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim ose me burgim të përjetshëm*

Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve: *me gjobë deri në 7500 euro apo me burgim deri në pesë (5) vite.*

Dënimi i shqiptuar:

Për të akuzuarin e parë:

Për vrasje të rëndë: katërbëdhjetë (14) vjet e gjashtë (6) muaj burgim

Për mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve: një (1) vit burgim

Për ndihmë në kryerjen e veprës penale: 9 vite e 6 muaj burg

Për mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve: 1 vit

Rrethanat lehtësuese:

1. Moshën e tij relativisht të re;
2. Është njeri familjar;
3. I dënuari nuk ka qenë më parë i dënuar;

Rrethanat rënduese për të dënuarin e parë:

Pasojat e kësaj vepre penale, meqë me veprimet e tij është shkaktuar vdekja e tani të ndjerit;

Rrethanat rënduese për të dënuarin e dytë:

1. Ka ndihmuar kryerjen e veprës penale

Përshtatshmëria e dënimit:

Gjykata ka vlerësuar së dënimi i shqiptuar është në përputhje me peshën e veprës penale, rrethanat në të cilat është kryer kjo vepër si dhe në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale dhe intensitetin e pasojës së shkaktuar. Gjykata ka vlerësuar se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit.

Zbatimi i udhëzuesit

Përshtatshmëria e dënimit

Në këtë pjesë, gjykata nuk ka marrë parasysh dhe nuk ka arsyetuar asnjë prej qëllimeve të dënimit të cilat sipas udhëzuesit duhet të merren parasysh në çdo rast. Në këtë pjesë, gjykata ka përmendur disa prej parimeve të dënimit, por që nuk e ka ndërlidhur asnjërin prej tyre me ndonjë rrethanë rënduese apo lehtësuese, por vetëm i ka cituar.

Zbatimi i parimeve

Gjykata në këtë rast vetëm ka cituar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, duke mos bërë asnjë ndërlidhje me parimet që duhet të merren parasysh me rastin e caktimit të dënimit, siç përcaktohet në udhëzues.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Sa i përket moshës relativisht të re, fillimisht sipas udhëzuesit mosha “*relativisht e re*”, nuk ekziston si rrethanë lehtësuese, derisa është e pakuptimtë se si kjo rrethanë merret si rrethanë

lehtësuese, kur dy të dënuarit ishin nga 37 vjeçar. Sa i përket faktit se i dënuari është familjar, udhëzuesi përcakton shtatë faktorë të cilët gjykata duhet ti marrë parasysh dhe ti arsyetojë në këto raste, gjë që gjykata nuk e ka bërë në këtë aktgjykim. Sa i përket faktit se të dënuarit për herë të parë kanë rënë ndesh me ligjin, sipas udhëzuesit, kjo rrethanë kualifikohet tek rrethanat e tjera lehtësuese. Në udhëzues thuhet se nëse gjykata e konstaton mungesën e dënimeve të mëparshme penale dhe mund të jepet zbutja, do të kërkoj gjetje të fakteve që e mbështesin përfundimin e sjelljes përkatëse dhe predispozitat për rehabilitim. Kjo çështje, nuk trajtohet fare në këtë aktgjykim. Sa i përket rrethanave rënduese për të dy të dënuarit, sipas udhëzuesit, gjykata në të dyja rastet ka bërë dyfishim të rrethanave, pasi pasoja e shkaktuar, respektivisht ndihma në kryerjen e kësaj veprë penale, janë elemente qenësore të vetë veprave penale për të cilat janë akuzuar dhe dënuar të pandehurit.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruara nga aktgjykimi

Janë një sërë rrethanash, si lehtësuese ashtu edhe rënduese, të cilat gjykata nuk i ka marrë për bazë në këtë arsyetim, e madje as nuk ka dhënë arsyetim se pse të njëjtat nuk janë marrë parasysh. Gjkata nuk ka marrë parasysh fare shkallën e pjesëmarrjes së personit në kryerjen e veprës penale, shkallën e dashjes, praninë e dhunës apo kanosjes në kryerjen e veprës penale, nëse vepra penale është kryer në mënyrë posaçërisht mizore, nëse vepra penale përfshin disa viktime, nëse viktime e veprës penale ka qenë posaçërisht e pambrojtur apo e ndjeshme, moshja e viktimës, (mos) provokimin nga viktime, bashkëpunimi i përgjithshëm i personit me gjykatën, pendimin/mungesën e pendimit nga i dënuari, keqardhjen e shfaqur, (mos) kompensimi i dëmit të shkaktuar, sjelljen e personit të dënuar pas konfliktit, (mos) shkelja e urdhrave të gjykatës, kalimin e kohës dhe (mos) mbështetja pala e dëmtuar.

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Gjkata në këtë aktgjykim nuk ka përcaktuar dhe dhënë arsyetim mbi rëndësinë e brendshme për asnjë prej rrethanave të aplikuara, si dhe nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me peshimin e rrethanave. Për këtë arsye, llogaritja është kuantitative. Në rastin konkret, për dy të dënuarit, kemi tri rrethana lehtësuese dhe një rënduese, që sipas udhëzuesit bëhet fjalë për “ekzistimin e së paku dy rrethanave për zvogëlim të fajësisë apo dëmit dhe asnjë/ose një rrethanë të vogël rënduese”, që kualifikohet tek kolona 5, përkatësisht tek rrethanat që arsyetojnë zbutjen maksimale të dënimit brenda kufirit. Për veprën penale “vrasje e rëndë” dhe “ndihmë në vrasje të rëndë”, limitet e dënimit sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 7, pika h, janë nga 10 vjet deri në 13 vjet, që i bie se ky dënim është brenda këtyre limiteve sa i përket të dënuarit të dytë, por jo edhe sa i përket të dënuarit të parë. Ndërsa, sa i përket veprës penale “mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, sipas pjesës 1, pika 7 të kësaj shtojcë, limitet e dënimit janë nga një muaj deri në një vit, që i bie se dënimi është brenda këtyre limiteve.

5 Rasti PKR.nr.253/16 - Vrasje e rëndë nga neni 147 par. 1 pika 4 dhe 9 i KPK-së.

Aktgjykimi i marrë

Sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, të shpallur më 26 qershor 2018, i dënuari G.E. ishte shpallur fajtor për veprën penale “Vrasje e rëndë”. Kjo pasi që, më 2 janar 2010, rreth orës 22:45 në diskotekën “City Club” me dashje dhe nga motivet e hakmarrjes ka privuar nga jeta viktimën B.Sh. duke vënë në rrezik edhe jetën e V.K., A.B. dhe një numër të madh të personave të pranishëm. I dënuari, në natën kritike, kishte hyrë në diskotekë me qëllim që ta privoj nga jeta V.K., i cili kishte qenë shumë afër të ndjerit B.Sh. me ç’rast viktimën e godet me një predhë në gjoks duke i shkaktuar vdekjen e menjëhershme, ndërsa V.K. e godet po ashtu në gjoks duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore. I dënuari më pas duke u larguar vazhdon të shtijë në drejtime të ndryshme, ku me ç’rast e godet edhe viktimën A.B. të cilës i shkakton lëndime trupore. I dënuar G.E, për lëndimet që kishin pësuar të dëmtuarit, A.B, V.K dhe H.B, akuzohet për tri vrasje të rënda në tentativë, mirëpo, pasi ri cilësimi të këtyre veprave nga gjykata, i njëjti ishte shpallur fajtor për veprën penale “shkaktim i rrezikut të përgjithshëm”.

Dënimi sipas KPK/KPRK-së:

Vrasje e rëndë: dhjetë (10) vjet burgim apo me burgim afatgjatë

Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm: dënim me burgim prej një (1) deri në 12 vjet

Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve: me gjobë deri në 7500 euro apo me burgim deri në pesë (5) vite.

Dënimi i shqiptuar:

Për veprën penale vrasje e rëndë: *njëzetepesë (25) vjet burg*

Për veprën penale shkaktim i rrezikut të përgjithshëm: *(pesë) 5 vjet burgim*

Për veprën penale mbajtje në pronësi, kontroll, posedim ose përdorim i paautorizuar i armëve: *një (1) vit burgim*

Rrethanat lehtësuese:

Asnjë

Rrethanat rënduese

1. Rrezikimi i jetës së shumë personave;
2. Ndaj të dënuarit për gjashtë vite kishte flete rreshtim ndërkombëtarë pasi që i dënuari i ishte shmangur organeve të ndjekjes;

Përshtatshmëria e dënimit:

Gjykata ka vlerësuar se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit dhe do të parandalohet i pandehuri nga kryerja e veprave të tilla në të ardhmen.

Zbatimi i udhëzuesit

Përshtatshmëria e dënimit

Gjykata në këtë aktgjykim ka përmendur vetëm parandalimin specifik të veçantë të dënimit dhe vetëm e ka cituar atë, duke mos dhënë asnjë arsytim siç edhe e parasheh udhëzuesi. Sa i përket tri qëllimeve të tjera të dënimit të cekura në udhëzues, gjykata të njëjtat nuk i ka përmendur fare në këtë aktgjykim.

Zbatimi i parimeve

Gjykata në këtë rast vetëm ka cituar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, duke mos bërë asnjë ndërlidhje me parimet që duhet të merren parasysh me rastin e caktimit të dënimit, siç përcaktohet në udhëzues.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Sa i përket rrethanës rënduese se i dënuari ka rrezikuar jetën e shumë personave, sipas udhëzuesit, këtu bëhet fjalë për dyfishim të rrethanave. Kjo, për arsye se vënia në rrezik e personave të tjerë me rastin e kryerjes së veprës penale nuk është rrethanë në këtë rast, por është formë e kualifikuar e veprës penale, për të cilën edhe është dënuar i pandehuri. Sa i përket mos bashkëpunimit së të dënuarit me organet e ndjekjes, kjo është një gjendje faktike me të cilën vërtetohet një rrethanë e caktuar. Por, gjykata në këtë rast nuk ka treguar se për cilën rrethanë rënduese bëhet fjalë.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruara nga aktgjykimi

Janë një sërë rrethanash, si lehtësuese ashtu edhe rënduese, të cilat gjykata nuk i ka marrë për bazë në këtë arsytim, e madje as nuk ka dhënë arsytim se pse të njëjtat nuk janë marrë parasysh. Gjykata nuk ka marrë parasysh fare shkallën e dashjes, praninë e dhunës apo kanosjes në kryerjen e veprës penale, nëse vepra penale është kryer në mënyrë posaçërisht mizore, nëse vepra penale përfshin disa viktime, nëse viktime e veprës penale ka qenë posaçërisht e pambrojtur apo e ndjeshme, moshën e viktimës, (mos) provokimin nga viktime, moshën e të pandehurit, shkallën e dëmit të shkaktuar, rrethanat personale dhe karakteri i personit të dënuar, pendimin/mungesën e pendimit nga i dënuari, keqardhjen e shfaqur, (mos) kompensimi i dëmit të shkaktuar, sjelljen e personit të dënuar pas konfliktit, e kaluara kriminale/jo kriminale e të dënuarve, (mos) shkelja e urdhrave të gjykatës, kalimin e kohës dhe (mos) mbështetja pala e dëmtuar.

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Gjykata në këtë rast nuk ka dhënë arsyetim për rëndësinë e brendshme të asnjë prej rrethanave të aplikuara si dhe nuk ka dhënë asnjë arsyetim mbi peshimin e rrethanave. Për këtë arsye, llogaritja është kuantitative. Në rastin konkret, kemi dy rrethana rënduese dhe asnjë rrethanë lehtësuese, që sipas udhëzuesit bëhet fjalë për rastet kur kemi “dy apo më shumë rrethana të fajësisë apo dëmit të shtuar pa asnjë rrethanë lehtësuese”, që kualifikohet tek faktorët që arsyetojnë dënimin maksimal brenda kufirit. Sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 7, pika 5, dënimi në këtë rast duhet të jetë nga 18 deri në 20 vjet burgim. Nëse e marrim në mënyrë analoge dënimin me burgim të përjetshëm në raport me dënimin me burgim afatgjatë, nëse shqiptohet ky i fundit, gjykata duhet të japë një arsyetim të veçantë për "rrethana veçanërisht rënduese" ose për vepra penale që "kanë shkaktuar pasoja shumë të rënda", gjë që gjykata nuk e ka bërë në këtë rast, dhe si rrjedhojë, konsiderohet se ky aktgjykim është më i ashpër se sa standardet e përcaktuara nga udhëzuesi.

6 Rasti PKR.nr.89/17 - Vrasje e rëndë 179 par.1 pika 1.5 dhe 1.8 i KPRK-së

Aktgjykimi i marrë

Sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Departamenti për Krime të Rënda, të shpallur më 20 qershor 2018, i dënuari M.B. ishte shpallur fajtor për veprën penale “Vrasje e rëndë”. Kjo pasi që, më 29 shtator 2015, rreth orës 16:30 në Skenderaj, në afërsi të stacionit të autobusëve, me dashje dhe nga hakmarrja e kishte privuar nga jeta të ndjerin V.G., pasi që i ndjeri kishte vrarë B.B, i dënuari në shenjë hakmarrje deri sa viktima ishte ndalur me veturën e tij, me një veturë tjetër të drejtuar nga personi i paidentifikuar, shtie në drejtim të viktimit, duke i shkaktuar dëmtime në pjesë vitale të trupit. Kështu ka vënë në rrezik edhe jetën e bashkudhëtares së të ndjerit N.G. dhe A.F., të cilit i ka shkaktuar edhe lëndime trupore.

Dënimi sipas KPRK-së:

Për vrasje të rëndë: dënim me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim ose me burgim të përjetshëm

Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve: me gjobë deri në 7500 euro apo me burgim deri në pesë (5) vite.

Dënimi i shqiptuar:

Për vrasje të rëndë: *njëzet (20) vjet burgim*

Për mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve: *dy (2) vite burgim*

Rrethanat lehtësuese:

1. I dënuari për herë të parë ka rënë në kundërshtim me ligjin;

2. Është baba i tre fëmijëve dhe pas vdekjes së bashkëshortes është mbajtës i vetëm i familjes;

Rrethanat rënduese

1. Shkalla e lartë e dashjes për ta privuar nga jeta të viktimën, pasi i pandehuri pas vrasjes së vëllait ka qenë këmbëngulës që të hakmerret ndaj viktimës dhe një kohë të gjatë është përgatitur dhe gjithë këtë e ka bërë me paramendim;

2. Në këtë vepër, janë përfshirë dy viktima;

3. Tani i ndjeri ka qenë i moshës së re, i martuar, i punësuar dhe e ka pasur jetën përpara;

5. Me këtë vepër penale është shkaktuar dëm i madh nga ana e të akuzuarit, pasi edhe një person tjetër ka pësuar lëndime të rënda trupore të përhershme

Përshtatshmëria e dënimit:

Gjykata është e bindur se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi dënimit, që të parandaloj kryerësin nga kryerja e veprave të tjera penale në të armen dhe të bëj rehabilitimin e tij si dhe me anë të këtij dënimi do të parandalohen edhe personat e tjerë nga kryerja e vepra penale.

Zbatimi i udhëzuesit

Përshtatshmëria e dënimit

Në këtë pjesë, gjykata citon vetëm dy qëllime të dënimit (parandalimin specifik/të veçanta dhe të përgjithshëm). Asnjë prej këtyre qëllimeve gjykata nuk e arsyeton sipas kërkesave të udhëzuesit në atë mënyrë që të tregojë se si do të arrihen këto dy qëllime përmes këtij dënimi. Sa i përket dy qëllimeve të tjera, gjykata fare nuk i merr parasysh dhe nuk i përmend në këtë aktgjykim.

Zbatimi i parimeve

Sa i përket rrethanave rënduese, gjykata i ka zbatuar parimet e dënimit sipas kërkesave të udhëzuesit, në atë mënyrë që të njëjtat i ka ndërlidhur me rrethana të posaçme rënduese. Por, këtë gjykata nuk e ka bërë në raport me rrethanat lehtësuese. Këto të fundit, gjykata i ka trajtuar pa i ndërlidhur fare me parimet e dënimit.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Sa i përket faktit se i dënuari për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, sipas udhëzuesit, kjo rrethanë kualifikohet tek rrethanat e tjera lehtësuese. Në udhëzues thuhet se nëse gjykata e konstaton mungesën e dënimeve të mëparshme penale dhe mund të jepet zbutja, do të kërkoj

gjetje të fakteve që e mbështesin përfundimin e sjelljes përkatëse dhe predispozitat për rehabilitim. Kjo çështje nuk trajtohet fare në këtë aktgjykim. Sa i përket faktit se i dënuari është familjar, gjykata e ka arsytuar mjaftueshëm dhe në përputhje me kriteret e udhëzuesit këtë rrethanë. Po ashtu, gjykata e ka arsytuar mjaftueshëm dhe sipas kriterëve të udhëzuesit edhe rrethanat rënduese si: shkalla e lartë e dashjes, numri i viktimave dhe mosha e viktimës. Por, gjykata ka bërë dyfishim të rrethanave në momentin kur si dy rrethana të veçanta rënduese ka marrë parasysh numrin e të dëmtuarve si dhe numrin e të dëmtuarve të cilët kanë pësuar lëndime të rënda trupore.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruara nga aktgjykimi

Janë një sërë rrethanash, si lehtësuese ashtu edhe rënduese, të cilat gjykata nuk i ka marrë për bazë në këtë arsyetim, e madje as nuk ka dhënë arsyetim se pse të njëjtat nuk janë marrë parasysh. Gjukata nuk ka marrë parasysh fare praninë e dhunës apo kanosjes në kryerjen e veprës penale, nëse vepra penale është kryer në mënyrë posaçërisht mizore, nëse viktima e veprës penale ka qenë posaçërisht e pambrojtur apo e ndjeshme, (mos) provokimin nga viktima, mosha e të pandehurit, bashkëpunimi i përgjithshëm i personit me gjykatën, pendimin/mungesën e pendimit nga i dënuari, keqardhjen e shfaqur, (mos) kompensimi i dëmit të shkaktuar, sjelljen e personit të dënuar pas konfliktit, (mos) shkelja e urdhrave të gjykatës, kalimin e kohës dhe (mos) mbështetja pala e dëmtuar.

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Ndonëse rrethanat e përdorura në këtë aktgjykim janë arsytuar deri në një masë, gjykata nuk ka dhënë asnjë arsyetim mbi rëndësinë e brendshme të këtyre rrethanave e as mbi peshimin e rrethanave. Për këtë arsye, llogaritja është kuantitative. Në rastin konkret, kemi katër rrethana rënduese dhe dy rrethana lehtësuese, që sipas udhëzuesit bëhet fjalë për rastet kur “totali i rrethanave rënduese e tejkalon dukshëm më shumë atë të rrethanave lehtësuese”, e që kualifikohet tek faktorët që arsyetojnë dënimin maksimal brenda kufirit. Sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 7, pika h, dënimi në këtë rast duhet të jetë nga 22 deri në 25 vjet dënim me burgim, që i bie se sa i përket veprës penale të vrasjes së rëndë, dënimi nuk është brenda këtyre limiteve, përkatësisht është për dy vite më i butë. Sa i përket veprës penale mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 1, pika g, dënimi duhet të jetë nga katër deri në pesë vjet burgim, që i bie se dënimi në këtë rast nuk është brenda këtyre limiteve, përkatësisht është më i butë.

7 Rasti PKR.nr.108/18 - Vrasje e rëndë 179 par1. nën par. 1.4, 1.3 dhe 1.8 i KPRK-së

Aktgjykimi i marrë

Sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj – Departamenti për Krime të Rënda, të shpallur më 11 nëntor 2018, i dënuari R.Sh. ishte shpallur fajtor për veprën penale “Vrasje e rëndë”. Kjo pasi që, më 13 prill 2018, rreth orës 03:30, në fshatin Varosh të Komunës së

Ferizajt, me qëllim që ta privoj nga jeta, bashkëshorten e tij N.Sh. deri sa ajo ishte në gjumë, del jashtë në oborr merr një sëpatë dhe hynë dhe e godet tri herë në pjesën e qafës viktimën, duke i shkaktuar lëndime trupore, e që si pasojë e këtyre lëndimeve e dëmtuara qëndron në komë e pas një kohe edhe ndërron jetë në QKUK në Prishtinë.

Dënimi sipas KPRK-së: dënim me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim ose me burgim të përjetshëm

Dënimi i shqiptuar: dymbëdhjetë (12) vjet burg

Rrethanat lehtësuese:

1. I dënuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale;
2. Nuk ka qenë më parë i dënuar;
3. Pendimin e shprehur;
4. Mosha e shtyrë;
5. Vuan nga një çrregullim mendor;

Rrethanat rënduese

1. Vepra penale është kryer në orët e vona të natës, kur e ndjera ka qenë në gjumë;

Përshtatshmëria e dënimit:

Gjykata është e bindur se me dënimin e shqiptuar do të rrihet qëllimi dënimit, në kuptimin e preventives speciale dhe gjeneralë dhe se dënimi është adekuat dhe në proporcion me peshën e veprave penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë dhe personalitetit e të pandehurit.

Zbatimi i udhëzuesit

Përshtatshmëria e dënimit

Në këtë pjesë, gjykata citon vetëm dy qëllime të dënimit (parandalimin specifik/të veçanta dhe të përgjithshëm). Asnjë prej këtyre qëllimeve gjykata nuk e arsyeton sipas kërkesave të udhëzuesit në atë mënyrë që të tregojë se si do të arrihen këto dy qëllime përmes këtij dënimi. Sa i përket dy qëllimeve të tjera, gjykata fare nuk i merr parasysh dhe nuk i përmend në këtë aktgjykim.

Zbatimi i parimeve

Gjykata në këtë rast vetëm ka cituar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, duke mos bërë asnjë ndërlidhje me parimet që duhet të merren parasysh me rastin e caktimit të dënimit, siç përcaktohet në udhëzues.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Sa i përket pranimin të fajësisë, sipas udhëzuesit janë gjithsej katër pyetje relevante të cilave Gjykata duhet tu japë përgjigje në aktgjykim, gjë që në arsyetimin e këtij aktgjykimi nuk përmendet asnjë. Kështu ka vepruar gjykata edhe përballë tetë faktorëve që kërkohen sa i përket rrethanës së pendimit. Në këtë mënyrë, përderisa gjykata nuk i ka sqaruar këto dy rrethana me fakte dhe prova të caktuara, sipas udhëzuesit, bëhet fjalë për dyfishim të rrethanave. Sa i përket faktit se i dënuari për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, sipas udhëzuesit, kjo rrethanë kualifikohet tek rrethanat e tjera lehtësuese. Në udhëzues thuhet se nëse gjykata e konstaton mungesën e dënimeve të mëparshme penale dhe mund të jepet zbutja, do të kërkoj gjetje të fakteve që e mbështesin përfundimin e sjelljes përkatëse dhe predispozitat për rehabilitim. Kjo çështje nuk trajtohet fare në këtë aktgjykim. Sa i përket moshës së të dënuarit, gjykata në këtë rast vetëm ka treguar se i pandehuri është i moshës së shtyrë, çfarë paraqet një nga nëntë pyetjet relevante që gjykata duhet tu japë përgjigje në këtë rast. Pyetjet e tjera relevante nuk janë arsyetuar nga gjykata në këtë aktgjykim. Sa i përket çrregullimit mendor, ndonëse në pjesët e tjera të këtij aktgjykimi gjendet një arsyetim mbi këtë të dhënë, në pjesën për caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata nuk u përgjigjet asnjë prej pyetjeve relevante që përcakton udhëzuesi për këto raste. Ndërsa, kur gjykata si rrethanë rënduese ka konstatuar atë se “vepra penale është kryer në orët e vona të natës, kur e ndjera ka qenë në gjumë”, nëse i referohemi udhëzuesit, nuk është e qartë se cilës rrethanë rënduese i është referuar gjykata në këtë rast.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruar nga aktgjykimi

Janë një sërë rrethanash, si lehtësuese ashtu edhe rënduese, të cilat gjykata nuk i ka marrë për bazë në këtë arsyetim, e madje as nuk ka dhënë arsyetim se pse të njëjtat nuk janë marrë parasysh. Gjykata nuk ka marrë parasysh fare, praninë e dhunës apo kanosjes në kryerjen e veprës penale, nëse vepra penale është kryer në mënyrë posaçërisht mizore, nëse vepra penale përfshin disa viktime, mosha e viktimës, (mos) provokimin nga viktime, bashkëpunimi i përgjithshëm i personit me gjykatën, shkallën e dëmit të shkaktuar, rrethanat personale dhe karakteri i personit të dënuar, keqardhjen e shfaqur, (mos) kompensimi i dëmit të shkaktuar, sjelljen e personit të dënuar pas konfliktit, (mos) shkelja e urdhrave të gjykatës dhe (mos) mbështetja pala e dëmtuar.

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Gjykata në këtë rast nuk ka dhënë asnjë arsyetim mbi rëndësinë e brendshme të rrethanave e as mbi peshimin e rrethanave. Për këtë arsye, llogaritja është kuantitative. Në rastin konkret, kemi pesë rrethana lehtësuese dhe një rrethanë rënduese, që sipas udhëzuesit bëhet fjalë për rastet kur kemi “rrethana lehtësuese të kombinuara në përgjithësi (të cilit do lloj) në sasi shumë më të madhe se sa rrethanat rënduese”, i cili rast kualifikohet tek rrethanat që

arsyetojnë zbutjen maksimale të dënimit brenda kufirit. Sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 7, pika h, dënimi në këtë rast duhet të jetë nga 10 deri në 13 vite burgim, që i bie se dënimi në këtë rast është brenda këtyre kufijve.

8 Rasti PKR.nr.369/17 - Vrasje e rëndë nga neni 179 par 1 nën par 11 KPRK-së.

Aktgjykimi i marrë

Sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, të shpallur më 5 qershor 2018, i dënuari L.I. ishte shpallur fajtor për veprën penale “Vrasje e rëndë”. Kjo pasi që, më 29 gusht 2016, rreth orës 11:40 në P., afër parkut të qytetit, në rrugën “H.J.”, ka privuar nga jeta E.A.2 dhe A.G., ashtu që pasi që paraprakisht për shkak të një mosmarrëveshje rreth një borxhi me të njëjtit, të cilin borxh i akuzuari nuk e ka pranuar për të vetin, të njëjtit një ditë më parë derisa kishte shkuar te shtëpia e tani të ndjerit E.2 ja kishin marrë të dy të ndjerit E.2 dhe A. veturën e cila ishte në pronësi të motrës së tij dhe pas presioneve dhe kërcënimeve të vazhdueshme për kthimin e borxhit, në ditën kritike, pas komunikimit telefonik në mes të akuzuarit L. dhe tani të ndjerit E.2, i njëjti bashkë me tani të ndjerin A.G. me motorin të cilin e drejtonte tani i ndjeri A., janë nisur në drejtim të parkut të qytetit dhe pasi që kanë arritur të parku i qytetit, derisa i akuzuari L. ka qenë duke e kaluar rrugën në drejtim të Parkut të Qytetit, të njëjtit me vrull e kanë ndaluar motorin dhe tani i ndjeri E.A.2 ka zbritur nga motori dhe furishëm është nisur në drejtim të akuzuarit L.I, ndërsa që në atë moment i akuzuari L.I, me dashje që të njëjtit ti privojë nga jeta, ka shtënë në drejtim të tyre me armë zjarri, duke i goditur disa herë nëpër pjesë të ndryshme të trupit, me ç’rast iu ka shkaktuar lëndime të rënda trupore, shkak i të cilave tani i ndjeri E.A.2 ka vdekur në vendin e ngjarjes, ndërsa tani i ndjeri A.G. në QKUK,

Dënimi sipas KPRK-së:

Vrasje e rëndë: dënim me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim ose me burgim të përjetshëm

Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve: me gjobë deri në 7500 euro apo me burgim deri në pesë (5) vite.

Dënimi i shqiptuar:

Për vrasje të rëndë: nëntëmbëdhjetë (19) vjet e gjashtë (6) muaj burgim

Për mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve: një (1) vit burgim

Rrethanat lehtësuese:

1. Moshën e tij të re në kohën e kryerjes së veprës penale;
2. Rrethanat në të cilat është kryer vepra penale pra që ngjarjes kritike i ka paraprirë një mosmarrëveshje lidhur me një borxh të cilin i akuzuari nuk e ka pranuar si të vetin e që për

këtë edhe ka qenë i kërcënuar e po ashtu edhe i është marrë vetura e cila ka qenë në pronësi të motrës së tij;

3. I dënuari që nga fillimi i procedurës penale thujse në tërësi e ka pranuar kryerjen e veprës penale me përjashtim të rrethanave që i kanë paraprirë të njëjtës;

4. Sjelljen e tij para dhe pas kryerjes së veprës penale;

5. I dënuari nuk ka qenë më parë i dënuar;

Rrethanat rënduese

1. Moshën e re së të ndjerëve;

2. Dëmin e shkaktuar me kryerjen e veprës penale familjeve të tani të ndjerëve të cilët janë privuar në mënyrë të përhershme nga prania e më të dashurve të tyre duke shkaktuar dhembje të pa kompensueshme prindërve së të njëjtëve;

Përshtatshmëria e dënimit:

Gjykata ka vlerësuar së dënimi i shqiptuar është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale së të akuzuarit, intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura dhe për këtë veprë penale është bindur se ky dënim është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore dhe shkallën e përgjegjësisë penale së të akuzuarit dhe si e tillë duhet të shërbejë si preventive gjenerale, posaçërisht asaj individuale, tek forcimi i moralit të shoqërisë dhe respektimin e jetës së çdo qytetari.

Zbatimi i udhëzuesit

Përshtatshmëria e dënimit

Gjykata në këtë rast i citon tre prej qëllimeve të dënimit (parandalimin specifik apo të veçantë, parandalimin e përgjithshëm dhe gjykimin shoqëror, ngritja e moralit dhe forcimi i detyrimit për respektimin e ligjit). Të njëjtat, gjykata vetëm i citon dhe nuk i arsyeton sipas kërkesave të udhëzuesit. Sa i përket qëllimit të katërt (viktimat dhe komuniteti) gjykata të njëjtin nuk e aplikon dhe nuk e arsyeton fare në këtë aktgjykim.

Zbatimi i parimeve

Sa i përket parimeve, gjykata e ka zbatuar vetëm një parim (mënyrën e kryerjes së veprës penale) ashtu siç e përcakton udhëzuesi, në atë mënyrë që arsyetimin e të njëjtit e ka bërë me rrethana të veçanta. Parimet e tjera nuk janë përmendur dhe nuk janë arsyetuar, ashtu siç e përcakton udhëzuesi. Disa prej parimeve, duke mos i ndërlidhur me asnjë rrethanë, gjykata i citon tek përshtatshmëria e dënimit.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Sa i përket rrethanave në të cilat është kryer vepra penale, pranimin e fajësisë dhe dëmin e shkaktuar, gjykata ka dhënë arsyetimin e duhur se pse të njëjtat mund të përdoren si rrethana, qoftë lehtësuese apo rënduese. Ndërsa, sa i përket moshës së të dënuarit, gjykata në këtë rast vetëm ka treguar se i pandehuri është i moshës së re, çfarë paraqet një nga nëntë pyetjet relevante që gjykata duhet tu japë përgjigje në këtë rast. Pyetjet e tjera relevante nuk janë arsyetuar nga gjykata në këtë aktgjykim. Për më tepër, në arsyetimin e këtij aktgjykimi nuk përmendet se cila ka qenë mosha e të dënuarit. Në këtë mënyrë gjykata ka vepruar edhe në rastin kur moshën e viktimës e ka aplikuar si rrethanë rënduese. Sa i përket sjelljes së të dënuarve pas konfliktit, gjykata nuk ka dhënë asnjë përgjigje lidhur me tri pyetjet relevante të cekura në udhëzues, derisa nuk dihet se çfarë ka pasur parasysh gjykata kur si rrethanë lehtësuese ka përmendur sjelljen e të akuzuarve para kryerjes së veprës penale. Sa i përket faktit se i dënuari për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, sipas udhëzuesit, kjo rrethanë kualifikohet tek rrethanat e tjera lehtësuese. Në udhëzues thuhet se nëse gjykata e konstaton mungesën e dënimeve të mëparshme penale dhe mund të jepet zbutja, do të kërkojë gjetje të fakteve që e mbështesin përfundimin e sjelljes përkatëse dhe predispozitat për rehabilitim. Kjo çështje nuk trajtohet fare në këtë aktgjykim.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruara nga aktgjykimi

Janë një sërë rrethanash, si lehtësuese ashtu edhe rënduese, të cilat gjykata nuk i ka marrë për bazë në këtë arsyetim, e madje as nuk ka dhënë arsyetim se pse të njëjtat nuk janë marrë parasysh. Gjkata nuk ka marrë parasysh fare shkallën e dashjes, praninë e dhunës apo kanosjes në kryerjen e veprës penale, nëse vepra penale është kryer në mënyrë posaçërisht mizore, nëse viktimi e veprës penale ka qenë posaçërisht e pambrojtur apo e ndjeshme, bashkëpunimi i përgjithshëm i personit me gjykatën, rrethanat personale dhe karakteri i personit të dënuar, pendimin/mungesën e pendimit nga i dënuari, keqardhjen e shfaqur, (mos) kompensimi i dëmit të shkaktuar, shkelja e urdhrave të gjykatës dhe (mos) mbështetja pala e dëmtuar.

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Gjkata në këtë aktgjykim nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me rëndësinë e brendshme të rrethanave si dhe nuk ka dhënë asnjë arsyetim mbi peshimin e rrethanave. Për këtë arsye, llogaritja është kuantitative. Në rastin konkret, kemi pesë rrethana lehtësuese dhe dy rrethana rënduese, që sipas udhëzuesit bëhet fjalë për rastet kur kemi “rrethana lehtësuese të kombinuara në përgjithësi (të cilit do lloj) në sasi shumë më të madhe se sa rrethanat rënduese” e cila kualifikohet tek rastet kur rrethanat arsyetojnë zbutjen maksimale të dënimit brenda kufirit. Sa i përket veprës penale të vrasjes së rëndë, sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 7, pika h, dënimi në këtë rast duhet të jetë nga 10 vjet deri në 13 vjet, që i bie se në rastin konkret dënimi nuk është brenda këtyre limiteve, por është për gjashtë vjet e gjashtë muaj më i ashpër. Sa i përket veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, sipas pjesën 1, pika g të kësaj shtojcë, dënimi duhet të jetë nga një muaj deri në një vit burgim, që i bie se dënimi në këtë rast është brenda këtij kufiri.

9 Rasti PKR.nr.31/2018 - Vrasje e rëndë 179 par1. nën par. 1.1 dhe 1.11 i KPRK

Aktgjykimi i marrë

Sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti për Krime të Rënda, të shpallur më 3 maj 2019, i dënuari E.Sh. ishte shpallur fajtor për veprën penale “Vrasje e rëndë” ndërsa i dënuari tjetër E.Sh., ishte shpallur fajtor për veprën penale “Dhënia e ndihmës pas kryerjes së veprës penale”. Kjo pasi që, më 8 prill 2015, rreth orës 14:10 në Prizren pas një mosmarrëveshje të mëhershme, me qëllim të privimit nga jeta së të ndjerëve F.Sh., H.Th. dhe B.E., del nga shtëpia me qëllim të furnizimit me gjëra ushqimore dhe niset në drejtim të qytetit në shoqërinë e djalit të tij, E.Sh., i cili kishte qenë duke drejtuar veturën “Golf 2” ku paraprakisht pa dijeninë e djalit të tij, vë në bagazhin e makinës pushkën automatike dhe në brez pistoletën, ku me të arritur në vendin e ngjarjes teksa sheh tashmë të ndjerët duke qëndruar në këmbë, del nga vetura, merr nga bagazhi pushkën dhe në distancë 5-6 metra shtie në drejtim të tyre, e që të tre viktimat nga breshëria e plumbave goditën dhe shtrihen në tokë, ku më pas i dënuari u afrohet dhe i gjuan për vdekje sërish me pistoletën që kishte pasur në brez. Më pas kthehet në automjet dhe i thotë djalit të tij të largohen nga vendi i ngjarjes. Në këtë rast, F.Sh. mbetet i vdekur në vend ndërsa viktimat H.Th. dhe B.E. dërgohen në emergjence ku edhe ndërrojnë jetë, si pasojë e plagëve të marra.

Dënimi sipas KPRK-së:

Vrasje e rëndë: dënim me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim ose me burgim të përjetshëm

Dhënia e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprave penale: gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet

Dënimi i shqiptuar:

Për vrasje të rëndë: njëzetetë (23) vjet burgim

Për dhënie të ndihmës kryesve pas kryerjes së veprave penale: katër (4) vjet e gjashtë (6) muaj

Rrethanat lehtësuese:

1. Sjelljen korrekte së të akuzuarve në të gjitha fazat e procedurës;
2. Provokimin e vazhdueshëm nga viktimat;
3. Aftësinë esencialisht të zvogëluar të akuzuarit e parë;
4. Sidomos moshën e re për të dënuarin e dytë;

Rrethanat rënduese

1. Shkallën e përgjegjesisë penale;
2. Intensiteti i rrezikimit të vlerës së mbrojtur;

Përshtatshmëria e dënimit:

Gjykata është e bindur se me këto dënime do të arrihet qëllimi i dënimit.

Zbatimi i udhëzuesit

Përshtatshmëria e dënimit

Nga arsyetimi i dhënë në aktgjykim, mund të konkludohet vetëm ajo se gjykata ka qenë e bindur se me këto dënime arrihet qëllimi i dënimit, duke mos dhënë arsytim për asnjërën prej katër qëllimeve që i përcakton udhëzuesi dhe për të treguar se në çfarë forme do të arrihen këto qëllime. Pra, në raport me përshtatshmërinë e dënimit, ky aktgjykim nuk merr parasysh kërkesat e udhëzuesit.

Zbatimi i parimeve

Gjykata në këtë rast vetëm ka cituar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, duke mos bërë asnjë ndërlidhje me parimet që duhet të merren parasysh me rastin e caktimit të dënimit, siç përcaktohet në udhëzues.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Sa i përket sjelljes korrekte së të akuzuarve, aktgjykimi e arsyeton këtë rrethanë sipas kërkesave të udhëzuesit. Po ashtu, aktgjykimi e merr parasysh edhe aftësinë esencialisht të zvogëluar, duke e ndërlidhur atë rrethanat të cilat për pak nuk arrijnë të jenë bazë për përjashtimin e përgjegjesisë penale, si për shembull, aftësia e zvogëluar mendore. Sa i përket provokimit nga ana e viktimave, gjykata e merr parasysh si rrethanë lehtësuese këtë fakt, por, nëse i referohemi udhëzuesit, janë një sërë çështjesh që hyjnë në kuadër të kësaj rrethane, e të cilat gjykata fare nuk i ka arsyetuar. Ndërsa, është e pakuptimtë se si për të dënuarin e dytë, gjykata merr moshën e re si rrethanë lehtësuese, duke pasur parasysh se i dënuar në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë 23 vjeçar. Sa i përket rrethanave rënduese, gjykata ka përcaktuar dhe ka dhënë arsyetimin e duhur rreth shkallës së përgjegjesisë penale, derisa në mënyrë të paarsyetuar e ka përdorur si rrethanë rënduese intensitetin e veprës penale. Për më tepër, nuk dihet se çfarë ka nënkuptuar gjykata me “*intensitet*”. Nëse kuptohet ajo se në rastin konkret kemi pasur tre viktima, kjo rrethanë nuk mund të përdoret si rrethanë rënduese, pasi ky intensitet përfshihet në vetë formulimin e veprës penale, ku përcaktohet si formë e kualifikuar e veprës penale kryerja e dy apo më shumë vrasjeve. Për këtë arsye, kjo rrethanë është përdorur tërësisht jashtë standardeve të vendosura nga udhëzuesi. Për më tepër, intensiteti i veprës penale përcaktohet si parim i dënimit, të cilin gjykata duhet ta arsyetojë

me rrethana të tjera të veçanta, gjë që gjykata nuk e ka bërë në këtë rast. Për këtë arsye, sipas udhëzuesit, në këtë rast kemi të bëjmë me dyfishim të rrethanave.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruara nga aktgjykimi

Janë një sërë rrethanash, si lehtësuese ashtu edhe rënduese, të cilat gjykata nuk i ka marrë për bazë në këtë arsyetim, e madje as nuk ka dhënë arsyetim se pse të njëjtat nuk janë marrë parasysh. Gjykata nuk ka marrë parasysh fare praninë e dhunës apo kanosjes në kryerjen e veprës penale, nëse vepra penale është kryer në mënyrë posaçërisht mizore, nëse vepra penale përfshin disa viktime, nëse viktime e veprës penale ka qenë posaçërisht e pambrojtur apo e ndjeshme, mosha e viktimës, rrethanat personale dhe karakteri i personit të dënuar, pendimin/mungesën e pendimit nga i dënuari, keqardhjen e shfaqur, (mos) kompensimi i dëmit të shkaktuar, sjelljen e personit të dënuar pas konfliktit, e kaluara kriminale/jo kriminale e të dënuarve, kalimin e kohës dhe (mos) mbështetja pala e dëmtuar.

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Në arsyetimin e aktgjykimit, gjykata nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me rëndësinë e brendshme të rrethanave të përdorura e as lidhur me peshimin e rrethanave. Për këtë arsye, konsiderohet se rrethanat janë trajtuar si të barabarta, dhe llogaritja është kuantitative.

Sa i përket veprës penale të vrasjes së rëndë, gjykata ka marrë parasysh tri rrethana lehtësuese dhe dy rrethana rënduese, që sipas udhëzuesit, bëhet fjalë për “ekzistimin e pak rrethanave rënduese së bashku me shumë rrethana lehtësuese apo zbutëse (rrethanë individuale apo rrethana të kombinuara) në sasi më të madhe se sa rrethanat rënduese”, që kualifikohet faktorët që tregojnë më shumë rrethana lehtësuese se sa rënduese. Sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 7, pika h, dënimi në këtë rast duhet të jetë nga 13 deri në 17 vjet burgim, që i bie se dënimi në këtë rast nuk është marrë brenda këtyre limiteve, por ka qenë për gjashtë vite më i ashpër.

Sipas KPRK-së është e dënueshme me jo më pak se 10 vite apo me burgim të përjetshëm. Sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 7, pika h, pikënisja për matjen e dënimit në këtë rast është 17 vite burgim, derisa në rastet kur ka më shumë rrethana lehtësuese se sa rënduese, dënimi duhet të jetë nga 13 deri në 17 vite burgim, ndërsa në rastin konkret, dënimi ka qenë 23 vjet për të dënuarin për vrasje të rëndë.

Sa i përket veprës penale të dhënies së ndihmës kryerësit pas kryerjes së veprës penale, gjykata në këtë rast ka përdorur katër rrethana lehtësuese dhe dy rrethana rënduese, që sipas udhëzuesit përsëri kualifikohet si në rastin e veprës së parë. Sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 2, pika h, dënimi në këtë rast duhet të jetë nga një vit e gjashtë muaj deri në dy vite e gjashtë muaj, që i bie se dënimi as në këtë rast nuk ka qenë brenda këtyre kufijve, por ka qenë për dy vite më i lartë.

10 Rasti P.nr.06/2018 - Vrasje dhe vrasje e mbetur e tentativë nga neni 178 i KPRK-së

Aktgjykimi i marrë

Sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, të shpallur më 20 nëntor 2018, i dënuari F.L. ishte shpallur fajtor për veprën penale “Vrasje” ndërsa i dënuari tjetër F.G. ishte shpallur fajtor për veprën penale “Vrasje” e mbetur në tentativë. Kjo pasi që më 14 korrik 2017, rreth orës 15:15, i dënuari F.L., kishte privuar nga jeta viktimën I.G. para shtëpisë së tij, ne mënyrë që pas një mosmarrëveshje që kishte pasur me të, në ditën kritike teksa ai kishte zbratur drunjtë para shtëpisë së tij, kishte prekur murin e tani të dënuarit, ku më pas edhe e merr sëpatën dhe me “çykë” të saj e godet viktimën në kokë e ku si pasojë e plagëve të marra viktimë ndërron jetë në spital. Ai po ashtu është dënuar edhe për veprën penale “mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”.

Ndërsa, i dënuari F.G. në po të njëjtën ditë kishte tentuar ta privoj nga jeta të dënuarin F.L. ashtu që pasi ishte njoftuar se prindi i tij I.G. ishte goditur në kokë me sëpatë, merr armën dhe shkon në shtëpinë e të dënuarit F.L. në drejtim të cilin shtie shtatë herë mirëpo nuk arrin ta godet.

Dënimi sipas KPRK-së:

Vrasja: dënim me jo më pak se pesë (5) vjet burgim.

Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve: me gjobë deri në 7500 euro apo me burgim deri në pesë (5) vite.

Dënimi i shqiptuar:

F.L. – Për veprën penale të vrasjes – *dymbëdhjetë (12) vjet burg;*

Për veprën penale mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve: *dy (2) vite burgim*

F.G. – për veprën penale vrasje në tentativë – *dy (2) vjet burg;*

Për veprën penale mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve: *500 euro gjobë*

Rrethanat lehtësuese:

F.L.:

1. Pranimin e fajësisë për veprën penale “mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve;
2. Sjellje sociale dhe të paqortueshme gjatë shqyrtimit gjyqësor;

3. Kërkim falja palëve të dëmtuara;
4. Pendimi i thellë për veprën penale;

F.G.:

1. Pranimin e fajësisë për veprën penale “mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve”;
2. Fakti që nuk kishte qenë i dënuar më parë;
3. Sjellja para dhe pas kryerjes së veprës penale, që ishte sjellje posaçërisht sociale dhe e paqortueshme;
4. Pendimi i thellë për veprën penale;

Rrethanat rënduese:

F.L.

1. I dënuari edhe më parë ka qenë i dënuar dhe palë e dëmtuar ka qenë pikërisht viktimja si dhe pas mbajtjes së dënimit ka pasur sjellje jo korrekte me viktimën;
2. Ka mbajtur armën pa ndonjë arsye të fortë dhe në mënyrë të vazhdueshme, duke shkaktuar rrezik potencial;

I.G.

1. Ka mbajtur armën pa ndonjë arsye të fortë dhe në mënyrë të vazhdueshme, duke shkaktuar rrezik potencial;

Përshtatshmëria e dënimit:

Gjykata ka vlerësuar së dënimi i shqiptuar është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë dhe rrezikshmërinë e veprës penale, është i baraspeshuar dhe me anë të njëjtit dënim do të arrihet edhe qëllimi i dënimit që kryerësit të parandalohen nga përsëritja e këtyre veprimeve në të ardhmen por edhe të parandalohen kryerësit e tjerë prej veprave të tilla penale.

Zbatimi i udhëzuesit

Përshtatshmëria e dënimit

Gjykata në këtë rast i citon dy prej qëllimeve të dënimit (parandalimin specifik apo të veçantë, parandalimin e përgjithshëm). Të njëjtat, gjykata vetëm i citon dhe nuk i arsyeton sipas kërkesave të udhëzuesit. Sa i përket dy qëllimeve të tjera (viktimat dhe komuniteti dhe

gjkimi shoqëror, ngritja e moralit dhe forcimi i detyrimit për respektimin e ligjit) gjykata të njëjtat nuk i aplikon dhe nuk i arsyeton fare në këtë aktgjykim.

Zbatimi i parimeve

Gjykata në këtë rast vetëm ka cituar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, duke mos bërë asnjë ndërlidhje me parimet që duhet të merren parasysh me rastin e caktimit të dënimit, siç përcaktohet në udhëzues.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Tek pranimi i fajësisë, që në raport me veprën penale të mbajtjes në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve gjykata e ka aplikuar si rrethanë lehtësuese për dy të pandehurit, asnjë kërkesë e cila sipas udhëzuesit duhet të aplikohet me rastin e marrjes parasysh të kësaj rrethane, e cila përcakton edhe rëndësinë e kësaj rrethane në rastin konkret, nuk është marrë parasysh, si dhe gjykata nuk ka dhënë përgjigje në katër pyetjet që sipas udhëzuesit, janë relevante në këtë rast. Lidhur me sjelljen korrekte së të pandehurit gjatë procedurës, sipas udhëzuesit, gjykata duhet tu jap përgjigje gjithsej pesë pyetjeve, gjë të cilën gjykata nuk e ka bërë në këtë aktgjykim. Sa i përket pendimit, sipas udhëzuesit, gjykata duhet të marrë parasysh dhe të arsyetojë tetë faktorët e përcaktuar në udhëzues, gjë që gjykata nuk e ka bërë në rastin konkret. Sa i përket faktit se i dënuari për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, sipas udhëzuesit, kjo rrethanë kualifikohet tek rrethanat e tjera lehtësuese. Në udhëzues thuhet se nëse gjykata e konstaton mungesën e dënimeve të mëparshme penale dhe mund të jepet zbutja, do të kërkojë gjetje të fakteve që e mbështesin përfundimin e sjelljes përkatëse dhe predispozitat për rehabilitim. Kjo çështje nuk trajtohet fare në këtë aktgjykim. Sa i përket kërkim faljes së të dënuarit ndaj palëve të dëmtuara, sipas udhëzuesit, kjo nuk paraqet rrethanë të veçantë lehtësuese, por është faktorë me të cilin vërtetohet rrethana lehtësuese “keqardhja e shfaqur nga personi i dënuar”. Pra në këtë rast, sipas udhëzuesit, bëhet fjalë për dyfishim të rrethanave. Sa i përket faktit se të dënuarit kanë mbajtur armë pa ndonjë arsye të fortë, gjykata këtë vetëm e ka treguar si gjendje faktike, duke mos treguar se me zbatimin e cilës rrethanë rënduese kemi të bëjmë në rastin konkret. Sa i përket faktit se njëri nga të dënuari ka qenë edhe më parë i dënuar, gjykata ka marrë parasysh dy nga faktorët që përcaktohen në udhëzues, derisa nuk ka marrë parasysh dhe nuk ka arsyetuar tre faktorët e tjerë.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruara nga aktgjykimi

Janë një sërë rrethanash, si lehtësuese ashtu edhe rënduese, të cilat gjykata nuk i ka marrë për bazë në këtë arsyetim, e madje as nuk ka dhënë arsyetim se pse të njëjtat nuk janë marrë parasysh. Gjykata nuk ka marrë parasysh fare shkallën e pjesëmarrjes së personit në kryerjen e veprës penale, shkallën e dashjes, praninë e dhunës apo kanosjes në kryerjen e veprës penale, nëse vepra penale është kryer në mënyrë posaçërisht mizore, nëse vepra penale përfshin disa viktime, nëse viktime e veprës penale ka qenë posaçërisht e pambrojtur apo e ndjeshme, mosha e viktimës, (mos) provokimin nga viktime, mosha e të pandehurit, bashkëpunimi i përgjithshëm i personit me gjykatën, shkallën e dëmit të shkaktuar, rrethanat

personale dhe karakteri i personit të dënuar, keqardhjen e shfaqur, (mos) kompensimi i dëmit të shkaktuar dhe (mos) mbështetja pala e dëmtuar.

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Gjykata nuk ka dhënë asnjë arsyetim mbi rëndësinë e brendshme të rrethanave të aplikuara, si dhe nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me peshimin e rrethanave. Për këtë arsye, llogaritja është kuantitative. Në raport me të dënuarin e parë, për veprën penale të vrasjes, gjykata ka aplikuar tri rrethana lehtësuese dhe një rrethanë rënduese, ndërsa në raport me të dënuarin e dytë, për veprën penale të vrasjes në tentativë, gjykata ka aplikuar tri rrethana lehtësuese dhe asnjë rrethanë rënduese. Në këto dy raste, sipas udhëzuesit, bëhet fjalë për “ekzistimin e së paku dy rrethanave për zvogëlim të fajësisë apo dëmit dhe asnjë/ose një rrethanë të vogël rënduese“, që kualifikohet tek rastet kur rrethanat arsyetojnë zbutjen maksimale të dënimit brenda kufirit. Në bazë të shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 6, pika e, dënimi në këtë rast duhet të jetë prej 5 deri në 9 vite burgim, që i bie se dënimi në këtë rast nuk është brenda këtyre kufijve, përkatësisht për të dënuarin e parë është më i ashpër, ndërsa për të dënuarin e dytë është më i butë. Sa i përket veprës penale të mbajtjes në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, në raport me të pandehurin e parë, gjykata ka aplikuar katër rrethana lehtësuese dhe dy rrethana rënduese, ndërsa në raport me të pandehurin e dytë ka aplikuar katër rrethana lehtësuese dhe një rrethanë rënduese. Në rastin e parë, sipas udhëzuesit, kemi të bëjmë me rastet kur kemi “ekzistimin e së paku dy rrethanave për zvogëlim të fajësisë apo dëmit dhe asnjë/ose një rrethanë të vogël rënduese“, ndërsa në rastin e dytë kemi të bëjmë me rastet kur “rrethana lehtësuese të kombinuara në përgjithësi (të cilitdo lloj) në sasi shumë më të madhe se sa rrethanat rënduese”. Të dy këto raste kualifikohen tek rrethanat që arsyetojnë zbutjen maksimale të dënimit brenda kufirit. Sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 1, pika g, dënimi për të akuzuarin e parë duhet të jetë prej një muaj deri në një vit, që nënkupton se dënimi i shqiptuar nuk është brenda këtyre limiteve. Sa i përket të dënuarit të dytë, dënimi duhet të jetë prej 100 deri në 2000 euro, që i bie se dënimi në këtë rast është brenda këtyre limiteve.

VIII. Politika ndëshkimore në rastet e terrorizmit

a. Hyrje

IKD në këtë kapitull ka analizuar gjithsej katër aktgjykime të veprave penale të terrorizmit. Në bazë të metodologjisë së përmendur në fillim të këtij raporti, IKD ka analizuar edhe këto katër aktgjykime që kanë të bëjnë me veprat penale të terrorizmit, nëse në të njëjtat, gjyqtarët kanë zbatuar kërkesat dhe standardet e vendosura nga udhëzuesi, me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit. Këto katër aktgjykime përfshijnë gjithsej 15 persona, derisa ndaj tyre janë shqiptuar 25 dënime.

Të gjeturat e IKD-së të prezantuara më poshtë, tregojnë se as në rastet e terrorizmit, udhëzuesi nuk ka gjetur zbatimin e kënaqshëm në praktikë.. Ajo çfarë e dallon këtë kategori nga kategoritë e tjera, është se numri i rrethanave rënduese të aplikuara në këto raste është jashtëzakonisht disproporcional me numrin e rrethanave lehtësuese, derisa nuk është identifikuar asnjë rast i vetëm kur këto rrethana janë aplikuar sipas kërkesave të udhëzuesit, çka në kuptim të udhëzuesit, paraqet aplikim arbitrar të rrethanave lehtësuese dhe rënduese. Pra, edhe sa i përket këtij kapitulli, nëse si pikë reference për një politikë të ligjshme ndëshkimore merret udhëzuesi, atëherë nënkuptojmë se politika ndëshkimore në sistemin gjyqësorë të Republikës së Kosovës, në rastet e terrorizmit është hiq më pak se arbitrare.

Sa i përket arsytimit të aktgjykimeve mbi caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, gjithnjë duke marrë parasysh standardet e vendosura nga udhëzuesi, palët dhe publiku në asnjë rrethanë nuk mund të krijojnë bindjen se pse në rastin konkret është caktuar një dënim i tillë.

Në këtë mënyrë, ajo që ishte prezantuar si progres dhe hap konkret në drejtim të përmirësimit të politikës ndëshkimore brenda sistemit të drejtësisë në Republikën e Kosovës, e që është miratimi i udhëzuesit, nga të gjeturat e këtij raporti shihet edhe në veprat penale të terrorizmit, ky udhëzues ka mbetur politikë në letër, i pazbatuar në praktikë.

b. Gjetjet e përgjithshme


Në katër aktgjykimet e analizuara në këtë kapitull, janë përfshirë tetë lloje të veprave penale për të cilat janë dënuar të pandehurit. Llojet e veprave penale janë si më poshtë:

Vepra penale	Numri i dënimeve
Shtytje për kryerjen e veprave terroriste	1
Moslajmërim të veprave penale ose kryerësve	1
Organizimi dhe pjesëmarrja në grupe terroriste	8
Mbajtja në pronësi, kontroll apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve	4
Kryerja e veprave terroriste	3
Fshehja ose moslajmërimi i terroristëve dhe grupeve terroriste	2
Përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës:	2
Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse	4

Tabela 24 – Numri i dënimeve sipas veprave penale.


Në këto katër aktgjykime janë të përfshirë 15 persona, ndaj të cilëve janë shqiptuar gjithsej 25 dënime.

Nga 25 dënimet e shqiptuara, 21 prej tyre janë dënime me burgim efektiv, derisa me gjobë janë shqiptuar tre dënime ndërsa vetëm një ka qenë dënim me burgim me kusht.



Grafika 29 – Llojet e dënimeve të shqiptuara.

Sa i përket lartësisë së dënimeve, kemi një laramani të dënimeve të shqiptuara, ndërsa dënimi më i shpeshtë i shqiptuar në këto raste është dënimi me tre vjet burgim, i cili është shqiptuar katër herë.



Grafika 30 – Lartësia e dënimeve me burgim.

Sa i përket dënimeve me gjobë, në dy raste dënimi me gjobë ka qenë në lartësi prej 1.800 euro, ndërsa në një rast ka qenë 2.500 euro.

Sa i përket aplikimit të rrethanave në këto raste, gjykatat kanë aplikuar gjithsej 30 rrethana, ku shumica dërrmuese e tyre, përkatësisht 87%, janë rrethana lehtësuese.



Grafika 31 – Numri total i rrethanave të përdorura në aktgjykimet e analizuar.

Sa i përket numrit të rrethanave lehtësuese të aplikuar në këto raste, gjykatat në dy raste kanë aplikuar nga katër rrethana lehtësuese, në një rast shtatë rrethana lehtësuese ndërsa në rastin tjetër, gjykata ka aplikuar gjithsej 11 rrethana lehtësuese.

Numri i rrethanave lehtësuese të aplikuar	Numri i rasteve
4 rrethana të aplikuar	2 raste
7 rrethana të aplikuar	1 rast
11 rrethana të aplikuar	1 rast

Tabela 25 – Numri i rrethanave lehtësuese të aplikuar.

Ndërsa, sa i përket rrethanave rënduese, gjykata në një rast nuk ka përdorur asnjë rrethanë rënduese, në dy raste ka aplikuar nga një rrethanë rënduese derisa në një rast ka aplikuar dy rrethana rënduese.

Numri i rrethanave rënduese të aplikuar	Numri i rasteve
Asnjë rrethanë rënduese	1 rast
1 rrethanë të aplikuar	2 raste
2 rrethana të aplikuar	1 rast

Tabela 26 – Numri i rrethanave rënduese të aplikuar.

Sa i përket llojit të rrethanave të aplikuara më së shpeshti në këto aktgjykime janë, pendimi, gjendja ekonomike, mosha e të dënuarve dhe pranimi i fajësisë.

Lloji i rrethanës	Numri i rasteve në të cilat është aplikuar
Pendimi	3
Gjendjen tejet të vështirë ekonomike	3
Moshën e re të tyre	3
Pranimi i fajësisë	3
Sjellja korrekte e tyre gjatë gjykimit	2
Premtimi se ne të ardhmen nuk do të ndërmer veprime të tilla	2
Nuk është i dënuar më parë	2
Niveli i ulët i arsimimit	1
Janë përsëritës të veprave penale të natyrës së njëjte	1
Pesha e rëndë e veprës penale.	1
Faktin se i dënuari edhe më parë ka qenë i akuzuar për një vepër tjetër penale	1
Në mënyrë të rregullt i janë përgjigjur ftesave të gjykatës	1
Janë kthyer vullnetarisht dhe asnjëherë nuk kanë ndërmarrë ndonjë veprim apo tentim për shkuarje të serishme në Siri dhe të marrin pjesë në çfarëdo grupi terrorist, gjë që gjykata konsideron se të njëjtit janë penduar.	1
Angazhimi i të dënuarit në punë	1
Për të dënuarin A.K pati parasysht faktin se është familjar	1
Sjelljen e mirë pas kryerjes së veprës penale	1

Është njeri familjar	1
Që nga koha e kryerjes së verës penale nuk ka rënë ndesh me ligjin	1
Gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor nuk kanë treguar asnjë shenjë të keqardhjes apo të pendimit për veprimet të cilat i kanë kryer	1

Tabela 27 – Lloji i rrethanave të aplikuara.


Por në kuptim të udhëzuesit, mënyra se si janë aplikuar dhe arsyetuar këto rrethana, flet për mos zbatim të plotë të udhëzuesit në praktikë, pasi nga analiza që IKD u ka bërë këtyre aktgjykimeve rezulton se asnjë rrethanë nuk është aplikuar dhe zbatuar sipas kërkesave të udhëzuesit.



Grafika 32 – Aplikimi i rrethanave sipas kërkesave të udhëzuesit.

Sa i përket rrethanave të injoruar, në të gjitha këto aktgjykime, gjykatat kanë injoruar nga pesë rrethana.


Sa i përket dyfishimit të rrethanave, IKD ka gjetur se kjo dukuri është e shfaqur në 3 nga 4 rastet e analizura. Për më tepër, në njërin prej këtyre rasteve, nga analiza e IKD-së ka rezultuar se janë paraqitur plot 3 dyfishime të rrethanave.



Grafika 33 – Dyfishim i rrethanave.


Sa i përket përshtatshmërisë së dënimit, të gjitha aktgjykimet e analizuara në këtë kapitull përmbajnë pjesën që flet për përshtatshmërinë e dënimit.

Sa i përket aplikimit të qëllimeve të dënimit, asnjë prej aktgjyqimeve të analizuara në këtë kapitull nuk aplikon të gjitha qëllimet e dënimit, derisa një aktgjykim nuk aplikon asnjë prej qëllimeve të dënimit.




Grafika 34 –Numri i qëllimeve të dënimit të aplikuara në aktgjyqime.

Sa i përket llojeve të qëllimeve të aplikuara në këto aktgjykime, qëllimi i dënimit viktimat dhe komuniteti nuk është aplikuar në asnjërin prej aktgjykimeve të analizuara në këtë kapitull.



Grafika 35 – Llojet e qëllimeve të dënimit të aplikuara në aktgjykime.

Por, sa i përket zbatimit të udhëzuesit edhe kjo pjesë flet për mos zbatim absolut të udhëzuesit në praktikë, në atë mënyrë që asnjë prej qëllimeve të dënimit nuk është arsyetuar sipas kërkesave të udhëzuesit, por të njëjtat qëllime vetëm janë cituar dhe arritja e të njëjtave është marrë si e mirëqenë.




Grafika 36 - Aplikimi dhe arsyetimi i qëllimeve të dënimit sipas kërkesave të udhëzuesit.

Situatë identike është edhe sa i përket zbatimit të parimeve të dënimit, në atë mënyrë që sipas kërkesave të udhëzuesit, në asnjë prej këtyre aktgjykimeve nuk janë zbatuar parimet e dënimit.



Grafika 37 – Zbatimi i parimeve.

Ndërsa, sa i përket kufijve të dënimit të përcaktuar në shtojcën 1 të udhëzuesit, 50 % e këtyre aktgjykimeve janë brenda limiteve të përcaktuara nga udhëzuesi, derisa gjysma tjetër është jashtë këtyre limiteve.



Grafika 38 - Kufinjtë e dënimeve.

c. Analiza e veçantë e rasteve të terrorizmit

1. Rasti P.nr.12/18 - Shtytja për kryerjen e veprave terroriste nga neni 141 të KPRK-së, veprën penale nga neni 3 par.4 të LNBKA, Moslajmërimi i veprave penale apo kryerësve nga neni 368 par.1 pika 1,4 të KPRK-së

1.1 Aktgjykimi i marrë

Sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, të dënuarit R.A dhe K.P janë shpallur fajtorë për veprën penale “Shtytja për kryerjen e veprave terroriste” dhe atë “Moslajmërimi i veprave penale apo kryerësve”. Kjo pasi që sipas aktgjykimit, i dënuari R.A nga vera e vitit 2017, në vazhdimësi, ka postuar mesazhe për publikun, me qëllim që të shtyjë kryerjen e aktit terrorist, ashtu që në profilin e tij në “facebook” me emrin R.A., ka postuar video incizime, fotografi duke shprehur haptazi përkrahjen dhe simpatinë ndaj organizatës terroriste, Shtetit Islamik-ISIS. Ai përmes këtyre postimeve shpreh urrejtje ndaj pjesëtarëve tjerë të komunitetit dhe propagandon islamizmin, ashtu që fotografitë e publikuara që paraqesin “Xhihadistë” dhe “sulumues vetëvrasës”, ku ka komentuar “për njo qësi lazem, po s’po ka ksajde”, dhe komente tjera, me qëllim që të shtyjë kryerjen e aktit terrorist, duke shkaktuar rrezik serioz që veprat e tilla edhe të kryhen.

Ndërsa, i dënuari K.P ishte shpallur fajtor pasi në periudhë të pacaktuar të vitit 2017, nuk e ka lajmëruar veprën penale dhe kryesin e saj, në atë mënyrë që pasi i njëjti ka pasur kontakte me persona që kanë marrë pjesë në Siri dhe të cilët janë marrë me aktivitete terroriste, ashtu që kur i dënuari R.A, për të cilin ka qenë në dijeni se merret me aktivitete të tilla, ka kërkuar nga ai që të kryej një sulm vetëvrasës në territorin e Republikës së Kosovës, duke i thënë “se i duheshin të holla për financim dhe disa vëllezër mysliman, për të organizuar një sulm istishadije (vetëvrasës) kundër shtetit, kundër qeverisë, edhe pse nuk ka pranuar, i pandehuri Kreshnik nuk e ka lajmëruar rastin në polici.

Dënimi sipas KPRK-së:

Shtytje për kryerjen e veprave terroriste: *një (1) vit deri në pesë (5) vite burgim.*

Moslajmërim të veprave penale ose kryerësve: *gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet*

Dënimi i shqiptuar

Shtytje për kryerjen e veprave terroriste: *një (1) vit e gjashtë muaj burgim.*

Dënimi i shqiptuar për Moslajmërim të veprave penale ose kryerësve: *gjashtë (6) muaj burgim.*

Rrethanat lehtësuese:

1. Sjellja korrekte e tyre gjatë gjykimit;

2. Pendimi;

3. Premtimi se në të ardhmen nuk do të ndërmerr veprime të tilla;
4. Gjendjen tejet të vështirë ekonomike;
5. Moshën e re të tyre;
6. Niveli i ulët i arsimit për të dënuarin R.A;
7. Pranimit i fajësisë në fazë fillestare nga i dënuari K.P dhe nga i dënuari R.A në shqyrtim gjyqësor që sipas vlerësimit të gjykatës paraqet pendim të sigurtë dhe fillim të rehabilitimit të tyre;

Rrethanat rënduese

1. Janë përsëritës të veprave penale të natyrës së njëjtë;

Përshtatshmëria e dënimit:

Gjykata ka vlerësuar se ky dënim i shqiptuar është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale dhe intensitetin e vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata është e bindur se ky dënim do të shërbejë për arritjen e qëllimit të dënimit për pengimin e tyre në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe do të ndikoj si preventive gjenerale për personat e tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale.

Zbatimi i udhëzuesit

Përshtatshmëria e dënimit

Gjykata në këtë aktgjykim ka cituar dy prej qëllimeve të dënimit dhe e ka marrë si të mirëqenë faktin se me shqiptimin e këtij dënimi, të njëjtat qëllime do të arrihen, mirëpo që asnjërin prej këtyre dy qëllimeve gjykata nuk i ka arsytuar. Sa i përket qëllimit të katërt (gjykimi shoqëror, ngritja e moralit dhe forcimi i detyrimit për respektimin e ligjit dhe viktimat dhe komuniteti) gjykata nuk e ka aplikuar dhe arsytuar fare këtë qëllim të dënimit të paraparë me udhëzues.

Zbatimi i parimeve

Gjykata në këtë rast vetëm ka cituar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, duke mos bërë asnjë ndërlidhje me parimet që duhet të merren parasysh me rastin e caktimit të dënimit, siç përcaktohet në udhëzues.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Lidhur me sjelljen korrekte së të pandehurit gjatë procedurës, sipas udhëzuesit, gjykata duhet tu jap përgjigje gjithsej pesë pyetjeve, gjë të cilën gjykata nuk e ka bërë në këtë aktgjykim. Sa i përket pranimit të fajësisë, sipas udhëzuesit janë gjithsej katër pyetje relevante të cilave

gjkata duhet tu japë përgjigje, ndërsa në rastin konkret, gjykata ka treguar vetëm kohën se kur të pandehurit e kanë pranuar fajësinë, duke mos arsyetuar fare se çfarë nënkupton ky fakt. Gjykata nuk ka marrë parasysh dhe nuk ka arsyetuar sipas kërkesave të udhëzuesit as rrethanën lehtësuese të pendimit, në atë mënyrë që të marrë parasysh dhe të arsyetojë tetë faktorët e përcaktuar sipas udhëzuesit. Në këtë drejtim, tek pranimi i fajësisë, gjykata thotë se ky pranim i fajësisë nënkupton pendimin e të akuzuarve. Në këtë mënyrë, gjykata do të shmangej dyfishimit të rrethanave. Por, pendimin gjykata e ka aplikuar përsëri si rrethanë lehtësuese, çfarë sipas udhëzuesit, përderisa nuk kemi arsyetim për secilën prej tyre sipas kërkesave të udhëzuesit, kemi të bëjmë me dyfishim të rrethanave. Tutje, premtimi se në të ardhmen nuk do të kryejë veprë tjetër penale, në udhëzues nuk përmendet fare si rrethanë lehtësuese. Sa i përket faktit se të dënuarit janë të gjendjes së vështirë ekonomike, gjykata nuk e ka dhënë asnjë arsyetim për këtë rrethanë si dhe nuk ka treguar se pse në rastin konkret, ky fakt përbënë rrethanë lehtësuese. Kështu ka vepruar gjykata edhe sa i përket nivelit të arsimimit së të pandehurve. Por, gjendja ekonomike dhe niveli i arsimimit nuk janë dy rrethana të ndara lehtësuese, por përbëjnë një rrethanë të vetme, e që është “rrethanat personale dhe karakteri i personit të dënuar”. Në këtë mënyrë, sipas udhëzuesit, këtu kemi të bëjmë me dyfishim të rrethanave. Sa i përket moshës së të dënuarve, sipas udhëzuesit janë gjithsej nëntë pyetje relevante që gjykata duhet ti marrë parasysh dhe tu jap përgjigje në aktgjykim, gjë që gjykata nuk e ka bërë në këtë rast. Për më tepër, është e pakuptueshme se si moshë mund të merret si rrethanë lehtësuese në këtë rast, përderisa njëri nga të akuzuari në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë 26 vjeçar, ndërsa tjetri 23 vjeçar. Sa i përket faktit se të akuzuarit janë përsëritës të veprave penale, gjykata ka marrë parasysh dhe arsyetuar vetëm një prej pesë faktorëve që përcaktohen me udhëzues, në atë mënyrë që ka treguar se dënimet e mëparshme kanë qenë për natyrën e njëjtë të veprave penale, derisa ka anashkaluar katër faktorët e tjerë.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruar nga aktgjykimi

Gjykata nuk ka marrë parasysh fare shkallën e dashjes, nëse vepra penale përfshin disa të dëmtuar, shkallën e dëmit të shkaktuar, (mos) keqardhjen e shfaqur dhe sjelljen e personit të dënuar pas konfliktit.

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Gjykata në këtë rast nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me rëndësinë e brendshme të rrethanave dhe po ashtu, nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me peshimin e rrethanave. Për këtë arsye, llogaritja është kuantitative. Në rastin konkret, sa i përket të dënuarit të parë, gjykata ka marrë parasysh shtatë rrethana lehtësuese dhe një rrethanë rënduese, ndërsa sa i përket të dënuarit të dytë, gjykata ka marrë parasysh gjashtë rrethana lehtësuese dhe një rrethanë rënduese. Sipas udhëzuesit, në të dy rastet bëhet fjalë për “rrethana lehtësuese të kombinuara në përgjithësi (të cilat do lloj) në sasi shumë më të madhe se sa rrethanat rënduese”, që kualifikohet tek rrethanat që arsyetojnë zbutjen maksimale të dënimit brenda kufirit. Sa i përket veprës penale për shtytje në kryerjen e veprave terroriste, sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 3, pika d, dënimi në këtë rast duhet të jetë nga një vit deri në dy vite burgim, që i bie se në rastin konkret, dënimi është brenda kufijve. Ndërsa, sa i përket veprës

penale “moslajmërim i veprave penale ose kryerësve”, sipas pjesës 1, pika f të kësaj shtojcë, dënimi duhet të jetë nga një muaj deri në tetë muaj burgim, që i bie se dënimi edhe për këtë veprë penale është brenda këtyre limiteve.

2. Rasti PKR.nr.264/15 - Organizimi dhe pjesëmarrja në grupe terroriste nga neni 143 par.2 të KPRK-së, Mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së

Aktgjykimi i marrë

Sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë– Departamenti për Krime të Rënda, të dënuarit B.SH, A.B, E.L, J.B, A.K dhe B.H janë shpallur fajtorë pasi që gjykata kishte gjetur se të njëjtit janë kryes të veprës penale “Organizimi dhe pjesëmarrja në grupe terroriste” dhe të dënuarit K.B dhe B.H janë shpallur fajtorë edhe për veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve”. Kjo pasi që sipas aktgjykimit, të dënuarit B.SH, A.B, E.L, J.B, A.K, B.H akuzohen se në periudha të ndryshme kohore, përmes Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës, kanë udhëtuar për në Turqi, e më pas për në Siri, ashtu që kanë kryer stërvitjet ushtarake dhe fizike si pjesë e organizatës terroriste “ISIS”. Ata akuzohen se kanë luftuar në Siri për një kohë, e më vonë janë kthyer në Kosovë. I dënuari B.H ishte shpallur fajtor edhe për veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve”, pasi që më parë është furnizuar pa autorizim deri më 11 gusht 2014, ka mbajtur municion dhe atë: dy pushkë automatike AK-47, një pushkë gjysmë-automatike, katër karikator, municion të llojeve të ndryshëm, një uniformë ushtarake dhe një maskë gazi, të cilat janë gjetur dhe konfiskuar me rastin e bastisjes nga policia në shtëpinë e të dënuarit B.H.

Ndërsa, i dënuari K.B ishte shpallur fajtor vetëm për veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve”, pasi më parë ishte furnizuar pa autorizim deri më 11 gusht 2014, ashtu që ka poseduar revole të tipit “TT”, të cilën armë e kishte gjetur dhe konfiskuar policia në banesën e tij.

Dënimi sipas KPRK-së:

Organizimi dhe pjesëmarrja në grupe terroriste: *Burgim prej pesë (5) deri në dhjetë (10) vjet*

Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve : *dënohet me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7.500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet.*

Dënimi i shqiptuar për veprën penale Organizimi dhe pjesëmarrja në grupe terroriste:

B.Sh është dënuar me burgim në kohëzgjatje prej tre (3) vjet;

A.B është dënuar me burgim në kohëzgjatje prej dy vjet (2) e katër (4) muaj;

E.L është dënuar me burgim në kohëzgjatje prej tri (3) vjet;

J.B është dënuar me burgim në kohëzgjatje prej dy (2) vjet e katër (4) muaj;

A.K është dënuar me burgim në kohëzgjatje prej katër (4) vjet;

B.H është dënuar me burgim në kohëzgjatje prej dy (2) vjet e tetë (8) muaj;

Dënimi i shqiptuar për veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”:

K.B është dënuar me burgim me kusht në kohëzgjatje prej tetë (8) muajve;

B.H është dënuar me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve;

Rrethanat lehtësuese:

1. Moshë e re e të dënuarve;

2. Në mënyrë të rregullt i janë përgjigjur ftesave të gjykatës;

3. Janë kthyer vullnetarisht dhe asnjëherë nuk kanë ndërmarrë ndonjë veprim apo tentim për shkuarje të serishme në Siri dhe të marrin pjesë në çfarëdo grupi terrorist, gjë që gjykata konsideron se të njëjtit janë penduar;

4. Pranimi i fajësisë për të dënuarit A.B, J.B për veprën penale nga neni 143 par.2 të KPRK si dhe K.B e B.H për veprën penale nga neni 374 par. 2 të KPRK-së;

5. Për të dënuarit A.B, J.B, K.B dhe B.H, faktin se për të njëjtit nuk ka evidencë se më parë kanë qenë të dënuar me aktgjykim të formës së prerë për vepër të tillë apo të ngjashme;

6. Për të dënuarit A.B, J.B, K.B dhe B.H, sjelljen e tyre të mirë pas kryerjes së kësaj vepre penale;

7. Për të dënuarit A.B, J.B, K.B dhe B.H, gjendjen e dobët ekonomike në familjet e tyre;

8. Për të dënuarit A.B, J.B, K.B dhe B.H, pendesën e shfaqur për veprimin e ndërmarrë;

9. Për të dënuarit A.B, J.B, K.B dhe B.H, paraqitjen e tyre në gjykatë në mënyrë të rregullt sipas ftesës së gjykatës, pa tendencë për çfarëdo stërzgjatje të procedurës;

10. Moshën e re për të dënuarit B.SH, E.L dhe B.H;

11. Për të dënuarit A.B, J.B, K.B dhe B.H, pendesën e shfaqur me vet faktin se të njëjtit vullnetarisht janë kthyer nga Siria në Kosovë;

12. Për të dënuarit B.Sh, E.L dhe B.H, angazhimin e tyre në punë;

13. Për të dënuarit B.Sh, E.L, B.H, paraqitjen me rregull në ftesa të gjykatës përkundër faktit se kanë qenë në liri;

14. Për të dënuarin A.K pati parasysh faktin se është familjar;

15. Moshë e re, për të dënuarin A.K;

Rrethanat rënduese

Asnjë

Përshtatshmëria e dënimit:

Gjykata të dënuarve u shqiptoi secilit dënime të precizuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ashtu që aplikoi dispozitivin për zbutje nga neni 75 dhe neni 76 par.1 pika 1,2 të KPRK-së. Gjykata ka bërë individualizimin e dënimeve duke vlerësuar se të gjitha dënimet janë adekuate dhe të drejta për secilin nga të dënuarit, me bindje se dënimet e tilla i përgjigjen peshës së veprës penale, sjelljeve dhe shkallës së përgjegjësisë penale për secilin prej tyre, se do të ndikojnë në risocializimin e të njëjtëve, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, gjithashtu do të ndikojnë tek të tjerët në mos kryerjen e veprave të tilla penale dhe se me dënime të tilla do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK-së dhe në fund me bindje se të akuzuarit në të ardhmen nuk do të përsërisin veprë tjetër penale të natyrës së tillë apo të ngjashme.

Zbatimi i udhëzuesit

Përshtatshmëria e dënimit

Gjykata në këtë aktgjykim ka cituar tre prej qëllimeve të dënimit dhe e ka marrë si të mirëqenë faktin se me shqiptimin e këtij dënimi, të njëjtat qëllime do të arrihen, mirëpo që asnjërin prej këtyre tre qëllimeve gjykata nuk i ka arsyetuar. Sa i përket qëllimit të katërt (viktimat dhe komuniteti) gjykata nuk e ka aplikuar dhe arsyetuar fare këtë qëllim të dënimit të paraparë me udhëzues.

Zbatimi i parimeve

Gjykata në këtë rast vetëm ka cituar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, duke mos bërë asnjë ndërlidhje me parimet që duhet të merren parasysh me rastin e caktimit të dënimit, siç përcaktohet në udhëzues.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Sa i përket moshës së të dënuarve, sipas udhëzuesit janë gjithsej nëntë pyetje relevante që gjykata duhet t'i marrë parasysh dhe tu jap përgjigje në aktgjykim, gjë që gjykata nuk e ka bërë në këtë rast. Për më tepër, sa i përket të dënuarve A.K, B.Sh, E.L, B.H, gjykata ka bërë dyfishim të rrethanave në këtë rast, në atë mënyrë që moshën e re e ka përdorur në dy raste. Po ashtu, përballë kërkesave të udhëzuesit, gjykata nuk ka dhënë asnjë arsyetim sipas standardeve të udhëzuesit kur ka aplikuar rrethanat lehtësuese se disa prej të dënuarve janë familjar, të angazhuar në punë dhe për disa të dënuar të tjerë, gjendjen e dobët ekonomike. Gjykata si rrethanë lehtësuese ka marrë edhe faktin se të dënuarit i janë përgjigjur me rregull ftesave të gjykatës. Sa i përket kësaj rrethane, ndaj disa të dënuarve gjykata e ka përdorur

njëherë këtë rrethanë lehtësuese, ndërsa të njëjtën rrethanë lehtësuese, ndaj dy të dënuarve e ka aplikuar tre herë. Sipas udhëzuesit, këtu paraqiten edhe dy dyfishime të rrethanave. Ndryshe, lidhur me sjelljen korrekte së të pandehurit gjatë procedurës, sipas udhëzuesit, gjykata duhet tu jap përgjigje gjithsej pesë pyetjeve, gjë të cilën gjykata nuk e ka bërë në këtë aktgjykim në asnjërin rast kur është aplikuar kjo rrethanë lehtësuese. Tek pranimi i fajësisë, asnjë kërkesë e cila sipas udhëzuesit duhet të aplikohet me rastin e marrjes parasysh të kësaj rrethane, e cila përcakton edhe rëndësinë e kësaj rrethane në rastin konkret, nuk është marrë parasysh, si dhe gjykata nuk ka dhënë përgjigje në katër pyetjet që sipas udhëzuesit, janë relevante në këtë rast. Sa i përket faktit se i dënuari për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, sipas udhëzuesit, kjo rrethanë kualifikohet tek rrethanat e tjera lehtësuese. Në udhëzues thuhet se nëse gjykata e konstaton mungesën e dënimeve të mëparshme penale dhe mund të jepet zbutja, do të kërkoj gjetje të fakteve që e mbështesin përfundimin e sjelljes përkatëse dhe predispozitat për rehabilitim. Kjo çështje nuk trajtohet fare në këtë aktgjykim. Sa i përket sjelljes së të akuzuarve pas kryerjes së veprave penale, gjykata ka dhënë një arsyetim optimal, duke treguar ndërlidhur këto rrethana me faktin se të njëjtit janë kthyer vullnetarisht nga zona e luftës dhe të njëjtit më nuk kanë tentuar që të kthehen në atë zonë.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruar nga aktgjykimi

Gjykata nuk ka marrë parasysh fare shkallën e pjesëmarrjes së personit në kryerjen e veprës penale, shkallën e dashjes, shkallën e dëmit të shkaktuar, (mos) keqardhjen e shfaqur dhe kalimin e kohës.

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Gjykata në këtë rast nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me rëndësinë e brendshme të rrethanave dhe po ashtu, nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me peshimin e rrethanave. Për këtë arsye, llogaritja është kuantitative. Në rastin konkret, gjykata ka marrë parasysh një mori rrethanash lehtësuese të cilat dallojnë prej një të dënuari tek i dënuari tjetër, derisa nuk ka marrë parasysh asnjë rrethanë rënduese. Sipas udhëzuesit në këtë rast bëhet fjalë për rastet kur kemi “ekzistimin e së paku dy rrethanave për zvogëlim të fajësisë apo dëmit dhe asnjë/ose një rrethanë të vogël rënduese”, që kualifikohet tek rrethanat që arsyetojnë zbutjen maksimale të dënimit brenda kufirit. Sa i përket veprës penale të organizimit dhe pjesëmarrjes në grupe terroriste, sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 6, pika a, dënimi në këtë rast duhet të jetë nga pesë vite deri në gjashtë vite burgim, që i bie se në rastin konkret, dënimi është brenda kufijve. Sa i përket nenit 75, gjykata nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me zbatueshmërinë e të njëjtit në këtë rast. Kjo i bie se aktgjykimi ndaj gjashtë të dënuarve për këtë veprë penale është jashtë këtyre limiteve, përkatësisht më i ulët. Tutje, sa i përket veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 1, pika g, dënimi duhet të jetë nga një muaj deri në një vit burgim, që i bie se në rastin konkret, dënimi është brenda këtyre limiteve.

3. Rasti PKR.nr.161/18 - Organizimi dhe pjesëmarrja në grupe terroriste nga neni 143 par.2 të KPRK-së,

Aktgjykimi i marrë

Sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, i dënuari N.A është shpallur fajtor për veprën penale “Organizimi dhe pjesëmarrja në grupe terroriste”. Kjo pasi, sipas aktgjykimit, i dënuari N.A, më 17 janar 2014, ka udhëtuar nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës për në Stamboll, e pastaj nga Stambolli ka udhëtuar për në qytetin Gazientep të Turqisë, afër kufirit me Sirinë, e nga aty ka arritur të kalojë në territorin e Sirisë me dashje që t’i bashkohet dhe të bëhet pjesë e organizatës “Al Nusra”. I dënuari N.A, pasi që ka qëndruar një javë në Siri është kthyer në Kosovë dhe më 4 mars 2016, ka provuar që përsëri të shkojë në Siri, duke shfrytëzuar rrugën Shkup-Stamboll, mirëpo i njëjti pasi mbërrin në Aeroportin e Stambollit, ndalohej nga autoritetet turke të cilat pastaj e dëbojnë për shkak të lidhjes së tij me zonën e luftës.

Dënimi sipas KPRK-së: *Burgim prej pesë (5) deri në dhjetë (10) vjet*

Dënimi i shqiptuar: *Burgim me kusht në kohëzgjatje prej dy (2) viteve.*

Rrethanat lehtësuese:

1. Pendimi për kryerjen e kësaj vepre penale;
2. Premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla apo çfarëdo qofshin ato;
3. Faktin se i dënuari që nga koha e kryerjes së kësaj vepre penale, pra nga viti 2014 nuk ka rënë ndesh me ligjin;
4. Është i gjendjes së dobët ekonomike;

Rrethanat rënduese

1. Pështja e rëndë e veprës penale;
2. Faktin se i dënuari edhe më parë ka qenë i akuzuar për një vepër tjetër penale;

Përshtatshmëria e dënimit:

Gjykata është e mendimit se edhe me dënimin e shqiptuar do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit sipas nenit 41 të KPRK-së.

Zbatimi i udhëzuesit

Përshtatshmëria e dënimit

Gjykata në këtë aktgjykim nuk ka marrë parasysh dhe nuk ka arsyetuar arritjen e asnjë prej katër qëllimeve të përmendura në udhëzues. Gjykata vetëm ka nënvizuar se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit duke mos përmendur dhe arsyetuar asgjë më shumë.

Zbatimi i parimeve

Gjykata në këtë rast vetëm ka cituar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, duke mos bërë asnjë ndërlidhje me parimet që duhet të merren parasysh me rastin e caktimit të dënimit, siç përcaktohet në udhëzues.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Sa i përket pendimit, sipas udhëzuesit, gjykata duhet të marrë parasysh dhe të arsyetojë tetë faktorët e përcaktuar në udhëzues, gjë që gjykata nuk e ka bërë në rastin konkret. Premtimi se në të ardhmen nuk do të kryejë veprë tjetër penale, në udhëzues nuk përmendet fare si rrethanë lehtësuese. Sa i përket kohës së kaluar, gjykata ka marrë në konsideratë faktin se që nga ajo kohë i dënuari nuk ka kryer veprë tjetër penale dhe këtë rrethanë e ka arsyetuar. Sa i përket faktit se i dënuari është i gjendje së dobët ekonomike, gjykata nuk e ka mbështetur me asnjë provë dhe me asnjë arsyetim këtë rrethanë, në mënyrë që kuptohet qartë se pse ky fakt në rastin konkret paraqet rrethanë lehtësuese. Ndërsa, gjykata në këtë aktgjykim ka marrë si rrethanë rënduese peshën e veprës penale. Sipas udhëzuesit, pesha e veprës penale është parim i dënimit, i cili duhet të arsyetohet dhe ndërlidhet me rrethana të tjera të posaçme. Pra, në vetvete, pesha e veprës penale nuk paraqitet si rrethanë, çka nënkupton se sipas udhëzuesit, këtu kemi të bëjmë me dyfishim të rrethanave. Ndërsa, sa i përket dënimeve të mëparshme, sipas udhëzuesit, gjykata në këtë rast duhet të marrë parasysh pesë faktorë si dhe të japë përgjigje në gjashtë pyetjet relevante, gjë të cilën gjykata nuk e ka bërë në këtë aktgjykim.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruar nga aktgjykimi

Gjykata nuk ka marrë parasysh fare shkallën e dashjes, bashkëpunimi i përgjithshëm i personit me gjykatën, shkallën e dëmit të shkaktuar, (mos) keqardhjen e shfaqur dhe (mos) shkelja e urdhrave të gjykatës.

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Gjykata në këtë rast nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me rëndësinë e brendshme të rrethanave dhe po ashtu, nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me peshimin e rrethanave. Për këtë arsye, llogaritja është kuantitative. Në rastin konkret, gjykata ka marrë parasysh katër rrethana lehtësuese dhe dy rrethana rënduese, që sipas udhëzuesit bëhet fjalë për rastet kur kemi “ekzistimin e pak rrethanave rënduese së bashku me shumë rrethana lehtësuese apo zbutëse”, që kualifikohet tek faktorët që tregojnë më shumë rrethana lehtësuese se sa rënduese. Ndonëse gjykata në aktgjykim e këtij rasti e ka cituar nenin 75, gjykata nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me mundësinë e zbatimit të këtij neni në këtë rast. Sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 6, pika a, dënimi në këtë rast duhet të jetë nga gjashtë muaj deri në dy vite burgim, që i bie se në rastin konkret, dënimi është jashtëzakonisht larg këtyre kufijve. Po

ashtu, edhe sikur në rastin konkret të ishte arsyetuar zbutja sipas nenit 75, dhe zbutja të ishte e plotë apo e pjesshme, dënimi minimal në këtë rast mund të jetë tre vite, që i bie se edhe në këto rrethana, dënimi i shqiptuar është më i ulët se sa limitet e përcaktuara nga udhëzuesi.

- 4. Rasti PKR.nr.203/2017 - Kryerja e veprave terroriste nga neni 136 par.1 lidhur me nenin 145 dhe 31 të KPRK-së, Përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës nga neni 144 par.1 lidhur me nenin 135 par.1 nën par. 1,1 lidhur me nenin 179 nën par. 1,9 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve, materieve plasëse nga neni 372 par.1 të KPRK-së, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së**

Aktgjykimi i marrë

Sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë– Departamenti për Krime të Rënda, të dënuarit V.A, B.I, L.V dhe F.G janë shpallur fajtorë për veprën penale “Kryerja e veprës terroriste”, të dënuarit A.A dhe L.G janë shpallur fajtorë për veprën penale “Përgatitja e veprave terroriste ose veprës kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës, pastaj të dënuarit V.I dhe K.P për veprën penale “Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse”. Kurse, të dënuarit B.I dhe L.M janë shpallur fajtorë për veprën penale “Fshehja ose moslajmërimi i terroristeve dhe grupeve terroriste”, pastaj i dënuari L.G është shpallur fajtorë edhe për veprën penale “Organizmi dhe pjesëmarrja në grup terrorist”, të dënuarit L.M dhe B.P janë shpallur fajtor për “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”. Kjo pasi nëntë të dënuarit akuzoheshin se gjatë ndeshjes së futbollit ndërmjet Shqipërisë dhe Izraelit, që ishte zhvilluar në qytetin e Shkodrës, në nëntor të vitit 2016, kanë planifikuar të kryejnë sulm terrorist kundër lojtarëve dhe tifozëve izraelitë. Ashtu që, Lavdrim Muhaxheri, përmes kontakteve të rregullta me të dënuarin V.A, i ka bërë thirrje që ta kryejë sulmin terrorist kundër lojtarëve dhe tifozëve nga Izraeli, të cilët duhej të vinin në Shqipëri, në qytetin e Shkodrës, nëntorin e 2016-ës, komunikime këto të kryera duke përdorur një aplikacion të internetit të quajtur “Telegram”. Të dënuarit A.A dhe L.G, e kanë shfrytëzuar të njëjtin aplikacion për të komunikuar me Lavdrim Muhaxherin, me qëllim që gjatë tetorit të kryenin sulme terroriste brenda Kosovës, ashtu që kanë planifikuar sulm terrorist-atentat në ndërkombëtarët ose në institucionet e sigurisë. Pjesë e këtij organizimit ishte edhe blerja e armëve për grupin, me paratë që do të siguroheshin nga Lavdrim Muhaxheri. Gjykata ka gjetur se ky grup kishte arritur të prodhonte eksploziv (materiale plasëse) në shtëpinë e të dënuarit K.P. I dënuari L.G, akuzohet se ka marrë pjesë aktivisht për dy javë në radhët e organizatës terroriste “Al Nusra”, duke kryer veprën penale të organizimit dhe pjesëmarrjes në grupet terroriste.

Dënimi sipas KPRK-së për veprën penale “Kryerja e veprave terroriste”: *jo më pak se pesë (5) vjet burgim.*

Dënimi sipas KPRK-së për veprën penale “Fshehja ose moslajmërimi i terroristëve dhe grupeve terroriste”: *Dënim me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.*

Dënimi sipas KPRK-së për veprën penale “Përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës”: *jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.*

Dënimi sipas KPRK-së për veprën penale “Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist”: *dënohet me burgim prej pesë (5) deri në dhjetë (10) vjet.*

Dënimi sipas KPRK-së për veprën penale “Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse”: *Dënohet me gjobë deri në shtatë mijëpesëqind (7.500) Euro dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.*

Dënimi sipas KPRK-së për veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”: *Dënohet me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7.500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet*

Dënimi i shqiptuar për veprën penale “Kryerja e veprave terroriste”:

V.I është dënuar me burgim në kohëzgjatje prej nëntë (9) viteve.

L.V është dënuar me burgim në kohëzgjatje prej pesë (5) viteve.

F.G është dënuar me burgim në kohëzgjatje prej pesë (5) viteve.

Dënimi i shqiptuar për veprën penale “Fshehja ose moslajmërimi i terroristëve dhe grupeve terroriste”:

B.I është dënuar me burgim në kohëzgjatje prej tre (3) viteve.

L.M është dënuar me burgim në kohëzgjatje prej tre (3) viteve.

Dënimi i shqiptuar për veprën penale “Përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës”:

A.A është dënuar me burgim në kohëzgjatje prej një (1) vjet e gjashtë (6) muaj.

L.G është dënuar me burgim në kohëzgjatje prej dy (2) viteve.

Dënimi i shqiptuar për veprën penale “Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist”:

L.G është dënuar me burgim në kohëzgjatje prej pesë (5) viteve.

Dënimi i shqiptuar për veprën penale “Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse”:

V.I është dënuar me gjobë në lartësi prej një mijë e tetëqind euro (1.800,00) si dhe dënim me burg në kohëzgjatje prej dy (2) viteve.

K.P është dënuar me gjobë në lartësi prej një mijë e tetëqind euro (1.800,00) si dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) vjet e gjashtë (6) muaj.

Dënimi i shqiptuar për veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”:

L.M është dënuar me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti.

B.P është dënuar me gjobë në lartësi prej dy mijë e pesëqind euro (2,500.00).

Rrethanat lehtësuese:

1. Për të dënuarit A.A, K.P dhe B.P, si rrethanë lehtësuese është konsideruar pranimi i fajësisë;
2. Për të dënuarit A.A, K.P , B.P, fakti se janë të moshës së re;
3. Për të dënuarit A.A, K.P dhe B.P, qëndrimi korrekt gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor
4. Për të dënuarit, V.I, B.I, L.V, F.G, L.G dhe L.M si rrethanë lehtësuese gjeti se janë të moshës së re;
5. Për të dënuarit V.I, B.I, L.V, F.G, L.G dhe L.M, fakti se deri më tani, për sa kjo gjykatë është në dijeni, për herë të parë kanë kryer veprë penale;

Rrethanat rënduese

Për të dënuarit V.I, B.I, L.V, F.G, L.G dhe L.M, fakti se këta të dënuar gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor nuk kanë treguar asnjë shenjë të keqardhjes apo të pendimit për veprimet të cilat i kanë kryer;

Përshtatshmëria e dënimit:

Kjo gjykatë konsideron se me dënimet e shqiptuara ndaj tani të dënuarve do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me ligj, konform nenit 41 të KPRK-së, përkatësisht se do të parandalojë kryerësit e këtyre veprave penale nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëhet rehabilitimi i tyre, të parandalojë personat tjerë nga kryerja e veprave penale dhe nëpërmjet këtyre dënimeve të shprehet gjykimi shoqëror për veprat penale të kryera nga tani të akuzuarit.

Zbatimi i udhëzuesit

Përshtatshmëria e dënimit

Gjykata në këtë aktgjykim ka cituar tre prej qëllimeve të dënimit dhe e ka marrë si të mirëqenë faktin se me shqiptimin e këtij dënimi, të njëjtat qëllime do të arrihen, mirëpo që asnjërin prej këtyre tri qëllimeve gjykata nuk i ka arsyetuar. Sa i përket qëllimit të katërt (viktimat dhe komuniteti) gjykata nuk e ka aplikuar dhe arsyetuar fare këtë qëllim të dënimit të paraparë me udhëzues.

Zbatimi i parimeve

Gjykata në këtë rast vetëm ka cituar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, duke mos bërë asnjë ndërlidhje me parimet që duhet të merren parasysh me rastin e caktimit të dënimit, siç përcaktohet në udhëzues.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Tek pranimi i fajësisë, asnjë kërkesë e cila sipas udhëzuesit duhet të aplikohet me rastin e marrjes parasysh të kësaj rrethane, e cila përcakton edhe rëndësinë e kësaj rrethane në rastin konkret, nuk është marrë parasysh, si dhe gjykata nuk ka dhënë përgjigje në katër pyetjet që sipas udhëzuesit, janë relevante në këtë rast. Sa i përket moshës së të dënuarit, gjykata nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me këtë rrethanë, përballë nëntë pyetjeve relevante të cilave sipas udhëzuesit duhet dhënë përgjigje në këtë rast. Lidhur me sjelljen korrekte së të pandehurit gjatë procedurës, sipas udhëzuesit, gjykata duhet tu jap përgjigje gjithsej pesë pyetjeve, gjë të cilën gjykata nuk e ka bërë në këtë aktgjykim. Ndërsa, sa i përket faktit se i dënuari për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, sipas udhëzuesit, kjo rrethanë kualifikohet tek rrethanat e tjera lehtësuese. Në udhëzues thuhet se nëse gjykata e konstaton mungesën e dënimeve të mëparshme penale dhe mund të jepet zbutja, do të kërkoj gjetje të fakteve që e mbështesin përfundimin e sjelljes përkatëse dhe predispozitat për rehabilitim. Kjo çështje nuk trajtohet fare në këtë aktgjykim. Ndërsa, si rrethanë rënduese, për mos shprehjen e keqardhjes gjykata ka dhënë një arsyetim modest, por të pranueshëm, në atë mënyrë që ka treguar se gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor, gjykata ka ardhur në përfundim se të njëjtit nuk kanë treguar keqardhje.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruar nga aktgjykimi

Gjykata nuk ka marrë parasysh fare shkallën e dashjes, praninë e dhunës apo kanosjes në kryerjen e veprës penale, shkallën e dëmit të shkaktuar dhe rrethanat personale dhe karakteri i personit të dënuar.

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Gjykata në këtë rast nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me rëndësinë e brendshme të rrethanave dhe po ashtu, nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me peshimin e rrethanave. Për këtë arsye, llogaritja është kuantitative. Në rastin konkret, gjykata ndaj të dënuarve ka marrë parasysh nga tre, respektivisht dy rrethana lehtësuese dhe një rrethanë rënduese, që sipas udhëzuesit bëhet fjalë për rastet kur kemi “ekzistimin e së paku dy rrethanave për zvogëlim të fajësisë apo dëmit dhe asnjë/ose një rrethanë të vogël rënduese”, që kualifikohet tek rrethanat që arsyetojnë zbutjen maksimale të dënimit brenda kufirit. Sa i përket veprës penale të kryerjes së veprave penale terroriste, sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 6, pika e, dënimi në

këtë rast duhet të jetë nga pesë vite deri në nëntë vite burgim, që i bie se në rastin konkret, dënimi është brenda kufijve. Sa i përket veprës penale fshehja ose moslajmërimi i terroristëve dhe grupeve terroriste, sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 2, pika h, dënimi duhet të jetë nga gjashtë muaj deri në një vit e gjashtë muaj, që i bie se në këtë rast, dënimi nuk është brenda këtyre limiteve, përkatësisht është më i lartë. Sa i përket veprës penale të përgatitjes së veprave terroriste ose veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës, sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 7, pika h, dënimi në këtë rast duhet të jetë nga 10 vite deri në 13 vite, që i bie se në rastin konkret, dënimi është më i butë, madje nën minimumin ligjor. Sa i përket kësaj vepre penale, gjykata fillimisht fare nuk ka dhënë arsyetim mbi zbatueshmërinë e nenit 75 të KPRK. Por, edhe sikur i njëjti të aplikohet dhe të arsyetohej nga gjykata, gjykata sipas kësaj shtojce, në asnjë rrethanë nuk ka pasur mundësi që të shqiptoj dënim nën pesë vite burgim, siç ka bërë në rastin konkret. Sa i përket veprës penale të organizimit dhe pjesëmarrjes në grup terrorist, sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 6, pika a, dënimi në këtë rast duhet të jetë nga pesë vite deri në gjashtë vite burgim, që i bie se në këtë rast dënimi shqiptuar është brenda këtyre limiteve. Për veprën penale importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuara e armëve apo materieve plasëse, sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 3, pika g, dënimi me burgim në këtë rast duhet të jetë nga një vit deri në tre vite burgim, derisa ai me gjobë nga 100 deri në 1000 euro, që i bie se në rastin konkret dënimi nuk është brenda asnjërin prej këtyre dy limiteve. Ndërsa, sa i përket veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 1, pika g, dënimi duhet të jetë nga një muaj deri në një vit burgim, derisa ai me gjobë duhet të jetë nga 100 deri në 1000 euro, që i bie se në rastin konkret dënimi i shqiptuar me burgim për këtë vepër penale është brenda këtyre limiteve, ndërsa ai me gjobë është jashtë këtyre limiteve.

IX. Politika ndëshkimore në rastet e veprave penale të armëve

a. Hyrje

IKD në këtë kapitull ka analizuar gjithsej katër aktgjykime të veprave penale të armëve. Në bazë të metodologjisë së përmendur në fillim të këtij raporti, IKD ka analizuar edhe këto katër aktgjykime që kanë të bëjnë me veprat penale të armëve, nëse në të njëjtat, gjyqtarët kanë zbatuar kërkesat dhe standardet e vendosura nga udhëzuesi, me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit. Këto katër aktgjykime përfshijnë gjithsej 11 persona, derisa ndaj tyre janë shqiptuar 24 dënime.

Të gjeturat e IKD-së të prezantuara më poshtë, tregojnë se as në këto raste, udhëzuesi nuk ka gjetur zbatimin e duhur në praktikë.. Ajo çfarë e dallon deri në një masë këtë kategori nga kategoritë e tjera, është se përkundër disproporcionalitetit në numrin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese të aplikuara në këto raste, asnjë rrethanë nuk është aplikuar dhe arsyetuar sipas kërkesave të udhëzuesit si dhe asnjë dënim nuk i ka respektuar limitet e përcaktuar në shtojcën 1 të udhëzuesit. Pra, si edhe në kapitujt e tjerë, nëse si pikë reference për një politikë të ligjshme ndëshkimore merret udhëzuesi, atëherë nënkuptojmë se politika ndëshkimore në sistemin gjyqësorë të Republikës së Kosovës, në rastet e veprave penale të armëve, është hiq më pak se arbitrare.

Sa i përket arsytimit të aktgjykimeve mbi caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, gjithnjë duke marrë parasysh standardet e vendosura nga udhëzuesi, palët dhe publiku në asnjë rrethanë nuk mund të krijojnë bindjen se pse në rastin konkret është caktuar një dënim i tillë.

Në këtë mënyrë, ajo që ishte prezantuar si progres dhe hap konkret në drejtim të përmirësimit të politikës ndëshkimore brenda sistemit të drejtësisë në Republikën e Kosovës, e që është miratimi i udhëzuesit, nga të gjeturat e këtij raporti shihet edhe në veprat penale të terrorizmit, ky udhëzues ka mbetur politikë në letër, i pazbatuar në praktikë.

b. Gjetjet e përgjithshme


Në këtë kapitull, IKD ka analizuar katër raste të importit, eksportit, furnizimit, transportimit, prodhimit, këmbimit, ndërmjetësimit ose shitjes së paautorizuar të armëve apo materieve plasëse. Përpos kësaj vepre penale, në këto aktgjykime janë të përfshira edhe tre lloje të tjera të veprave penale. Veprat penale të përfshira në këto aktgjykime janë si më poshtë.

Vepra penale	Numri i dënimeve
Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve, materieve plasëse	10
Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve:	7
Nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mos durimit kombëtar, racor, fetar apo etnik	1
Sulmi	1
Moslajmërimi i përgatitjes së veprës penale:	1

Tabela 28 - Numri i dënimeve sipas veprave penale.


Në këto katër aktgjykime, janë të përfshirë gjithsej 11 persona, ndaj të cilëve janë shqiptuar gjithsej 24 dënime.

Prej këtyre 24 dënimeve, 16 prej tyre janë dënime me burgim efektiv, ndërsa tetë janë dënime më gjobë.




Grafika 39 – Llojet dënimeve të shqiptuara.

Sa i përket lartësisë së dënimit me burgim, dënimi me një vit burgim është dënimi më i shpeshtë i shqiptuar, në plot gjashtë raste. Dënimi më i ulët i shqiptuar në këtë kategori është gjashtë muaj burgim, ndërsa më i larti është pesë vite e gjashtë muaj burgim.



Grafika 40 - Lartësia e dënimeve me burgim.

Ndërsa sa i përket dënimit me gjobë, dënimi më i shpeshtë i shqiptuar është ai me 1.800 euro gjobë në tre raste. Dënimi më i ulët më gjobë në këtë kategori është 1.000 euro, ndërsa më i larti është 7.000 euro.



Grafika 41 - Lartësia e dënimeve me gjobë.

Sa i përket numrit të rrethanave të aplikuara në këto raste, gjykatat kanë aplikuara gjithsej 22 rrethana. Për dallim nga kategoritë e tjera, kjo është categoria e vetme ku në total, numri i rrethanave të rënduese të aplikuar tejkalon numrin e rrethanave lehtësuese.



Grafika 42 - Numri total i rrethanave të përdorura në 10 aktgjykime.

Sa i përket rrethanave lehtësuese, në dy raste janë aplikuar nga tre rrethana lehtësuese, ndërsa në dy rastet e tjera janë aplikuar nga katër rrethana lehtësuese.

Numri i rrethana lehtësuese të aplikuar	Numri i rasteve
3 rrethana të aplikuar	2 raste
4 rrethana të aplikuar	2 raste

Tabela 29 - Numri i rrethana lehtësuese të aplikuar.

Ndërsa, sa i përket rrethanave lehtësuese, në dy raste nuk është aplikuar asnjë rrethanë rënduese, në një rast është aplikuar një rrethanë rënduese ndërsa në rastin tjetër janë aplikuar gjithsej 7 rrethana rënduese.

Numri i rrethana rënduese të aplikuar	Numri i rasteve
Asnjë rrethanë rënduese	2 raste
1 rrethanë të aplikuar	1 raste
7 rrethana te aplikuar	1 rast

Tabela 30 - Numri i rrethana rënduese të aplikuar.

Sa i përket llojeve të rrethanave të aplikuar, të dhënat tregojnë për një laramani të rrethanave të aplikuar në këto raste, ku në total, janë aplikuar 18 lloje të rrethanave, ku vetëm katër prej tyre janë aplikuar nga 2 raste.

Lloji i rrethanës	Numri i rasteve në të cilat është aplikuar
Nuk ka qene me parë i dënuar	2
Pranimi i fajësisë	2
Koha e gjatë nga koha e kryerjes së veprës penale	2
Fakti se i dënuari është i martuar, baba i pesë fëmijëve dhe mbajtës i fëmijëve	2
Sjellja e te dënuarit pas kryerjes së veprave penale	1
Sjellje korrekte në gjykatë	1
Fakti se nga fillimi i hetimit për veprat penale si më lartë e deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të njëjtit nuk kanë kryer ndonjë vepër tjetër penale	1
Shkallën e përgjegjësisë penale së të dënuarve, pasi të njëjtit kanë pasur njohuri për përgjegjësinë penale dhe veprat penale	1
Fakti se kanë qenë të rritur dhe të arsimuar mjaftueshëm për të kuptuar se çfarë janë duke vepruar	1
Intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur	1
Prania e dhunës ndaj viktimave të ndjeshme dhe kryerja e veprës penale ndaj tyre për shkak të besimit fetar	1
Shkallën e lartë të pjesëmarrjes së të akuzuarve në veprat penale që nënkupton posedimin e armëve dhe municioneve në numër të madh në shtëpitë e tyre si dhe blerjen e armëve të tjera në numër të madh.	1
Rrethanat në të cilat është kryer vepra penale	1
Shkallën e lartë të pjesëmarrjes së tani të dënuarve në kryerjen e veprave penale për të cilat janë shpallur fajtorë dhe shkallën e lartë të dashjes për kryerjen e këtyre veprave penale nga tani të dënuarit	1

E kaluara kriminale	1
Rrethanat personale për të dënuarin	1
Gjendja e dobët ekonomike	1
Pendimi	1


Tabela 31 – Llojet e rrethanave të aplikuara.

Por në kuptim të zbatimit të udhëzuesit, shqetësuese është fakti se asnjë prej rrethanave të aplikuara, qoftë lehtësuese apo rënduese, nuk është aplikuar dhe zbatuar sipas kërkesave të udhëzuesit, çka tregon se zbatimi i udhëzuesit në praktikë edhe në këtë kategori është në nivelin zero.



Grafika 43 - Aplikimi i rrethanave sipas kërkesave të udhëzuesit.

Në të gjitha aktgjykimet janë identifikuar rrethana të injoruara nga gjykata. Në një rast është identifikuar vetëm një rrethanë e injoruar, në rastin tjetër janë identifikuar pesë rrethana të injoruara derisa në dy raste janë identifikuar nga gjashtë rrethana të injoruara.




Grafika 44 - Numri i rrethanave të injoruara.

Sa i përket dyfishimit të rrethanave, IKD ka identifikuar një rast në këtë kapitull ku ka pasur një dyfishim të rrethanave.


Sa i përket përshtatshmërisë së dënimit, të gjitha aktgjykimet përmbajnë pjesën e arsytimit mbi përshtatshmërinë e dënimit.

Sa i përket aplikimit të qëllimeve të dënimit, IKD ka gjetur se në asnjë prej aktgjyqimeve të analizuar në këtë kapitull nuk i ka zbatuar të gjitha qëllimet e dënimit të përcaktuara në udhëzues.




Grafika 45 - Numri i qëllimeve të dënimit të aplikuar në aktgjyqime.

Sa i përket llojeve të qëllimeve të dënimit të cilat janë aplikuar në këto raste, qëllimi më i shpeshtë i aplikuar ka qenë parandalimi specifik/i veçantë, derisa qëllimi viktimat dhe komuniteti është aplikuar në vetëm një rast.



Grafika 46 - Llojet e qëllimeve të dënimit të aplikuara në aktgjykime.

Por në kuptim të zbatimit të udhëzuesit në praktikë, është jashtëzakonisht shqetësuese në këtë kategori se nuk është identifikuar asnjë qëllim i vetëm i aplikuar, i cili është aplikuar dhe arsyetuar konform kërkesave të udhëzuesit, çka e përforcon edhe më shumë faktin e mos zbatueshmërisë së udhëzuesit brenda sistemit gjyqësor.



Grafika 47 - Aplikimi dhe arsyetimi i qëllimeve të dënimit sipas kërkesave të udhëzuesit.

E gjetur e njëjtë është edhe sa i përket zbatimit të parimeve, ku në përputhje me udhëzuesin, gjykatat vetëm në një rast kanë zbatuar pjesërisht parimet, ndërsa në rastet e tjera, parimet janë plotësisht të pazbatuara sipas kërkesave të udhëzuesit.



Grafika 48 - Zbatimi i parimeve.

Sa i përket limiteve të dënimit të cilat i ka përcaktuar shtojca 1 e udhëzuesit, në të gjitha rastet, dënimi është shqiptuar duke mos i respektuar këto limite.



Grafika 49 - Kufinj të dënimeve.

c. Analiza e veçantë e rasteve të veprave penale të armëve

1. Rasti PKR.nr.252/15 - Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve, materieve plasëse nga neni 372 par.1 të KPRK-së, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, Nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mos durimit kombëtar, racor, fetar apo etnik”, nga neni 147 par.1 lidhur me nenin 31, Sulmi nga neni 187 par.2 lidhur me par.1 dhe lidhur me nenin 31 të KPRK-së, “Moslajmërimi i përgatitjes së veprës penale”, nga neni 385 par.2 të KPRK-së

Aktgjykimi i marrë

Sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, të dënuarit V.SH, A.M, N.S dhe G.S janë shpallur fajtorë për veprën penale “Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve, materieve plasëse”, i dënuari A.M është shpallur fajtor për veprën penale “Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve, materieve plasëse” dhe për veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, pastaj i dënuari N.S është shpallur fajtor për veprat penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” dhe për veprën penale “Sulmi”. I dënuari G.S është shpallur fajtor edhe për veprën penale “nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mos durimit kombëtar, racor, fetar apo etnik”. Pastaj, sipas aktgjykimit, i dënuari V.Sh është shpallur fajtor edhe për veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”. I dënuari M.H është gjetur fajtor për veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” dhe atë të “Moslajmërimi i përgatitjes së veprës penale”. Kjo pasi sipas aktgjykimit, ishte provuar se të dënuarit V.SH, A.M, N.S dhe G.S më 5 nëntor 2013, duke vepruar si grup, në bashkëkryerje dhe në shkelje të ligjit të zbatueshëm për armët apo materiet plasëse në Kosovë, në lokacionin “Gërmia” në Prishtinë kanë blerë 14 pushkë automatike dhe një pushkë me snajper. I dënuari A.M është gjetur fajtor sepse në një datë të paspecifikuar, para datës 5 nëntor 2013, në Gjilan, ka prodhuar material shpërthyes duke kombinuar dhe modifikuar pleh artificial, duke e përzier atë më lëndë djegëse dhe në këtë mënyrë ka krijuar nitrat amoni i njohur si ANFO, që përdoret shpesh si një komponent shpërthyes për bombat e punuar me dorë. I dënuari N.S është gjetur fajtor sepse nga një datë e pacaktuar e deri më 5 nëntor 2013, ka mbajtur në kontroll, pronësi dhe posedim dy armë. Po ashtu, N.S është shpallur fajtor edhe për veprën penale “Sulmi”, sepse më 3 nëntor 2013, në bashkëveprim me persona tjerë, për shkak të urrejtjes fetare dhe jo tolerancës religjioze, kanë sulmuar fizikisht të dëmtuarit E.R dhe C.Ë, për shkak se të njëjtit kanë shpërndarë literaturë fetare. Ndërsa, i dënuari V.SH është gjetur fajtor sepse nga data e paspecifikuar e deri më 5 nëntor 2013, ka mbajtur në pronësi, kontroll dhe posedim armët: pushka e gjuetisë, pushkë ajrore, 1583 fishekë të kalibrave të ndryshëm dhe 1,173 plumba në kundërshtim me ligjin në fuqi lidhur me armët e tilla. I dënuari G.S

është dënuar për veprën penale “nxitja e urrejtjes, përçarjes apo mos durimit kombëtar, racor, fetar apo etnik” sepse nga korriku 2013 e deri më 5 nëntor 2014, në Prishtinë, Gjilan dhe vende tjera në Republikën e Kosovës, duke përdorur një platformë elektronike të komunikimit dhe mediave sociale, kanë nxitur publikisht dhe përhapur urrejtje, përçarje dhe jo tolerancë ndërmjet grupeve fetare që jetojnë në Kosovë. Tutje, i dënuari M.H është shpallur fajtor për armëmbajtje pa leje sepse nga data e pacaktuar e deri më 5 nëntor 2013, ka pasur në pronësi, ka kontrolluar dhe poseduar dy armë, një pushkë gjuetie dhe një pistoletë me gaz. Po ashtu, i dënuari M.H është gjetur fajtor edhe për veprën penale “moslajmërimi i përgatitjes së veprës penale”, sepse nga data 5 nëntor 2013, nga takimi në restorant “Nora”, në Klinë, duke qenë i informuar, i vetëdijshëm për hollësitë dhe duke marrë pjesë në takime të ndryshme të një grupi me të pandehur tjerë, ka dështuar të paraqes përgatitjen e kryerjes së veprave në kundërshtim me kapitullin XXX, të cilat nuk janë raportuar tek autoritetet për zbatimin e ligjit.

Dënimi sipas KPRK-së për veprën penale “Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve, materieve plasëse”:

Dënohet me gjobë deri në shtatë mijesëqind (7.500) Euro dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet

Dënimi sipas KPRK-së për veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”:

Dënohet me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7.500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet.

Dënimi sipas KPRK-së për veprën penale “Nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mos durimit kombëtar, racor, fetar apo etnik”:

Dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë (5) vjet.

Dënimi sipas KPRK-së për veprën penale “Sulmi”:

Dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

Dënimi sipas KPRK-së për veprën penale “Moslajmërimi i përgatitjes së veprës penale”:

Dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.

Dënimi i shqiptuar për veprën penale “Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve, materieve plasëse”:

V.SH për këtë vepër të kryer në bashkëkryerje është dënuar me katër (4) vite e gjashtë (6) muaj burgim dhe dënim me gjobë në shumë prej një mijë e tetëqind euro (1.800).

A.M për këtë vepër të kryer në bashkëkryerje është dënuar me katër (4) vite e gjashtë (6) muaj burgim dhe dënim me gjobë në shumë prej njëmijë e tetëqind euro (1.800).

Po ashtu, A.M, për këtë vepër është dënuar edhe me dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti dhe dënim me gjobë prej një mijë euro (1000).

N.S për këtë vepër të kryer në bashkëkryerje është dënuar me katër (4) vite e gjashtë (6) muaj burgim dhe dënim me gjobë në shumë prej njëmijë e tetëqind euro (1.800).

G.S për këtë vepër të kryer në bashkëkryerje është dënuar me katër (4) vite e gjashtë (6) muaj burgim dhe dënim me gjobë në shumë prej njëmijë e tetëqind euro (1.800).

Dënimi i shqiptuar për veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”:

A.M është dënuar me burgim në kohëzgjatje prej dy (2) viteve;

N.S është dënuar me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti;

V.SH është dënuar me burgim në kohëzgjatje prej dy (2) viteve;

M.H është dënuar me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti;

Dënimi i shqiptuar për veprën penale “Nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mos durimit kombëtar, racor, fetar apo etnik”:

G.S është dënuar me gjobë në shumë prej një mijë e tetëqind euro (1.800).

Dënimi i shqiptuar për veprën penale “Sulmi”:

N.S është dënuar me burgim në kohëzgjatje prej tre (3) vite e gjashtë (6) muaj.

Dënimi i shqiptuar për veprën penale “Moslajmërimi i përgatitjes së veprës penale”:

M.H është dënuar me gjobë në shumë prej gjashtëqind euro (600).

Rrethanat lehtësuese:

1. Fakti që sipas të dhënave të kësaj gjykate nuk rezulton që ata të jenë gjykuar dhe dënuar më parë me ndonjë aktgjykim të formës së prerë për ndonjë vepër penale e as të jetë ngritur aktakuzë ndaj tyre;

2. Për të dënuarit A.M, G.S dhe N.S fakti se kanë pranuar fajësinë për veprat penale që hyjnë në kapitullin e armëve;

3. Për të dënuarit, sjelljen e tyre pas kryerjes së veprave penale, duke pasur parasysh faktin se të njëjtit kanë pasur sjellje korrekte, përkatësisht kanë respektuar masën e paraqitjes në stacion policor dhe janë paraqitur në gjykatë në kohën e caktuar;

4. Për të dënuarit, fakti se nga fillimi i hetimit për veprat penale si më lartë e deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të njëjtit nuk kanë kryer ndonjë vepër tjetër penale, përfshirë periudhën nga data 5 nëntor 2013 e deri më tani;

Rrethanat rënduese

1. Shkallën e përgjegjësisë penale së të dënuarve, pasi të njëjtit kanë pasur njohuri për përgjegjësinë penale dhe veprat penale;

2. Fakti se kanë qenë të rritur dhe të arsimuar mjaftueshëm për të kuptuar se çfarë janë duke vepruar;

3. Intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur, përkatësisht tani të dëmtuarve-misionareve amerikane Robertson dhe Eheelock iu kanë shkaktuar lëndime trupore;

4. Prania e dhunës ndaj viktimave të ndjeshme dhe kryerja e veprës penale ndaj tyre për shkak të besimit fetar - sa i përket të dënuarit N.S;

5. Shkallën e lartë të pjesëmarrjes së të akuzuarve në veprat penale që nënkupton posedimin e armëve dhe municioneve në numër të madh në shtëpitë e tyre si dhe blerjen e armëve të tjera në numër të madh;

6. Rrethanat në të cilat është kryer vepra penale;

7. Shkallën e lartë të pjesëmarrjes së tani të dënuarve në kryerjen e veprave penale për të cilat janë shpallur fajtorë dhe shkallën e lartë të dashjes për kryerjen e këtyre veprave penale nga tani të dënuarit;

8. Shkallën e intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur, duke pasur parasysh se armët dhe materiet me të cilat mund të prodhohen materie plasëse në mënyrë artizanale të gjetura tek të akuzuarit përbëjnë rrezikshmëri të lartë dhe janë të dëmshme për përdoruesit e tyre dhe për qytetarët e Republikës së Kosovës, pasi që përdorimi i tyre paraqet rrezik serioz për individin në veçanti apo për qytetarët në përgjithësi.

Përshtatshmëria e dënimit:

Gjykata të dënuarve iu shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprave penale për të cilat edhe janë shpallur fajtorë, si dhe shkallës së përgjegjësisë penale së të dënuarve. Pastaj, fakti se me dënimin e shqiptuar ndaj tyre, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK-së, përkatësisht të parandalojë kryerësit nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose komunitetit për humbjet se dëmet e shkaktuara nga veprat penale dhe të shprehë gjykim shoqëror për veprën penale, për ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Zbatimi i udhëzuesit

Përshtatshmëria e dënimit

Gjykata në këtë rast ka aplikuar tre prej qëllimeve të dënimit, derisa qëllimin e parandalimit të përgjithshëm gjykata nuk e ka aplikuar dhe arsyetuar fare në këtë rast. Por, të tre prej qëllimeve të dënimit të cilat gjykata i ka aplikuar në këtë rast, gjykata i ka marrë si të mirëqenë dhe të vetëkuptueshëm arritjen e tyre, pasi për të njëjtat nuk ka dhënë asnjë arsyetim se si me këto dënime do të arrihen këto qëllime, respektivisht lidhjen kauzale në këtë rast.

Zbatimi i parimeve

Gjykata në këtë rast ka aplikuar një numër të caktuar të parimeve të dënimit sa i përket rrethanave lehtësuese, por të njëjtën nuk e ka bërë tek rrethanat rënduese të aplikuara në këtë rast. Për më tepër, tek rrethanat rënduese, gjykata i merr si rrethanë rënduese rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, që sipas udhëzuesit në këtë rast nuk kemi të bëjmë me rrethanë të veçantë rënduese, por me parim të dënimit, i cili duhet të ndërlidhet me rrethana të tjera të posaçme. Pra, në këtë rast kemi të bëjmë me zbatim të pjesshëm të parimeve të dënimit.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Sa i përket faktit se i dënuari për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, sipas udhëzuesit, kjo rrethanë kualifikohet tek rrethanat e tjera lehtësuese. Në udhëzues thuhet se nëse gjykata e konstaton mungesën e dënimeve të mëparshme penale dhe mund të jepet zbutja, do të kërkoj gjetje të fakteve që e mbështesin përfundimin e sjelljes përkatëse dhe predispozitat për rehabilitim. Kjo çështje nuk trajtohet fare në këtë aktgjykim. Tek pranimi i fajësisë, asnjë kërkesë e cila sipas udhëzuesit duhet të aplikohet me rastin e marrjes parasysh të kësaj rrethane, e cila përcakton edhe rëndësinë e kësaj rrethane në rastin konkret, nuk është marrë parasysh, si dhe gjykata nuk ka dhënë përgjigje në katër pyetjet që sipas udhëzuesit, janë relevante në këtë rast. Lidhur me sjelljen korrekte së të pandehurit gjatë procedurës, sipas udhëzuesit, gjykata duhet tu jap përgjigje gjithsej pesë pyetjeve, ndërsa në këtë rast, gjykata ka treguar vetëm se të pandehurit kanë respektuar masën e sigurisë dhe janë paraqitur në gjykatë. Sa i përket kohës së kaluar, gjykata ka arsyetuar këtë rrethanë sipas kërkesave të udhëzuesit. Sa i përket rrethanave rënduese, gjykata të gjitha rrethanat rënduese i ka aplikuar dhe arsyetuar sipas kërkesave të udhëzuesit, përjashtimisht rrethanave në të cilat është kryer vepra penale. Sa i përket kësaj të fundit, gjykata të njëjtën e ka aplikuar si rrethanë rënduese, duke mos e ndërlidhur me asnjë rrethanë të veçantë. Sipas udhëzuesit, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale është parim i dënimit dhe jo rrethanë e veçantë. Në kuptim të udhëzuesit, në këtë rast gjykata ka bërë dyfishim të rrethanave.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruar nga aktgjykimi

Gjykata nuk ka marrë parasysh fare në këtë rast pendimin apo mungesën e pendimit së të dënuarve.

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Gjykata në këtë rast nuk ka dhënë asnjë arsytim lidhur me rëndësinë e brendshme të rrethanave dhe po ashtu, nuk ka dhënë asnjë arsytim lidhur me peshimin e rrethanave. Për këtë arsye, llogaritja është kuantitative. Në rastin konkret, gjykata ndaj të dënuarve ka marrë parasysh tre, respektivisht katër rrethana lehtësuese dhe shtatë, respektivisht tetë rrethana rënduese, që sipas udhëzuesit bëhet fjalë për rastet kur “totali i rrethanave rënduese e tejkalon dukshëm më shumë atë të rrethanave lehtësuese”, që kualifikohet tek faktorët që arsyetojnë dënimin maksimal brenda kufirit. Sa i përket veprës penale importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve, materieve plasëse, sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 1, pika i, dënimi me burgim në këtë rast duhet të jetë nga 6 vite deri në 8 vite burgim derisa ai me gjobë duhet të jetë nga 5250 euro deri në 7500 euro, që i bie se në rastin konkret, asnjëri prej dënimeve nuk është brenda këtyre limiteve. Sa i përket veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 1, pika g, dënimi në këtë rast duhet të jetë nga katër vite deri në pesë vite burgim, që nënkupton se në rastin konkret, dënimi i shqiptuar për këtë veprë penale nuk është brenda këtyre limiteve. Tutje, sa i përket veprës penale nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mos durimit kombëtar, racor, fetar apo etnik, dënimi me gjobë sipas shtojcës së udhëzuesit duhet të jetë nga 17.500 euro deri në 25.000 euro, që i bie se as për këtë veprë penale, dënimi nuk është brenda këtyre limiteve. Për veprën penale të sulmit, sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 2, pika h, dënimi në këtë rast duhet të jetë nga katër vite deri në pesë vite burgim, që në rastin konkret, dënimi i shqiptuar nuk është brenda këtyre limiteve. Për veprën penale të moslajmërimit të përgatitjes së veprës penale, sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, dënimi duhet të jetë nga 17.500 deri në 25.000 euro gjobë, që nënkupton se as në këtë rast, dënimi i shqiptuar nuk është brenda këtyre limiteve.

2. Rasti PKR.nr.130/11 – Furnizimi, Transporti, Prodhimi, Këmbimi ose Shitja e paautorizuar e armëve nga neni 327 par.2 lidhur me nenin 23 të KPK-së, Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në Shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.3 lidhur me par.2 të KPK-së

Aktgjykimi i marrë

Sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë– Departamenti për Krime të Rënda, të dënuarit A.M dhe Av.M janë shpallur fajtorë për veprën penale “Furnizimi, Transporti, Prodhimi, Këmbimi ose Shitja e paautorizuar e armëve”. Po ashtu, i dënuari A.M është shpallur fajtor edhe për veprën penale “Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve”. Kjo pasi sipas aktgjykimit, është provuar se të dënuarit A.M dhe Av.M në bashkëveprim me tani të ndjerin G.M, deri më 3 prill 2008, në shtëpinë e tyre në rr. “Aleksander Moisiu”, janë furnizuar me armë nga Shqipëria dhe në punëtoritë e tyre, të cilat i kanë modifikuar dhe pastaj të njëjtat i kanë shitur. I dënuari Av.M është shpallur fajtor edhe për veprën penale “Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve” pasi është provuar se më 3 prill 2008, në shtëpinë e tij ka mbajtur në pronësi, pa leje valide, revole të kalibrave të ndryshëm, fishekë të ndryshëm, dhe në kotecin e pëllumbave së të dënuarit Av.M janë gjetur edhe 44 mijë euro, të

mbështjella në dy pako cigare “Ronson” dhe “Marlboro”, si rezultat i kryerjes së veprës penale.

Dënimi sipas KPK-së për veprën penale “Furnizimi, Transporti, Prodhimi, Këmbimi ose Shitja e paautorizuar e armëve”:

Dënohet me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.

Dënimi sipas KPK-së për veprën penale “Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve”:

Dënohet me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.

Dënimi i shqiptuar për veprën penale “Furnizimi, Transporti, Prodhimi, Këmbimi ose Shitja e paautorizuar e armëve”:

A.M është dënuar me burgim me kusht në kohëzgjatje prej një (1) viti;

Av.M është dënuar me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti;

Dënimi i shqiptuar për veprën penale “Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve”:

Av.M është dënuar me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj.

Rrethanat lehtësuese:

1. Për të dënuarit A.M dhe Av.M, koha e gjatë nga koha e kryerjes së veprës penale;
2. Për të dënuarit A.M dhe Av.M, sjelljen e tyre para kryerjes së veprës penale dhe pas kryerjes së veprës penale, pasi që gjykata nuk ka ndonjë të dhënë se ndaj të njëjtëve është filluar, vazhduar ose përfunduar ndonjë procedurë penale;
3. Për të dënuarin Av.M, gjykata ka vlerësuar si rrethanë veçanërisht lehtësuese, pranimin e fajësisë se ai e ka kryer veprën penale “Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve”, e cila edhe i ka mundësuar gjykatës aplikimin e dispozitave për zbutjen e dënimit dhe shqiptimin e dënimit nën minimumin e paraparë për këtë vepër penale;
4. Rrethanat personale për të dënuarin Av.M;
5. Fakti se i dënuari Av.M është i martuar, baba i pesë fëmijëve dhe mbajtës i fëmijëve;

Rrethanat rënduese:

Asnjë

Përshtatshmëria e dënimit:

Duke i vlerësuar në këtë mënyrë rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, kjo gjykatë ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale së të dënuarve, intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura dhe në këtë mënyrë do të ndikojë në parandalimin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëjë rehabilitimin e të njëjtëve, si dhe do të përmbajë persona të tjerë nga kryerja e veprave penale, çka është edhe qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPK-së.

Zbatimi i udhëzuesit

Përshtatshmëria e dënimit

Gjykata në këtë aktgjykim ka cituar dy prej qëllimeve të dënimit dhe e ka marrë si të mirëqenë faktin se me shqiptimin e këtij dënimi, të njëjtat qëllime do të arrihen, mirëpo që asnjërin prej këtyre dy qëllimeve gjykata nuk i ka arsyetuar. Sa i përket qëllimit të katërt (gjykimi shoqëror, ngritja e moralit dhe forcimi i detyrimit për respektimin e ligjit dhe viktimat dhe komuniteti) gjykata nuk e ka aplikuar dhe arsyetuar fare këtë qëllim të dënimit të paraparë me udhëzues.

Zbatimi i parimeve

Gjykata në këtë rast vetëm ka cituar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, duke mos bërë asnjë ndërlidhje me parimet që duhet të merren parasysh me rastin e caktimit të dënimit, siç përcaktohet në udhëzues.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Sa i përket kalimit të kohës, gjykata nuk jep asnjë konsideratë në arsyetimin e këtij aktgjykimi. Ndërsa, sa i përket faktit se e dënuari për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, sipas udhëzuesit, kjo rrethanë kualifikohet tek rrethanat e tjera lehtësuese. Në udhëzues thuhet se nëse gjykata e konstaton mungesën e dënimeve të mëparshme penale dhe mund të jepet zbutja, do të kërkoj gjetje të fakteve që e mbështesin përfundimin e sjelljes përkatëse dhe predispozitat për rehabilitim. Kjo çështje nuk trajtohet fare në këtë aktgjykim. Tek pranimi i fajësisë, asnjë kërkesë e cila sipas udhëzuesit duhet të aplikohet me rastin e marrjes parasysh të kësaj rrethane, e cila përcakton edhe rëndësinë e kësaj rrethane në rastin konkret, nuk është marrë parasysh, si dhe gjykata nuk ka dhënë përgjigje në katër pyetjet që sipas udhëzuesit janë relevante në këtë rast. Për më tepër, gjykata në këtë aktgjykim ka deklaruar se kjo rrethanë ia ka mundësuar gjykatës që të aplikojë dispozitat e zbutjes, në atë mënyrë që të pandehurit ti dënojë nën minimumin e përcaktuar ligjor, ndonëse pranimi i fajësisë është bërë pasi ka filluar gjykimi. Lidhur me këtë situatë, udhëzuesi përcakton shprehimisht se “zbutja sipas nenit 75 nuk duhet të jetë më në dispozicion kur të filloj gjykimi”. Po ashtu,

gjykata ka marrë parasysh si rrethanë lehtësuese rrethanat personale për njërin nga të pandehurit, derisa për të njëjtin të pandehur, gjykata e ka cilësuar si rrethanë lehtësuese faktin se i njëjti është i martuar, baba i pesë fëmijëve dhe mbajtës i familjes. Përpos që asnjërën prej këtyre dy rrethanave gjykata nuk i ka arsyetuar sipas kërkesave të udhëzuesit, gjykata në këtë rast ka bërë dyfishim të rrethanave, për arsye se gjendja familjare e të pandehurit hynë në kuadër të rrethanës lehtësuese “rrethanat personale dhe karakteri i personit të dënuar”, dhe nuk paraqet rrethanë të veçantë.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruara nga aktgjykimi

Gjykata nuk ka marrë parasysh fare shkallën e pjesëmarrjes së personit në kryerjen e veprës penale, shkallën e dashjes, bashkëpunimi i përgjithshëm i personit me gjykatën, shkallën e dëmit të shkaktuar, pendimin/mungesën e pendimit nga i dënuari dhe (mos) keqardhjen e shfaqur.

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Gjykata në këtë rast nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me rëndësinë e brendshme të rrethanave dhe po ashtu, nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me peshimin e rrethanave. Për këtë arsye, llogaritja është kuantitative. Në rastin konkret, gjykata ka marrë parasysh pesë rrethana lehtësuese dhe asnjë rrethanë rënduese për të njërin të dënuar, derisa për të dënuarin e dytë gjykata ka marrë parasysh dy rrethana lehtësuese dhe asnjë rrethanë rënduese, që sipas udhëzuesit në të dy rastet bëhet fjalë për rastet kur kemi “ekzistimin e së paku dy rrethanave për zvogëlim të fajësisë apo dëmit dhe asnjë/ose një rrethanë të vogël rënduese”, që kualifikohet tek rrethanat që arsyetojnë zbutjen maksimale të dënimit brenda kufirit. Sa i përket veprës penale, furnizimi, transporti, prodhimi, këmbimi ose shitja e paautorizuar e armëve, sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 1, pika j, dënimi duhet të jetë nga një vit deri në katër vite burgim, që nënkupton se dënimi në këtë rast është brenda këtyre limiteve. Ndërsa, sa i përket veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve, sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 1, pika j, dënimi në këtë rast duhet të jetë nga një vit deri në katër vite burgim, që nënkupton se dënimi i shqiptuar nuk është brenda këtyre limiteve.

3. Rasti PKR.nr.30/18 - Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve nga neni 372 par.2 të KPRK, dhe Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 PAR.1 i KPRK

Aktgjykimi i marrë

Sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, - Departamenti për Krime të Rënda, të shpallur më 20 korrik 2018, të dënuarit M.D., A.K., D.P., D.M., ishin shpallur fajtorë për veprën penale “Trafikim me armë” dhe “Mbajtje në pronësi kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve”, pasi që gjykata kishte gjetur se të dënuarit M.D., A.K., D.P duke

vepruar si grup i organizuar kriminal, në krye me A.V. kundër të cilit procedura penale është duke u zhvilluar në SHBA, kishin kryer vepra të rënda penale, të trafikimit me armë.

Sipas aktgjykimit, gjatë muajit prill/maj 2017, në territorin e SHBA-ve, agjenti i policisë amerikane nga DEA (Drug Enforcement Administration), nën mbulim, kishte lidhur marrëveshje me A.V. për blerjen e 15 armëve automatike, kinse për narkobandat në Meksikë, më çmim prej 900 dollarë, dhe për këtë ia kishte paguar shumën prej 13.500 dollarë. Të akuzuarit A.K. dhe A.V., më 18 qershor 2017, pas marrëveshjes paraprake me oficerin e Policisë së Kosovës, i cili ishte duke e zbatuar masën e fshehtë të blerjes së stimuluar në koordinim me policinë amerikane, ishin takuar në restorantin “N”, në Klinë, dhe të njëjtit ia kishin dorëzuar oficerit policor 6 armë të gjata “AK 47” dhe një karikator të zbrazët për armë të gjata.

Ndërsa, më 27 qershor 2017, dyshohet se A.K. dhe D.P., në vendin e njëjtë, oficerit nën mbulim, ia kishin dorëzuar 8 pushka automatike “AK 47” me nga një karikator, një antitank të dorës me një projekttil 64 mm në të, si dhe 3 karikator të zbrazët, ndërsa i akuzuari M.D. e kishte mbikëqyrë nga restoranti, dhe disa qaste me vonë të gjithë ishin arrestuar.

Dënimi sipas KPRK-së për veprën penale “Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse: *Dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.*

Dënimi sipas KPRK për veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”: *Dënohet me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7.500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet.*

Dënimi i shqiptuar për veprën “Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse”:

M.D. është dënuar me burgim në kohëzgjatje prej 5 vite e 6 muaj dhe 7.000 euro gjobë;

A.K. është dënuar me burgim në kohëzgjatje prej 4 vite e 6 muaj dhe 5.000 euro gjobë;

D.P. është dënuar me burgim në kohëzgjatje prej 2 vite dhe 3.000 euro gjobë;

Dënimi i shqiptuar për veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”:

A.K. është dënuar me burgim në kohëzgjatje prej 1 viti;

D.M. është dënuar me gjobë në lartësi prej 4.000 euro gjobë;

Rrethanat lehtësuese:

Për të dënuarin D.M.:

1. Pranimi i fajësisë;
2. E kaluara jo kriminale;

Për të dënuarin D.P.:

1. E kaluara jo kriminale;
2. Pendimi;

Për të dënuarit M.D. dhe A.K.:

1. Ndjenjën e pendimit për veprën penale të kryer;

Rrethanat rënduese:

Për të dënuarit M.D. dhe A.K.:

1. Kanë të kaluar kriminale

Përshtatshmëria e dënimit:

Gjykata kishte vlerësuar se dënimet e shqiptuara janë adekuate dhe të drejta për secilin të akuzuar, me bindje se dënimet e tilla i përgjigjen peshës së veprave penale, sjelljes dhe shkallës së përgjegjësisë penale të secilit të akuzuar, dhe do të ndikoj në risocializimin e të njëjtëve, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Gjithashtu do të ndikoj tek të tjerët për në moskryerjen e veprave penale.

Zbatimi i udhëzuesit

Përshtatshmëria e dënimit

Gjykata në këtë aktgjykim ka cituar tre prej qëllimeve të dënimit dhe e ka marrë si të mirëqenë faktin se me shqiptimin e këtij dënimi, të njëjtat qëllime do të arrihen, mirëpo që asnjërin prej këtyre tre qëllimeve gjykata nuk i ka arsyetuar. Sa i përket qëllimit të katërt (viktimat dhe komuniteti) gjykata nuk e ka aplikuar dhe arsyetuar fare këtë qëllim të dënimit të paraparë me udhëzues.

Zbatimi i parimeve

Gjykata në këtë rast vetëm ka cituar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, duke mos bërë asnjë ndërlidhje me parimet që duhet të merren parasysh me rastin e caktimit të dënimit, siç përcaktohet në udhëzues.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Tek pranimi i fajësisë, asnjë kërkesë e cila sipas udhëzuesit duhet të aplikohet me rastin e marrjes parasysh të kësaj rrethane, e cila përcakton edhe rëndësinë e kësaj rrethane në rastin

konkret, nuk është marrë parasysh, si dhe gjykata nuk ka dhënë përgjigje në katër pyetjet që sipas udhëzuesit, janë relevante në këtë rast. Sa i përket dënimeve të mëparshme, sipas udhëzuesit, gjykata në këtë rast duhet të marrë parasysh pesë faktorë si dhe të japë përgjigje në gjashtë pyetjet relevante, gjë të cilën gjykata nuk e ka bërë në këtë aktgjykim. Sa i përket faktit se i dënuari për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, sipas udhëzuesit, kjo rrethanë kualifikohet tek rrethanat e tjera lehtësuese. Në udhëzues thuhet se nëse gjykata e konstaton mungesën e dënimeve të mëparshme penale dhe mund të jepet zbutja, do të kërkoj gjetje të fakteve që e mbështesin përfundimin e sjelljes përkatëse dhe predispozitat për rehabilitim. Kjo çështje nuk trajtohet fare në këtë aktgjykim. Sa i përket pendimit, sipas udhëzuesit, gjykata duhet të marrë parasysh dhe të arsyetojë tetë faktorët e përcaktuar në udhëzues, gjë që gjykata nuk e ka bërë në rastin konkret.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruara nga aktgjykimi

Gjykata nuk ka marrë parasysh fare shkallën e pjesëmarrjes së personit në kryerjen e veprës penale, shkallën e dashjes, bashkëpunimi i përgjithshëm i personit me gjykatën, shkallën e dëmit të shkaktuar, rrethanat personale dhe karakteri i personit të dënuar, sjelljen e personit të dënuar pas konfliktit dhe (mos) shkelja e urdhrave të gjykatës.

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Gjykata në këtë rast nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me rëndësinë e brendshme të rrethanave dhe po ashtu, nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me peshimin e rrethanave. Për këtë arsye, llogaritja është kuantitative. Në rastin konkret, sa i përket dy të dënuarve të parë, gjykata ka marrë parasysh nga dy rrethana lehtësuese dhe asnjë rrethanë rënduese, që sipas udhëzuesit bëhet fjalë për rastet kur kemi “Ekzistimi i së paku dy rrethanave për zvogëlim të fajësisë apo dëmit dhe asnjë/ose një rrethanë të vogël rënduese”, që kualifikohet tek rrethanat që arsyetojnë zbutjen maksimale të dënimit brenda kufirit. Në këtë drejtim, sa i përket të dënuarit për veprën për veprën “Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse”, sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 1, pika j, dënimi me burgim në këtë rast duhet të jetë nga një vit deri në katër vite burgim, derisa dënimi me gjobë duhet të jetë nga 100 euro deri në 6250 euro, që i bie se në rastin konkret, dënimi është brenda kufijve. Sa i përket të dënuarit të dytë, për veprën penale “mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, sipas shtojcës 1 të udhëzuesit dënimi me gjobë duhet të jetë nga 100 euro deri në 1000 euro dënim me gjobë. Në rastin konkret, gjoba e shqiptuar është jashtë këtyre limiteve. Ndërsa, sa i përket dy të dënuarve të tjerë, gjykata ka marrë për secilin prej tyre nga një rrethanë rënduese dhe nga një rrethanë lehtësuese, që sipas udhëzuesit kemi të bëjmë me rastet kur “Rrethanat rënduese dhe lehtësuese janë të barabarta dhe asnjëra nuk mbizotëron mbi tjetrën“, që kualifikohet tek kolona 7, përkatësisht tek pikënisja për matjen e dënimit. Sa i përket të dënuarit të parë në këtë pjesë, për veprën penale “importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse”, sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 1, pika j, dënimi me burgim në këtë rast duhet të jetë nga pesë vite burgim, derisa dënimi me gjobë duhet të jetë 12.500 euro, që i bie se në rastin konkret, dënimi i shqiptuar nuk është në përputhje me këtë përcaktim të udhëzuesit. Ndërsa,

sa i përket të dënuarit të dytë në këtë pjesë, për veprën për veprën “importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse”, sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 1, pika j, dënimi me burgim në këtë rast duhet të jetë pesë vite burgim, derisa dënimi me gjobë duhet të jetë 12.500 euro, që i bie se në rastin konkret, dënimi i shqiptuar nuk është në përputhje me këtë përcaktim të udhëzuesit. Ndërsa, sa i përket të dënuarit të njëjtit, për veprën penale “mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, sipas shtojcës 1 të udhëzuesit dënimi me gjobë duhet të jetë 3750 euro, që nënkupton se dënimi në këtë rast nuk ka qenë sipas këtij përcaktimi të udhëzuesit.

4. Rasti P.nr.266/08 – Furnizimi, Transporti, Prodhimi, Këmbimi ose Shitja e paautorizuar e armëve nga neni 327 par.2 lidhur me par.1 dhe lidhur me nenin 23 të KPK-së

Aktgjykimi i marrë

Sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë– Departamenti për Krime të Rënda, i dënuari A.A është shpallur fajtor për veprën penale “Furnizimi, Transporti, Prodhimi, Këmbimi ose Shitja e paautorizuar e armëve” pasi është provuar se i dënuari A.A më parë është furnizuar dhe ka transportuar një sasi të madhe armësh së bashku me të akuzuarin B.A dhe H.R, me qëllim të shitjes pa autorizim të tyre. Po ashtu, është provuar se i dënuari A.A me të akuzuarin B.A kanë biseduar me telefona celularë lidhur me shitjen e armëve të ndryshme, ndërsa më 1 gusht 2007, gjatë kontrollimit të shtëpisë së të akuzuarit B.A dhe H.R policia ka gjetur dhe konfiskuar armë të kalibrave të ndryshëm, përfshirë sasi të madha të fishekëve, karikatorëve, pushkëve të gjuetisë.

Dënimi sipas KPK-së për veprën penale “Furnizimi, Transporti, Prodhimi, Këmbimi ose Shitja e paautorizuar e armëve”:

Dënohet me burgim prej një (1) deri në (10) dhjetë vjet.

Dënimi i shqiptuar për veprën penale “Furnizimi, Transporti, Prodhimi, Këmbimi ose Shitja e paautorizuar e armëve”:

A.A është dënuar me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë muaj, i cili dënim me pëlqimin e tij mund të zëvendësohet në dënim me gjobë në shumën prej tre mijë euro.

Rrethanat lehtësuese:

1. Koha e gjatë nga koha e kryerjes së veprës penale;
2. Faktin se i dënuari është njeri familjar, baba i pesë fëmijëve dhe mbajtës i familjes;

3. Gjendjen e dobët ekonomike;

5. Sjelljen e tij para kryerjes dhe pas kryerjes së veprës penale, pasi që gjykata nuk ka të dhëna se i njëjti është gjykuar dhe dënuar për kryerjen e ndonjë veprë tjetër penale;

Rrethanat rënduese

Asnjë.

Përshtatshmëria e dënimit:

Duke i vlerësuar në këtë mënyrë rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, kjo gjykatë ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale së të dënuarve, intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura dhe për këtë veprë penale është e bindur se ky dënim është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore dhe shkallën e përgjegjësisë penale së të akuzuarit dhe si i tillë duhet të shërbejë si preventivë gjenerale, posaçërisht asaj individuale, tek forcimi i moralit të shoqërisë dhe respektimin e jetës së çdo qytetari siç përcaktohet me nenin 41 të KPRK-së.

Zbatimi i udhëzuesit

Përshtatshmëria e dënimit

Gjykata në këtë aktgjykim ka cituar tre prej qëllimeve të dënimit dhe e ka marrë si të mirëqenë faktin se me shqiptimin e këtij dënimi, të njëjtat qëllime do të arrihen, mirëpo që asnjërin prej këtyre qëllimeve gjykata nuk i ka arsyetuar. Sa i përket qëllimit të katërt (viktimat dhe komuniteti) gjykata nuk e ka aplikuar dhe arsyetuar fare këtë qëllim të dënimit të paraparë me udhëzues.

Zbatimi i parimeve

Gjykata në këtë rast vetëm ka cituar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, duke mos bërë asnjë ndërlidhje me parimet që duhet të merren parasysh me rastin e caktimit të dënimit, siç përcaktohet në udhëzues.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Sa i përket kalimit të kohës, gjykata nuk jep asnjë konsideratë në arsyetimin e këtij aktgjykimi. Sa i përket gjendjet familjare së të dënuarit, gjykata nuk i adreson të gjitha kërkesat e udhëzuesit në momentin kur këtë rrethanë e kualifikon si rrethanë lehtësuese. Sa i përket gjendjes ekonomike, gjykata nuk jep asnjë arsyetim. Por, gjendja ekonomike dhe gjendja familjare nuk janë dy rrethana të ndara dhe të veçanta, por që të dyja janë pjesë e rrethanave personale dhe familjare, që në kuptim të udhëzuesit, këtu kemi të bëjmë me dyfishim të rrethanave. Sa i përket faktit se i dënuari për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, sipas udhëzuesit, kjo rrethanë kualifikohet tek rrethanat e tjera lehtësuese. Në udhëzues thuhet se nëse gjykata e konstaton mungesën e dënimeve të mëparshme penale dhe mund të

jepet zbutja, do të kërkoj gjetje të fakteve që e mbështesin përfundimin e sjelljes përkatëse dhe predispozitat për rehabilitim. Kjo çështje nuk trajtohet fare në këtë aktgjykim.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruara nga aktgjykimi

Gjykata nuk ka marrë parasysh fare shkallën e dashjes, bashkëpunimi i përgjithshëm i personit me gjykatën, shkallën e dëmit të shkaktuar, pendimin/mungesën e pendimit nga i dënuari, (mos) keqardhjen e shfaqur dhe (mos) shkelja e urdhrave të gjykatës.

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Gjykata në këtë rast nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me rëndësinë e brendshme të rrethanave dhe po ashtu, nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me peshimin e rrethanave. Për këtë arsye, llogaritja është kuantitative. Në rastin konkret, gjykata ka marrë parasysh katër rrethana lehtësuese dhe asnjë rrethanë rënduese, që sipas udhëzuesit bëhet fjalë për rastet kur kemi “ekzistimin e së paku dy rrethanave për zvogëlim të fajësisë apo dëmit dhe asnjë/ose një rrethanë të vogël rënduese”, që kualifikohet tek rrethanat që arsyetojnë zbutjen maksimale të dënimit brenda kufirit. Sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 1, pika j, dënimi në këtë rast duhet të jetë nga një vit deri në katër vite burgim, që i bie se në rastin konkret, dënimi nuk është brenda këtyre kufijve, por është nën minimumin e përcaktuar ligjor. Sa i përket shqiptimit të dënimit nën minimumin e përcaktuar me ligj, e që bëhet në rastet e aplikimit sipas nenit 75, gjykata vetëm ka thënë se ka shkuar nën minimum, duke mos arsyetuar në asnjë rrethanë lehtësimin dhe arsyeshmërinë e zbatimit të kësaj norme, në kuptim të udhëzuesit.

X. Politika ndëshkimore në rastet e veprave penale të gjykuara në Departamentin e Përgjithshëm

a. Hyrje

Në mënyrë që në raport mos të trajtohen vetëm veprat e rënda penale të cilat gjykohen në Departamentet për Krime të rënda, IKD ka analizuar edhe aktgjykimet për rastet të cilat gjykohen në Departamentin e Përgjithshëm.

Në bazë të metodologjisë së përmendur në fillim të këtij raporti, IKD ka analizuar edhe këto 20 aktgjykime që kanë të bëjnë veprat penale të cilat gjykohen në departamentin e përgjithshëm, nëse në të njëjtat, gjyqtarët kanë zbatuar kërkesat dhe standardet e vendosura nga udhëzuesi, me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit. Këto 20 aktgjykime përfshijnë gjithsej 21 persona, derisa ndaj tyre janë shqiptuar 23 dënime.

Të gjeturat e IKD-së të prezantuara më poshtë, tregojnë se as në këto raste, udhëzuesi nuk ka gjetur as për së afërmi zbatueshmëri të mjaftueshme në praktikë. Në këto aktgjykime të gjeturat tregojnë për një ndërtim të një shablloni të arsytimi, si në kuptim të rrethanave lehtësuese dhe rënduese, po ashtu edhe në kuptim të qëllimeve të dënimit, derisa si e vdekur mbetet zbatueshmëria e parimeve të dënimit. Ajo çfarë e karakterizon këtë kapitull në raport me kapitujt e tjerë, është se në këto raste numri i rrethanave të njëjta të përsëritura në raste të ndryshme është jashtëzakonisht i madh, si dhe (mos) arsytimi është i njëjtë. Pra, si edhe në kapitujt e tjerë, nëse si pikë reference për një politikë të ligjshme ndëshkimore merret udhëzuesi, atëherë nënkuptojmë se politika ndëshkimore në sistemin gjyqësorë të Republikës së Kosovës, në rastet e gjykuara në Departamentin e Përgjithshëm, është hiq më pak se arbitrare.

Sa i përket arsytimit të aktgjykimeve mbi caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, gjithnjë duke marrë parasysh standardet e vendosura nga udhëzuesi, palët dhe publiku në asnjë rrethanë nuk mund të krijojnë bindjen se pse në rastin konkret është caktuar një dënim i tillë.

Në këtë mënyrë, ajo që ishte prezantuar si progres dhe hap konkret në drejtim të përmirësimit të politikës ndëshkimore brenda sistemit të drejtësisë në Republikën e Kosovës, e që është miratimi i udhëzuesit, nga të gjeturat e këtij raporti shihet edhe në veprat penale të cilat gjykohen në departamentin e përgjithshëm, ky udhëzues ka mbetur politikë në letër, i pazbatuar në praktikë.

b. Gjetjet e përgjithshme


20 aktgjykimet e analizuara në këtë kapitull janë për vepra të ndryshme penale, por të cilat aktgjykime janë marrë në Departamentin e Përgjithshëm. Këto aktgjykime përfshijnë veprat penale si më vijim:

Vepra penale	Numri i dënimeve
Trajtim i pandërgjegjshëm mjekësor	1
Vjedhje e rëndë	12
Vjedhje e rëndë në tentativë	1
Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armës	1
Sulm	1
Lëndim i lehtë trupor	2
Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale	1
Vjedhja e shërbimeve komunale	1
Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave	1
Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm	1
Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare	4
Mashtrim	2
Vjedhje pylli	2
Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge	2
Rrezikimi i trafikut publik	2

Tabela 32 – Numri i dënimeve sipas veprave penale.

Në këto 20 aktgjykime janë të përfshirë 21 persona, si dhe ndaj të njëjtëve janë shqiptuar gjithsej 33 dënime.

Prej këtyre 23 dënimeve, dominojnë dënimi me kusht dhe dënimi me burg, me nga nëntë raste secili, pasohet me dënimin me gjobë në shtatë raste ndërsa në një rast ka pasur vërejtje gjyqësore.




Grafika 50 – Llojet e dënimeve të shqiptuara.

Sa i përket lartësisë së dënimeve me burgim (efektiv dhe me kusht), në këtë kapitull vërehet se ka një laramani të dënimeve, derisa dënimi më i shpeshtë është tre muaj burgim me kusht.



Grafika 51 – Lartësia e dënimeve me burgim.

Laramani ka edhe sa i përket dënimeve me gjobë, por dënimi maksimal i këtij lloji është shqiptuar në lartësi prej 2000 eurove, derisa numri më i madh i këtij lloj dënimi është 200 euro gjobë, i shqiptuar në tre raste.



Grafika 52 – Lartësia e dënimeve me gjobë.

Në 20 aktgjykimet e analizuara në këtë kapitull janë aplikuar gjithsej 82 rrethana. Por, numri i rrethanave lehtësuese në raport me rrethanat rënduese të aplikuar në këto aktgjykime është në disproporcion të madh, pasi nga totali i rrethanave të aplikuar, 85% e tyre janë rrethana lehtësuese.



Grafika 53 – Numri total i rrethanave të përdorura në 20 aktgjykime.

Sa i përket rrethanave lehtësuese, gjykatat në këto aktgjykime kanë marrë nga një deri në shtatë rrethana lehtësuese, derisa në një rast nuk është marrë parasysh asnjë rrethanë lehtësuese.

Numri i rrethanave lehtësuese të aplikuara	Numri i rasteve
Asnjë rrethanë lehtësuese	0 raste
1 rrethanë e aplikuar	2 raste
2 rrethana të aplikuara	1 rast
3 rrethana të aplikuara	6 raste
4 rrethana të aplikuara	4 raste
5 rrethana të aplikuara	5 raste
7 rrethana të aplikuara	1 rast

Tabela 33 – Numri i rrethanave lehtësuese të aplikuara.

Por, përkundër numrit të madh të rrethanave rënduese që janë të parapara në KPRK dhe në udhëzues, në 13 prej këtyre aktgjykimeve IKD ka gjetur se nuk është përdorur asnjë rrethanë e vetme rënduese, derisa maksimumi i rrethanave rënduese të aplikuara është tre rrethana rënduese, të cilat janë marrë parasysh në vetëm një aktgjykim.

Numri i rrethana rënduese të aplikuara	Numri i rasteve
Asnjë rrethanë rënduese	13 raste
1 rrethanë e aplikuar	2 raste
2 rrethana të aplikuara	4 raste
3 rrethana të aplikuara	1 rast

Tabela 34 - Numri i rrethana rënduese të aplikuara.

Sa i përket llojeve të rrethanave të përdorura, pranimi i fajësisë, fakti se më parë i pandehuri nuk ka qenë i dënuar dhe sinqeriteti i treguar janë rrethanat të cilat më së shpeshti janë aplikuar në këto aktgjykime.

Lloji i rrethanës	Numri i rasteve në të cilat është aplikuar
Pranimi i fajësisë	14
Nuk ka qenë më parë i dënuar	12
Sinqeritetin e treguar gjatë shqyrtimit	9
Pendimi	5
Gjendja ekonomike	4
Premtimi se nuk do të kryej në të ardhmen vepra të tjera penale	4
Rrethanat në të cilat është kryer vepra penale	4
Është njeri familjar	3
Intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur	3
Sjellje e treguar gjatë shqyrtimit	3
Faktin se i dënuari është i pensionuar	2
Ka kaluar kohë e gjatë që nga kryerja e veprës penale	1
Vepra penale nuk është kryer nga dashja direkte por nga dashja eventuale	1
Fëmija ka mbetur me pasoja të përhershme	1
Baba i një fëmije	1
Dyshohet të jetë i përfshirë edhe në mbi 49 vepra penale që përfshijnë vjedhje e rëndë, posedim të substancave narkotike dhe armëve, kërcënime, sulm etj.	1

Vepra penale ka mbetur në tentativë	1
I dënuar edhe më parë	1
Ndihet keq për pasojën e shkaktuar	1
Është student	1
Është i angazhuar në punë të ndërtimitarisë për të mbajtur familjen	1
Kërkim faljen	1
Rrezikshmërinë e veprës penale	1
Të dënuarit janë në gjendje të mirë ekonomike dhe për kryerjen e kësaj vepre penale nuk kanë qenë të shtyrë nga shkaqet ekonomike	1
Vepra penale është kryer me dashje dhe këmbëngulësi	1
Mos shprehja e keqardhjes dhe pendesës	1
Aksidenti kishte ndodhur jo vetëm nga lëshimet e tij	1
Nuk e ka pranuar fajësinë	1
Nuk ka kërkuar falje për veprën penale	1

Tabela 35 – Llojet e rrethanave të aplikuara.

Në kuptim të zbatimit të udhëzuesit, të gjeturat e IKD-së thonë se sa i përket kësaj kategorie, udhëzuesi është i vdekur për nga zbatueshmëria, ndërsa aplikimi i rrethanave sipas kërkesave të udhëzuesit, në këto aktgjykime ka qenë përjashtim dhe jo rregull, pasi ka ndodhur në vetëm 2% të rasteve.



Grafika 54 - Aplikimi i rrethanave sipas kërkesave të udhëzuesit.

Prej rrethanave lehtësuese, 99% e rrethanave lehtësuese të aplikuara në këto aktgjykime, përkatësisht 68 rrethana, nuk janë aplikuar dhe arsyetuar sipas kërkesave të udhëzuesit.




Grafika 55 - Aplikimi dhe arsyetimi i rrethanave lehtësuese sipas kërkesave të udhëzuesit.

Situatë të njëjtë kemi edhe sa i përket rrethanave rënduese, pasi nga të gjitha rrethanat rënduese të aplikuara në këto aktgjykime, vetëm një rrethanë lehtësuese është bërë në përputhje me kërkesat e udhëzuesit, derisa 11 rrethanat e tjera lehtësuese nuk kanë respektuar përcaktimet e udhëzuesit.




Grafika 56 - Aplikimi dhe arsyetimi i rrethanave rëndësuese kërkesave të udhëzuesit.

Edhe më shqetësuese është fakti i injorimit të rrethanave, aspekt i cili edhe ndikon në mos pasjen e një pasqyre të drejtë mbi arsyeshmërinë e politikës ndëshkimore në Sistemin Gjyqësor të Republikës së Kosovës. Nga këto 20 aktgjykime të analizuara, nuk është asnjë rast në të cilin nuk është identifikuar asnjë rrethanë e injoruar, derisa numri më i vogël i rrethanave të injoruara është gjashtë rrethana, më i shpeshti është 10 rrethana në pesë raste, ndërsa në një rast, numri i rrethanave të injoruara është plot 19 rrethana.




Grafika 57 - Numri i rrethanave të injoruara.

Sa i përket dukurisë e cila sipas udhëzuesit cilësohet si dyfishim i rrethanave, kjo dukuri është jashtëzakonisht shumë e shprehur në aktgjykimet e analizuara në këtë kapitull. Nga të gjeturat e IKD-së rezulton se prej 20 aktgjykimeve të analizuara në këtë kapitull, në 14 prej tyre identifikohen rrethana të dyfishuara, ku në tre prej këtyre rasteve kemi nga dy dyfishime.




Grafika 58 – Dyfishimi i rrethanave.

Sa i përket përshtatshmërisë së dënimit, nga këto 20 aktgjykime, në tre prej tyre nuk ka fare arsyetim mbi përshtatshmërinë e dënimit të shqiptuar.




Grafika 59 - Përshtatshmëria e dënimit.

Për nga numri i qëllimeve të aplikuara, në këtë pjesë shihet se ka një numër më të madh të qëllimeve të aplikuara nga gjykatat në krahasim me kategoritë e tjera, në atë mënyrë që në 14 aktgjykime janë aplikuar nga tre prej katër qëllimeve të dënimit. Ndërsa, në vetëm një rast janë aplikuar të gjitha qëllimet e dënimit, derisa në tre raste nuk është aplikuar asnjë qëllim.




Grafika 60 - Numri i qëllimeve të dënimit të aplikuara në aktgjykime.



Grafika 61 - Llojet e qëllimeve të dënimit të aplikuara në aktgjykime.

Por, shqetësuese është fakti se nga të gjitha qëllimet e aplikuara në të gjitha aktgjykimet, vetëm në një rast qëllimi i dënimit është aplikuar dhe arsyetuar konform kërkesave të udhëzuesit, derisa në të gjitha rastet e tjera, qëllimet e dënimit vetëm janë cituar.



Grafika 62 - Aplikimi dhe arsyetimi i qëllimeve të dënimit sipas kërkesave të udhëzuesit.


Situatë të njëjta kemi edhe sa i përket zbatimit të parimeve të dënimit. Në të gjitha aktgjykimet e analizuar në këtë kapitull, në vetëm dy raste apo në 10 % të rasteve parimet janë zbatuar vetëm pjesërisht, derisa në asnjë rast parimet e dënimit nuk janë zbatuar plotësisht. Në 18 aktgjykime, apo në 90% të aktgjykimeve të analizuar, parimet e dënimit nuk janë zbatuar sipas kërkesave të udhëzuesit.



Grafika 63 – Zbatimi i parimeve.

Ndërsa, sa i përket limiteve të dënimit të përcaktuara në shtojcën e udhëzuesit, këto limite nuk janë respektuar në 35 % të dënimeve të shqiptuara në këto aktgjykime.

Kufinjë e dënimeve



Grafika 64 - Kufinjë e dënimeve.

c. **Analizë e veçantë e rasteve të veprave penale të gjykuara në Departamentin e Përgjithshëm**

1. Rasti P.nr.3674/16 - Trajtim i pandërgjegjshëm mjekësor 219 par.4 lidhur me par.1 të KPK-së

Aktgjykimi i marrë

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, më 17 prill 2019 kishte shpallur fajtor të dënuarin H.D, pasi që kishte gjetur se i njëjti më 13 korrik 2009 në QKUK-në Klinikën Obsterike-Gjinekologjike në Prishtinë, gjatë mjekimit ka përdorur një metodë të papërshtatshme të lindjes së të porsalindurit T.G, duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore ne regjionin e kokës duke e dëmtuar rëndë shëndetin e fëmijës, të cilat janë konstatuar më vonë gjatë kontrollit pasi që me rastin e lëshimit të fëmijës nuk është lëshuar fletë lëshim.

Dënimi sipas KPRK-së: *prej një (1) deri në tetë (8) vite burgim*

Dënimi i shqiptuar: *një (1) vit burg me kusht*

Rrethanat lehtësuese:

1. Faktin se i dënuari është doktor i pensionuar;
2. Nuk ka qenë më parë i dënuar;
3. Është njeri familjar;
4. Ka kaluar kohë e gjatë që nga kryerja e veprës penale;
5. Vepra penale nuk është kryer nga dashja direkte por nga dashja eventuale;

Rrethanat rënduese:

1. Fëmija ka mbetur me pasoja të përhershme

Përshtatshmëria e dënimit:

Gjykata ka vlerësuar me bindje të plotë se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit ne kryerjen e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tij, parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tij, të parandaloj personat të tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Zbatimi i udhëzuesit

Përshtatshmëria e dënimit

Gjykata në këtë aktgjykim ka cituar tre prej qëllimeve të dënimit dhe e ka marrë si të mirëqenë faktin se me shqiptimin e këtij dënimi, të njëjtat qëllime do të arrihen në atë mënyrë që asnjërin prej këtyre tre qëllimeve gjykata nuk e ka arsyetuar. Sa i përket qëllimit të katërt (viktimat dhe komuniteti) gjykata nuk e ka aplikuar dhe arsyetuar fare këtë qëllim të dënimit të paraparë me udhëzues.

Zbatimi i parimeve

Gjykata në këtë rast vetëm ka cituar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, duke mos bërë asnjë ndërlidhje me parimet që duhet të merren parasysh me rastin e caktimit të dënimit, siç përcaktohet në udhëzues.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Faktin se i dënuari është doktor në pension, udhëzuesi nuk e parasheh si rrethanë lehtësuese. Por, nëse gjykata i është referuar moshës së të pandehurit në rastin konkret, sipas udhëzuesit janë gjithsej nëntë pyetje relevante që gjykata duhet ti marrë parasysh dhe tu jap përgjigje në aktgjykim, gjë që gjykata nuk e ka bërë në këtë rast. Sa i përket faktit se i dënuari për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, sipas udhëzuesit, kjo rrethanë kualifikohet tek rrethanat e tjera lehtësuese. Në udhëzues thuhet se nëse gjykata e konstaton mungesën e dënimeve të mëparshme penale dhe mund të jepet zbutja, do të kërkojë gjetje të fakteve që e mbështesin përfundimin e sjelljes përkatëse dhe predispozitat për rehabilitim. Kjo çështje nuk trajtohet fare në këtë aktgjykim. Sa i përket rrethanës lehtësuese se i akuzuari është familjar, udhëzuesi përcakton shtatë faktorë në të cilët gjykata duhet të bazohet në rastin kur këtë rrethanë e përcakton si rrethanë lehtësuese dhe të njëjtit faktorë duhet ti arsyetojë, gjë të cilën nuk e ka bërë gjykata në këtë aktgjykim. Sa i përket kalimit të kohës, gjykata e merr në konsideratë faktin se që nga ajo kohë e deri tash, i pandehuri nuk ka kryer vepër tjetër penale. Gjykata ka dhënë një arsyetim modest edhe sa i përket shkallës së dashjes. Sa i përket lëndimit me pasoja të përhershme së të miturit, gjykata në këtë rast është dashur që në aktgjykim të japë përgjigje ndaj nëntë pyetjeve relevante sipas udhëzuesit, gjë që gjykata nuk e ka bërë në këtë rast. Por, vetë lëndimi i shkaktuar, është element i veprës penale për të cilën i pandehuri është dënuar, kështu që sipas udhëzuesit, në rastin konkret kemi të bëjmë me dyfishim të rrethanave.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruara nga aktgjykimi

Janë një sërë rrethanash, si lehtësuese ashtu edhe rënduese, të cilat gjykata nuk i ka marrë për bazë në këtë arsyetim, e madje as nuk ka dhënë arsyetim se pse të njëjtat nuk janë marrë parasysh. Gjykata nuk ka marrë fare parasysh nëse vepra penale përfshin disa viktima, nëse viktima e veprës penale ka qenë posaçërisht e pambrojtur apo e ndjeshme, moshë e viktimës, (mos) provokimin nga viktima, bashkëpunimi i përgjithshëm i personit me gjykatën, pendimin/mungesën e pendimit nga i dënuari, (mos) keqardhjen e shfaqur, (mos) kompensimi

i dëmit të shkaktuar, (mos) shkelja e urdhrave të gjykatës, dhe (mos) mbështetja pala e dëmtuar.

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Gjykata në këtë rast nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me rëndësinë e brendshme të rrethanave dhe po ashtu, nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me peshimin e rrethanave. Për këtë arsye, llogaritja është kuantitative. Në rastin konkret, gjykata ka marrë parasysh pesë rrethana lehtësuese dhe një rrethanë rënduese, që sipas udhëzuesit, bëhet fjalë për rastet kur ka “rrethana lehtësuese të kombinuara në përgjithësi (të cilit do lloj) në sasi shumë më të madhe se sa rrethanat rënduese”, që kualifikohet tek rrethanat që arsyetojnë zbutjen maksimale të dënimit brenda kufirit. Sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 3, pika h, dënimi në këtë rast duhet të jetë nga një vit deri në 3 vite burgim, që i bie se në rastin konkret, dënimi është brenda kufijve.

2. Rasti P.nr.1/19 - Vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 i KPRK-së

Aktgjykimi i marrë

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, më 7 mars 2019, kishte shpallur fajtor, të dënuarin H.H, pasi që kishte gjetur se më 24 shtator 2018, në rr. “Dardania”, i dënuari së bashku me F.A i cili gjendet në arrati, duke përdorur forcën me mjet të përshtatshëm kanë hapur banesën e të dëmtuarit P.N dhe nga aty kanë vjedhur stoli ari në vlerë 1350 euro, një laptop me çantë dhe pajisje përcjellëse të gjitha në vlerë 250 euro.

Gjithashtu, i dënuari ishte shpallur fajtor sepse më 2 tetor 2018, së bashku me të akuzuarin tjetër kishin hyrë në banesën e të dëmtuarës D.M, nga ku edhe kishin vjedhur një kuti me të holla kursimesh.

Po ashtu, H.H ishte shpallur fajtor pasi që gjykata kishte gjetur se më 7 mars 2016, në rrugën “Dardania”, i dënuari në bashkëveprim me F.A i cili gjendet në arrati është afruar te ndërtesa me automjetin “Renault”, dhe duke përdorur forcë me mjet të përshtatshëm kanë hapur banesën e të dëmtuarit B.I dhe nga aty kanë vjedhur një laptop me çantë krahu në vlerë 200 euro.

Dënimi sipas KPRK-së: *dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në shtatë (7) vjet.*

Dënimi i shqiptuar:

Për veprën 1: *dy (2) vjet burgim dhe dënim me gjobë 1500 euro;*

Për veprën 2: *një (1) vjet e gjashtë (6) muaj burgim dhe 1.000 euro gjobë;*

Për veprën 3: *dy (2) vjet burgim dhe dënim me gjobë 1500 euro;*

Rrethanat lehtësuese:

1. Pranimi i fajësisë për një veprë penale për të cilën është penduar;
2. Gjendja ekonomike - i papunë;
3. Baba i një fëmije;
4. Premtimi se nuk do të kryej në të ardhmen vepra të tjera penale;

Rrethanat rënduese

1. Dyshohet të jetë i përfshirë edhe në mbi 49 vepra penale që përfshijnë vjedhje e rëndë, posedim të substancave narkotike dhe armëve, kërcënime, sulm etj.

Përshtatshmëria e dënimit:

Gjykata vlerësoi se dënimi i shqiptuar është proporcional me rëndësinë e veprës penale, sjelljen dhe rrethanat e kryerësit, shkallën e rrezikut social dhe përgjegjësinë e tij penale.

Po ashtu, gjykata vlerësoi se sanksioni ndaj të dënuarit do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e tij, po ashtu do të ndikoj tek të tjerët që të mos kryejnë vepra të tjera penale, çka edhe është qëllimi i dënimit.

Zbatimi i udhëzuesit

Përshtatshmëria e dënimit

Gjykata në këtë aktgjykim ka cituar dy prej qëllimeve të dënimit dhe e ka marrë si të mirëqenë faktin se me shqiptimin e këtij dënimi, të njëjtat qëllime do të arrihen, mirëpo asnjërin prej këtyre dy qëllimeve gjykata nuk e ka arsyetuar. Sa i përket qëllimit të katërt (gjykimi shoqëror, ngritja e moralit dhe forcimi i detyrimit për respektimin e ligjit dhe viktimat dhe komuniteti) gjykata nuk e ka aplikuar dhe arsyetuar fare këtë qëllim të dënimit të paraparë me udhëzues.

Zbatimi i parimeve

Gjykata në këtë rast vetëm ka cituar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, duke mos bërë asnjë ndërlidhje me parimet që duhet të merren parasysh me rastin e caktimit të dënimit, siç përcaktohet në udhëzues.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Tek pranimi i fajësisë, asnjë kërkesë e cila sipas udhëzuesit duhet të aplikohet me rastin e marrjes parasysh të kësaj rrethane, e cila përcakton edhe rëndësinë e kësaj rrethane në rastin konkret, nuk është marrë parasysh, si dhe gjykata nuk ka dhënë përgjigje në katër pyetjet që sipas udhëzuesit, janë relevante në këtë rast. Por, gjykata në këtë rast është kujdesur që të mos bëjë dyfishim të rrethanave, në atë mënyrë që edhe pendimin në këtë rast ta cilësojë si rrethanë të veçantë lehtësuese. Sa i përket faktit se i dënuari është person i varfër, gjykata nuk e ka mbështetur me asnjë arsyetim, por vetëm e ka cituar. Sa i përket faktit se i dënuari është familjar, gjykata në këtë rast vetëm ka cekur numrin e fëmijëve, duke i anashkaluar gjashtë faktorët e tjerë të cilët i përcakton udhëzuesi. Për më tepër, me vetë faktin se gjendja sociale dhe familjare janë marrë si dy rrethana të ndara lehtësuese, këtu sipas udhëzuesit kemi të bëjmë me dyfishim të rrethanave, pasi të njëjtat nuk paraqesin rrethana të veçanta lehtësuese, por janë faktorë përmes të cilëve vërtetohet rrethana lehtësuese “rrethanat personale dhe karakteri i personit të dënuar”. Premtimi se në të ardhmen nuk do të kryejë vepër tjetër penale, në udhëzues nuk përmendet fare si rrethanë lehtësuese. Ndërsa, sa i përket faktit se i pandehuri është dyshuar edhe për 49 vepra të tjera penale, kjo sipas udhëzuesit fare nuk mund të përcaktohet si rrethanë rënduese. Për gjykatën, relevante duhet të jenë dënimet e mëparshme. Ndërsa, sa i përket dënimeve të mëparshme, sipas udhëzuesit, gjykata në këtë rast duhet të marrë parasysh pesë faktorë si dhe të japë përgjigje në gjashtë pyetjet relevante, gjë të cilën gjykata nuk e ka bërë në këtë aktgjykim.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruar nga aktgjykimi

Janë një sërë rrethanash, si lehtësuese ashtu edhe rënduese, të cilat gjykata nuk i ka marrë për bazë në këtë arsyetim, e madje as nuk ka dhënë arsyetim se pse të njëjtat nuk janë marrë parasysh. Gjukata nuk ka marrë parasysh fare shkallën e dashjes, praninë e dhunës apo kanosjes në kryerjen e veprës penale, nëse vepra penale është kryer në mënyrë posaçërisht mizore, nëse vepra penale përfshin disa viktime, nëse viktime e veprës penale ka qenë posaçërisht e pambrojtur apo e ndjeshme, mosha e viktimës, (mos) provokimin nga viktime, mosha e të pandehurit, bashkëpunimi i përgjithshëm i personit me gjykatën, shkallën e dëmit të shkaktuar, (mos) keqardhjen e shfaqur, (mos) kompensimi i dëmit të shkaktuar, sjelljen e personit të dënuar pas konfliktit, (mos) shkelja e urdhrave të gjykatës, dhe (mos) mbështetja pala e dëmtuar.

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Gjukata në këtë rast nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me rëndësinë e brendshme të rrethanave dhe po ashtu, nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me peshimin e rrethanave. Për këtë arsye, llogaritja është kuantitative. Në rastin konkret, sa i përket veprës 1 dhe 3, gjykata ka marrë parasysh tri rrethana lehtësuese dhe një rrethanë rënduese, ndërsa sa i përket veprës 2, gjykata ka marrë parasysh katër rrethana lehtësuese dhe një rënduese. Sipas udhëzuesit, në të dy rastet bëhet fjalë për rastet kur kemi “ekzistimin e së paku dy rrethanave për zvogëlim të fajësisë apo dëmit dhe asnjë/ose një rrethanë të vogël rënduese”, që kualifikohet tek rrethanat që arsyetojnë zbutjen maksimale të dënimit brenda kufirit. Sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 5, pika c, dënimi në këtë rast duhet të jetë nga tre vjet deri katër vjet

burgim, që i bie se në rastin konkret, dënimi nuk është brenda kufijve për asnjë prej dënimeve të shqiptuara.

3. Rasti P.nr.816/18 - Sulm 187 par.3 i KPRK-së

Aktgjykimi i marrë

Sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, A.B ishte shpallur fajtor për veprën penale “Sulm” pasi që i njëjti më 13 dhjetor 2017, rreth orës 12:00 në Prishtinë, në rrugën “Kaçaniku” në shtëpinë e tij, pas një mosmarrëveshje me të dëmtuarën, nënën e tij, S.B kishte filluar ta sulmoj duke e goditur në fytyrë dhe në dorë.

Dënimi sipas KPRK-së: *dënim me burg gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet*

Dënimi i shqiptuar: *dënim gjashtë (6) muaj burgim me kusht*

Rrethanat lehtësuese:

1. I dënuari ka pranuar fajësinë;
2. Intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur;
3. Sinqeritetin e treguar gjatë shqyrtimit;
4. Rrethanat në të cilat është kryer vepra penale;
6. Për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin dhe nuk ka qenë i dënuar më parë;

Rrethanat rënduese

Asnjë

Përshtatshmëria e dënimit:

Gjykata ka vlerësuar se dënimi me kusht, në lartësi prej gjashtë muaj i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale për të cilën është shpallur fajtor. Sipas gjykatës, me anë të këtij dënimi, do të parandalohet kryerësi i kësaj vepre penale por edhe kryerësit e tjerë që në të ardhmen mos të kryejnë veprime të tilla si dhe ky dënim do të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Zbatimi i udhëzuesit

Përshtatshmëria e dënimit

Gjykata në këtë aktgjykim ka cituar tre prej qëllimeve të dënimit dhe e ka marrë si të mirëqenë faktin se me shqiptimin e këtij dënimi, të njëjtat qëllime do të arrihen, mirëpo asnjërin prej këtyre tre qëllimeve gjykata nuk e ka arsyetuar. Sa i përket qëllimit të katërt

(viktimat dhe komuniteti) gjykata nuk e ka aplikuar dhe arsyetuar fare këtë qëllim të dënimit të paraparë me udhëzues.

Zbatimi i parimeve

Gjykata në këtë rast vetëm ka cituar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, duke mos bërë asnjë ndërlidhje me parimet që duhet të merren parasysh me rastin e caktimit të dënimit, siç përcaktohet në udhëzues.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Tek pranimi i fajësisë, asnjë kërkesë e cila sipas udhëzuesit duhet të aplikohet me rastin e marrjes parasysh të kësaj rrethane, e cila përcakton edhe rëndësinë e kësaj rrethane në rastin konkret, nuk është marrë parasysh, si dhe gjykata nuk ka dhënë përgjigje në katër pyetjet që sipas udhëzuesit, janë relevante në këtë rast. Sa i përket intensitetit të rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, sipas udhëzuesit, këto nuk paraqesin rrethana të veçanta lehtësuese, por janë parime të dënimit, të cilat duhet të arsyetohen me rrethana të tjera të veçanta. Për këtë arsye, sipas udhëzuesit, këtu kemi të bëjmë me dy dyfishime të rrethanave. Sa i përket sinqeritetit të treguar, kjo në udhëzues nuk përmendet fare si rrethanë, ndërsa gjykata nuk ka dhënë asnjë arsyetim se pse ky fakt duhet të shërbejë si rrethanë lehtësuese. Sa i përket faktit se i dënuari për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, sipas udhëzuesit, kjo rrethanë kualifikohet tek rrethanat e tjera lehtësuese. Në udhëzues thuhet se nëse gjykata e konstaton mungesën e dënimeve të mëparshme penale dhe mund të jepet zbutja, do të kërkoj gjetje të fakteve që e mbështesin përfundimin e sjelljes përkatëse dhe predispozitat për rehabilitim. Kjo çështje nuk trajtohet fare në këtë aktgjykim.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruara nga aktgjykimi

Janë një sërë rrethanash, si lehtësuese ashtu edhe rënduese, të cilat gjykata nuk i ka marrë për bazë në këtë arsyetim, e madje as nuk ka dhënë arsyetim se pse të njëjtat nuk janë marrë parasysh. Gjykata nuk ka marrë parasysh fare shkallën e dashjes, praninë e dhunës apo kanosjes në kryerjen e veprës penale, nëse vepra penale është kryer në mënyrë posaçërisht mizore, nëse vepra penale përfshin disa viktima, nëse viktima e veprës penale ka qenë posaçërisht e pambrojtur apo e ndjeshme, moshja e viktimës, (mos) provokimin nga viktima, moshja e të pandehurit, bashkëpunimi i përgjithshëm i personit me gjykatën, shkallën e dëmit të shkaktuar, rrethanat personale dhe karakteri i personit të dënuar, pendimin/mungesën e pendimit nga i dënuari, (mos) keqardhjen e shfaqur, (mos) kompensimi i dëmit të shkaktuar, sjelljen e personit të dënuar pas konfliktit, (mos) shkelja e urdhrave të gjykatës, kalimin e kohës dhe (mos) mbështetja pala e dëmtuar.

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Gjykata në këtë rast nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me rëndësinë e brendshme të rrethanave dhe po ashtu, nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me peshimin e rrethanave. Për këtë arsye, llogaritja është kuantitative. Në rastin konkret, gjykata ka marrë parasysh pesë rrethana lehtësuese dhe asnjë rrethanë rënduese, që sipas udhëzuesit bëhet fjalë për rastet kur

ka “rrethana lehtësuese të kombinuara në përgjithësi (të cilit do lloj) në sasi shumë më të madhe se sa rrethanat rënduese”, që kualifikohet tek rrethanat që arsyetojnë zbutjen maksimale të dënimit brenda kufirit. Sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 2, pika f, dënimi në këtë rast duhet të jetë nga gjashtë muaj deri në një vit burgim, që i bie se në rastin konkret, dënimi është brenda kufijve.

4. Rasti P.nr.962/16 - Vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 i KPRK

Aktgjykimi i marrë

Sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, të shpallur më 25 mars 2019, Z.V. ishte shpallur fajtor për veprën penale “Vjedhja e shërbimeve komunale”, pasi që ishte vërtetuar se i dënuari prej datës së pavërtetuar deri më 28 korrik 2015 në shtëpinë e tij në Obiliq, me qëllim që vetës ti sjell dobi pasurore të kundërligjshme kishte vjedhur energjinë elektrike nga KEDS, duke bërë kyçje pa njehsor elektrik.

Dënimi sipas KPRK-së: *gjobë ose burgim deri në tre (3) vjet*

Dënimi i shqiptuar: *katër (4) muaj burg me kusht me periudhën verifikuese një (1) vit.*

Rrethanat lehtësuese:

1. I dënuari nuk ka qenë i dënuar më parë;
2. Është në moshë të shtyrë;
3. Ka gjendje të vështirë ekonomike;

Rrethanat rënduese:

Asnjë

Përshtatshmëria e dënimit:

Gjykata ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale. Sipas gjykatës, me anë të këtij dënimi do të arrihet qëllimi i dënimit që kryerësi e kësaj vepre penale dhe personat e tjerë të parandalohen nga kryerja e veprimeve të tilla në të ardhmen. Po ashtu, sipas gjykatës, ky dënim do të ndikojë në kompensimin e palës së dëmtuar për humbjet apo dëmet e shkaktuara si dhe do të ndikojë në shprehjen e gjykimit shoqëror në raport me veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit në shoqëri.

Zbatimi i udhëzuesit

4.2.1 Përshtatshmëria e dënimit

Gjykata në këtë aktgjykim ka citur të gjitha qëllimet e dënimit dhe e ka marrë si të mirëqenë faktin se me shqiptimin e këtij dënimi, të njëjtat qëllime do të arrihen, mirëpo asnjërin prej këtyre qëllimeve gjykata nuk e ka arsyetuar.

Zbatimi i parimeve

Gjykata në këtë rast vetëm ka cituar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, duke mos bërë asnjë ndërlidhje me parimet që duhet të merren parasysh me rastin e caktimit të dënimit, siç përcaktohet në udhëzues.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Sa i përket faktit se i dënuari për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, sipas udhëzuesit, kjo rrethanë kualifikohet tek rrethanat e tjera lehtësuese. Në udhëzues thuhet se nëse gjykata e konstaton mungesën e dënimeve të mëparshme penale dhe mund të jepet zbutja, do të kërkoj gjetje të fakteve që e mbështesin përfundimin e sjelljes përkatëse dhe predispozitat për rehabilitim. Kjo çështje nuk trajtohet fare në këtë aktgjykim. Sa i përket moshës së të pandehurit, gjykata ka marrë parasysh vetëm atë se i dënuari është i moshës së shtyrë, derisa ka anashkaluar tetë pyetjet e tjera relevante të cilave sipas udhëzuesit, gjykata duhet tu japë përgjigje në këtë rast. Sa i përket gjendjes së vështirë ekonomike, edhe këtë rrethanë gjykata vetëm e ka cituar, duke mos dhënë asnjë arsyetim.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruar nga aktgjykimi

Janë një sërë rrethanash, si lehtësuese ashtu edhe rënduese, të cilat gjykata nuk i ka marrë për bazë në këtë arsyetim, e madje as nuk ka dhënë arsyetim se pse të njëjtat nuk janë marrë parasysh. Gjykata nuk ka marrë parasysh fare, shkallën e dashjes, bashkëpunimi i përgjithshëm i personit me gjykatën, shkallën e dëmit të shkaktuar, pendimin/mungesën e pendimit nga i dënuari, (mos) keqardhjen e shfaqur, (mos) kompensimi i dëmit të shkaktuar, sjelljen e personit të dënuar pas konfliktit, (mos) shkelja e urdhrave të gjykatës dhe (mos) mbështetja pala e dëmtuar.

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Gjykata në këtë rast nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me rëndësinë e brendshme të rrethanave dhe po ashtu, nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me peshimin e rrethanave. Për këtë arsye, llogaritja është kuantitative. Në rastin konkret, gjykata ka marrë parasysh tri rrethana lehtësuese dhe një rrethanë rënduese, që sipas udhëzuesit bëhet fjalë për rastet kur kemi "Ekzistimin e së paku dy rrethanave për zvogëlim të fajësisë apo dëmit dhe asnjë/ose një rrethanë të vogël rënduese ", që kualifikohet tek rrethanat që arsyetojnë zbutjen maksimale të dënimit brenda kufirit. Sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 1, pika f, dënimi në këtë rast duhet të jetë nga një muaj deri në tetë muaj burgim, që i bie se në rastin konkret, dënimi është brenda kufijve.

5. Rasti P.nr.1305/16 - Blerja pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par.2 i KPRK-së

Aktgjykimi i marrë

Sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, të shpallur më 31 janar 2019, i dënuari A.R., ishte shpallur fajtor për veprën penale “Blerja pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale”. Kjo pasi që sipas aktgjykimit, më 9 korrik 2015, në Prishtinë, të dëmtuarit F.M. persona të panjohur ia kanë vjedhur telefonin “Iphone 4” dhe “Iphone 6 +”. Kjo sipas gjykatës i dënuari e ka ditur apo mund ta ketë ditur se telefoni “Iphone 6+” është përfituar me kryerjen e veprës penale.

Dënimi sipas KPRK-së: *dënohet me burgim deri në një (1) vit.*

Dënimi i shqiptuar: *vërejtje gjyqësore*

Rrethanat lehtësuese:

1. I dënuari ka pranuar fajësinë;
2. Ka pasur sjellje të mirë gjatë seancës;
3. I dënuari është penduar;

Rrethanat rënduese

Asnjë

Përshtatshmëria e dënimit:

Gjykata ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar është i drejtë dhe i ligjshëm, e në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale së të akuzuarit, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur dhe se me anë të këtij dënimi do të arrihet qëllimi i dënimit.

Zbatimi i udhëzuesit

Përshtatshmëria e dënimit

Në këtë aktgjykim, gjykata nuk i referohet dhe nuk e arsyeton asnjë prej katër qëllimeve të dënimit të cilët sipas udhëzuesit duhet të merren parasysh dhe të arsyetohen në çdo aktgjykim.

Zbatimi i parimeve

Gjykata në këtë rast vetëm ka cituar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, duke mos bërë asnjë ndërlidhje me parimet që duhet të merren parasysh me rastin e caktimit të dënimit, siç përcaktohet në udhëzues.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Sa i përket pranimit të fajësisë, sipas udhëzuesit janë gjithsej katër pyetje relevante të cilave Gjykata duhet tu japë përgjigje në aktgjykim, gjë që në arsyetimin e këtij aktgjykimi nuk përmendet asnjë. Kështu ka vepruar gjykata edhe përballë tetë faktorëve që kërkohen sa i përket rrethanës së pendimit. Në këtë mënyrë, përderisa gjykata nuk i ka sqaruar këto dy rrethana me fakte dhe prova të caktuara, sipas udhëzuesit, bëhet fjalë për dyfishim të rrethanave. Lidhur me sjelljen korrekte së të pandehurit gjatë procedurës, sipas udhëzuesit, gjykata duhet tu japë përgjigje gjithsej pesë pyetjeve, gjë të cilën gjykata nuk e ka bërë në këtë aktgjykim.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruara nga aktgjykimi

Gjykata nuk ka marrë parasysh fare shkallën e dashjes, moshën e të pandehurit, shkallën e dëmit të shkaktuar, rrethanat personale dhe karakteri i personit të dënuar, (mos) keqardhjen e shfaqur, (mos) kompensimi i dëmit të shkaktuar, sjelljen e personit të dënuar pas konfliktit, e kaluara kriminale/jo kriminale e të dënuarve, kalimin e kohës dhe (mos) mbështetja pala e dëmtuar.

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Gjykata në këtë rast nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me rëndësinë e brendshme të rrethanave dhe po ashtu, nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me peshimin e rrethanave. Për këtë arsye, llogaritja është kuantitative. Në rastin konkret, gjykata ka marrë parasysh tri rrethana lehtësuese dhe një rrethanë rënduese, që sipas udhëzuesit bëhet fjalë për rastet kur kemi “ekzistimin e së paku dy rrethanave për zvogëlim të fajësisë apo dëmit dhe asnjë/ose një rrethanë të vogël rënduese”, që kualifikohet tek rrethanat që arsyetojnë zbutjen maksimale të dënimit brenda kufirit. Sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 1, pika d, dënimi në këtë rast duhet të jetë nga një muaj deri në katër muaj burgim. Në rastin konkret, gjykata ka shqiptuar vërejtje gjyqësore. Sipas nenit 86, paragrafi 5 i KPRK, gjykata “Me rastin e vendosjes për shqiptimin e vërejtjes gjyqësore, gjykata veçanërisht merr parasysh qëllimin e vërejtjes gjyqësore, sjelljen e kryesit në të kaluarën, sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale, rrethanat e tjera në të cilat është kryer vepra penale dhe pjesëmarrjen vullnetare të kryesit në programin e trajtimit”. Për të gjitha këto, gjykata nuk ka dhënë asnjë arsyetim. Për këtë arsye, të zbatueshme janë kriteret e sipërpërmendura të udhëzuesit, që i bie se dënimi në këtë rast nuk është shqiptuar brenda këtyre kufijve.

6. Rasti P.nr.1439/13 - Vjedhje e rëndë në tentativë nga neni 253 par. 1, pika 1, lidhur me nenin 20 të KPK-së.

Aktgjykimi i marrë

Sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, të shpallur më 24 gusht 2018, i dënuari A.O ishte shpallur fajtor për veprën penale “Vjedhje e rëndë në tentativë”. Kjo pasi që sipas aktgjykimit, më 18 korrik 2011, në kohën e pavërtetuar, në P., në rrugën “H.P.”, në lokalit e këpucëve “A.”, me qëllim që vetës t’i sjell dobi pasurore të kundërligjshme, me përdorimin e forcës, ka hapur dritaren e katit përdhes të shtëpisë, pronë e të dëmtuarit L.T., ka depërtuar brenda, dyert e dhomave i ka hapur me forcë, mirëpo vepra ka mbetur në tentativë sepse nuk ka arritur të marrë asgjë pasi që nuk ka gjetur gjëra me vlerë, mirëpo të dëmtuarit i ka shkaktuar dëme materiale sepse derisa ka kërkuar gjësendet me vlerë për ti marr, ka demoluar në dy katet e shtëpisë, e pastaj ka ik nga vendi i ngjarjes,

Dënimi sipas KPRK-së: *dënohet me burgim prej gjashtë (6) muajve deri në pesë (5) vjet*

Dënimi i shqiptuar: *tetë (8) muaj burgim*

Rrethanat lehtësuese:

1. I dënuari e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar;
2. Është penduar për veprën e kryer;
3. Ka premtuar se nuk do të përsëris më vepra penale;
4. Vepra penale ka mbetur në tentativë;

Rrethanat rënduese:

1. I dënuari edhe më parë ka kryer vepër të njëjtë penale;

Përshtatshmëria e dënimit:

Gjykata është e bindur se dënimi i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e kryesve, si dhe do të ndikoj tek i njëjti, si dhe tek të tjerët që të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit.

Zbatimi i udhëzuesit

Përshtatshmëria e dënimit

Gjykata në këtë aktgjykim ka cituar tre prej qëllimeve të dënimit dhe e ka marrë si të mirëqenë faktin se me shqiptimin e këtij dënimi, të njëjtat qëllime do të arrihen, në atë mënyrë që asnjërin prej këtyre tre qëllimeve gjykata nuk e ka arsyetuar. Sa i përket qëllimit të katërt (viktimat dhe komuniteti) gjykata nuk e ka aplikuar dhe arsyetuar fare këtë qëllim të dënimit të paraparë me udhëzues.

Zbatimi i parimeve

Gjykata në këtë rast vetëm ka cituar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, duke mos bërë asnjë ndërlidhje me parimet që duhet të merren parasysh me rastin e caktimit të dënimit, siç përcaktohet në udhëzues.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Sa i përket pranimin të fajësisë, sipas udhëzuesit janë gjithsej katër pyetje relevante të cilave Gjykata duhet tu japë përgjigje në aktgjykim, gjë që në arsyetimin e këtij aktgjykimi nuk përmendet asnjë. Kështu ka vepruar gjykata edhe përballë tetë faktorëve që kërkohen sa i përket rrethanës së pendimit. Në këtë mënyrë, përderisa gjykata nuk i ka sqaruar këto dy rrethana me fakte dhe prova të caktuara, sipas udhëzuesit, bëhet fjalë për dyfishim të rrethanave. Premtimi se në të ardhmen nuk do të kryejë vepër tjetër penale, në udhëzues nuk përmendet fare si rrethanë lehtësuese. Sa i përket faktit se vepra penale ka mbetur në tentativë, sipas KPRK-së, kur vepra penale mbetet në tentativë, kryerësi dënohet më butë. Por, e njëjta as në KPRK e as në udhëzues nuk përcaktohet si rrethanë lehtësuese. Në këtë mënyrë, përmes këtij fakti, gjykata mund ta arsyetojë faktin se dënimi është shqiptuar më butë, në kuptim të dy limiteve të dënimit, por se nuk mundet që ky fakt të përdoret si rrethanë e veçantë lehtësuese. Në kuptim të udhëzuesit, këtu kemi të bëjmë me dyfishim të rrethanave. Ndërsa, sa i përket dënimeve të mëparshme gjykata vetëm është mjaftuar me atë se ka treguar që i pandehuri edhe më parë ka qenë i dënuar për veprën e njëjtë penale, derisa ka anashkaluar të gjitha faktorët e tjerë dhe pyetjet e tjera relevante të përcaktuara sipas udhëzuesit për këtë rrethanë.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruara nga aktgjykimi

Gjykata në këtë aktgjykim nuk ka marrë parasysh fare shkallën e dashjes, nëse vepra penale përfshin disa viktima, moshën e të pandehurit, bashkëpunimi i përgjithshëm i personit me gjykatën, shkallën e dëmit të shkaktuar, rrethanat personale dhe karakteri i personit të dënuar, (mos) keqardhjen e shfaqur, (mos) kompensimi i dëmit të shkaktuar, sjelljen e personit të dënuar pas konfliktit, (mos) shkelja e urdhrave të gjykatës, kalimin e kohës dhe (mos) mbështetja pala e dëmtuar.

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Gjykata në këtë rast nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me rëndësinë e brendshme të rrethanave dhe po ashtu, nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me peshimin e rrethanave. Për këtë arsye, llogaritja është kuantitative. Në rastin konkret, gjykata ka marrë parasysh katër rrethana lehtësuese dhe një rrethanë rënduese, që sipas udhëzuesit bëhet fjalë për rastet kur kemi “ekzistimin e së paku dy rrethanave për zvogëlim të fajësisë apo dëmit dhe asnjë/ose një rrethanë të vogël rënduese”, që kualifikohet tek rrethanat që arsyetojnë zbutjen maksimale të dënimit brenda kufirit. Sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 2, pika h, dënimi në këtë rast duhet të jetë nga gjashtë muaj deri në një vit e gjashtë muaj burgim, që i bie se në këtë rast, dënimi është brenda këtyre limiteve.

7. Rasti P.nr.1447/18 - Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 KPRK-së

Aktgjykimi i marrë

Sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, të shpallur më 8 prill 2019, i dënuari D.M ishte shpallur fajtor, pasi që gjykata kishte gjetur se i njëjti më 16 shkurt 2018, në shtëpinë e tij, Policia e Kosovës, pas marrjes së informatës së i mituri D.M, kishte postuar në rrjete sociale foto me armë, në lokacionin e identifikuar kishte zhvilluar kontroll nga ku kishte gjetur armën, për të cilën i dënuari kishte pranuar se është e tij dhe se i mituri në foto është djali i tij.

Dënimi sipas KPRK-së: dënohet me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7.500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet.

Dënimi i shqiptuar: 700 euro

Rrethanat lehtësuese:

1. Pranimi i fajësisë;
2. Pendimin e thellë për veprën penale të kryer;
3. Sinqeritetin deklarues;

Rrethanat rënduese

Asnjë

Përshtatshmëria e dënimit:

Gjykata vlerësoi se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit dhe se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe në proporcion me peshën e veprës penale. Sipas gjykatës, ky dënim do të ndikojë tek kryerësi i kësaj vepre penale por edhe tek personat e tjerë që të mos kryejnë vepra penale, si dhe do të ndikojë në ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Zbatimi i udhëzuesit

Përshtatshmëria e dënimit

Gjykata në këtë aktgjykim ka cituar tre prej qëllimeve të dënimit dhe e ka marrë si të mirëqenë faktin se me shqiptimin e këtij dënimi, të njëjtat qëllime do të arrihen, por që asnjërin prej këtyre tre qëllimeve gjykata nuk e ka arsyetuar. Sa i përket qëllimit të katërt

(viktimat dhe komuniteti) gjykata nuk e ka aplikuar dhe arsyetuar fare këtë qëllim të dënimit të paraparë me udhëzues.

Zbatimi i parimeve

Gjykata në këtë rast vetëm ka cituar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, duke mos bërë asnjë ndërlidhje me parimet që duhet të merren parasysh me rastin e caktimit të dënimit, siç përcaktohet në udhëzues.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Sa i përket pranimin të fajësisë, sipas udhëzuesit janë gjithsej katër pyetje relevante të cilave Gjykata duhet tu japë përgjigje në aktgjykim, gjë që në arsyetimin e këtij aktgjykimi nuk përmendet asnjë. Kështu ka vepruar gjykata edhe përballë tetë faktorëve që kërkohen sa i përket rrethanës së pendimit. Në këtë mënyrë, përderisa gjykata nuk i ka sqaruar këto dy rrethana me fakte dhe prova të caktuara, sipas udhëzuesit, bëhet fjalë për dyfishim të rrethanave. Sa i përket sinqeritetit të treguar, kjo në udhëzues nuk përmendet fare si rrethanë, ndërsa gjykata nuk ka dhënë asnjë arsyetim se pse ky fakt duhet të shërbejë si rrethanë lehtësuese.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruar nga aktgjykimi

Gjykata nuk ka marrë parasysh fare shkallën e dashjes, bashkëpunimi i përgjithshëm i personit me gjykatën, rrethanat personale dhe karakteri i personit të dënuar, (mos) keqardhjen e shfaqur, (mos) kompensimi i dëmit të shkaktuar, sjelljen e personit të dënuar pas konfliktit, e kaluara kriminale/jo kriminale e të dënuarve, (mos) shkelja e urdhrave të gjykatës dhe kalimin e kohës.

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Gjykata në këtë rast nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me rëndësinë e brendshme të rrethanave dhe po ashtu, nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me peshimin e rrethanave. Për këtë arsye, llogaritja është kuantitative. Në rastin konkret, gjykata ka marrë parasysh tri rrethana lehtësuese dhe asnjë rrethanë rënduese, që sipas udhëzuesit bëhet fjalë për rastet kur kemi “ekzistimin e së paku dy rrethanave për zvogëlim të fajësisë apo dëmit dhe asnjë/ose një rrethanë të vogël rënduese”, që kualifikohet tek rrethanat që arsyetojnë zbutjen maksimale të dënimit brenda kufirit. Sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 1, pika g, dënimi në këtë rast duhet të jetë nga 100 deri në 1000 euro, që i bie se në këtë rast, dënimi është brenda këtyre limiteve.

8. Rasti P.nr.1459/16 - Vjedhje e rëndë 327 par.1 nën par 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK

Aktgjykimi i marrë

Sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, i dënuar Sh.J ishte shpallur fajtor, pasi që gjykata kishte gjetur se i njëjti më 4 mars 2013, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasurorë, me kamionetën e tij “VË” në bashkëkryerje me një person tjetër, ka kryer veprën penale të vjedhjes së rëndë, ashtu që sipas aktgjykimit, të akuzuarit shkojnë tek objekti “Kijac” ndalin kamionetën dhe hyjnë në rrethojën e këtij objekti dhe aty marrin 5 korniza të dyerve të aluminit me dimensione 140me200, të cilat kishin qenë të mbështetura për muri dhe dy klima jashtë përdorimit dhe të njëjtat i ngarkojnë në kamionetë ku më pas edhe largohen nga vendi i ngjarjes.

Dënimi sipas KPRK-së: *gjobë dhe burg nga tre (3) deri në shtatë (7) vjet*

Dënimi i shqiptuar: *një (1) vit burg me kusht dhe 300 euro gjobë*

Rrethanat lehtësuese:

1. I dënuari ka pranuar fajësinë;
2. Singëritetin e treguar gjatë shqyrtimit fillestar;

Rrethanat rënduese

Asnjë

Përshtatshmëria e dënimit:

Gjykata ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar është i drejtë, i ligjshëm dhe në harmoni më shkallën e përgjegjësisë penale së të pandehurit dhe me intensitetin apo dëmtimin e vlerës së mbrojtur dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit.

Zbatimi i udhëzuesit

Përshtatshmëria e dënimit

Gjykata në këtë aktgjykim nuk ka marrë parasysh dhe nuk ka arsyetuar arritjen e asnjë prej katër qëllimeve të përmendura në udhëzues. Gjykata vetëm ka nënvizuar se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit, duke mos përmendur dhe arsyetuar asgjë më shumë.

Zbatimi i parimeve

Gjykata në këtë rast vetëm ka cituar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, duke mos bërë asnjë ndërlidhje me parimet që duhet të merren parasysh me rastin e caktimit të dënimit, siç përcaktohet në udhëzues.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Tek pranimi i fajësisë, asnjë kërkesë e cila sipas udhëzuesit duhet të aplikohet me rastin e marrjes parasysh të kësaj rrethane, e cila përcakton edhe rëndësinë e kësaj rrethane në rastin konkret, nuk është marrë parasysh, si dhe gjykata nuk ka dhënë përgjigje në katër pyetjet që

sipas udhëzuesit, janë relevante në këtë rast. Sa i përket sinqeritetit të treguar, kjo në udhëzues nuk përmendet fare si rrethanë, ndërsa gjykata nuk ka dhënë asnjë arsyetim se pse ky fakt duhet të shërbejë si rrethanë lehtësuese.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruar nga aktgjykimi

Gjykata nuk ka marrë parasysh fare shkallën e dashjes, nëse vepra penale përfshin disa të dëmtuar, mosha e të pandehurit, bashkëpunimi i përgjithshëm i personit me gjykatën, shkallën e dëmit të shkaktuar, rrethanat personale dhe karakteri i personit të dënuar, pendimin/mungesën e pendimit nga i dënuari, (mos) keqardhjen e shfaqur, (mos) kompensimi i dëmit të shkaktuar, sjelljen e personit të dënuar pas konfliktit, e kaluara kriminale/jo kriminale e të dënuarve, (mos) shkelja e urdhrave të gjykatës, kalimin e kohës dhe (mos) mbështetja pala e dëmtuar.

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Gjykata në këtë rast nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me rëndësinë e brendshme të rrethanave dhe po ashtu, nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me peshimin e rrethanave. Për këtë arsye, llogaritja është kuantitative. Në rastin konkret, gjykata ka marrë parasysh dy rrethana lehtësuese dhe asnjë rrethanë rënduese, që sipas udhëzuesit bëhet fjalë për rastet kur kemi “ekzistimin e së paku dy rrethanave për zvogëlim të fajësisë apo dëmit dhe asnjë/ose një rrethanë të vogël rënduese”, që kualifikohet tek rrethanat që arsyetojnë zbutjen maksimale të dënimit brenda kufirit. Në këtë aktgjykim, gjykata ka thënë se i është referuar nenit 75 për zbutjen e dënimit, por rreth zbatueshmërisë së këtij neni, gjykata nuk ka dhënë asnjë arsyetim, situatë kjo e pakualifikuar në udhëzues. Sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 5, pika c, dënimi me burgim në këtë rast duhet të jetë nga tre vite deri në katër vite burgim, derisa ai me gjobë duhet të jetë nga 100 deri në 6250 euro. Në rastin konkret, dënimi me burgim nuk është brenda këtyre limiteve, ndërsa ai më gjobë, është brenda këtyre limiteve.

9. Rasti P.nr.1496/19 - Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.9 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-së

Aktgjykimi i marrë

Sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, të shpallur më 6 maj 2019, i dënuari B.M. ishte shpallur fajtor për veprën penale “Rrezikim i trafikut publik”, pasi që pasi që sipas aktgjykimit, i njëjti më 3 prill 2019, rreth orës 16:45, në rrugën nacionale Prishtinë - Podujevë, përballë shkollës “Anton Zako Çajupi” në fshatin Bardhosh në Prishtinë, derisa ishte duke e drejtuar kamionetën e markës “Ivico”, nga pakujdesia, duke menduar lehtë se nuk do të rrezikoj komunikacionin, nuk i është përmbajtur rregullave të komunikacionit, duke rrezikuar jetën e njerëzve dhe duke vepruar në kundërshtim me nenin 53.1 të Ligjit mbi bazat e sigurisë së trafikut.

Sipas aktgjykimit, i dënuari duke mos pasur kujdes të shtuar ndaj pjesëmarrësve tjerë në komunikacion, e në këtë rast këmbësin, përkundër asaj se kushtet kanë qenë të përshtatshme për drejtimin e automjetit, duke mos përshtatur shpejtësinë e lëvizjes së automjetit ndaj kushteve të krijuara në komunikacion dhe duke marrë parasysh se pjesa e rrugës ku ka ndodhur aksidenti është vendbanim dhe dalja e këmbësorëve në rrugë është evidente dhe në momentin kur ju ka paraqitur rreziku nga aksidenti nuk ka mundur ta ndal automjetin me kohë para çdo pengese që ju ka paraqitur në rrugë dhe me pjesën e përparme ballore të anës së majtë e ka goditur këmbësin, tani të ndjerin N.G, duke e hedhur mbi retrovizorin (xhamin e përparmë) të kamionetës, e duke e gjuajtur në asfalt, i cili në momentin e aksidentit ishte duke e kaluar rrugën nga ana e majtë në anën e djathtë, shikuar drejtimin e lëvizjes së automjetit, me ç ‘rast viktimë N.G. merr lëndime dhe i ndjeri më 3 prill 2019 ndërroi jetë në spital nga lëndimet e marra në aksident dhe shkaktohet aksident komunikacioni.

Dënimi sipas KPRK-së: dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

Dënimi i shqiptuar: një (1) vit e gjashtë muaj burgim.

Rrethanat lehtësuese:

1. I dënuari e ka pranuar fajësinë;
2. Ka treguar sjellje korrekte në gjykatë;
3. Ndihet keq për pasojën e shkaktuar;
4. Asnjëherë nuk ka rënë ndesh me ligjin;
5. Është student;
6. Është i angazhuar në punë të ndërtimitarisë për të mbajtur familjen;
7. I ka premtuar gjykatës që do të jetë i kujdesshëm në komunikacion dhe nuk do të kryej vepra penale;

Rrethanat rënduese

1. Rrezikshmërinë e veprës penale, pasi në rastin konkret ka humbur jetën një person;

Përshtatshmëria e dënimit:

Gjykata ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryerësit, me bindje se dënimi i tillë do ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e kryerësit, por edhe do të parandalojë personat e tjerë që në të ardhmen mos të kryejnë vepra penale, si dhe do të ndikojë në ngritjen e moralit dhe të forcimit të detyrimit për respektimin e ligjit.

Zbatimi i udhëzuesit

Përshtatshmëria e dënimit

Gjykata në këtë aktgjykim ka cituar tre prej qëllimeve të dënimit dhe e ka marrë si të mirëqenë faktin se me shqiptimin e këtij dënimi, të njëjtat qëllime do të arrihen, mirëpo asnjërin prej këtyre tre qëllimeve gjykata nuk e ka arsyetuar. Sa i përket qëllimit të katërt (viktimat dhe komuniteti) gjykata nuk e ka aplikuar dhe arsyetuar fare këtë qëllim të dënimit të paraparë me udhëzues.

Zbatimi i parimeve

Gjykata në këtë rast ka zbatuar një prej parimeve të dënimit, atë të rrezikshmërisë së veprës penale, duke e ndërlidhur me një rrethanë të veçantë. Por, siç do të shohim më poshtë, e njëjta rrethanë paraqet dyfishim të rrethanave.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Tek pranimi i fajësisë, asnjë kërkesë e cila sipas udhëzuesit duhet të aplikohet me rastin e marrjes parasysh të kësaj rrethane, e cila përcakton edhe rëndësinë e kësaj rrethane në rastin konkret, nuk është marrë parasysh, si dhe gjykata nuk ka dhënë përgjigje në katër pyetjet që sipas udhëzuesit, janë relevante në këtë rast. Lidhur me sjelljen korrekte së të pandehurit gjatë procedurës, sipas udhëzuesit, gjykata duhet tu jap përgjigje gjithsej pesë pyetjeve, gjë të cilën gjykata nuk e ka bërë në këtë aktgjykim. Lidhur me shprehjen e keqardhjes, gjykata nuk ka marrë parasysh dhe nuk ka arsyetuar asnjë prej shtatë faktorëve të përcaktuar sipas udhëzuesit për këtë rrethanë, si dhe nuk ka dhënë përgjigje në tetë pyetjet relevante sipas udhëzuesit. Sa i përket faktit se e dënuari për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, sipas udhëzuesit, kjo rrethanë kualifikohet tek rrethanat e tjera lehtësuese. Në udhëzues thuhet se nëse gjykata e konstaton mungesën e dënimeve të mëparshme penale dhe mund të jepet zbutja, do të kërkoj gjetje të fakteve që e mbështesin përfundimin e sjelljes përkatëse dhe predispozitat për rehabilitim. Kjo çështje nuk trajtohet fare në këtë aktgjykim. Pa asnjë arsyetim gjykata ka marrë parasysh si rrethanë lehtësuese edhe faktin se i pandehuri është student është i angazhuar në punë të ndërtimitarisë për të mbajtur familjen. Ndërsa, premtimi se në të ardhmen nuk do të kryejë vepër tjetër penale, në udhëzues nuk përmendet fare si rrethanë lehtësuese. Sa i pasojës së shkaktuar në këtë rast, e cila nga gjykata është marrë si rrethanë rënduese, këtu sipas udhëzuesit kemi të bëjmë me dyfishim të rrethanave. Kjo për arsye se pasoja në këtë rast është formë e kualifikuar e veprës penale, për të cilën ligji ka paraparë dënim më të lartë, dhe në këtë mënyrë, e njëjta nuk mund të shërbejë si rrethanë e veçantë rënduese.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruara nga aktgjykimi

Gjykata nuk ka marrë parasysh fare shkallën e dashjes, nëse viktimat e veprës penale ka qenë posaçërisht e pambrojtur apo e ndjeshme, mosha e viktimës, numri i viktimave, mosha e të

pandehurit, (mos) kompensimi i dëmit të shkaktuar, sjelljen e personit të dënuar pas konfliktit dhe (mos) mbështetja nga pala e dëmtuar.

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Gjykata në këtë rast nuk ka dhënë asnjë arsytim lidhur me rëndësinë e brendshme të rrethanave dhe po ashtu, nuk ka dhënë asnjë arsytim lidhur me peshimin e rrethanave. Për këtë arsye, llogaritja është kuantitative. Në rastin konkret, gjykata ka marrë parasysh shtatë rrethana lehtësuese dhe një rrethanë rënduese, që sipas udhëzuesit bëhet fjalë për rastet kur kemi "ekzistimin e së paku dy rrethanave për zvogëlim të fajësisë apo dëmit dhe asnjë/ose një rrethanë të vogël rënduese", që kualifikohet tek rrethanat që arsyetojnë zbutjen maksimale të dënimit brenda kufirit. Sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 3, pika g, dënimi në këtë rast duhet të jetë nga një deri në tre vite burgim, që i bie se dënimi në këtë rast është brenda këtyre kufijve.

10. Rasti P.nr.2622/16 - Organizim i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par 1 dhe 2 i KPRK-së

Aktgjykimi i marrë

Sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm të shpallur më 12 mars 2019, i dënuari P.P. ishte shpallur fajtor për veprën penale "Organizim i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm". Kjo pasi që, i dënuari më 2 nëntor 2015, në kompleksin "Qafa" në katin e dytë në Prishtinë, me qëllim të përfitimit pasurorë në mënyrë të kundërligjshme ka ushtruar veprimtari të paligjshme të lojërave të fatit, ashtu që gjatë kontrollit nga policia është konstatuar se i njëjti nuk posedon licencë për të organizuar këto lojëra.

Atij i ishin gjetur dy aparate të lojërave të fatit, dy kuti me numra të konsiderueshëm cipa të pokerit, një tavolinë pokeri, 13 parë letra bixhozi, 17 letra që tregojnë rezultatet e lojërave nga klientët dhe 280 euro të cilat janë gjetur brenda një aparati.

Dënimi sipas KPRK-së: *dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.*

Dënimi i shqiptuar: *gjashtë (6) muaj burg, i cili me pëlqimin e tij i është zëvendësuar me gjobë në lartësi prej 1800 euro.*

Rrethanat lehtësuese:

1. I dënuari ka pranuar fajësinë;
2. Nuk ka qenë i dënuar më parë dhe as nuk është duke u zhvilluar ndonjë procedurë tjetër;
3. Sjelljen korrekte në gjykatë;

4. Është penduar;
5. Ka premtuar se nuk do të kryej më vepër penale

Rrethanat rënduese

Asnjë

Përshtatshmëria e dënimit:

Gjykata ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar është i drejtë dhe i ligjshëm, në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale së të dënuarit dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur. Duke gjetur se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë së veprës penale dhe përgjegjësisë sipas gjykatës, me anë të këtij dënimi do të arrihet edhe qëllimi i dënimit.

Zbatimi i udhëzuesit

Përshtatshmëria e dënimit

Gjykata në këtë aktgjykim nuk ka marrë parasysh dhe nuk ka arsyetuar arritjen e asnjë prej katër qëllimeve të përmendura në udhëzues. Gjykata vetëm ka nënvizuar se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit, duke mos përmendur dhe arsyetuar asgjë më shumë.

Zbatimi i parimeve

Gjykata në këtë rast vetëm ka cituar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, duke mos bërë asnjë ndërlidhje me parimet që duhet të merren parasysh me rastin e caktimit të dënimit, siç përcaktohet në udhëzues.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Sa i përket pranimin të fajësisë, sipas udhëzuesit janë gjithsej katër pyetje relevante të cilave Gjykata duhet tu japë përgjigje në aktgjykim, gjë që në arsyetimin e këtij aktgjykimi nuk përmendet asnjë. Kështu ka vepruar gjykata edhe përballë tetë faktorëve që kërkohen sa i përket rrethanës së pendimit. Në këtë mënyrë, përderisa gjykata nuk i ka sqaruar këto dy rrethana me fakte dhe prova të caktuara, sipas udhëzuesit, bëhet fjalë për dyfishim të rrethanave. Sa i përket faktit se e dënuari për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, sipas udhëzuesit, kjo rrethanë kualifikohet tek rrethanat e tjera lehtësuese. Në udhëzues thuhet se nëse gjykata e konstaton mungesën e dënimeve të mëparshme penale dhe mund të jepet zbutja, do të kërkoj gjetje të fakteve që e mbështesin përfundimin e sjelljes përkatëse dhe predispozitat për rehabilitim. Kjo çështje nuk trajtohet fare në këtë aktgjykim. Lidhur me sjelljen korrekte së të pandehurit gjatë procedurës, sipas udhëzuesit, gjykata duhet tu japë përgjigje gjithsej 5 pyetjeve, gjë të cilën gjykata nuk e ka bërë në këtë aktgjykim. Premtimi se

në të ardhmen nuk do të kryejë veprë tjetër penale, në udhëzues nuk përmendet fare si rrethanë lehtësuese.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruara nga aktgjykimi

Gjykata nuk ka marrë parasysh fare shkallën e dashjes, shkallën e dëmit të shkaktuar, rrethanat personale dhe karakteri i personit të dënuar, sjelljen e personit të dënuar pas konfliktit dhe kalimin e kohës.

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Gjykata në këtë rast nuk ka dhënë asnjë arsytim lidhur me rëndësinë e brendshme të rrethanave dhe po ashtu, nuk ka dhënë asnjë arsytim lidhur me peshimin e rrethanave. Për këtë arsye, llogaritja është kuantitative. Në rastin konkret, gjykata ka marrë parasysh katër rrethana lehtësuese dhe asnjë rrethanë rënduese, që sipas udhëzuesit bëhet fjalë për rastet kur kemi “ekzistimin e së paku dy rrethanave për zvogëlim të fajësisë apo dëmit dhe asnjë/ose një rrethanë të vogël rënduese”, që kualifikohet tek rrethanat që arsyetojnë zbutjen maksimale të dënimit brenda kufirit. Sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 2, pika h, dënimi në këtë rast duhet të jetë nga gjashtë muaj deri në një vit e gjashtë muaj burgim, që i bie se në rastin konkret, dënimi është brenda këtyre limiteve.

11. Rasti P.nr.3303/15 - Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 414 të KPRK-së

Aktgjykimi i marrë

Sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm të shpallur më 27 mars 2019, i dënuari Z.K, ishte shpallur fajtor për veprën penale “Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave”. Kjo pasi që i njëjti ishte gjetur fajtor se më 1 prill 2015, si shfrytëzues i njehsorit elektrik, i cili ka qenë i vendosur në shtëpinë e tij të konsumatorit, pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar të KEDS-it, me qëllim të përfitimit nga shërbimi për furnizim me energji elektrike dhe të shmangies së pagesës së energjisë elektrike të shpenzuar, e ka këputur shenjën e ngjitur-pllombën distribuove, e cila ka qenë e vendosur nga personat e autorizuar të KEDS-it – Distribucioni në Prishtinë.

Dënimi sipas KPRK: *dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.*

Dënimi i shqiptuar: *tre (3) muaj burg me kusht*

Rrethanat lehtësuese:

1. I dënuari për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin;

Rrethanat rënduese

Asnjë

Përshtatshmëria e dënimit:

Gjykata ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar është adekuat me shkallën e përgjegjësisë penale, si dhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit, i cili konsiston në parandalimin e kryerësit nga kryerja e veprave penale dhe të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalohen personat e tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe ky dënim do të ndikojë në ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Zbatimi i udhëzuesit

Përshtatshmëria e dënimit

Gjykata në këtë aktgjykim ka cituar tre prej qëllimeve të dënimit dhe e ka marrë si të mirëqenë faktin se me shqiptimin e këtij dënimi, të njëjtat qëllime do të arrihen, mirëpo asnjërin prej këtyre tre qëllimeve gjykata nuk i ka arsytuar. Sa i përket qëllimit të katërt (viktimat dhe komuniteti) gjykata nuk e ka aplikuar dhe arsytuar fare këtë qëllim të dënimit të paraparë me udhëzues.

Zbatimi i parimeve

Gjykata në këtë rast vetëm ka cituar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, duke mos bërë asnjë ndërlidhje me parimet që duhet të merren parasysh me rastin e caktimit të dënimit, siç përcaktohet në udhëzues.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Sa i përket faktit se i dënuari për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, sipas udhëzuesit, kjo rrethanë kualifikohet tek rrethanat e tjera lehtësuese. Në udhëzues thuhet se nëse gjykata e konstaton mungesën e dënimeve të mëparshme penale dhe mund të jepet zbutja, do të kërkojë gjetje të fakteve që e mbështesin përfundimin e sjelljes përkatëse dhe predispozitat për rehabilitim. Kjo çështje nuk trajtohet fare në këtë aktgjykim.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruar nga aktgjykimi

Gjykata nuk ka marrë parasysh fare shkallën e dashjes, bashkëpunimi i përgjithshëm i personit me gjykatën, shkallën e dëmit të shkaktuar, rrethanat personale dhe karakteri i personit të dënuar, pendimin/mungesën e pendimit nga i dënuari, (mos) keqardhjen e shfaqur, (mos) kompensimi i dëmit të shkaktuar, sjelljen e personit të dënuar pas konfliktit, (mos) shkelja e urdhrave të gjykatës, kalimin e kohës dhe (mos) mbështetja pala e dëmtuar.

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Gjykata në këtë rast nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me rëndësinë e brendshme të rrethanave dhe po ashtu, nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me peshimin e rrethanave. Për këtë arsye, llogaritja është kuantitative. Në rastin konkret, gjykata ka marrë parasysh një rrethanë lehtësuese dhe asnjë rrethanë rënduese, që sipas udhëzuesit bëhet fjalë për rastet kur kemi “ekzistimin e së paku një rrethane për zvogëlim të fajësisë, dëmit apo zbutje tjetër, në çfarëdo sasive, dhe nuk ka asnjë rrethanë rënduese”, që kualifikohet tek rastet kur faktorët tregojnë më shumë rrethana lehtësuese se sa rënduese. Sipas shtojcës 1 të udhëzuesit , pjesa 1, pika f, dënimi në këtë rast duhet të jetë nga tetë muaj deri në një vit burgim, që i bie se në rastin konkret, dënimi nuk është brenda këtyre limiteve.

12. Rasti P.nr.3341/17 - Mos raportim ose raportim i rremë i pasurisë, i të ardhurave personale ose i dobisë materiale ose detyrimeve financiare – 437 par.1 KPRK

Aktgjykimi i marrë

Sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, këshilltari komunal në Komunën e Prizrenit, S.F., ishte shpallur fajtor për mos deklarim të pasurisë, pasi që gjykata kishte gjetur që i dënuar prej 1 mars 2017 deri më 31 mars 2017, edhe pse kishte qenë i detyruar që në cilësinë e zyrtarit të lartë publik të bëjë deklarin e pasurisë, nuk e kishte deklaruar pasurinë në formularin e deklarinimit të pasurisë për periudhën kohore nga data 1 janar deri më 31 dhjetor 2016.

Dënimi sipas KPRK-së: *gjobë ose burgim deri në tre (3) vjet*

Dënimi i shqiptuar: *tre (3) muaj burg me kusht dhe 600 euro dënim me gjobë*

Rrethanat lehtësuese:

1. I dënuari ka pranuar fajësinë;
2. Intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur;
3. Sinqeritetin e treguar gjatë shqyrtimit;
4. Rrethanat në të cilat është kryer vepra penale;
5. Për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin dhe nuk ka qenë i dënuar më parë;

Rrethanat rënduese

Asnjë

Përshtatshmëria e dënimit:

Gjykata ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, madje vlerëson se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit, i cili konsiston në parandalimin e kryerësit por edhe të personave të tjerë nga kryerja e veprave penale në të ardhmen si dhe në ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Zbatimi i udhëzuesit

Përshtatshmëria e dënimit

Gjykata në këtë aktgjykim ka cituar tre prej qëllimeve të dënimit dhe e ka marrë si të mirëqenë faktin se me shqiptimin e këtij dënimi, të njëjtat qëllime do të arrihen, mirëpo asnjërin prej këtyre tre qëllimeve gjykata nuk i ka arsyetuar. Sa i përket qëllimit të katërt (viktimat dhe komuniteti) gjykata nuk e ka aplikuar dhe arsyetuar fare këtë qëllim të dënimit të paraparë me udhëzues.

Zbatimi i parimeve

Gjykata në këtë rast vetëm ka cituar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, duke mos bërë asnjë ndërlidhje me parimet që duhet të merren parasysh me rastin e caktimit të dënimit, siç përcaktohet në udhëzues.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Tek pranimi i fajësisë, asnjë kërkesë e cila sipas udhëzuesit duhet të aplikohet me rastin e marrjes parasysh të kësaj rrethane, e cila përcakton edhe rëndësinë e kësaj rrethane në rastin konkret, nuk është marrë parasysh, si dhe gjykata nuk ka dhënë përgjigje në katër pyetjet që sipas udhëzuesit, janë relevante në këtë rast. Në këtë aktgjykim, gjykata ka bërë dy dyfishime të rrethanave, në atë mënyrë që dy prej parimeve të dënimit (intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale) nuk i ka ndërlidhur me rrethana të tjera të veçanta, por vetë të njëjtat i ka përdorur si rrethana. Sa i përket sinqeritetit të treguar, kjo në udhëzues nuk përmendet fare si rrethanë, ndërsa gjykata nuk ka dhënë asnjë arsyetim se pse ky fakt duhet të shërbejë si rrethanë lehtësuese. Sa i përket faktit se i dënuari për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, sipas udhëzuesit, kjo rrethanë kualifikohet tek rrethanat e tjera lehtësuese. Në udhëzues thuhet se nëse gjykata e konstaton mungesën e dënimeve të mëparshme penale dhe mund të jepet zbutja, do të kërkoj gjetje të fakteve që e mbështesin përfundimin e sjelljes përkatëse dhe predispozitat për rehabilitim. Kjo çështje nuk trajtohet fare në këtë aktgjykim.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruara nga aktgjykimi

Gjykata nuk ka marrë parasysh fare shkallën e dashjes, bashkëpunimi i përgjithshëm i personit me gjykatën, shkallën e dëmit të shkaktuar, rrethanat personale dhe karakteri i personit të dënuar, pendimin/mungesën e pendimit nga i dënuari, (mos) keqardhjen e shfaqur,

sjelljen e personit të dënuar pas konfliktit, (mos) shkelja e urdhrave të gjykatës dhe kalimin e kohës.

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Gjykata në këtë rast nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me rëndësinë e brendshme të rrethanave dhe po ashtu, nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me peshimin e rrethanave. Për këtë arsye, llogaritja është kuantitative. Në rastin konkret, gjykata ka marrë parasysh pesë rrethana lehtësuese dhe asnjë rrethanë rënduese, që sipas udhëzuesit bëhet fjalë për rastet kur kemi “ekzistimin e së paku dy rrethanave për zvogëlim të fajësisë apo dëmit dhe asnjë/ose një rrethanë të vogël rënduese”, që kualifikohet tek rrethanat që arsyetojnë zbutjen maksimale të dënimit brenda kufirit. Sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 1, pika f, dënimi në këtë rast duhet të jetë nga një muaj deri në tetë muaj burgim, ndërsa dënimi me gjobë duhet të jetë nga 100 euro deri në 6250 euro, që nënkupton se dënimi i shqiptuar në këtë aktgjykim është brenda këtyre limiteve.

13. Rasti P.nr.3538/17 - Mashtrim, nga neni 335, par.1 i KPRK-së

Aktgjykimi i marrë

Sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, të shpallur më 10 maj 2019, e dënuara L.M. ishte shpallur fajtores për veprën penale “Mashtrim”, pasi që e njëjta më 9 tetor 2013, në Institutin e Gjuhëve “Goethe”, me qëllim që vetes ti sjell dobi pasurore të kundërligjshme, së bashku me të pandehurën Q.G., kanë mashtruar të dëmtuarin, përgjegjësin e provimeve në gjuhën gjermane E.J., ashtu që duke i fshehur faktet të njëjtit e kanë vënë në lajthim, në mënyrë që kishte hyrë në provim të gjuhës gjermane në vend të të pandehurës tjetër Q.G.

Dënimi sipas KPRK-së: *dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.*

Dënimi i shqiptuar: *katër (4) muaj burg me kusht dhe dënim me gjobë në lartësi prej 200 eurove*

Rrethanat lehtësuese:

1. E dënuara ka pranuar fajësinë;
2. Pendimin e thellë;
3. Sjelljen korrekte në gjykatë;
4. Kërkim faljen;

5. Premtimin se nuk do të kryej më vepër penale;

Rrethanat rënduese

Asnjë

Përshtatshmëria e dënimit:

Gjykata ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe do të ndikoj në risocializimin dhe risocializimin e saj si dhe tek të tjerët që të mos kryejnë vepra të tjera penale

Zbatimi i udhëzuesit

Përshtatshmëria e dënimit

Gjykata në këtë aktgjykim ka cituar dy prej qëllimeve të dënimit dhe e ka marrë si të mirëqenë faktin se me shqiptimin e këtij dënimi, të njëjtat qëllime do të arrihen, por që asnjërin prej këtyre dy qëllimeve gjykata nuk e ka arsytuar. Sa i përket qëllimit të katërt (gjykimi shoqëror, ngritja e moralit dhe forcimi i detyrimit për respektimin e ligjit dhe viktimat dhe komuniteti) gjykata nuk e ka aplikuar dhe arsytuar fare këtë qëllim të dënimit të paraparë me udhëzues.

Zbatimi i parimeve

Gjykata në këtë rast vetëm ka cituar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, duke mos bërë asnjë ndërlidhje me parimet që duhet të merren parasysh me rastin e caktimit të dënimit, siç përcaktohet në udhëzues.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Sa i përket pranimin të fajësisë, sipas udhëzuesit janë gjithsej katër pyetje relevante të cilave Gjykata duhet tu japë përgjigje në aktgjykim, gjë që në arsyetimin e këtij aktgjykimi nuk përmendet asnjë. Kështu ka vepruar gjykata edhe përballë tetë faktorëve që kërkohen sa i përket rrethanës së pendimit. Në këtë mënyrë, përderisa gjykata nuk i ka sqaruar këto dy rrethana me fakte dhe prova të caktuara, sipas udhëzuesit, bëhet fjalë për dyfishim të rrethanave. Lidhur me sjelljen korrekte së të pandehurit gjatë procedurës, sipas udhëzuesit, gjykata duhet tu japë përgjigje gjithsej pesë pyetjeve, gjë që cilën gjykata nuk e ka bërë në këtë aktgjykim. Premtimi se në të ardhmen nuk do të kryejë vepër tjetër penale, në udhëzues nuk përmendet fare si rrethanë lehtësuese. Sa i përket kërkim faljes, gjykata fillimisht nuk ka përcaktuar se çfarë realisht nënkupton kjo kërkim falje. Në raport me udhëzuesin, kërkim falja është një faktorë me anë të së cilës vërtetohet dhe aplikohet rrethana lehtësuese e shfaqjes së keqardhjes, por si e vetme, nuk paraqet rrethanë të veçantë lehtësuese. Për këtë arsye, sipas udhëzuesit, në këtë rast kemi të bëjmë me dyfishim të rrethanave.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruara nga aktgjykimi

Gjykata nuk ka marrë parasysh fare shkallën e dashjes, shkallën e dëmit të shkaktuar, rrethanat personale dhe karakteri i personit të dënuar, (mos) keqardhjen e shfaqur, sjelljen e personit të dënuar pas konfliktit, e kaluara kriminale/jo kriminale e të dënuarit, kalimin e kohës dhe (mos) mbështetja pala e dëmtuar.

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Gjykata në këtë rast nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me rëndësinë e brendshme të rrethanave dhe po ashtu, nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me peshimin e rrethanave. Për këtë arsye, llogaritja është kuantitative. Në rastin konkret, gjykata ka marrë parasysh katër rrethana lehtësuese dhe asnjë rrethanë rënduese, që sipas udhëzuesit bëhet fjalë për rastet kur kemi “ekzistimin e së paku dy rrethanave për zvogëlim të fajësisë apo dëmit dhe asnjë/ose një rrethanë të vogël rënduese”, që kualifikohet tek rrethanat që arsyetojnë zbutjen maksimale të dënimit brenda kufirit. Sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 2, pika b, dënimi në këtë rast duhet të jetë nga tre muaj deri në 10 muaj burgim, ndërsa dënimi me gjobë duhet të jetë nga 100 euro deri në 6250 euro, që nënkupton se dënimi i shqiptuar në këtë aktgjykim është brenda këtyre limiteve.

14. Rasti P.nr.3559/15 - Vjedhje pylli – 358 par.2 i KPRK-së

Aktgjykimi i marrë

Sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, i dënuari D. M, më 11 janar 2015, rreth orës 15:30 në pyllin publik të quajtur “Kallaqak” është takuar duke prerë dru me motosharrë, me ç’rast kishte prerë dru zjarri pa leje. Kështu, i njëjtime qëllim të vjedhjes ai kishte prerë dru të llojit bungu, të gjata 6-10 metra, me diametër 8-13 cm, me vëllim të përgjithshëm 5.126m³, e me këto veprime i kishte shkaktuar të dëmtuarës, Sektorit të Pylltarisë në Prishtinë, dëm në vlerë prej 461.34 euro.

Dënimi sipas KPRK-së: *me gjobë dhe me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vite*

Dënimi i shqiptuar: *Dënim me kusht tre (3) muaj burg dhe dënim me gjobë 300 euro*

Rrethanat lehtësuese:

1. I dënuari kishte pranuar fajësinë;
2. Ishte korrekt me sjellje në gjykatë;
3. Është penduar dhe i ka premtuar gjykatës që nuk do të përsëris më vepra penale;

Rrethanat rënduese:

Asnjë

Përshtatshmëria e dënimit:

Gjykata dënimin e shqiptuar e vlerësoi adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe shkallën e përgjegjësisë penale. Sipas gjykatës, me anë të këtij dënimi do të parandalohet kryerësi i kësaj vepre penale si dhe kryerësit e tjerë që në të ardhmen mos të kryejnë vepra të tjera penale, si dhe do të ngritet morali dhe forcimi i detyrimit për respektimin e ligjit.

Zbatimi i udhëzuesit

Përshtatshmëria e dënimit

Gjykata në këtë aktgjykim ka cituar tre prej qëllimeve të dënimit dhe e ka marrë si të mirëqenë faktin se me shqiptimin e këtij dënimi, të njëjtat qëllime do të arrihen, por që asnjërin prej këtyre tre qëllimeve gjykata nuk i ka arsytuar. Sa i përket qëllimit të katërt (viktimat dhe komuniteti) gjykata nuk e ka aplikuar dhe arsytuar fare këtë qëllim të dënimit të paraparë me udhëzues.

Zbatimi i parimeve

Gjykata në këtë rast vetëm ka cituar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, duke mos bërë asnjë ndërlidhje me parimet që duhet të merren parasysh me rastin e caktimit të dënimit, siç përcaktohet në udhëzues.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Sa i përket pranimit të fajësisë, sipas udhëzuesit janë gjithsej katër pyetje relevante të cilave Gjykata duhet tu japë përgjigje në aktgjykim, gjë që në arsyetimin e këtij aktgjykimi nuk përmendet asnjë. Kështu ka vepruar gjykata edhe përballë tetë faktorëve që kërkohen sa i përket rrethanës së pendimit. Në këtë mënyrë, përderisa gjykata nuk i ka sqaruar këto dy rrethana me fakte dhe prova të caktuara, sipas udhëzuesit, bëhet fjalë për dyfishim të rrethanave. Lidhur me sjelljen korrekte së të pandehurit gjatë procedurës, sipas udhëzuesit, gjykata duhet tu japë përgjigje gjithsej pesë pyetjeve, gjë të cilën gjykata nuk e ka bërë në këtë aktgjykim. Ndërsa, premtimi se në të ardhmen nuk do të kryejë vepër tjetër penale, në udhëzues nuk përmendet fare si rrethanë lehtësuese.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruara nga aktgjykimi

Gjykata nuk ka marrë parasysh fare shkallën e dashjes, shkallën e dëmit të shkaktuar, rrethanat personale dhe karakteri i personit të dënuar, (mos) keqardhjen e shfaqur, (mos) kompensimi i dëmit të shkaktuar, sjelljen e personit të dënuar pas konfliktit, e kaluara kriminale/jo kriminale e të dënuarve, kalimin e kohës dhe (mos) mbështetja pala e dëmtuar.

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Gjykata në këtë rast nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me rëndësinë e brendshme të rrethanave dhe po ashtu, nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me peshimin e rrethanave. Për këtë arsye, llogaritja është kuantitative. Në rastin konkret, gjykata ka marrë parasysh katër rrethana lehtësuese dhe asnjë rrethanë rënduese, që sipas udhëzuesit bëhet fjalë për rastet kur kemi “ekzistimin e së paku dy rrethanave për zvogëlim të fajësisë apo dëmit dhe asnjë/ose një rrethanë të vogël rënduese”, që kualifikohet tek rrethanat që arsyetojnë zbutjen maksimale të dënimit brenda kufirit. Sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 2, pika b, dënimi në këtë rast duhet të jetë nga tre muaj deri në 10 muaj burgim, ndërsa dënimi me gjobë duhet të jetë nga 100 euro deri në 6250 euro, që nënkupton se dënimi i shqiptuar në këtë aktgjykim është brenda këtyre limiteve.

15. Rasti P.nr.4091/15 - Vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 pika .1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së

Aktgjykimi i marrë

Sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm të shpallur më 15 prill 2019, të dënuarit D.A. dhe G.L. ishin shpallur fajtor, pasi që më 24 tetor 2015, në lagjen “Emshir”, në hyrjen 1, kati 4, të dënuarit në bashkëkryerje, me qëllim të përvetësimit të sendeve në mënyrë të kundërligjshme, me mjete të forta ka thyer cilindrin e derës së banesës së të dëmtuarit K.T. kanë depërtuar brenda dhe kanë marr një TV plazma, një DVD, gota, pjata, perde, jorgan, nxehtëse, qarqafa, duke i shkaktuar kështu të dëmtuarit dëm të konsiderueshëm material.

Dënimi sipas KPRK-së: *dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në shtatë (7) vjet*

Dënimi i shqiptuar (për 2 të dënuarit): *dy (2) vite burg dhe 2000 euro gjobë për secilin veç e veç.*

Rrethanat lehtësuese:

1. I dënuari për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin;

Rrethanat rënduese

1. Rrezikshmërinë e veprës penale;

2. Mënyrën dhe rrethanat e kryerjes pasi që të dëmtuarin e kanë pasur fqinjë dhe kanë shfrytëzuar mos prezencën e herëpashershme të tij;

3. Të dënuarit janë në gjendje të mirë ekonomike dhe për kryerjen e kësaj vepre penale nuk kanë qenë të shtyrë nga shkaqet ekonomike;

Përshtatshmëria e dënimit:

Gjykata ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësisë penale, si dhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit, i cili konsiston në parandalimin e kryerësit nga kryerja e veprave penale dhe të bëjë rehabilitimin e tij. Po ashtu, sipas gjykatës, ky dënim do të parandalojë edhe kryerësit e tjerë nga kryerja e vepra penale si dhe do të ndikojë në ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Zbatimi i udhëzuesit

Përshtatshmëria e dënimit

Në këtë aktgjykim, gjykata ka dhënë një arsytim pak më të avancuar mbi përshtatshmërinë e dënimit, por jo në raport me qëllimet e dënimit të listuara në udhëzues. Gjykata në këtë aktgjykim ka cituar tre prej qëllimeve të dënimit dhe e ka marrë si të mirëqenë faktin se me shqiptimin e këtij dënimi, të njëjtat qëllime do të arrihen, mirëpo që asnjërin prej këtyre tre qëllimeve gjykata nuk e ka arsytuar. Sa i përket qëllimit të katërt (viktimat dhe komuniteti) gjykata nuk e ka aplikuar dhe arsytuar fare këtë qëllim të dënimit të paraparë me udhëzues.

Zbatimi i parimeve

Gjykata në këtë rast ka zbatuar një parim të dënimit (mënyrën dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale), dhe ashtu siç përcaktohet me udhëzues, të njëjtin e ka arsytuar me rrethana të veçanta. Por, kështu nuk ka vepruar gjykata në raport me parimet e tjera të dënimit.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Sa i përket faktit se i dënuari për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, sipas udhëzuesit, kjo rrethanë kualifikohet tek rrethanat e tjera lehtësuese. Në udhëzues thuhet se nëse gjykata e konstaton mungesën e dënimeve të mëparshme penale dhe mund të jepet zbutja, do të kërkojë gjetje të fakteve që e mbështesin përfundimin e sjelljes përkatëse dhe predispozitat për rehabilitim. Kjo çështje nuk trajtohet fare në këtë aktgjykim. Sa i përket rrezikshmërisë së veprës penale, sipas udhëzuesit, kjo nuk është rrethanë e posaçme rënduese, por është parim i dënimit, çka nënkupton se në kuptim të udhëzuesit, gjykata në këtë rast ka bërë dyfishim të rrethanave. Rrethanën rënduese të gjendjes së mirë ekonomike, gjykata e ka zbatuar konform kërkesave të udhëzuesit.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruara nga aktgjykimi

Gjykata nuk ka marrë parasysh fare shkallën e pjesëmarrjes së personit në kryerjen e veprës penale, shkallën e dashjes, nëse vepra penale përfshin disa viktima, moshën e viktimës, bashkëpunimi i përgjithshëm i personit me gjykatën, shkallën e dëmit të shkaktuar, pendimin/mungesën e pendimit nga i dënuari, (mos) keqardhjen e shfaqur, (mos) kompensimi i dëmit të shkaktuar, sjelljen e personit të dënuar pas konfliktit, (mos) shkelja e urdhrave të gjykatës, kalimin e kohës dhe (mos) mbështetja pala e dëmtuar.

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Gjykata në këtë rast nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me rëndësinë e brendshme të rrethanave dhe po ashtu, nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me peshimin e rrethanave. Për këtë arsye, llogaritja është kuantitative. Në rastin konkret, gjykata ka marrë parasysh tre rrethana rënduese dhe një rrethanë lehtësuese, që sipas udhëzuesit bëhet fjalë për rastet kur "totali i rrethanave rënduese e tejkalon dukshëm më shumë atë të rrethanave lehtësuese", që kualifikohet tek faktorët që arsyetojnë dënimin maksimal brenda kufirit. Në këtë aktgjykim, gjykata fare nuk i është referuar nenit 75 për zbutjen e dënimit, ndonëse ka shkuar nën minimumin e përcaktuar ligjor. Sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 5, pika c, dënimi me burgim në këtë rast duhet të jetë nga gjashtë vite deri në shtatë vite burgim, derisa ai me gjobë duhet të jetë nga 18750 euro deri në 25000 euro. Në rastin konkret, dënimi i shqiptuar, si ai me burgim ashtu edhe ai me gjobë, është jashtëzakonisht më i ulët se sa këto limite të përcaktuara nga udhëzuesi.

16 Rasti P.nr.4786/16 - Lëndim i lehtë trupor – 188.1.14 KPRK-së

Aktgjykimi i marrë

Sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, i dënuari B.B. ishte shpallur fajtor sepse më 20 gusht 2016, rreth 00:00, në Fushë Kosovë, respektivisht në banesën e të dëmtuarit, pas njoftimit nga bashkëshortja e tij, ka ardhur së bashku me të akuzuarin tjetër i cili është liruar nga akuza, në banesën e dhëndëri të tij dhe me dashje që ti shkaktojnë lëndime trupore e kishin sulmuar fizikisht të dëmtuarin, ashtu që i dënuari e kishte sulmuar me mjet të fortë-dru. Si rezultat i këtyre veprimeve, të dëmtuarit i janë shkaktuar lëndime trupore, duke i shkaktuar ndrydhje të indeve të buta në regjionin ballor të kokës, të mollëzës, faqes së djathtë të fytyrës, plagë qarëse të indeve të vogla të hundës, dhe gjakderdhje nga hunda.

Dënimi sipas KPRK-së: *gjobë ose burgim deri në një (1) vit*

Dënimi i shqiptuar: *1.000 euro gjobë*

Rrethanat lehtësuese:

1. I dënuari për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin;

Rrethanat rënduese

1. Vepra penale është kryer me dashje dhe këmbëngulësi;

2. Mos shprehja e keqardhjes dhe pendesës;

Përshtatshmëria e dënimit:

Gjykata ka vlerësuar se dënimi me gjobë në lartësi prej 1000 euro, është adekuat me rrezikshmërinë shoqërore dhe shkallën e përgjegjësisë penale, si dhe i njëjti dënim do të

ndikojë në parandalimin e kryerësit por edhe të personave të tjerë nga kryerja e veprave të tjera penale si dhe do të ndikojë në ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Zbatimi i udhëzuesit

Përshtatshmëria e dënimit

Gjykata në këtë aktgjykim ka cituar tre prej qëllimeve të dënimit dhe e ka marrë si të mirëqenë faktin se me shqiptimin e këtij dënimi, të njëjtat qëllime do të arrihen, mirëpo që asnjërin prej këtyre tre qëllimeve, gjykata nuk i ka arsytuar. Sa i përket qëllimit të katërt (viktimat dhe komuniteti) gjykata nuk e ka aplikuar dhe arsytuar fare këtë qëllim të dënimit të paraparë me udhëzues.

Zbatimi i parimeve

Gjykata në këtë rast vetëm ka cituar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, duke mos bërë asnjë ndërlidhje me parimet që duhet të merren parasysh me rastin e caktimit të dënimit, siç përcaktohet në udhëzues.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Sa i përket faktit se i dënuari për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, sipas udhëzuesit, kjo rrethanë kualifikohet tek rrethanat e tjera lehtësuese. Në udhëzues thuhet se nëse gjykata e konstaton mungesën e dënimeve të mëparshme penale dhe mund të jepet zbutja, do të kërkoj gjetje të fakteve që e mbështesin përfundimin e sjelljes përkatëse dhe predispozitat për rehabilitim. Kjo çështje nuk trajtohet fare në këtë aktgjykim. Sa i përket faktit se vepra penale është kryer me dashje dhe me këmbëngulësi, gjykata përtej këtij qëndrimi nuk ka dhënë asnjë arsytim tjetër, duke anashkaluar shtatë pyetjet relevante sipas udhëzuesit në këtë rast. Edhe sa i përket mos shprehjes së keqardhjes dhe pendesën, gjykata vepron në të njëjtën mënyrë, duke mos dhënë asnjë arsytim mbi këtë rrethanë lehtësuese.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruar nga aktgjykimi

Gjykata nuk ka marrë parasysh fare praninë e dhunës apo kanosjes në kryerjen e veprës penale, nëse vepra penale përfshin disa viktima, nëse viktima e veprës penale ka qenë posaçërisht e pambrojtur apo e ndjeshme, mosha e viktimës, (mos) provokimin nga viktima, bashkëpunimi i përgjithshëm i personit me gjykatën, shkallën e dëmit të shkaktuar, rrethanat personale dhe karakteri i personit të dënuar, (mos) kompensimi i dëmit të shkaktuar, sjelljen e personit të dënuar pas konfliktit, (mos) shkelja e urdhrave të gjykatës, kalimin e kohës dhe (mos) mbështetja pala e dëmtuar.

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Gjykata në këtë rast nuk ka dhënë asnjë arsytim lidhur me rëndësinë e brendshme të rrethanave dhe po ashtu, nuk ka dhënë asnjë arsytim lidhur me peshimin e rrethanave. Për këtë arsye, llogaritja është kuantitative. Në rastin konkret, gjykata ka marrë parasysh dy rrethana rënduese dhe një rrethanë lehtësuese, që sipas udhëzuesit bëhet fjalë për rastet kur “totali i rrethanave rënduese e tejkalon atë të rrethanave lehtësuese”, që kualifikohet tek rastet kur faktorët tregojnë më shumë rrethana rënduese se sa lehtësuese. Sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 1, pika d, dënimi me gjobë në këtë rast duhet të jetë nga 12.500 euro deri në 18.750 euro, që i bie se në rastin konkret, dënimi është jashtëzakonisht larg prej këtyre limiteve.

17 Rasti P.nr.5562/18 - Lëndim i lehtë trupor – 188 par.3 lidhur me nënpar.3.2 të KPRK-së

17.1 Aktgjykimi i marrë

Sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, i dënuari A.M. ishte shpallur fajtor sepse më, 24 nëntor 2018, rreth orës 11:00, në shtëpinë e tij në rrugën “Ganimete Tërbeshi” pas një mosmarrëveshje me të dëmtuarën A.B, e sulmon atë duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore. I pandehuri me qëllim që ti shkaktonte lëndime trupore, e kap për flokësh duke e përplasur për tokë, pastaj përmes përdorimit të rrypit e godet në krah dhe në këmbën e majtë, e më pas me qëllim të shkaktimit të lëndimeve e godet edhe me një pjesë dru të laminatit dhe e tërheq zvarrë, me ç’rast i shkakton ndrydhje të indeve të buta në regjionin e shpatullës së majtë të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë.

Dënimi sipas KPRK-së: *gjashtë muaj (6) muaj deri në pesë (5) vjet burgim*

Dënimi i shqiptuar: *gjashtë (6) muaj burgim me kusht*

Rrethanat lehtësuese:

1. I dënuari ka pranuar fajësinë në seancën fillestare;
2. Intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur;
3. Sinqeritetin e treguar gjatë shqyrtimit;
4. Rrethanat në të cilat është kryer vepra penale;

Rrethanat rënduese

Asnjë

Përshtatshmëria e dënimit:

Gjykata ka vlerësuar me bindje se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore, të veprës penale për të cilën është shpallur fajtor dhe se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit, që konsiston në parandalimin e kryerësit por edhe të personave të tjerë që në të ardhmen mos të kryejnë vepra penale, por edhe në ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Zbatimi i udhëzuesit

Përshtatshmëria e dënimit

Gjykata në këtë aktgjykim ka cituar tre prej qëllimeve të dënimit dhe e ka marrë si të mirëqenë faktin se me shqiptimin e këtij dënimi, të njëjtat qëllime do të arrihen, mirëpo që asnjërin prej këtyre tre qëllimeve, gjykata nuk i ka arsyetuar. Sa i përket qëllimit të katërt (viktimat dhe komuniteti) gjykata nuk e ka aplikuar dhe arsyetuar fare këtë qëllim të dënimit të paraparë me udhëzues.

Zbatimi i parimeve

Gjykata në këtë rast vetëm ka cituar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, duke mos bërë asnjë ndërlidhje me parimet që duhet të merren parasysh me rastin e caktimit të dënimit, siç përcaktohet në udhëzues.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Tek pranimi i fajësisë, asnjë kërkesë e cila sipas udhëzuesit duhet të aplikohet me rastin e marrjes parasysh të kësaj rrethane, e cila përcakton edhe rëndësinë e kësaj rrethane në rastin konkret, nuk është marrë parasysh, si dhe gjykata nuk ka dhënë përgjigje në katër pyetjet që sipas udhëzuesit, janë relevante në këtë rast. Sa i përket sinqeritetit të treguar, kjo në udhëzues nuk përmendet fare si rrethanë, ndërsa gjykata nuk ka dhënë asnjë arsyetim se pse ky fakt duhet të shërbejë si rrethanë lehtësuese. Në anën tjetër, gjykata ka bërë dy dyfishime në këtë rast, në atë mënyrë që dy prej parimeve të dënimit (intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale) nuk i ka ndërlidhur me rrethana të veçanta, por vetë të njëjtat i ka përdorur si rrethana lehtësuese.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruara nga aktgjykimi

Gjykata nuk ka marrë parasysh fare shkallën e dashjes, praninë e dhunës apo kanosjes në kryerjen e veprës penale, nëse vepra penale përfshin disa viktima, nëse viktima e veprës penale ka qenë posaçërisht e pambrojtur apo e ndjeshme, mosha e viktimës, (mos) provokimin nga viktima, bashkëpunimi i përgjithshëm i personit me gjykatën, shkallën e dëmit të shkaktuar, rrethanat personale dhe karakteri i personit të dënuar, pendimin/mungesën e pendimit nga i dënuari, (mos) keqardhjen e shfaqur, (mos) kompensimi i dëmit të shkaktuar, sjelljen e personit të dënuar pas konfliktit, e kaluara kriminale/jo kriminale e të dënuarve, (mos) shkelja e urdhrave të gjykatës, kalimin e kohës dhe (mos) mbështetja pala e dëmtuar.

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Gjykata në këtë rast nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me rëndësinë e brendshme të rrethanave dhe po ashtu, nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me peshimin e rrethanave. Për këtë arsye, llogaritja është kuantitative. Në rastin konkret, gjykata ka marrë parasysh katër rrethana lehtësuese dhe asnjë rrethanë rënduese, që sipas udhëzuesit bëhet fjalë për rastet kur kemi "ekzistimin e së paku dy rrethanave për zvogëlim të fajësisë apo dëmit dhe asnjë/ose një rrethanë të vogël rënduese", që kualifikohet tek rrethanat që arsyetojnë zbutjen maksimale të dënimit brenda kufirit. Sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 2, pika h, dënimi në këtë rast duhet të jetë nga gjashtë muaj deri në një vit e gjashtë muaj burgim, që nënkupton se dënimi i shqiptuar në këtë aktgjykim është brenda këtyre limiteve.

18 Rasti P.nr.631/2017 - Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së

Aktgjykimi i marrë

Sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, të shpallur më 6 mars 2019, i dënuari H.H. ishte shpallur fajtor për veprën penale "Rrezikimi i trafikut publik". Kjo pasi sipas aktgjykimit, i dënuari më 4 korrik 2015, rreth orës 18:30, në rreth rrotullimin "Fontana", deri sa ishte duke drejtuar automjetin e tipit "VË Polo", nga pakujdesia ka shkelur ligjin mbi trafikun publik, në kundërshtim me nenin 62 të LSKR-së, ashtu që nuk i ka dhënë përparësi kalimi, i cili është i obliguar t'u jep pjesëmarrësve tjerë në trafik, e më këtë i pandehuri ka marrë veprim të pa sigurt kyçje në rrugën me përparësi kalimi, duke paraqitur pengesë fizike dhe në pjesën e pasme i pandehuri është goditur nga pjesa e përparme ballore nga automjeti i tipit "Chevrolet Clio", me ç 'rast tani e dëmtuara A.Gj. ka pësuar lëndime të lehta trupore.

Dënimi sipas KPRK-së: *dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.*

Dënimi i shqiptuar: *dënim me gjobë në lartësi prej 400 euro.*

Rrethanat lehtësuese:

1. I dënuari për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin;
2. Është mbajtës i familjes;
3. Aksidenti kishte ndodhur jo vetëm nga lëshimet e tij;

Rrethanat rënduese

1. Nuk e ka pranuar fajësinë;
2. Nuk ka kërkuar falje për veprën penale;

Përshtatshmëria e dënimit:

Gjykata ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësisë penale, si dhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit, i cili konsiston në parandalimin e kryerësit nga kryerja e veprave penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit në respektimin e ligjit. Sipas gjykatës, ky dënim është risocializimin e të pandehurit me anë të pezullimit të dënimit, pasi me anë të këtij dënimi, kryerësit i tërhiqet vërejtja seriozisht dhe i bëhet me dije se nëse kryejnë veprë tjetër penale, dënimi do të jetë më i rëndë.

Zbatimi i udhëzuesit

Përshtatshmëria e dënimit

Gjykata në këtë rast ka cituar tre qëllimet e dënimit (Parandalimi specifik/i veçantë, Parandalimi i përgjithshëm dhe Gjykimi shoqëror, ngritja e moralit dhe forcimi i detyrimit për respektimin e ligjit). Sa i përket parandalimit specifik apo të veçantë gjykata e ka arsyetuar mjaftueshëm mënyrën se si me anë të këtij dënimi do të arrihet ky qëllim. Arritjen e dy qëllimeve të tjera gjykata e merr si të mirëqenë dhe nuk jep asnjë arsyetim. Ndërsa, sa i përket qëllimit të katërt të dënimit (viktimat dhe komuniteti) gjykata të njëjtin nuk e aplikon dhe nuk e arsyeton fare në këtë aktgjykim.

18.2.2 Zbatimi i parimeve

Gjykata në këtë rast vetëm ka cituar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, duke mos bërë asnjë ndërlidhje me parimet që duhet të merren parasysh me rastin e caktimit të dënimit, siç përcaktohet në udhëzues.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Sa i përket faktit se i dënuari për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, sipas udhëzuesit, kjo rrethanë kualifikohet tek rrethanat e tjera lehtësuese. Në udhëzues thuhet se nëse gjykata e konstaton mungesën e dënimeve të mëparshme penale dhe mund të jepet zbutja, do të kërkoj gjetje të fakteve që e mbështesin përfundimin e sjelljes përkatëse dhe predispozitat për rehabilitim. Kjo çështje nuk trajtohet fare në këtë aktgjykim. Sa i përket rrethanës lehtësuese se i akuzuari është familjar, udhëzuesi përcakton shtatë faktorë në të cilët gjykata duhet të bazohet në rastin kur këtë rrethanë e përcakton si rrethanë lehtësuese dhe të njëjtit faktor duhet ti arsyetojë, gjë të cilën nuk e ka bërë gjykata në këtë aktgjykim. Sa i përket dashjes së të pandehurit, gjykata jep një arsyetim modest, duke treguar se nuk kanë qenë vetëm lëshimet e tij shkaktar të aksidentit. Sa i përket mos pranimit të fajësisë dhe kërkim faljes për kryerjen e kësaj veprë penale, gjykata nuk ka dhënë asnjë arsyetim mbi aplikimin e këtyre fakteve si rrethana rënduese.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruar nga aktgjykimi

Gjykata nuk ka marrë parasysh fare nëse vepra penale përfshin disa viktime, moshën e viktimës, bashkëpunimi i përgjithshëm i personit me gjykatën, shkallën e dëmit të shkaktuar, (mos) kompensimi i dëmit të shkaktuar, sjelljen e personit të dënuar pas konfliktit, (mos) shkelja e urdhrave të gjykatës, kalimin e kohës dhe (mos) mbështetja pala e dëmtuar.

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Gjykata në këtë rast nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me rëndësinë e brendshme të rrethanave dhe po ashtu, nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me peshimin e rrethanave. Për këtë arsye, llogaritja është kuantitative. Në rastin konkret, gjykata ka marrë parasysh tre rrethana lehtësuese dhe dy rrethana rënduese, që sipas udhëzuesit bëhet fjalë për rastet kur kemi “ekzistimin e pak rrethanave rënduese së bashku me shumë rrethana lehtësuese apo zbutëse”, që kualifikohet tek faktorët që tregojnë më shumë rrethana lehtësuese se sa rënduese. Sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 1, pika d, dënimi me gjobë në këtë rast duhet të jetë nga 6.250 euro deri në 12.500 euro, që nënkupton se dënimi i shqiptuar në këtë aktgjykim nuk është brenda këtyre limiteve.

19 Rasti P.nr.1961/2016 - Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 të KPRK-së

Aktgjykimi i marrë

Sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm të shpallur më 17 prill 2019 i dënuari P.M. ishte shpallur fajtor për veprën penale “Posedim i paautorizuar i narkotikëve”. Kjo pasi që sipas aktgjykimit, i dënuari më 27 dhjetor 2013, rreth orës 22:10 në Prishtinë, në rrugën “Sylejman Vokshi”, pa autorizim ka poseduar substancë narkotike, në atë mënyrë që gjatë punës operative zyrtarët policorë, pasi e kishin ndalur për identifikim, i kanë gjetur një qese plastike me substancë bimore, ngjyrë e gjelbër dhe një substancë e mbështjelle, me ç ‘rast sipas ekzaminimit nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë në Prishtinë, jepet konstatimi dhe mendimi se në bazë të karakteristikave morfologjike dhe përbërjes kimike, se dëshmia 1 dhe 2, përmbajnë kanabis (marihuanë), që përmban Tetrahidrokarbinol (THC), me peshë të përgjithshme neto 1.04 gramë.

Dënimi sipas KPRK-së: dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet.

Dënimi i shqiptuar: dy (2) muaj burg me kusht dhe gjobë 200 euro.

Rrethanat lehtësuese:

1. I dënuari ka qenë i singertë gjatë shqyrtimit gjyqësor;
2. Ka pranuar fajësinë në fazat fillestare;
3. Ka gjendje të vështirë ekonomike;

Rrethanat rënduese

Asnjë

Përshtatshmëria e dënimit:

Gjykata ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryerësit, me bindje se dënimi i tillë do ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe do të ndikojë në ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Sa i përket faktit se i dënuari është person i varfër, gjykata nuk ka dhënë asnjë arsytim përkitazi me këtë rrethanë.

Zbatimi i udhëzuesit

Përshtatshmëria e dënimit

Gjykata në këtë aktgjykim ka cituar tre prej qëllimeve të dënimit dhe e ka marrë si të mirëqenë faktin se me shqiptimin e këtij dënimi, të njëjtat qëllime do të arrihen, mirëpo që asnjërin prej këtyre tre qëllimeve gjykata nuk i ka arsytuar. Sa i përket qëllimit të katërt (viktimat dhe komuniteti) gjykata nuk e ka aplikuar dhe arsytuar fare këtë qëllim të dënimit të paraparë me udhëzues.

Zbatimi i parimeve

Gjykata në këtë rast vetëm ka cituar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, duke mos bërë asnjë ndërlidhje me parimet që duhet të merren parasysh me rastin e caktimit të dënimit, siç përcaktohet në udhëzues.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Sa i përket sinqeritetit të treguar, kjo në udhëzues nuk përmendet fare si rrethanë, ndërsa gjykata nuk ka dhënë asnjë arsytim se pse ky fakt duhet të shërbejë si rrethanë lehtësuese. Tek pranimi i fajësisë, asnjë kërkesë e cila sipas udhëzuesit duhet të aplikohet me rastin e marrjes parasysh të kësaj rrethane, e cila përcakton edhe rëndësinë e kësaj rrethane në rastin konkret, nuk është marrë parasysh, si dhe gjykata nuk ka dhënë përgjigje në katër pyetjet që sipas udhëzuesit, janë relevante në këtë rast. Po ashtu, gjykata vetëm e ka cituar gjendjen e dobët së të dënuarit, derisa nuk ka dhënë asnjë arsytim të këtij fakti në kuptim të rrethanës lehtësuese.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruara nga aktgjykimi

Gjykata nuk ka marrë parasysh fare shkallën e dashjes, bashkëpunimi i përgjithshëm i personit me gjykatën, pendimin/mungesën e pendimit nga i dënuari, (mos) keqardhjen e

shfaqur, sjelljen e personit të dënuar pas konfliktit, e kaluara kriminale/jo kriminale e të dënuarve, (mos) shkelja e urdhrave të gjykatës dhe kalimin e kohës.

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Gjykata në këtë rast nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me rëndësinë e brendshme të rrethanave dhe po ashtu, nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me peshimin e rrethanave. Për këtë arsye, llogaritja është kuantitative. Në rastin konkret, gjykata ka marrë parasysh tre rrethana lehtësuese dhe asnjë rrethanë rënduese, që sipas udhëzuesit bëhet fjalë për rastet kur kemi “ekzistimin e së paku dy rrethanave për zvogëlim të fajësisë apo dëmit dhe asnjë/ose një rrethanë të vogël rënduese”, që kualifikohet tek rrethanat që arsyetojnë zbutjen maksimale të dënimit brenda kufirit. Në këtë aktgjykim, gjykata fare nuk i është referuar nenit 75 për zbutjen e dënimit, ndonëse ka shkuar nën minimumin e përcaktuar ligjor. Sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 3, pika b, dënimi me burgim në këtë rast duhet të jetë nga 1 vit deri në 1 vit e 6 muaj burgim, derisa ai me gjobë duhet të jetë nga 100 deri në 6250 euro. Në rastin konkret, dënimi i shqiptuar, si ai me burgim ashtu edhe ai me gjobë, është jashtëzakonisht më i ulët se sa këto limite të përcaktuara nga udhëzuesi.

20 Rasti P.nr.4173/2018 - Mos raportim ose raportim i rremë i pasurisë, i të ardhurave personale ose i dobisë materiale ose detyrimeve financiare – 437 par.1 KPRK

Aktgjykimi i marrë

Sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, të shpallur më 16 prill 2019, të dënuarin F.G. e kishte shpallur fajtor për veprën penale “Mos raportim ose raportim i rremë i pasurisë, i të ardhurave personale ose i dobisë materiale ose detyrimeve financiare”, pasi që gjykata kishte gjetur që i pandehuri prej 1 mars deri më 31 mars 2018, edhe pse kishte qenë i detyruar që në cilësinë e zyrtarit të lartë publik të bëjë deklarimin e pasurisë, nuk e kishte deklaruar pasurinë në formularin e deklarimit të pasurisë për periudhën kohore nga data 1 janar deri më 31 dhjetor 2017.

Dënimi sipas KPRK-së: *gjobë dhe burgim deri në tre (3) vjet*

Dënimi i shqiptuar: *tre (3) muaj burg me kusht dhe 200 euro gjobë*

Rrethanat lehtësuese:

1. I dënuari ka pranuar fajësinë;
2. Singëritetin e treguar gjatë shqyrtimit fillestar;
3. Nuk ka qenë i dënuar më parë;

Rrethanat rënduese

Asnjë

Përshtatshmëria e dënimit:

Gjykata ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryerësit, shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryerësit. Gjykata është e bindur se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit në parandalimin e kryerësit por edhe të personave të tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe do të ndikojë në ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Zbatimi i udhëzuesit

Përshtatshmëria e dënimit

Gjykata në këtë aktgjykim ka cituar tre prej qëllimeve të dënimit dhe e ka marrë si të mirëqenë faktin se me shqiptimin e këtij dënimi, të njëjtat qëllime do të arrihen, mirëpo që asnjërin prej këtyre tre qëllimeve gjykata nuk i ka arsyetuar. Sa i përket qëllimit të katërt (viktimat dhe komuniteti) gjykata nuk e ka aplikuar dhe arsyetuar fare këtë qëllim të dënimit të paraparë me udhëzues.

Zbatimi i parimeve

Gjykata në këtë rast vetëm ka cituar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, duke mos bërë asnjë ndërlidhje me parimet që duhet të merren parasysh me rastin e caktimit të dënimit, siç përcaktohet në udhëzues.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura në aktgjykim

Tek pranimi i fajësisë, asnjë kërkesë e cila sipas udhëzuesit duhet të aplikohet me rastin e marrjes parasysh të kësaj rrethane, e cila përcakton edhe rëndësinë e kësaj rrethane në rastin konkret, nuk është marrë parasysh, si dhe gjykata nuk ka dhënë përgjigje në katër pyetjet që sipas udhëzuesit, janë relevante në këtë rast. Sa i përket sinqeritetit të treguar, kjo në udhëzues nuk përmendet fare si rrethanë, ndërsa gjykata nuk ka dhënë asnjë arsyetim se pse ky fakt duhet të shërbejë si rrethanë lehtësuese. Sa i përket faktit se i dënuari për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, sipas udhëzuesit, kjo rrethanë kualifikohet tek rrethanat e tjera lehtësuese. Në udhëzues thuhet se nëse gjykata e konstaton mungesën e dënimeve të mëparshme penale dhe mund të jepet zbutja, do të kërkoj gjetje të fakteve që e mbështesin përfundimin e sjelljes përkatëse dhe predispozitat për rehabilitim. Kjo çështje nuk trajtohet fare në këtë aktgjykim.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të injoruara nga aktgjykimi

Gjykata nuk ka marrë parasysh fare shkallën e dashjes, bashkëpunimin i përgjithshëm i personit me gjykatën, shkallën e dëmit të shkaktuar, rrethanat personale dhe karakteri i personit të dënuar, pendimin/mungesën e pendimit nga i dënuari, (mos) keqardhjen e shfaqur, (mos) kompensimi i dëmit të shkaktuar, sjelljen e personit të dënuar pas konfliktit dhe (mos) shkeljen e urdhrave të gjykatës.

Metoda e udhëzuesit për matjen e dënimit

Gjykata në këtë rast nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me rëndësinë e brendshme të rrethanave dhe po ashtu, nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me peshimin e rrethanave. Për këtë arsye, llogaritja është kuantitative. Në rastin konkret, gjykata ka marrë parasysh tre rrethana lehtësuese dhe asnjë rrethanë rënduese, që sipas udhëzuesit bëhet fjalë për rastet kur kemi “ekzistimin e së paku dy rrethanave për zvogëlim të fajësisë apo dëmit dhe asnjë/ose një rrethanë të vogël rënduese”, që kualifikohet tek rrethanat që arsyetojnë zbutjen maksimale të dënimit brenda kufirit. Sipas shtojcës 1 të udhëzuesit, pjesa 1, pika f, dënimi me burgim në këtë rast duhet të jetë nga një muaj deri në tetë muaj burgim, ndërsa ai me gjobë duhet të jetë nga 100 deri në 6250 euro, që i bie se në rastin konkret, dënimi është brenda kufijve.

XI. Politika ndëshkimore në Gjykatën e Apelit

Sipas udhëzuesit, “një nga qëllimet më të rëndësishme të udhëzimit për caktimin e dënimit është që të zvogëlohet dallimi apo pabarazia në dënime pa hequr diskrecionin e gjyqtarëve për t’iu adaptuar situatave të veçanta”.

Në këtë drejtim, vendosjen e standardeve dhe praktikave të drejta dhe në përputhje me udhëzuesin e ka për obligim Gjykata e Apelit, e cila shërben si korigjuese e gjykatave të shkallës së parë. Për këtë arsye, barra për zbatimin e udhëzuesit bie pothuajse në masën më të madhe të Gjykatës së Apelit, si gjykatë e cila mban përgjegjësinë për unifikimin e praktikave në gjykatat e shkallës së parë.

Për të parë se si Gjykata e Apelit e shqyrton çështjen e vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, si dhe aplikimin dhe arsyetimin e kësaj çështje në kuptim të udhëzuesit, IKD ka analizuar 10 aktgjykime të Gjykatës së Apelit, të cilat janë të natyrave të ndryshe (rastet: 1. PAKR.nr.525/2018, 2. PAKR.nr.80/2019, 3. PAKR.nr.629/2018, 4. PAKR.nr.585/2018, 5. PAKR.nr.95/2019, 6. PAKR.nr.246/2018, 7. PAKR.nr.77/2019, 8. PAKR.nr.27/2018, 9. PAKR.nr.88/2018 dhe 10. PAKR.nr.89/2018).

Fillimisht, pas analizimit të këtyre rasteve, IKD ka gjetur se edhe brenda vetë Gjykatës së Apelit çështja e politikës ndëshkimore, në kuptim të udhëzuesit, nuk është e unifikuar. Kjo për arsye se ka një laramani të madhe në mes të aktgjykimeve të Gjykatës së Apelit për këtë pjesë. Në këtë mënyrë, përderisa edhe brenda vetë Gjykatës së Apelit nuk ka një standard të unifikuar se si vepron në këto raste, praktika në gjykatat e shkallës së parë do aq më e pa unifikuar.

Në shtatë prej këtyre 10 aktgjykimeve, Gjykata e Apelit vetëm citon rrethanat rënduese apo lehtësuese, dhe nuk vepron në frymën e udhëzuesit, i cili për secilën rrethanë përcakton faktorët që duhet të merren parasysh, pyetjet relevante të cilave gjykata duhet tu jap përgjigje në aktgjykim, konsideratat për rrethanën etj. Në këtë drejtim, në këto aktgjykime, gjykata vetëm citon dhe përmend rrethana të ndryshme, por nuk bënë asnjë ndërlidhje të rrethana të përdorura me parimet e dënimit dhe me qëllimet e dënimit. Madje, në një prej këtyre shtatë rasteve, gjykata nuk jep asnjë arsyetim mbi çështjen e rrethanave lehtësuese dhe rënduese të aplikuar nga gjykata e shkallës së parë, parimeve të dënimit dhe qëllimeve të dënimit.

Ndërsa, në vetëm një aktgjykim gjykata trajton në detaje rrethanat lehtësuese dhe rënduese, në atë mënyrë që përpos që përcakton rrethanat e injoruara, kjo gjykatë edhe arsyeton vetë rrethanat e përdorura, duke i ndërlidhur me rrethana të ndryshme faktike. Pjesërisht, këtë gjykata e bënë në këtë mënyrë në dy aktgjykime të tjera.

Për më tepër, as vetë Gjykata e Apelit, ashtu si edhe gjykatat e shkallës së parë, nuk jep arsyetim mbi rëndësinë e brendshme të rrethanave dhe peshimin e rrethanave, çfarë e forcon në masë jashtëzakonisht të madhe se këto dy parime të rëndësishme të politikës ndëshkimore sipas udhëzuesit, janë të vdekura në praktikë.

Po ashtu, janë një sërë problematikash të tjera të aktgjyqimeve të shkallës së parë në raport me udhëzuesin, të cilat janë edhe të gjetura të këtij raporti, që Gjykata e Apelit nuk i shqyrton fare në këto aktgjyqime. Në asnjërin prej këtyre 10 aktgjyqimeve, gjykata nuk e ka trajtuar faktin nëse ka pasur apo jo dyfishim të rrethanave, mos ndërlidhje të rrethanave me parimet e dënimit, mos arsyeshmëri të qëllimeve të dënimit etj.

Në këtë mënyrë, nga të gjeturat e këtij raporti është ajo se Gjykata e Apelit renditet në radhën e gjykatave të cilat nuk janë zbatues të udhëzuesit, apo janë zbatues minimal.

Në këtë drejtim, nëse Gjykata e Apelit do të vazhdojë që aktgjyqimet e saj ti trajtojë në kuptim të udhëzuesit, IKD vlerëson se është pikërisht Gjykata e Apelit ajo e cila do ta humb edhe vullnetin brenda gjykatave të shkallës së parë që të kemi një reformim sa i përket politikës ndëshkimore. Kjo pasi nëse gjyqtarëve të njëjtë u vërtetohen raste të cilat janë në kundërshtim me kërkesat e udhëzuesit, kjo e bënë udhëzuesin pothuajse të vdekur, pasi krijohet bindja se mënyra se si gjykatat e shkallës së parë arsyetojnë rrethanat është e drejtë.

XII. Rekomandime

1. Sistemi gjyqësor ta ketë parasysh se është koha e fundit për të ndërtuar një sistem konsistent të politikës ndëshkimore. Në këtë drejtim, sistemi gjyqësor duhet ta ketë parasysh se miratimi i udhëzuesit ka qenë një hap në drejtim të konsolidimit të politikës ndëshkimore në Republikën e Kosovës dhe jo vetë konsolidimi i kësaj politike.
2. Gjyqtarët ta respektojnë udhëzuesin me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit.
3. Gjyqtarët ta kuptojnë se për palët dhe publikun nuk është me rëndësi ajo çfarë ka menduar gjyqtari, por ajo çfarë gjyqtari e ka arsyetuar në aktgjykim.
4. Gjyqtarët me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, të kenë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që parashihet me KPRK dhe sqarohen në udhëzues
5. Këto rrethana, gjyqtarët ti arsyetojnë konform kërkesave të udhëzuesit
6. Gjyqtarët të kenë kujdes dhe ti shmangen dyfishimit të rrethanave, pasi në këto raste krijohen situatat kur nga një rrethanë lehtësuese apo rënduese, i pandehuri përfiton apo pëson më tepër se sa që e parasheh ligji
7. Gjyqtarët në secilin rast, të caktojnë rëndësinë e brendshme për secilën rrethanë të aplikuar
8. Gjyqtarët në secilin rast të bëjnë peshimin e rrethanave
9. Gjyqtarët të zbatojnë në secilin rast parimet e dënimit
10. Gjyqtarët duhet që në secilin aktgjykim ta trajtojnë përshtatshmërinë e dënimit
11. Gjykatat duhet ti aplikojnë të gjitha qëllimet e dënimit të cilat i përcakton udhëzuesi si dhe arritjen e tyre përmes dënimit të shqiptuar ta arsyetojnë, dhe jo ta marrin si fakt të mirëqenë.
12. Me rastin e caktimit të dënimit, gjykatat ti referohen udhëzuesit, përkatësisht kapitullit “*zbatimi i udhëzuesi në praktikë*” dhe shtojcës 1 të udhëzuesit.
13. Gjyqtarët ti shmangen shablloneve të aplikimit dhe arsyetimit të rrethanave si dhe arsyetimit lidhur me përshtatshmërinë e dënimit, në atë formë që arsyetimi të jetë specifik për secilin rast.
14. Komisioni për Vlerësimin e Performancës brenda KGJK-së, të analizojë aktgjykimet e gjyqtarëve edhe në pjesën e arsyetimit lidhur me caktimit e llojit dhe lartësisë së dënimit, dhe të intervenojë me masa konkrete dukuri të cilat janë në kundërshtim me politikën e drejtë ndëshkimore, të përcaktuar me KPRK dhe të sqaruar përmes udhëzuesit.
15. KGJK të organizojë trajnime dhe seminare intensive për të gjithë gjyqtarët, në mënyrë që ti trajnojnë të njëjtit për përdorimin e udhëzuesit.